

BOTIM I UNIVERSITETIT MESDHE'TAR TË SHQIPËRISË

EUROMEDITERRANEAN

Revistë periodike shkencore

5

Dhjetor 2011

Tiranë, Dhjetor 2011

© UMSH PRESS

EUROMEDITERRANEAN

Revistë shkencore

Botim i UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

Nën Drejtimin e Akad.Asoc. Prof. Dr Anastas ANGJELI

Bordi i Nderit

Prof.Dr.Arben Puto
Prof.Dr.Artistotel Pano
Prof.Dr.Sabah Hilmija
Prof.Dr.Ilia Kristo
Prof.Dr.Emin Riza
Prof.Dr.Vasil Tole

Kryeredaktor

MA. Ilir HEBOVIJA

Redaktorë Shkencore

MA.Nevila RAMA
MA.Kriton KUÇI

Bordi Drejtues-Shkencor -Editorial

Kryetar

Prof.Dr.ANASTAS ANGJELI

Akademik i Asoc.

Anëtarë

Prof.Dr.Kosta Bajraba
Prof.Dr Ilia Kristo
Prof.Dr. Esmeralda Uruçi
Prof.Dr. Stefan Çapaliku
MA. Ben Blushi
Prof.Asoc. Mimoza Manxhari
Prof.Dr.Orfea Dhuci
Dr. Hysen Çela
Dr. Altin Hoti
Dr. Fatos Ibrahimimi
Dr.Skender Demaliaj
MA. Gjergj Teneqexhi
MA. Ardian Petollari
MA. Nevila Rama
MA Jona MARASHI
MA. Ilir Aliaj
MA.Besnik Leskaj
MA. Kriton Kuci
MA. Etleva Vertopi
MA.Merita Myftari
MA. Emilio Cika

Kopertina Quick Advertise

Faqosja: Dafina Stojko

© UMSH PRESS

Shtypyr: GEER, 2011

PËRMBLEDHJA

I. ARSIMI

ASPEKTE TË POLITIKËS SË SHTETIT SHQIPTAR NDAJ

SHKOLLAVE TË MINORITETEVE ETNIKE

GJATË PERIUDDHËS SË MONARKISË (1928-1939)

Hasan BELLO

Qendra për Studime Albanologjike 7

INVESTIMET TURKE EDUKATIVO-ARSIMORE NË BALLKAN NË EPOKËN E GLOBALIZMIT

Muhamed ALI

Ss.Cyril and Methodius University, Skopje, Macedonia. 26

MËSIMDHËNIA INTERAKTIVE DHE ROLI I KOMUNIKIMIT NË VLERËSIMIN E STUDENTIT

Evis TASKA

Mediterranean University of Albania

Nevila RAMA

Mediterranean University of Albania 38

CILËT JANË FAKTORËT QË PËRBËJNË KËRKESAT

PASUNIVERSITARE, DHE CILAT JANË NIVELET

E PAJTIMIT ME KËTA FAKTORË?

Nevila XOXA

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Greta ANGJELI

Universiteti Mesdhetar i Tiranës

Vladimir MICI

Universiteti Mesdhetar i Tiranës 47

REFORMA LIGJORE NË ARSIMIN E LARTË PËRBALLË

NEVOJAVE TË SHOQËRISË SHQIPTARE

Rovena SULSTAROVA (ÇADRI)

Ministrisa e Arsimit dhe Shkencës 66

II. FAMILJA

VLERËSIMI I QËNDRIMEVE NDAJ TERAPISË SË FAMILJES

Brilanda LUMANAJ

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" 79

MARTESAT NDËRMJET PERSONAVE TË TË NJËJTIT SEKS

Ergysa IKONOMI

Universiteti Ismail Qemali

Jonada ZYBERAJ

Universiteti Ismail Qemali 94

**MBI ZBATIMIN E LIGJIT TE RI PER DHUNEN NE
FAMILJE: PERVOJE, PROBLEME, SUGJERIME**

Uarda ALBUNESA

Hermina ALBUNESA 109

FËMIJËT ME NËNA TË DËNUARA

Juliana AJDINI

Universiteti i Tiranës 125

**ROLI PRAKTIKAVE EDUKATIVE FAMILJARE NË
NDËRTIMIN SOCIAL TË IDENTITETIT GJINOR TEK FËMIJA**

Marta TOPÇIU

Universiteti Aleksandër Xhuvani

Joana MYFTIU

Universiteti Aleksandër Xhuvani 137

**FORMA DHE STRUKTURA E FAMILJES NË SHOQËRINË
BASHKËKOHORE - NJË VIZION DHE SFIDE GLOBALE**

Sonila OMARI

Universiteti i Tiranës

Eniana QARRI

Universiteti i Tiranës 149

III. KOMUNIKIMI**DIMENSIONET SOCIAL-KULTURORE NË EVIDENTIMIN
E VLERAVE DHE NDËRTIMIN E IMAZHEVE PËR TURIZMIN**

Dhimitraq Furxhi

Teatri Petro Marko 167

E DREJTA PER TU INFORMUAR DHE INTERESI PUBLIK

Loreta TOZAJ (ALUSHI)

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Eriola CAKRANI (HOXHA)

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë 182

ASPEKTET PSIKOSOCIALE TË KOMUNIKIMIT

Roland LAMI

Universiteti European i Tiranës 194

I.

ARSIMI

ASPEKTE TË POLITIKËS SË SHTETIT SHQIPTAR NDAJ SHKOLLAVE TË MINORITETEVE ETNIKE GJATË PERIUDHËS SË MONARKISË (1928-1939)

Hasan BELLO

Qendra për Studime Albanologjike

ABSTRACT

Tolerant attitude towards ethnic minorities during the monarchy was seen as part of official policy which will further contribute to the stability of the state. Such an attitude is reflected in the number of educational institutions, which, in proportion to minority population was located in a compact manner. However, due to the fact that ethnic minorities were seen as means of penetration and political influence from neighbouring countries, the Albanian Government pursued a policy which kept asunder constant control these institutors along with their teaching staff. Compared with other Balkan states, in which lived a large number of the Albanian population, the Albanian Government pursued a correct policy, in accordance with all international conventions which guarantee the freedoms and rights of ethnic minorities. In this context, also the right to education in mother tongue.

Keywords : ethnic minorities in Albania, schools in ethnic language

Me 17 dhjetor 1920, kur Asambleja e Përgjithshme e Lidhjes së Kombeve vendosi të pranonte Shqipërinë si anëtare me të drejta të plota të kësaj organizate ndërkombëtare, pati «shprehur dëshirën» që qeveria shqiptare të zotohej për mbrojtjen e pakicave në territorin e saj¹. Në vitin 1921, kur qeverisë shqiptare iu desh të bënte një luftë të ashpër për të shpëtuar kufijtë e 1913-s, Lidhja e

1 Arben Puto, *Demokracia e rrethuar*, Tiranë: "8 Nëntori", 1990, f.144.

Kombeve, krahas rekomandimit që i bëri Konferencës së Ambasadorëve për të zgjidhur këtë çështje, kërkoi prej saj (qeverisë shqiptare), gati si një kusht paraprak, që të merte zotime konkrete për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Shqipëri². E gjendur nën presion më 2 tetor 1921, qeveria shqiptare e cila përfaqësohej në Gjenevë nga Fan Stilian Noli, u detyrua të nënshkruante një deklaratë të posaçme, si dhe të pranonte “Regjimin e mbrojtjes së minoriteteve”³. Kjo deklaratë kishte trajtën e një statuti, në artikullin 1, shkruhej se: “Ujdirat që përmban kjo deklaratë do të quhen si ligje themelore në Shqipëri. Gjithë ndënjësve në Shqipëri do t’u jepet mbrojtje e plotë”; në bazë të artikullit 2, “Lidhur me minoritetet Shqipëria pranonte autoritetin e Lidhjes së Kombeve”; ndërsa sipas artikullit 3, “Shqipëria është gati t’u shtrohet porosive që do t’i bëhen nga ana e Këshillit të Shoqërisë së Kombeve, mbi emigracionin e të dy palëve edhe me vullnetin e atyre që përbëjnë minoritetet etnike”⁴.

Një kërkesë tjetër e deklaratës ishte dhe fakti se, qeveria shqiptare, ishte e detyruar që brenda 6 muajve nga nënshkrimi t’i paraqeste Këshillit të Lidhjes së Kombeve një raport të hollësishëm «mbi statusin legal të komuniteteve fetare, kishave, manastireve, shkollave, shoqatave bamirëse të pakicave» të racës, fesë dhe gjuhës së ndryshme, por dhe të merte parasysh çdo rekomandim që mund t’i bëhej për këtë nga Lidhja e Kombeve⁵.

Pas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të 9 nëntorit 1921, i cili i hidhte poshtë pretendimet territoriale greke e jugosllave, duke i njohur vetëm Italisë disa të drejta të posaçme strategjike dhe ekonomike⁶, Greqia, vazhdoi të ushtronte presion mbi shtetin shqiptar duke bërë akuza për keqtrajtimin e popullsisë së krishterë dhe të minoritetit grek. Që t’i jepej fund një gjendjeje të tillë, qeveria shqiptare i kërkoi Lidhjes së Kombeve të dërgonte një komision hetimor. Ky arriti në Shqipëri në fillim të vitit 1922 dhe përbëhej nga ekspertë të Lidhjes së Kombeve, me në krye delegatin suedez Sedërholm⁷. Raporti i këtij

2 Dhimitër Berati, *Qëllimet dhe Organizimi i Lidhjes së Kombeve*, Tiranë: Mbrothësija, 1931, f.3-4.

3 Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: *AQSh*), Fondi: Ministria e Punëve të Brendshme, viti 1921, dosja 288, fl.2-3.

4 *Po aty*.

5 S.d.N, *Protection des minorities en Albanie. Résolution du 2 octobre 1921 et Déclaration de la Délégation albanaise (même date)*. Doc. A. 176. 1921, CC. 361.

6 Gaetano Salvemini, *Mussolini diplomatico (1922-1932)*, Bari: Laterza, 1952, p.194; Amedeo Giannini, *L’Albania dall’indipendenza all’unione con Italia (1913-1939)*, Milano: Istituto per gli Studi di Politica Internazionale, 1939, p.132-134.

7 Beqir Meta, *Tensioni Greko-Shqiptar (1939-1949)*, Tiranë: GEER, 2002, f.29-30.

komisioni, iu paraqit Këshillit të Lidhjes së Kombeve më 12 maj 1922⁸. Ndërsa në maj të vitit 1923 Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve paraqiti raportin sipas të cilit numri i popullsisë greqishtfolëse në Shqipërinë e Jugut arrinte deri në 35000-40.000 persona⁹. Në prefekturën e Korçës, nënvizon raporti, nuk ekzistonte edhe sipas statistikës greke, asnjë popullatë që të fliste greqisht: “nëse zoti Klemanso*, munda të thotë më 1913 se në Korçë mbase gjysma e popullsisë ishte greke, opinioni i tij që nuk është vërtetuar nga faktet është shkaktuar nga ngatërrimi i fesë me racën. Ky ngatërrim është vënë re shpesh kur ka qenë rasti për të biseduar mbi çështjet e Ballkanit, ku është njësuar feja ortodokse me kombësinë greke”¹⁰.

Shqipëria pasi nënshkroi në Gjenevë deklaratën mbi mbrojtjen e minoriteteve i përmbushi detyrimet e saj në mënyrë të njëanshme, kjo për faktin se krahasur me gjendjen e popullsisë shqiptare në Jugosllavi e Greqi, që ishin objekt i persekutimeve më të rënda, ngritur në politikë zyrtare, megjithë ankesat e drejtuara nga personalitetet e kohës nuk u bë ndonjëherë problem serioz në organet e Lidhjes së Kombeve¹¹.

Minoritetet vazhduan të gëzonin në Shqipëri të gjitha të drejtat që gëzonte çdo qytetar shqiptarë, ata kishin institucionet e tyre arsimore, objektet e kultit, si dhe të gjitha hapësirat e duhura për t’u integruar në sferat e jetës politike, administratës lokale dhe asaj qendrore.

Periudha e monarkisë, e cila përbën një nga etapat më të rëndësishme të konsolidimit të shtetit shqiptar, është një nga periudhat më me interes për të treguar se si janë trajtuar minoritetet në vendin tonë. Dhe në këtë kuadër, vlen të merret në shqyrtim politika e shtetit të asaj kohe ndaj shkollave të minoriteteve etnike, si një nga të drejtat më themelore për këtë kategori.

Sipas disa studiuësve: “Mbreti Zog, i ndodhur përballë fqinjëve të fuqishëm dhe me aspirata kundrejt shtetit shqiptar, u përpoq që të bënte një politikë pragmatiste dhe sa më luajale ndaj tyre. Qëndrimi tolerant dhe luajal ndaj minoriteteve u konsiderua si një pjesë e kësaj politike dhe si një faktor që do të

8 *League of Nations Journal*, viti III, nr.6, f.575.

9 *AQSh*, Fondi 251, viti 1923, dos.211, fl.241-242. Raporti i Komisionit Hetimor i Lidhjes së Kombeve; *Politika*, 21 qeshor 1923, Nr.23; *Populli*, 29 maj 1923, Nr.16. *Zhorzh Klemanso, Politikan francez, kryeministër e ministër i brendshëm.

10 *Po aty*, fl.243.

11 *AQSh*, Fondi “Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, viti 1921, dos.56, fl.12-16. Promemoria e paraqitur nga Bedri Pejani në Kongresin ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të popujve, që i zhvilloi punimet në Gjenevë nga data 1-10 shtator 1921, nuk u mor aspak parasyshë. Megjithëse ai ishte përfaqësues i “Komiteteve të Bashkuara të Shqiptarëve Irredentistë”.

kontribonte në stabilitetin e shtetit shqiptar¹². Por, as kjo nuk e ndali fushatën mediatike dhe presionet që vazhdimisht shtetet ballkanike bënin lidhur me këtë çështje. Në krye të kësaj fushate qëndronte shtypi grek, i cili, me datë 14 maj 1929 shkruante se: “sipas informatave që kemi, jeta e popullsisë greko-ortodokse të vorio-epirit, nën regjimin shqiptar të Ahmet Zogut, që tashi së fundi u kurorëzua si mbret, është bërë e pajetueshme. Çdo shenjë lirie është hequr; më në fund u hoqën gjuha dhe kishat. Nëse nuk kemi mënyrë tjetër për t’iu imponuar vendit fqinjë, të paktën, le të heqim që andej popullsin tonë që të zbresin për të punuar tokën e Epirit të lirë, se është mëkat t’i sakrifikojmë me dijeninë tonë¹³. Ndërsa po një tjetër e përditshme greke, akuzonte autoritetet shqiptare, se gjoja nuk po sillëshin mirë me pakicën greke që ishte aty, dhe njëkohësisht kritikonte përfaqësinë e vendit të saj, se duhet të bënte më shumë për këtë pakicë¹⁴. Nga një raport i nënprefekturës së Delvinës, mbi përfundimin e vitit shkollor 1928-1929, krahas pasqyrimit të problemeve të arsimit në këtë rajon, midis të tjerave informohen instancat qeveritare se: “dhespoti i Janinës ishte “dirigjuesi” i përgjithshëm i arsimit në Epirin Jugor, në Janinë, edhe i Epirit Verior siç e quajnë ata Prefekturën e Gjirokastrës¹⁵. Sipas raportit, ky dhespot kishte në dispozicion fonde kolosale për këtë qëllim. Me këto fonde paguheshin mësuesit e shkollave grekofone, të cilët përbënin një kategori shumë më të dobët, krahasuar kjo me mësuesit e shkollave shqiptare, por, “ideja panhelenike dhe interesi i madh që tregonte Greqia, bënte që këto shkolla të funksiononin sido që kanë personel të dobët¹⁶. Megjithatë, siç shihet dhe nga tabelat në shtojcën e këtij shkrimi, ku jepen në mënyrë të detajuar pasqyrat përmbledhëse të shkollave të minoriteteve etnike në Shqipëri (tabelat: 2, 3, 4) edhe sipas shpërndarjes gjeografike (tabelat: 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13) minoritetet dispononin institucione arsimore dhe mësues në varësi të nevojave. Pa ju mohuar aspak e drejta që ato kishin për të mësuar në gjuhën amtare.

Përfundim të bënin vetëm rastet kur në këto shkolla nuk zbatoheshin rregullat dhe kriteret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Kështu, me 13 janar 1930, Ministri i Arsimit Abdurrahman Dibra informonte Ministrinë e Punëve të Jashtme se disa ditë më parë kishte dhënë urdhër për mbylljen e shkollës ortodokse serbe në Shkodër. Për arsye se kjo shkollë, megjithë urdhërat e

12 Beqir Meta, “Politika e shtetit shqiptar ndaj minoriteteve gjatë periudhës së monarkisë”, në *Studime Historike*, nr.3-4, Tiranë 2009, f.203.

13 Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), viti 1929, dosja 850, fl.122, Gazeta “*Imerisios Tipos*”, 14.4.1929.

14 *Po aty*, Gazeta “*Eleftheron Vima*”, 14.4.1929.

15 *AQSh*, Fondi 295, viti 1929, dosja 7, fl.42.

16 *Po aty*, fl.43.

dhëna më përpara, vijonte të mos aplikonte programin e shtetit dhe të jepte mësim vetëm në gjuhën serbe. Në këtë shkollë jepnin mësim mësues që s' dinin fare shqip dhe që s'ishin nënshtetas shqiptarë, gjithashtu librat dhe regjistrat e përdorura nuk ishin ato të miratuara nga ky dikaster. Sipas Ministrisë të Arsimit, kjo shkollë nuk mund të vijonte më në këtë mënyrë mbasi veprimtaria e saj binte në kundërshtim me Statutin Themeltar të Mbretërisë. Në bazë të një marrëveshje që këto dy ministri kishin bërë me njëra-tjetrën, kishin vendosur që përkohësisht t'a lejonin këtë shkollë derisa ajo të përmbushte kriteret e mësipërme, në të kundërtën ishte vendosur që ajo të mbyllej. Prandaj, porosiste Ministri i Arsimit, kjo duhet t'u njoftohet të interesuarve (Legatës Jugosllave)¹⁷.

Ministri i Punëve të Jashtme z.Rauf Fico, me 7 maj 1930 informonte Ministrinë e Arsimit se qeveria e Rumanisë, duke u interesuar miqësisht për çështjen e arsimit të vllahëve që jetonin në Shqipëri, me anë të përfaqësuesit të saj në Tiranë, në mënyrë verbale i kishte parashtruar atij disa propozime. Me qëllim që të gjendej një zgjidhje e kënaqshme për të dyja palët e interesuara. Sipas tyre:

1) Qeveria Shqiptare duhet t'u jepte autorizim për të hapur shkolla komuniteteve të vllahëve në bazë të kërkesave që ato kishin.

2) Shkollat e sotme vllahe të Korçës e të Shipckës, qeveria shqiptare duhet që miqësisht t'u a dorëzojë komuniteteve përkatëse.

3) Mësuesit e propozuar prej komunitetit vllah duhet të emëroheshin me aprovimin e Ministrisë së Arsimit.

4) Mësimet duhet të bëheshin në rumanisht, por do të mësohej edhe gjuha shqipe, gjeografija dhe historia e Shqipërisë duke ndjekur programin e shtetit.

5) Shkollat dhe kishat rumune të mbaheshin prej komuniteteve vllahe të formuara legalisht, me dhuratat dhe pagesat e pjestarëve të këtij komuniteti, dhe pas miratimit të Qeverisë Mbretërore të Shqipërisë, me ndihma dhe nga Rumania¹⁸.

Bashkangjitur me relacionin e mësipërm, Ministri i Jashtëm, sqaronte se këto ishin vetëm propozime, por, para se të hyej në bisedime konkrete, ai kërkonte mendimin e dikasterit përkatës mbi këtë çështje dhe në mënyrë të veçantë mbi këto propozime.

17 *AMPJ*, dosja 228, viti 1930, fl.5. Raport i Ministrisë të Arsimit Abdurrahman Dibra për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 13.1.1930.

18 *Po aty*, fl.33. Raport i Ministrisë të Punëve të Jashtme z.Rauf Fico për Ministrinë e Arsimit, 7.4.1930.

Edhe Bullgaria nuk kishte hezituar të bënte presionet e saj në këtë drejtim. Përfaqësuesi i Legatës Shqiptare në Sofje, informonte se përgjatë takimit që kishte patur me Ministrin e Punëve të Jashtme të Bullgarisë, z.Bourov, pasi i kishte paraqitur letrat kredenciale, midis të tjerave, ai, ishte shprehur dhe për: “zgjidhjen miqësore të disa çështjeve të vogla që janë në konformitet me interesat tona të përbashkëta”¹⁹. Ç`ka sipas tij, nënkuptonte shkollat bullgare në Shqipëri. Një shqetësim të tillë, të parashtruar nga pala bullgare, Ministria e Jashtme ia përcillte me një shkresë Ministrisë së Arsimit, ku ndër të tjera i kërkonte sqarime për shkollat e fshatrave Shulin, Postec, Gllomboç, Gorke e Vidovë, ku ishte përqëndruar kryesisht minoriteti bullgarë²⁰. Ministria e Arsimit vetëm pak ditë më pas, në përgjigjen e saj informonte Ministrin e Jashtëm se në fshtrat e mësipërm kishte vetëm shkolla shqipe, sa për mësimin e gjuhës bullgare: “kjo nuk mund të bëhej tash për tash, mbasi ne nuk kemi mësues të posaçëm për këtë punë”²¹.

Një etapë e re në drejtim të politikës së shtetit shqiptar ndaj shkollave të minoriteteve etnike do të fillojë atëherë kur Mbreti Zog I do të mari një varg masash, të cilat ripohonin linjën e pavarësisë dhe ishin në të njëjtën kohë një kundërvënie ndaj diktatit italian. Në shtypin e kohës do të fillojë një fushatë e cila ngrinte zërin ndaj një gjendjeje të tillë, duke kërkuar që shkollat të organizoheshin dhe të drejtoheshin vetëm nga shteti. Shkolla e shtetit duhej të ishte e vetmja vatër e formimit të njëtrajtshëm kombëtar të brezave, ku do të qëndronin pranë e pranë fëmijë të të gjithë shtresave. Shkollat e huaja shikoheshin si përcuese të influencave të jashtme dhe një rrezik për unitetin kombëtar²². Sipas një raporti të hartuar nga Ministria e Arsimit: “Konsequenca e kësaj gjendjeje tek këto shkolla dalë nga dalë u vesh me një autoritet independentë me të cilin justifikoheshin për zbatimin e programit dhe të sistemeve antipedagogjike dhe shpesh në kundërshtim me ato të shkollës shtetërore si dhe me ndihma të huaja”²³. Një interesim i shpejtë shtetëror imponohej. Insiativa u mor nga parlamenti i cili në mbledhjen e 10 dhe 11 prillit 1933, ndryshoi nenin 206 të kushtetutës, sipas të cilit tani e tutje:

19 *Po aty*, fl.8. Raport i përfaqësuesit të Legatës Shqiptare në Sofje për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 18.4.1930.

20 *Po aty*, fl.10. Raport i Ministrin të Punëve të Jashtme z.Rauf Fico për Ministrinë e Arsimit, 18.4.1930.

21 *Po aty*, fl.11. Raport i Ministrisë së Arsimit për Ministrin e Jashtëm z.Rauf Fico, 21.11.1930.

22 *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Tiranë, 2003, f.429

23 *AQSh*, Fondi 295, viti 1934, dosja 4, fl.3. Raport mbi aktivitetin e zhvilluar nga Ministria e Arsimit gjatë viteve 1932-33-34; *Hylli i Dritës*, maj-qeshor 1933, Nr.56, f.216-217.

“-Mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptarë janë një e drejtë ekskluzive e shtetit. Jepet vetëm ndër shkollat dhe institute shtetërore shkollash sipas ligjit.

-Arsimi fillor për të gjithë shtetasit shqiptarë është i detyrueshëm dhe jepet falas.

-Shkollat private, të çdo kategorie qofshin, që kanë vepruar deri më sot mbyllën”²⁴. Në relacionin e parlamentit shqiptar lidhur me ndryshimin e nenit 206 (sëbashku me nenin 197 që kishte të bënte me shtypin dhe nenin 207 që kishte të bënte me shkollat fetare) shkruhej se shkollat private nuk kishin përmbushur kondita të tilla si:

1. Që burimi i mjeteve të tyre të jetë i sigurum dhe i pajtueshëm me qëllimin e shkollës shtetnore.
2. Që personeli edukues i tyre të jetë i zgjedhur prej çdo ndjesije, që është kundërshtim me përshkrimet e shtetit dhe me parimet që në dhënien e edukatës brezit të ri duhet me zbatue.
3. Që të ndihmojë shtetin, tue u çelë në ato vende në të cilat shteti nuk mundet me hap të vetat²⁵.

Por, po sipas relacionit, e shumta e tyre i nxirrte mjetet e ekzistencës nga burimet e huaja, të dhëna për qëllime aspak të mira. Personeli edukues ose ishte i frymëzuar nga përfitimi financiar, ose ishte i huaj dhe i nënshtruar nga pikëpamja e veprimit të mendimit dhe mënyrës së edukimit një autoriteti tjetër dhe jo ndaj shtetit shqiptar, i cili, nuk ishte në përputhje me qëllimet e këtij të fundit në rritjen e ndjeshmërisë së edukimit e të arsimimit tek shtetasit. Këto shkolla ishin hapur në vende në të cilat nuk ndjehej nevoja e tyre, sepse në ato vende kishte shkolla shtetërore të po asaj kategorie. Qëllimi i tyre në shumicën e rasteve mbështetej mbi spekulacionin politiko-fetar ose mbi atë financiar, ose të dyja sëbashku. Duke ia përshtatur veprimtarinë e tyre këtyre qëllimeve, shkaktonin përçarje në popull dhe rinisë i jepnin një edukatë që nuk ishte në përputhje me interesat e larta të kombit²⁶. Ndryshimet në statut u pranuan unanimisht prej parlamentit dhe në 22 prill 1933 u dekretuan nga Mbreti Zogu I. Me 26 prill filloi zbatimi i tyre duke mbyllur kështu të gjitha shkollat private duke përfshirë edhe ato të minoriteteve etnike.

24 *Fletore Zyrtare*, 1933, Nr.21, f.2.

25 *AQSh*, Fondi 295, viti 1934, dosja 4, fl.4. Raport mbi aktivitetin e zhvilluar nga Ministria e Arsimit gjatë viteve 1932-33-34.

26 *Po aty*.

Tabela .1.Sasia dhe kategoria e shkollave të mbyllura në vitin 1933²⁷

Shkolla private jofetare	21
Shkolla klerikale myslimane	14
Shkolla klerikale katolike	17
Shkolla klerikale ortodokse	4
Shkolla të huaja për shqiptarë	19
Shkolla private të minoritetit grek	10
Gjithsej	85

Në Shqipërinë e Jugut qarqet shoviniste greke të pëртејkufirit krijuan një situatë të tensionuar, duke e paraqitur shtetëzimin e shkollave private minoritare greke si një masë për të ndaluar mësimin e greqishtes në ato shkolla. Po ashtu u sajuan shpifje për persekutimin e klerit ortodoks, deri edhe të ashtuquajturin ndalim që iu bënin mësuesit shqiptarë nxënësve ortodoks të psalnin në kishë pa lejen e mësuesve të tyre²⁸. Kryesia e Kishës Ortodokse e përgënjeshtroi shtypin grek, që sajonte gjëra të paqena²⁹. Kryepeshkopi Visarion Xhuvani, duke iu kundërvënë propogandës greke, deklaroi publikisht: “Le të na provojë botërisht gazeta greke «Epiritikon Melon» se çfarë persekutimi dhe atë më të vogël qoftë, që jemi neve si kishë tue i ba elementit grek në Shqipni dhe ku dhe si”³⁰. Vendimi për shtetëzimin e shkollave shkaktoi pakënaqësi të madhe në Romë dhe Athinë, vetëm kësaj të fundit ju mbyllën rreth 10 shkolla private në zonat minoritare të cilat subvencionoheshin drejtë përsëdrejti nga qeveria greke. Athina e akuzoi qeverinë shqiptare se kishte shkelur deklaratën që ajo kishte bërë në tetor 1921 përpara Lidhjes së Kombeve për rrespektimin e të drejtave të minoriteteve. Kjo akuzë bëhej nga një qeveri që nuk njihte kurrfarë detyrimi në trajtimin e popullsisë shqiptare të Çamërisë dhe kryente shkelje masive të të drejtave të saj³¹.

Delegati shqiptar në Lidhjen e Kombeve, Lec Kurti, duke iu përgjigjur protestave greke deklaroi se në bazë të amendamenteve kushtetuese të prillit

27 *Historia e arsimit...vep. e cituar.*, f.444; *Hylli i Dritës*, maj-qeshor 1933, Nr.56, f.219.

28 *Gazeta Besa*, Tiranë 5.5.1933, nr.1004.

29 *Gazeta Besa*, Tiranë 30.8.1933, nr.1135.

30 *Gazeta Besa*, Tiranë 23.2.1935, nr.1136.

31 Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f.503; *Shih*: Mehdi Frashëri, *Bisedim në Këshillin e Shoqnisë së Kombevet mbi çështjen e minoritetit shqiptar dhe pasunive shqiptare në Greqi*, Tiranë: Nikaj, 1928.

1933 arsimi dhe edukimi i shtetasve shqiptarë u bë prerogativë ekskluzive e shtetit, ndërsa shkollat private të çdo kategorie u vendos që të mbylleshin. Pretendimin e palës greke se mësuesit e greqishtes ishin reduktuar nga 90 në 11 ai e hodhi poshtë si shpifje, duke deklaruar se aktualisht në Shqipëri minoriteti kishte 45 shkolla me 71 mësues dhe se orët e mësimit të greqishtes nuk ishin reduktuar, por vazhdonin 6-7 orë në javë e se përdroreshin po ato libra. Por, qeveria shqiptare kërkonte që nxënësit, meqë ishin shtetas shqiptarë, të dinin mirë edhe gjuhën shqipe me shkrim e këndim për të cilën as që mendohej se ajo do të toleronte. Për akuzën se në kishat ortodokse ishte ndaluar përdorimi i greqishtes ai tha se Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare me atributet e saj legale, kishte vendosur që nga themelimi i saj përdorimin e gjuhës së vetë kombëtare në kishat shqiptare, duke u lënë liri të plotë liturgjive greqisht në kishat e fshatrave minoritare greke. Në përfundim ai deklaroi se asnjë shtet nuk ka detyrim t'u japë pakicave kombëtare të një shteti tjetër në territorin e tij më shumë të drejta se sa gëzojnë banorët e shtetit mëmë dhe aq më tepër kur marrëdhëniet ndërkombëtare bazoheshin në parimin e reciprocitetit, gjë që s'ishte zbatuar për popullsinë shqiptare që jetonte në Greqi³².

Meqenëse kjo çështje kishte karakter juridik Këshilli i Lidhjes më 21 janar 1935 ia përcolli ankesën greke Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, e cila në muajin mars filloi një proces gjyqësor përpara të cilit të dyja palët paraqitën ankesat e tyre. Mbrojtjen e palës shqiptare e mori përsipër profesori francez i së drejtës ndërkombëtare Gilber Gidel, i cili midis të tjerave deklaroi se: "Qeveria shqiptare mendon se, duke vendosur monopolin e mësimit, nuk ka dhunuar as letrën dhe as shpirtin e deklaratës së nënshkruar prej saj më 1921 as edhe obligimin e themeluar nga neni 5 i kësaj deklarate. Suprimimi i shkollave private në Shqipëri, nuk është një masë e veçantë për shkollat e pakicave por një masë e përgjithshme e zbatueshme për shumicën dhe për pakicën. Pra, pakica vazhdon të drejtën e barazisë së stipuluar me përfitimin e saj përse u përket ngrehinave të mësimit. Një e drejtë barazie nuk mund të jetë e drejtë e jashtëzakonshme, një privilegj në favorin e pakicës, çka pakica mund të kërkojë legjitimisht të gëzojë po atë trajtim si edhe shumica"³³. Gilbert Gideli përmendi edhe faktin e rëndësishëm se në Shqipëri, në raport me numrin e popullsisë, minoriteti kishte përfituar më shumë shkolla. Kështu, sipas dekretligjit të vitit 1925 çelja e një shkolle duhej të bëhej kur së paku një qendër banimi kishte

32 *AQSh*, Fondi: Legata Italiane, viti 1934, dosja 18, fl.772-779. Vërejtje e qeverisë shqiptare në Lidhjen e Kombeve lidhur me problemin e minoritetit grek në Shqipëri, Tiranë, 23 korrik 1934.

33 *Gazeta Besa*, Tiranë 3, 4, 5, 6.1935, nr.1136, 1137, 1138.

të paktën 250 banorë, ndërsa 41 fshatrat nga 70 të minoritetit grek kishin më pak se 250 banorë dhe që sipas ligjit mund të përjashtoheshin nga hapja e shkollës. Pastaj në raport me popullsinë në përgjithësi, grekofonët ishin më të privilegjuar, sepse në qoftëse 1500 banorëve shqiptarë u takonte një shkollë, 730 banorë grekë kishin një shkollë³⁴.

Përfaqësuesi i qeverisë shqiptare, Mehdi Frashëri, pasi hodhi poshtë pretendimet e palës greke të cilat i tejkalonin edhe qëllimet e këtij procesi gjyqësor e mbylli fjalën e tij duke theksuar se Greqia refuzoi të bënte një deklaratë analoge me atë që kishte bërë qeveria shqiptare në tetor të vitit 1921 dhe “për pasojë minoritetet shqiptare në Greqi nuk gëzonin asnjë të drejtë”³⁵. Megjithatë në fillim të prillit 1935, Gjykata e Hagës me 8 vota pro dhe 3 vota kundër duke përfshirë edhe kryetarin e gjyqit anglezin Sesil J.B.Hurst me anëtarët Demetre Negulesku (rumun) dhe Kont M.Rostworoski (polak), i dha të drejtë palës greke. Përfundimisht Lidhja e Kombeve plotësoi kërkesën greke për riçeljen e shkollave private të minoritetit grek në Shqipëri dhe nuk pyeti për shkollimin në gjuhën amtare as për milionin e popullsisë shqiptare në Kosovë dhe as për mijërat e shqiptarëve në Çamëri që banonin në trojet e tyre³⁶.

Sipas studiuesve, presioni i Shqipërisë dhe i Mbretit Zogu I duke ndjekur një politikë të tillë, pavarësisht verdiktit të dhënë në favor të Greqisë pati efektet e veta: “Ish një arsye më tepër që Italia të rifillonte shlyrjen e detyrimeve financiare ndaj Shqipërisë, bile t’i shtonte investimet ndërsa Greqia, megjithëse gjeti përkrahje për problemin e shkollave të minoritetit në Lidhjen e Kombeve, mori një mësim që i vlejti për të frenuar politikën helenizuese që ndiqte në Shqipëri”³⁷.

Me 2 nëntor 1935, Mbreti Zog dekretoi “Rregulloren mbi shkollat private të minoriteteve”³⁸ të hartuar nga Ministria e Arsimit në të cilën theksohej qartë se Shqipëria do të rrespektonte deklaratën e saj, lëshuar përpara Lidhjes së Kombeve në 2 tetor 1921. Në bazë të kësaj rregulloreje, kërkesa për hapjen e një shkolle private minoritare bëhej prej pleqësisë së vendit dhe i drejtohej Ministrisë së Arsimit me anë të Prefekturës, në kërkesë duhej të specifikohesh:

a) dëshira e hapjes së shkollës private minoritare të mbajtur me shpenzimet e popullsisë së vendit.

34 *Gazeta Besa*, Tiranë 30.5.1935, nr.1156.

35 Arben Puto, *E drejta ndërkombëtare publike*, Tiranë: Dudaj, 2008, f.444-445.

36 Iliaz Gogaj, *Mirash Ivanaj, Personalitet i shquar i universitetit shqiptar*, Tiranë: Botime Erik, 2004, f.174.

37 Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e Mbretit Zog I-rë*, Tiranë 1996, f.289.

38 *Fletore Zyrtare*, 1935, Nr.58, f.1-2.

b) numri i fëmijëve të të dy sekseve në moshën ligjore të detyrshmëris shkollore sipas ligjit

c) emri dhe jetëshkrimi i shkurtër i mësuesit ose i mësuesve

d) rroga mujore që vendi duhet t'i paguente mësuesit ose mësuesve bashkë me dokumentat e tyre³⁹.

Kandidatët për mësues në shkollat private minoritare duhet të plotësonin këto kondita:

a) të ishin shtetas shqiptar

b) të kishin mbushur moshën 21 vjeç dhe të kishin përmbushur detyrimin ushtarak

c) të dinin sa ishte e mundur gjuhën shqipe, kjo konditë hynte në fuqi pas tre vjetësh

d) mos të ishte i ndaluar nga ofiqet publike

e) të kishte kryer një shkollë normale, kjo konditë hynte në fuqi pas dy vjetësh

f) të mos kishte kryer më parë shërbimin ushtarak në ndonjë vend të huaj

g) të mos ketë pasur dhe të mos kishte lidhje me organizatat anti-shqiptare

h) të paguhej vetëm prej popullsisë së vendit që kishte hapur shkollën private minoritare⁴⁰.

Mësuesi i një shkolle private minoritare mund të fillonte punë vetëm me dekret të Ministrisë së Arsimit, dekret i cili duhet të dilte brenda një muaji nga data e dorëzimit të kërkesës përkatëse. Kontrolli zyrtar didaktik e administrativ i këtyre mësuesve do të bëhej në bazë të dispozitave ligjore të Ministrisë së Arsimit me anë të inspektorëve të saj. Programi shkollor do të ishte i njëjtë me atë që aplikohet në shkollat e shtetit me të vetmin ndryshim se lëndët do të zhvilloheshin në gjuhën e minoriteteve përkatëse, hartimi i teksteve në këto gjuhë ishte përsëri e drejtë ekskluzive e dikasterit të mësipërm. Për zonat minoritare të cilat deklarorin se nuk dëshironin apo nuk mundeshin nga ana financiare të mbanin shkolla private, Ministria e Arsimit, në bazë të nenit 6 të deklaratës së 2 tetorit 1921, do të hapte shkolla shtetërore në të cilat i gjithë programi mësimor do të zhvillohej në gjuhën e minoritetit përkatës, me të vetmin kusht që të futej si lëndë e detyrueshme edhe mësimi i gjuhës shqipe⁴¹.

Një politike të tillë tolerante ndaj minoriteteve i bëri jehonë dhe shtypi grek, sipas një të përditshmeje: "Çelja e gjithë shkollave greke në Shqipëri

39 *Rregullore mbi shkollat private të minoriteteve*, Tiranë: Shtypshkronja e Ministrisë së Arsimit, 1935, f.4.

40 *Po aty*, f.5.

41 *Po aty*, f.8-10.

dhe fillimi i punimit të tyre me mësues grek në kushte të favorshme përbën një gjest të Qeverisë së Tiranës që meriton çdo lavdi⁴². Po sipas saj, me anën e këtij vendimi shqiptarët shfaqnin dispozitat e tyre më të sinqerta për një bashkëpunim harmonik dhe për forcimin e marrëdhënieve midis dy shteteve e dy qeverive. Me rihapjen e këtyre shkollave ngriheshin të gjitha pengesat, të cilat kishin krijuar një ftohtësi të përkohshme duke çelur kështu një kapitull të ri marrëdhëniesh në interes të dy popujve.

Megjithatë nga dokuemtacioni i kohës na rezulton se shteti grek nuk iu përgjigj në mënyrë reciproke kësaj politike, popullsia shqiptare e Çamërisë vazhdonte të diskriminohej duke u privuar nga e drejta e saj për të hapur shkolla shqipe. Konsujt grek, gjithashtu vazhduan të kompromentonin mësuesit e shkollave minoritare me premtime dhe rroga suplementare me qëllim vënien e tyre në shërbim të politikës ekspansioniste që synonte aneksimin e Shqipërisë së Jugut⁴³. Këta mësues ndonëse në dukje propozoheshin prej pleqësive dhe emëroheshin nga Ministria e Arsimit, në realitet sugjeroheshin nga konsullatat greke, për të ushtruar influencën e tyre tek nxënësit për çdo lloj propogande antishqiptare e antikombëtare në katundet ortodokse. Duke u nisur nga kjo situatë, kryetari i Bashkisë së Delvinës, z.Asim Kalasa, në një parashtrësë që i dërgonte Ministrisë së Arsimit me datë 10 shtator 1937 i shkruante se: “përpara kësaj gjendjeje interesat jetike të politikës kombëtare imponojnë që në qarkun e Gjirokastrës dhe në rrethin e Himarës, elementi shqiptar, duhet të ndahet përgjithësisht nga influencat greke dhe duke u naltësuar moralisht⁴⁴. Ndër të tjera ai sugjeronte se, duke marë parasysh çdo sakrificë të përgatiteshin dhe të dërgoheshin në katundet ortodokse shqiptare famulltar me ndjenja kombëtare, të cilët të kryenin edhe detyrën e agentit propagandist kombëtarë sepse çdo propogandë antikombëtare në të kaluarën ishte zhvilluar dhe rrënjosur me anë të klerit. Famulltarët e pajisur me ndjenja kombëtare -sipas tij- do të ishin ata që do të loznin rolin më të madh për mbarëvajtjen e politikës kombëtare dhe për ç`rrënjosjen e ideve që katundari injorant ortodoks shqiptar kishte se çdo

42 *AQSh*, Fondi 295, viti 1937, dosja 137, fl.18-19. Raport i përfaqësuesit shqiptar në Athinë mbi një artikull të botuar në gazetën greke “*Eleftheron Vima*” lidhur me shkollat e minoritetit grek në Shqipëri, 24.9.1937.

43 *Po aty*, fl.19. Raport i Prefekturës së Gjirokastrës dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi urdhërin e konsullatës greke në Sarandë për mësuesit e shkollave grekofone, 4.8.1937.

44 *AQSh*, Fondi 295, viti 1937, dosja 149, fl.1-3. Parashtrësë e kryetarit të Bashkisë së Delvinës, z.Asim Kalasa, dërguar Ministrisë së Arsimit mbi aktivitetin e kryepleqësive të fshatrave grekofone për të sunduar shkollat e minoritetit me mësues të shkolluar në greqi.

ortodoks është grek. Po ashtu duhej të jepeshin edhe disa bursa studimi për vajzat dhe djemtë ortodoksë shqiptar, dhe disa prej tyre duhet të mereshin në shërbim të xhandarmërisë apo ushtrisë shqiptare me qëllim lartësimin e tyre moral⁴⁵.

Pasqyrë përmbledhëse e shkollave të minoriteteve etnike në Shqipëri (viti 1929)⁴⁶

Tabela 2.

Shkolla greke	Nr
Shkolla të mbajtura prej Shtetit Shqiptar	22
Shkolla të mbajtura prej Komunitetit	32
Gjithsej	54
Numri i mësuesve me origjinë shqiptare	28
Numri i mësuesve me origjinë grekofone	62
Gjithsej	90
Numri i nxënësve që mësojnë në këto shkolla	3003
Sasia e parave që Shteti Shqiptar harxhonte çdo vit për mbajtjen e këtyre shkollave	61.000 franga ari

Tabela .3.

Shkolla serbe	Nr
Shkolla të mbajtura prej Komunitetit	2
Numri i mësuesve me origjinë shqiptare	2
Numri i mësuesve me origjinë serbe	8
Gjithsej	10
Numri i nxënësve që mësojnë në këto shkolla	120
Sasia e parave që Shteti Shqiptar harxhonte çdo vit për mbajtjen e këtyre shkollave	4980 franga ari

45 *Po aty*, fl.4.

46 *AMPJ*, viti 1929, dosja 797, fl.7.

Tabela 4.

Shkolla rumune	Nr
Shkolla të mbajtura prej Shtetit Shqiptar	2
Numri i mësuesve me origjinë shqiptare	3
Numri i mësuesve me origjinë rumune	2
Gjithsej	5
Numri i nxënësve që mësojnë në këto shkolla	165
Sasia e parave që Shteti Shqiptar harxhonte çdo vit për mbajtjen e këtyre shkollave	8880 franga ari

Pasqyrë e shkollave të minoriteteve etnike në Shqipëri sipas shpërndarjes gjeografike (viti 1929)⁴⁷

Tabela 5.

Prefektura e Gjirokastrës

Shkolla të mbajtura prej Shtetit Shqiptar

Nr	Vendi i shkollës	Kategoria	Nr. i klasave	Nr. i nxënësve	Emri i mësuesit	Origjina	Gjuha e shkollës	Paguhet prej	
								Shtetit	Komunitetit
1	Dervişan	Fillore	5	114	Spiro Nrico	grekofon	greke	shtetit	komunitetit
					Filip Ikonomidhi	grekofon			komunitetit
					Sokrat Kutra	shqiptar			komunitetit
2	Goranxu	Fillore	5	54	Mihal Zografi	shqiptar	greke	shtetit	komunitetit
					Vasil Xhaj	grekofon			
3	Vaniste	Fillore	5	35	Andon Zhonga	shqiptar	greke	shtetit	komunitetit
					Teodor Papanikolla	grekofon			
4	Teriat	Fillore	5	44	Ilija Liço	shqiptar	greke	shtetit	komunitetit
					vakant për t'u emëruar	grekofon			
5	Grapsh	Fillore	4	24	Nikolla Filipi	shqiptar	greke	shtetit	komunitetit
					Demosten Kalivopulli	grekofon			

⁴⁷ Po aty, fl.5-6.

Tabela .6.
 Prefektura e Gjirokastrës
 Shkolla private

Nr	Vendi i shkollës	Kategoria	Nr. i klasave	Nr. i nxënësve	Emri i mësuesit	Origjina	Gjuha e shkollës	Paguhet prej	
								Shtetit	Komunitetit
1	Dhuvjan	Fillore	5	95	Koço Miho Vasil Llapa	shqiptar grekofon	greke		komunitetit komunitetit
2	Hashovë	Fillore	4	33	Kristo Papajorgji	grekofon	greke		komunitetit
3	Goricë	Fillore	3	10	Grigor Çami	grekofon	greke		komunitetit
4	Sofratik	Fillore	3	38	Harallamb Xhaj	grekofon	greke		komunitetit

Tabela .7.
 Nënprefektura e Libohovës
 Shkolla të mbajtura prej Shtetit Shqiptar

Nr	Vendi i shkollës	Kategoria	Nr. i klasave	Nr. i nxënësve	Emri i mësuesit	Origjina	Gjuha e shkollës	Paguhet prej	
								Shtetit	Komunitetit
1	Jergucat	Fillore	5	81	Koço Kostaqi Evanthi Konomi	shqiptar grekofone	greke	shtetit	komunitetit
2	Bularat	Fillore	5	122	Aleks Dani Vasil Dajlani Vasil Stiljano	shqiptar shqiptar grekofon	greke	shtetit shtetit	komunitetit
3	Sotir	Fillore	5	120	Stavri Cico Margarita Cico Andon Pando	shqiptar shqiptar grekofon	greke	shtetit shtetit	komunitetit
4	Llongo	Fillore	3	53	Jorgji Tako Niko Llazopulli	shqiptar grekofon	greke	shtetit	komunitetit
5	Poliçan	Fillore	5	110	Llazar Bibaj Panajot Germanoj M.Peri Atë Vangjeli	shqiptar shqiptar grekofon grekofon	greke	shtetit shtetit	komunitetit komunitetit

6	Skore	Fillore	5	48	Pavlo Cimbi Jani Dalla Eleni Notidhi	shqiptar shqiptar shqiptar	greke	shtetit shtetit	komunitetit
7	Sopik	Fillore	5	147	Kolë Koci Branko Merxhangopulli Ilija Karajani Harilla Konomi Eleni Luci	grekofon grekofon grekofon grekofon grekofon	greke	shtetit shtetit shtetit shtetit	komunitetit
8	Çatiste	Fillore	4	73	Kristo Vido Panajot Vasiliadhi Rumbo	shqiptar grekofon shqiptare	greke	shtetit	komunitetit komunitetit
9	Hllomo	Fillore	5	85	Odhise Mjella Eleni Odhiseja Thanas Papastavri	grekofon grekofon grekofon	greke	shtetit	komunitetit komunitetit
10	Suhe	Fillore	4	42	Jani Noti	shqiptar	greke	shtetit	
11	Pepel	Fillore	4	51	Dimitri Sqevi	shqiptar	greke	shtetit	

Tabela .8.

Nënprefektura e Libohovës
Shkolla private

Nr	Vendi i shkollës	Kategoria	Nr. i klasave	Nr. i nxënësve	Emri i mësuesit	Origjina	Gjuha e shkollës	Paguhet prej	
								Shtetit	Komunitetit
1	Ajnikollë	Fillore	4	52	Mihal Ikonomidhi	grekofon	greke		komunitetit
2	Peshk e poshtme	Fillore	3	37	Thoma Papadhoppullo	grekofon	greke		komunitetit
3	Peshk e sipërme	Fillore	3	28	Harallamb Çeli	grekofon	greke		komunitetit
4	Vlaho Goranxi	Fillore	3	24	Dimitri Duçi	grekofon	greke		komunitetit

Tabela .9.
Nënprefektura e Delvinës
Shkolla të mbajtura prej Shtetit Shqiptar

Nr	Vendi i shkollës	Kategoria	Nr. i klasave	Nr. i nxënësve	Emri i mësuesit	Origjina	Gjuha e shkollës	Paguhet prej	
								Shtetit	Komunitetit
1	Delvinë	Fillore	5	60	Simon Kosta	grekofon	greke	shtetit	
2	Dhrovjan	Fillore	5	128	Nikolla Geçi Kristo M.Jorgji Spiro Kaliva Mihal Vidhuri Jorgji Spirako Sofija Kumblli	shqiptar shqiptar grekofon grekofon grekofon grekofon	greke	shtetit shtetit shtetit shtetit	komunitetit komunitetit
3	Aliko	Fillore	4	45	Jani Thanasi	shqiptar	greke	shtetit	
4	Jerm	Fillore	4	45	Vangjel Zaho	shqiptar	greke	shtetit	
5	Dhivri	Fillore	5	82	Jorgji Greka Spiro Saqellari Fotimi Konomi	grekofon grekofon grekofon	greke	shtetit	komunitetit komunitetit

Tabela.10
Nënprefektura e Delvinës
Shkolla private

Nr	Vendi i shkollës	Kategoria	Nr. i klasave	Nr. i nxënësve	Emri i mësuesit	Origjina	Gjuha e shkollës	Paguhet prej	
								Shtetit	Komunitetit
1	Kardhikaq	Fillore	4	34	Jorgji Partali	grekofon	greke		komunitetit
2	Brahilat	Fillore	3	22	Grigor Mikeli	grekofon	greke		komunitetit
3	Kakodhiq	Fillore	5	80	Vasil Daleko	grekofon	greke		komunitetit
4	Leftereor	Fillore	4	47	Stavro Zisi	grekofon	greke		komunitetit
5	Krane	Fillore	3	33	Foto Papahristo	grekofon	greke		komunitetit
6	Çukë	Fillore	4	36	Andrea Qesko	grekofon	greke		komunitetit
7	Vrion	Fillore	3	31	Stavro Janidhi	grekofon	greke		komunitetit
8	Finiqi	Fillore	4	60	Koço Jani	grekofon	greke		komunitetit
9	Krongji	Fillore	3	30	Thanas Vasili	grekofon	greke		komunitetit
10	Leshn e poshtme	Fillore	5	87	Jorgji Lica Vasiliqi Lezo	grekofon grekofon	greke		komunitetit

Tabela.11
Nënprefektura e Kolonjës
Shkolla private

Nr	Vendi i shkollës	Kategoria	Nr. i klasave	Nr. i nxënësve	Emri i mësuesit	Origjina	Gjuha e shkollës	Paguhet prej	
								Shtetit	Komunitetit
1	Llazar Kallsat	Fillore	5	72	Grigor Nasho	grekofon	greke		komunitetit
2	Grave	Fillore	3	23	Thimio Kushta	grekofon	greke		komunitetit
3	Theolog	Fillore	5	100	Jorgji Papa Spiro Isari Stefan Baho	grekofon	greke		komunitetit
4	Grazhdan	Fillore	4	50	Miço Fili	grekofon	greke		komunitetit
5	Zminec	Fillore	3	24	Spiro Çaka	grekofon	greke		komunitetit
6	Vagalat	Fillore	3	27	Kole Miçi	shqiptar	greke		komunitetit
7	Hajadaraga	Fillore	3	24	Kole Mine	shqiptar	greke		komunitetit
8	Kulluric-Hoxhaj	Fillore	4	35	Kosta Papatanas	grekofon	greke		komunitetit
9	Kalivi Pasha	Fillore	5	74	Kosto Budri	grekofon	greke		komunitetit
10	Ymer Efendi	Fillore	3	33	Kosto Papahristo	grekofon	greke		komunitetit

Tabela.12

Nënprefektura e Përmetit

Shkolla të mbajtura prej Shtetit Shqiptar

Nr	Vendi i shkollës	Kategoria	Nr. i klasave	Nr. i nxënësve	Emri i mësuesit	Origjina	Gjuha e shkollës	Paguhet prej	
								Shtetit	Komunitetit
1	Vllaho-Psill	Filllore	3	35	Kadri Skënder Kristalli	shqiptar grekofon	greke	shtetit	komunitetit

Tabela.13

Prefektura e Shkodrës

Shkolla private

Nr	Vendi i shkollës	Kategoria	Nr. i klasave	Nr. i nxënësve	Emri i mësuesit	Origjina	Gjuha e shkollës	Paguhet prej	
								Shtetit	Komunitetit
1	Shkodër	Filllore	5	70	Harallamb Ando	shqiptar	serbe	shtetit	komunitetit
					Angjelija Ando	shqiptar			komunitetit
					Vuk Stajkoviç	serbe			komunitetit
					Kel Vila	serbe			komunitetit
					Milica Kadiq	shqiptare			komunitetit
Decanca Gjorgjeviç	serbe	komunitetit							
2	Vrakë	Filllore	4	50	Llazar Brajoviç	serbe	serbe	shtetit	komunitetit
					Vidosava Brajoviç	serbe			komunitetit
					Karl Shiroka	shqiptar			komunitetit

INVESTIMET TURKE EDUKATIVO-ARSIMORE NË BALLKAN NË EPOKËN E GLOBALIZMIT

Muhamed ALI

Ss.Cyril and Methodius University, Skopje, Macedonia.

ABSTRACT

Since the period of the ottoman rule, Balkan's region has always attracted the interest of Turkish political elites. However, after the withdrawal of ottoman factor and the establishment of the new Turkish state, Balkans lost its strategic significance in the prospect of the Turkish policymakers. All this occurred as a result of internal and external factors that have determined the closing of this state within its internal borders. Strategic circumstances of the Cold War have affected the continuation of this self isolation policy, too.

By the end of the Cold War, as a result of the new globalization circumstances, Turkish foreign policy started a new diplomatic, economic and education campaign in its hinterland, especially in Balkans area. In 90's Turkish investments in Balkans were carried out by individuals from the private and non – government sector as a result of the Gülen movement initiative and very often without opened support of Turkish policymakers, due to the ideological circumstances. After AK party coming to power, a new momentum was revealed, where except the initiative of the private and non – government sector an intensified encouragement of the Turkish government was provided in terms of education investments within this important region for the new proactive and integrative Turkish policy.

Finally, it should be underlined that these education investments in Balkans are having – and will have – a vital role in making Turkey a serious factor in regional and further in global arena.

Keywords: Education investments, Gülen movement, Turkey, AK Party, Balkans, globalization.

Hyrje

Me shuarjen e Perandorisë Osmane, në arenën ndërkombëtare doli në skenë shteti i ri turk i cili në krye me shtetformuesin Ataturk filloi të iniciojë politika të reja pro – perëndimore si brenda vendit poashtu edhe ndaj botës së jashtme. Ndër hapat më me rëndësi të liderit të shtetit të posalindur mbi gërmadhat e Perandorisë Osmane ishte reformimi dhe modernizimi i shoqërisë turke. Si pasojë e gjithë kësaj, pos disa përpjekjeve (si formimi i Paktit të Ballkanit i cili nuk kishte ndonjë sukses të rëndësishëm) politika e jashtme turke në masë të madhe determinoi fillimin e izolimit të shtetit turk brenda kufijve të vet me çka brenda një periudhe të shkurtër humbi edhe ndikimin e tij në hinterlandin e tij ku bën pjesë edhe rajoni i Ballkanit. Fillimi i Luftës së Ftohtë konsiderohet një moment i ri që kishte refleksione vitale në përafrimin e mëtejshëm të Turqisë me perëndimin sidomos me SHBA – në duke pasur parasysh rrezikun e kërcënimit të sovjetiko - komunist ndaj interesave gjeostrategjike turke. Harmonizimi i politikës së jashtme turke me atë perëndimore gjatë Luftës së Ftohtë që kishte implikacione negative në ruajtjen e pavarësisë diplomatike ndaj Ballkanit dhe ndikimi sovjetiko - komunist në këtë rajon mund të konsiderojmë si faktorë determinantë që pos hapjes politike, ekonomike dhe kulturore të shtetit turk penguan edhe hapjen edukativo – arsimore në këtë rajon.

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë fillon një epokë e re në marrëdhëniet ndërkombëtare ku sistemi botëror nga bipolarizmi u shndërrua në sistem njëpolar, në krye me superfuqinë SHBA. Nga ana tjetër u shemb rreziku sovjetiko - komunist dhe Turqia filloi të aplikojë politikë të jashtme multidimensionale dhe pro – aktive që synoi shndërrimin e këtij shteti në faktor rajonal. Shteti turk pos avancimit politik, ekonomik dhe kulturor poashtu edhe me soft power – in e tij filloi të bëjë hapa të mëdhenj në fushën e arsimit në hinterlandin e tij në krye me Ballkanin.

Vitet e 1990 – ta të shekullit të kaluar dëshmojnë inicimin e investimeve edukativo – arsimore turke me iniciativë të sektorit privat dhe joqeveritar turk në krye me lëvizjen e Gylenit, iniciativë e cila në dekadën e parë të viteve të 2000 – ta fiton edhe përmbajtjen e qeverisë turke e udhëhequr nga partia AKP konservative. Në vijim, do të sjellim një retrospektivë të shkurtër të politikës së jashtme turke ndaj Ballkanit në shekullin e kaluar, pastaj do të vazhdojmë me analizimin e dy faktorëve determinantë që kanë rol vital në ecurinë e investimeve edukativo – arsimore turke në Ballkan në kohën e globalizmit (në dy dekadat e fundit) dhe në fund do të përfundojmë me analizimin e këtyre aktiviteteve të fushës arsimore.

1. Restrospektivë e shkurtër rreth marrëdhënieve Turqi - Ballkan

Fundi i shekullit XIX. dhe fillimi i shekullit XX në historinë e marrëdhënieve midis popullit turk dhe popujve të Ballkanit karakterizohet me përfundimin e udhëheqësisë disashekullore të Perandorisë Osmane në këto troje. Më 1832 Greqia fitoi pavarësinë, ndërsa më 1878 Bullgaria, Serbia, Mali i Zi dhe Rumania shpallën pavarësinë, dhe në të njëjtin vit Bosnja u bë pjesë e Perandorisë Austro - Hungareze. Si pasojë e luftës Ballkanike, më 1912 mbaroi sundimi osman në Maqedoni dhe Shqipëri, moment ky që konsiderohet edhe si fundi i sundimit osman në këto troje. Më 1923, me formimin e shtetit të ri turk, filloi një periudhë e re në marrëdhëniet turko - ballkanike. Në këtë kontekst, duhet cekur se Turqia morri pjesë aktive në Konferencat Ballkanike të organizuara mes dy luftërave botërore¹ me çka dha kontribut në zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale me shtetet ballkanike si Shqipëria, Greqia, Jugosllavia, Rumania dhe Bullgaria. Në këtë periudhë Turqia bashkë me Jugosllavinë, Greqinë dhe Rumaninë formuan Paktin e Ballkanit me anë të cilit synonin mbrojtjen e tyre nga sulmet eventuale të jashtme. Mosinkuadrimi i Shqipërisë dhe Bullgarisë në këtë pakt dhe mosndalimi i sulmeve të gjermanëve dhe italianëve ndaj shteteve të këtij pakti ishin faktorë determinantë që ndikuan në shuarjen e kësaj aleance mbrojtëse nga skena ndërkombëtare. Gjithashtu, periudha midis dy luftërave botërore karakterizohet edhe me përpjekjet për zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare midis Turqisë dhe shteteve ballkanike. Formimi i Dhomës Ballkanike të Tregtisë me seli në Stamboll është dëshmi shtesë që pasqyron përpjekjet e Turqisë bashkë me shtetet e Ballkanit për avancimin e marrëdhënieve politike dhe ekonomike midis tyre.² Megjithatë, aplikimi i politikave pro - perëndimore dhe sukcesi i ulët i përpjekjeve turke për zhvillim të marrëdhënieve reciproke me shtetet ballkanike mund ti konsiderojmë si karakteristika kryesore të periudhës së lartpërmendur.

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore arena ndërkombëtare u ballafaqua me një sfidë të re e njohur si Luftë e Ftohtë. Kjo periudhë e re u karakterizua me bipolarizmin e botës në krye me SHBA - në dhe Bashkimin Sovjetik. Këto rrethana të reja patën refleksione vitale edhe ndaj politikës së jashtme turke. Kështu që, hinterlandi i Turqisë u ballafaqua me koniunkturë të re që gjithnjë

1 Khalilzad, Zalmay et.al., *Türk Batı İlişkilerinin Geleceği: Stratejik Bir Plana Doğru*, ASAM Yayınları, İstanbul, 2001, f. 39; Lesser, O. Ian et.al., *Balkanlar'dan Batı Çin'e Türkiye'nin Yeni Jeopolitik Konumu*, Alfa Yayınları, İstanbul, 2000, f.182.

2 *Shih Lesser*, Op.cit., f. 182,183, Saybaşılı, Kemali et.al. (ed.), *Yeni Balkanlar Eski Sorunlar*, Bağlam Yayınları, İstanbul, 1997, f. 213.

rrezikonte sovranitetin dhe sigurinë e shtetit turk. Kërcënimi sovjetik për ndërrimin e kufirit turko - sovjetik në dobi të interesave sovjetike, kërkesa sovjetike për formim të bazës tokësore dhe detare në Bosfor, ndikimi i madh sovjetik në shtetin fqinj bullgar dhe tërë rajonin ballkanik konsideroheshin si sinjale të rëndësishme që tregojnë nivelin e rrezikut me të cilin ballafaqohet politika e jashtme turke të asaj periudhe. Gjithë kjo, rezultoi me intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të shtetit turk me Perëndimin, sidomos me SHBA - në.³ Megjithëse, politika e jashtme turke pro - perëndimore gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë kishte refleksione pozitive ndaj interesave gjeostrategjike të shtetit turk, si mbrojtja nga rreziku rus, integrimi në NATO (1952) dhe shfrytëzimi i ndihmave amerikane në kuadër të doktrinës së Trumanit (1947), prapëseprapë kjo politikë ndikoi dukshëm në minimalizimin e pavarësisë së vendimmarrjes së diplomacisë turke ndaj rajoneve që gjinden në hinterlandin e saj, si në rastin e Ballkanit. Politika e jashtme turke pro - perëndimore ose e përmbajtur ndaj ndodhive që ndodheshin në hinterlandin e saj ku bën pjesë edhe Ballkani gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë në masë të madhe pakësoi faktorizimin e shtetit turk në rajonin e përmendur.

Përkundër të gjitha presioneve ndërkombëtare, më 1974 shteti turk nën udhëheqjen e kryeministrit Bylent Exhevit realizoi operacion ushtarak në ishullin e Qipros me pretekst të mbrojtjes së pakicës turke në ishullin e cekur. Ky hap i shtetit turk konsiderohet si hap i parë i pavarur i këtij shteti pas një periudhe të gjatë të zhvillimit të politikave pro - perëndimore. Gjithashtu ky hap ushtarako - politik mund të komentohet edhe si prioritetizim i interesave shtetërore turke duke ruajtur në të njëjtën kohë edhe kursin pro - perëndimor të Turqisë. Periudha e dytë e faktorizimit të shtetit turk në Ballkan fillon në periudhën e Turgut Ozallit në fillim si kryeministër e pastaj si president shteti, moment ky i cili korrespondon edhe me çastet e fundit dhe përfundimin e Luftës së Ftohtë, shndërrimin e sistemit ndërkombëtar nga bipolarizmi në njëpolarizëm dhe shembjen e kërcënimit sovjetik ndaj shtetit turk. Pikërisht në këtë periudhë, Ozalli filloi me ndryshimin e boshtit të politikës turke duke u munduar që Turqisë t'ia kthejë peshën e dikurshme, nëse jo të periudhës osmane, atëherë ta bëjë atë faktor me peshë rajonale, madje duke mos u mjaftuar me kaq. Ozall bëri hapa të rëndësishëm në politikën e jashtme turke: **a)** realizoi hapjen ekonomike të shtetit turk,⁴ **b)** mundësoi integrimin e Turqisë me botën e jashtme, **c)** zhvilloi marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare me shtetet

3 *Shih* Lütem, Lütem, E. Ömer et.al. (ed.), *Balkan Diplomasisi*, ASAM Yayınları, Ankara, 2001, f. 12,13.

4 Fuller, E. Graham, *Yeni Türkiye Cumhuriyeti*, Timaş yayınları, İstanbul, 2008, f. 86.

e Ballkanit. Vitet e 1990 – ta dëshmojnë edhe faktorizimin e islamistëve në rrafshin politik turk. Kështu që, me ardhjen e politikanit islamist Nexhmedin Erbakan në krye të qeverisë turke politika e jashtme turke bëri hapa shtesë për faktorizimin e shtetit turk në suaza rajonale dhe globale. Por, rrethanat brenda shtetit turk (rrëzimi i qeverisë së Erbakanit nga ana e ushtrisë laike turke) dhe koniunktura ndërkombëtare (atëkohë qëndrimi i Erbakanit në krye të qeverisë turke ishte në kundërshtim me interesat gjeostrategjike të SHBA – së në rajon) ndikuan në mosrealizimin e synimeve strategjike dhe diplomatike të Erbakanit për faktorizimin e Turqisë në hinterlandin e saj.⁵

2. Faktorët determinantë të investimeve turke edukativo - arsimore në Ballkan

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe ndryshimin e ekuilibrave strategjike në arenën ndërkombëtare politikëbërësit turq filluan të krijojnë politika dhe strategji multidimensionale që kishin për synim hapjen politike, ekonomike dhe kulturore të Turqisë ndaj hinterlandit të saj me synim të faktorizimit të këtij shteti në suaza rajonale. Në vitet e 1990 – ta si rezultat i rrethanave të reja të globalizmit Turqia pos hapjes së lartëpërmendur filloi edhe një fushatë të re edukativo – arsimore në *hinterlandin* e saj, sidomos në Ballkan. Në këtë periudhë investimet edukativo – arsimore turke në Ballkan u realizuan me anë të individëve të sektorit privat dhe joqeveritar në krye me lëvizjen e Gylenit, shumë herë pa pasur mbështetjen e hapur të politikëbërësve turq për shkak të rrethanave ideologjike.⁶ Por, dekada e parë e viteve 2000 – ta është dëshmitare e një momenti të ri, ku me ardhjen e Partisë AK konservative në krye të qeverisë turke pos iniciativës së sektorit privat, kemi edhe inkujarimin e qeverisë turke për rritjen e investimeve edukativo – arsimore në këtë rajon të rëndësishëm për politikën e re turke pro – aktive dhe integruese. Nga e larta mund të konkludojmë se vitet e 1990 – ta dallohen me investimet turke edukativo – arsimore në Ballkan falë aktiviteteve të sektorit joqeveritar në krye me lëvizjen e Gylenit, ndërsa vitet e dekadës së parë të këtij shekulli janë dëshmitare të intensifikimit

5 Lidhur me zhvillimet e reja në politikën e jashtme turke pas Luftës së Ftohtë shih Makovsky, Alan et.al. (ed.), *Changing Dynamics of Turkish Foreign Policy*, Washington Institute for Near East Policy Press, Washington D.C., 2000; Robins, Philip, *Turkey and Middle East*, Royal Institute of International Affairs, London, 1991.

6 Këtu duhet cekur se në vitet e 1990 – ta edhe pse një pjesë e madhe e politikëbërësve turq përmbanin iniciativën e sektorit privat për aktivitete arsimore jashtë vendit, megjithatë ushtria turke për shkaqe ideologjike kishte qëndrim negativ ndaj kësaj fushate.

të këtyre investimeve falë edhe strategjisë së re turke ndaj Ballkanit bazuar në politikën e jashtme të AKP - së konservative. Edhe pse gjatë dy dekadave të fundit ekzistojnë faktorë të ndryshëm që ndikuan në zhvillimin dhe rritjen e aktiviteteve edukativo - arsimore në Ballkan, megjithatë mendojmë se lëvizja e Gylenit dhe faktori i partisë AK të Erdoganit mund ti rradhisim si dy faktorë kyqë që ndikuan dhe sot e kësaj dite ndikojnë në ecurinë e investimeve të lartëpërmendura. Në vijim do të analizojmë dy faktorët e mësipërm, e më pastaj do të vazhdojmë me paraqitjen e investimeve turke në fushën e arsimit në Ballkan gjatë dy dekadave të fundit duke bërë edhe analiza më të detajuara.

2.1. Lëvizja e Gylenit

Ideologu dhe lideri kësaj lëvizjeje është Fethulah Gylen, i cili njihet si lider, pedagog, teolog dhe shkencëtar. Shpesh herë nga revistat me reputacion ndërkombëtar është zgjedhur si një ndër figurat muslimane më me ndikim në botë. Duhet cekur se është ndikuar nga mësimet e Said Nursit i cili pos si autor i përmbledhjeve të librave të quajtur *Risale - i Nur* që parasegjithash trajton tema fetare, është i njohur edhe si iniciues i lëvizjes fetare *nurxhi*. Gyleni është autor i 60 librave dhe i shumë artikujve ku trajton tema të religjionit, të fushave politike dhe sociale. Pos shkrimit të librave dhe artikujve është edhe iniciues aktiv i dialogut mes feve, me Vatikanin dhe me organizata të rëndësishme të hebrenjëve. Takimet e tij me Papë Jean Paul - in II dhe me liderë të ndryshëm të hebrenjëve mund të konsiderojmë si aktivitete të rëndësishme në rrugën e vendosjes së dialogut mes feve të ndryshme. Është kritikues i ashpër i çdo lloji të terrorizmit dhe në të njëjtën kohë ka mendime progresive dhe moderne rreth të drejtave të gruas. Sipas tij mund të harmonizohen demokracia dhe Islami dhe se këta dy nuk e kundërshtojnë njëri tjetrin. Ka qëndrim pozitiv ndaj integritit të Turqisë në UE dhe është inkujarues i rrugës së integritit të shtetit turk në këtë institucion. Duhet cekur se kishte qëndrim kritikues ndaj organizatorëve turq në flotën humanitare Mavi Marmara që shkaktoi lëkundjen dhe ftohjen e marrëdhënieve turko - izraelite.⁷

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë lëvizja e Gylenit filloi të bëjë aktivitete të dendura për hapjen edukativo - arsimore në hinterlandin e Turqisë, ku bën pjesë edhe Ballkani me çka u shndërrua në iniciues kryesor i hapjes edukativo - arsimore turke në Ballkan gjatë dy dekadave të fundit. Në këtë kontekst, duhet cekur se lëvizja e Gylenit nuk mjaftoi me fushatën arsimore vetëm brenda kufijve të rajoneve fqinje të shtetit turk, por inicioi edhe formimin e mbi 1000

7 *Shih* tr.fgulen.com

institucioneve edukativo – arsimore në 100 shtete të botës nga shkolla filllore deri në universitete.⁸

2.2. Partia AK e Erdoganit

AKP – ja e Erdoganit u formua më 2001 dhe solli frymë të re në arenën politike turke. Formuesit më eminent të kësaj partie ishin ish nxënësit e Erbakanit islamist, ish bashkëpunëtorët e Ozallit dhe personalitete të rëndësishme nga e djathta qendrore. Më pas kësaj partie iu bashkëngjiten edhe ish funksionarë të partive të njohura majtiste. Kjo parti konservative, në politikën dhe strategjinë e saj të jashtme në masë të madhe ndikohet nga doktrina e thellësisë strategjike të Ahmet Davutogllut, ministri i punëve të jashtme të Turqisë dhe ish kryekëshilltari i Erdoganit për politikë të jashtme. Doktrina e Davutogllut e njohur si thellësi strategjike synon shndërrimin e Turqisë në *shtet qendror* e më në fund në *aktor global* apo fuqi globale. Pos principeve si *balancë mes sigurisë dhe lirisë, zero probleme me fqinjët, përfaqësim më të madh në organizatat ndërkombëtare, diplomaci ritmike, zhvillimi i marrëdhënieve me rajonet fqinje* vizioni davutogllian dallohet edhe me principin e *shumëdimensionalitetit dhe të soft power* – it që parasheh intensifikimin e investimeve akademike rajonet fqinje të Turqisë, ku bën pjesë edhe Ballkani.

3. Investimet turke edukativo – arsimore në Ballkan në dy dekadat e fundit

Tabela 1: Investimet turke edukativo – arsimore në Maqedoni⁹

Shkolla fillore	Shkolla të mesme (kolegje)	Universitete
Sh.f. Jahja Qemal	Kolegji Jahja Qemal Shkup (1996)	Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik (1996)
	Kolegji Jahja Qemal Gostivar (1999)	
	Kolegji Jahja Qemal Strugë (2002)	
	Kolegji Jahja Qemal Strumicë	
	Kolegji Jahja Qemal Tetovë (në ndërtim e sipër)	

8 *Shih* Turgut, Pelin, “The Turkish Imam and His Global Educational Mission”, www.time.com / 26 april 2010.

9 Öktem, Kerem, *New Islamic actors after the Wehhabi intermezzo: Turkey’s return to the Muslim Balkans*, St. Antony’s College, University of Oxford, 2010, f. 38.

Tabela 2: Investimet turke edukativo - arsimore në Kosovë¹⁰

Qendra arsimore Gylistan (2000)
Kolegji Mehmet Akif Prishtinë (2000)
Kolegji Mehmet Akif Prizren
Kolegji Mehmet Akif Gjakovë

Tabela 3: Investimet turke edukativo - arsimore në Bosnjë¹¹

Fondacione	Shkolla Fillore	Kolegje	Universitete
Sema (1997)	Sarajevë	Sarajevë	Universiteti Burxh (2008)
	Zenicë	Bihaç	Universiteti Ndërkombëtar i Sarajevës (2008)
	Tuzlë	Tuzlë	

Tabela 4: Investimet turke edukativo - arsimore në Shqipëri¹²

Fondacione	Kolegje	Medrese që menaxhohen në koordinim me KMSH ¹	Universitete
Sema	Mehmet Akif Tiranë	Cerrik, Liria, Elbasan	Universiteti Epoka (2008)
	Hasan Riza Pasha, Shkodër	Hafëz Ali Korça, Kavajë	Universiteti Bedër (në koordinim me KMSH)
	Institucioni Parashkollor Mehmet Akif Tiranë	Mahmut Dashi, Tiranë	
	Qendër Kursesh Meridian, Tiranë	Medreseja Vexhi, Tiranë	
		Medreseja e Korçës	

Fillimisht duhet përmendur se aktivitetet edukativo – arsimore të lëvizjes Gylen konsiderohen si investimet e para turke në fushën e arsimit në Ballkan. Këto shkolla sollën konkurrencë me çka rritën cilësinë e arsimit në këto treva.

10 Öktem, Op.cit.

11 Öktem, Op.cit.

12 Öktem, Op.cit.

Këto institucione arsimore kanë karakter shumëgjuhësor dhe shumëkulturore (p.sh. në Jahja Qemal të Maqedonisë përdorën maqedonishtja, turqishtja dhe anglishtja dhe mësojnë nxënës me përkatësi të ndryshme etnike dhe fetare) dhe kanë për synim shndërrimin e gjuhës turke në gjuhë ndërkombëtare. Si shkollat fillore dhe kolegjet, poashtu edhe universitetet e kësaj lëvizjeje kanë karakter laik ku jepet rëndësi të veçantë lëndëve dhe drejtimeve të shkencave natyrore.

Duhet cekur se nka ky rregull bëjnë përjashtim medresetë në Shqipëri dhe Universiteti i Bedrit në Tiranë (institucione këto të cilat edhe zyrarisht i takojnë KMSH – së, megjithatë menaxhohen bashkë me lëvizjen e Gylenit)¹³ ku ekziston departmenti i Shkencave Islame në kuadër të Fakultetit të Shkencave Humane. Ndonjëherë këto shkolla transferojnë edhe problematikat nga shoqëria turke në shoqëritë e Ballkanit (p.sh. ka raste kur përdorimi i shamisë për vajzat muslimane ndalohet nga ana e udhëheqësisë së këtyre shkollave, gjë që nuk ndalohet me kushtetutën apo ligjet e këtyre shteteve. Si ilustrim mund të mirrret rasti i kolegjit të kësaj lëvizjeje në Shkup ku ndalohet vijimi i mësimi nga ana e nxënësve me shami, edhe pse kjo gjë lejohet në të gjitha institucionet arsimore në Maqedoni qofshin ato publike apo private)

Nga viti 2002 me ardhjen e AKP – së në pushtet si rezultat i politikës së jashtme pro – aktive dhe integruese që inkujaronte investimet edukativo – arsimore jashtë shtetit filloi edhe rritja e numrit të institucioneve edukativo – arsimore të kësaj lëvizjeje. Risia e kësaj periudhe të re është është se lëvizja e Gylenit nga faza e hapjes së kolegjeve kaloi në një fazë më të avancuar ku pos hapjes së kolegjeve filloi edhe formimi i institucioneve të arsimit të lartë (si Burc University në Sarajevë, Universitetet Epoka dhe Bedër (në koordinim me KMSH – në) në Tiranë.¹⁴

Gjithashtu, ndër karakteristikat kryesore të viteve të 2000 – ta në fushën e investimeve arsimore turke në Ballkan është edhe fakti se pos lëvizjes së Gylenit, me inkujarim të qeverisë erdoganiane edhe lëvizjet tjera të sektorit joqeveritar të Turqisë filluan të realizojnë aktivitete konkrete në këtë fushë. Këtu si ilustrim mund të merret hapja e Universitetit Ndërkombëtar të Sarajevës dhe hapja e Universitetit Ndërkombëtar Ballkanik në Shkup, universitete këto që kanë karakter laik dhe që nuk i takojnë lëvizjes së Gylenit. Duke pasur

¹³ Öktem, Op.cit.

¹⁴ Rreth rolit të sektorit privat dhe joqeveritar turk në formimin e institucioneve arsimore në Ballkan *shih* Idriz, Mesut, “The Role of Endowment Foundations in the Private Higher Education in the Balkans: The Case of the Minority Muslim Communities”, paper presented at 2nd International Conference on Islam and Higher Education (2nd ICIHE), the Pahang State Foundation Complex, Malaysia, 14-16 November 2011.

parasysh konkurrencën e madhe në arsimin e lartë në Ballkan mendoj se këto universitete duhet të intensifikojnë aktivitetet me synim të rritjes së cilësisë për të qenë konkurrentë në tregun akademik në këto troje. Për në fund duhet potencuar se me ardhjen e partisë AK në pushtet, iniciativat e sektorit privat turk kanë mbështetje të hapur politike edhe nga ana e qeverisë turke. Mbështetja e këtyre shkollave nga ana e shtetit turk ka për synim faktorizimin e Turqisë në këtë rajon. Pos mbështetjes politike ndaj këtyre institucioneve qeveria turke me anë të Projektit të Madh për Studentë të Ministrisë së Arsimit dhe Dijanetit jep bursa për studentë nga Ballkani, me çka intensifikon hapjen arsimore të Turqisë ndaj Ballkanit.

Përfundime dhe rekomandime:

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë elita politike turke filloi të krijojë strategji multidimensionale që kishin për synim hapjen politike, ekonomike dhe kulturore të Turqisë ndaj *hinterlandit* të saj. Në këtë periudhë si rezultat i rrethanave të reja të globalizmit Turqia pos hapjes së lartëpërmendur filloi edhe një fushatë të re edukativo – arsimore në Ballkan. Investimet edukativo – arsimore turke në Ballkan u realizuan me anë të individëve të sektorit privat dhe joqeveritar në krye me lëvizjen e Gylenit, shumë herë pa pasur mbështetjen e hapur të politikëbërësve turq për shkak të rrethanave ideologjike. Por, dekada e parë e viteve 2000 – ta është dëshmitare të një momenti të ri, ku me ardhjen e Partisë AK konservative në krye të qeverisë turke pos iniciativës së sektorit privat, kemi edhe inkujarimin e qeverisë turke për rritjen e investimeve edukativo – arsimore në këtë rajon të rëndësishëm për politikën e re turke pro – aktive dhe integruese. Në këtë kontekst, lëvizjen e Gylenit dhe faktorin e partisë AK të Erdoganit mund ti rradhisim si dy faktorë kyqë që ndikuan dhe sot e kësaj dite ndikojnë në ecurinë e investimeve të lartëpërmendura. Duhet cekur se institucionet edukativo – arsimore të Gylenit sollën konkurrencë me çka rritën cilësinë e arsimit në këto treva. Këto institucione arsimore kanë karakter shumëgjuhësor dhe shumëkulturor dhe kanë për synim shndërrimin e gjuhës turke në gjuhë ndërkombëtare. Si shkollat fillore dhe kolegjet, poashtu edhe universitetet e kësaj lëvizjeje kanë karakter laik ku jepet rëndësi të veçantë lëndëve dhe drejtimeve të shkencave natyrore.

Nga viti 2002 me ardhjen e AKP – së në pushtet si rezultat i politikës së jashtme pro – aktive dhe integruese që inkujaronte investimet edukativo – arsimore jashtë shtetit filloi edhe rritja e numrit të institucioneve edukativo

- arsimore të kësaj lëvizjeje. Risia e kësaj periudhe të re është është se lëvizja e Gylenit nga faza e hapjes së kolegjeve kaloi në një fazë më të avancuar ku pos hapjes së kolegjeve filloi edhe formimi i institucioneve të arsimit të lartë (si Burxh University në Sarajevë, Universitetet Epoka dhe Bedër (në koordinim me KMSH - në) në Tiranë. Gjithashtu, ndër karakteristikat kryesore të viteve të 2000 - ta në fushën e investimeve arsimore turke në Ballkan është edhe fakti se pos lëvizjes së Gylenit, me inkujarim të qeverisë erdoganiane edhe lëvizjet tjera të sektorit joqeveritar të Turqisë filluan të realizojnë aktivitete konkrete në këtë fushë. Duhet potencuar se me mbështetjen e këtyre investimeve edukativo - arsimore shteti turk synon faktorizimin e Turqisë në suaza rajonale, më vonë edhe globale. Për në fund mund të rekomandojmë:

§ Rritjen e numrit të institucioneve edukativo - arsimore turke duke pasur parasysh rolin e tyre në zhvillimin e marrëdhënieve mes shteteve të Ballkanit dhe Turqisë.

§ Rritjen e cilësisë së institucioneve turke të arsimit të lartë për të qenë konkurrentë në tregun akademik në Ballkan.

§ Inkuadrimin e më shumë akademikëve vendas nëpër institucionet e arsimit të lartë me orgjinë turke me synim të rritjes së cilësisë

§ Hapjen e filialeve të universiteteve më prestigjioze të Turqisë në Ballkan me çka do të kontribuohet në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në këto troje.

§ Mostransferimin e problematikave shoqërore që i takojnë shoqërisë turke dhe veprimin në ujdi me rrethanat e këtij rajoni.

Referencat:

1. Khalilzad, Zalmay et.al., *Türk Batı İlişkilerinin Geleceği: Stratejik Bir Plana Doğru*, ASAM Yayınları, İstanbul, 2001.
2. Lesser, O. Ian et.al., *Balkanlar'dan Batı Çin'e Türkiye'nin Yeni Jeopolitik Konumu*, Alfa Yayınları, İstanbul, 2000.
3. Saybaşılı, Kemal et.al. (ed.), *Yeni Balkanlar Eski Sorunlar*, Bağlam Yayınları, İstanbul, 1997.
4. Lütem, E. Ömer et.al. (ed.), *Balkan Diplomasisi*, ASAM Yayınları, Ankara, 2001.

5. Fuller, E. Graham, *Yeni Türkiye Cumhuriyeti*, Timaş yayınları, İstanbul, 2008.
6. Makovsky, Alan et.al. (ed.), *Changing Dynamics of Turkish Foreign Policy*, Washington Institute for Near East Policy Press, Washington D.C., 2000
7. Robins, Philip, *Turkey and Middle East*, Royal Institute of International Affairs, London, 1991.
8. Turgut, Pelin, "The Turkish Imam and His Global Educational Mission", www.time.com / 26 april 2010.
9. Sözen, Ahmet, "New Principles of Turkish Foreign Policy Making" *Paper presented at the annual meeting of the ISA s 49th ANNUAL CONVENTION BRIDGING MULTIPLE DIVIDES Hilton San Francisco CA USA Mar 26 2008*, http://www.allacademic.com//meta/p_mla_apa_research_citation/2/5/2/2/0/pages252203/p252203-1.php/.
10. Ali, Muhamed, *Impaktet e Doktrinës së Thellësisë Strategjike në Politikën e Turqisë Ndaj Lindjes së Mesme (tezë masteri)*, UEJL - Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike, Tetovë, 2009.
11. Öktem, Kerem, *New Islamic actors after the Wehhabi intermezzo: Turkey's return to the Muslim Balkans*, St. Antony's College, University of Oxford, 2010.
12. Idriz, Mesut, "The Role of Endowment Foundations in the Private Higher Education in the Balkans: The Case of the Minority Muslim Communities", paper presented at 2nd International Conference on Islam and Higher Education (2nd ICIHE), the Pahang State Foundation Complex, Malaysia, 14-16 November 2011.
13. tr.fgulen.com

MËSIMDHËNIA INTERAKTIVE DHE ROLI I KOMUNIKIMIT NË VLERËSIMIN E STUDENTIT

Evis TASKA

Mediterranean University of Albania

Nevila RAMA

Mediterranean University of Albania

ABSTRACT:

The study will be focus on the educational system in Albania, based on the monitoring, evaluating, counselling of the quality of the pre-university and university education and the functions of its managerial structures (schools, Regional Directorates of Education, Educational Office, Universities) etc.

The study will describe the development of the didactic-educational process and its management, the problems raised at schools-universities regarding the ways of communications, as an important tool for creating an ethical clima and professional care of the students. It will be also focus on the implementation of the normative provisions of the school, the ethical code of the teacher, the job achieved by the school board and its democratic actors.

Hyrje

Ndjekur nga rendësia e reformave të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës mbi demokratizimit e sistemit të mësimdhënies në Shqipëri, ky studim do të theksojë rëndësinë që Universitetet i japin krijimit të një klime dhe etike profesionale në këtë proces, ndikimi i madh i tyre në motivim, duke theksuar kujdesin ndaj studentëve të tij.

Studimi kryesisht fokusohet në disa koncepte të lidhura ngushtë me çështjen e mësimdhënies interaktive në auditor. Këtu theksohet se mësimdhënia e sotme mund të quhet lehtë interaktive, pasi studentët inkurajohen që të angazhohen në një mënyrë sa më aktive në gjithë procesin e mësimdhënies-mësimnxënies. Mësimdhënësit, me anë të përdorimit të teknologjisë së re apo e thënë ndryshe, artit të shkencës së komunikimit, prezantojnë një kulturre të re, duke krijuar një mjedis ku studentët mund t'i shprehin lirshëm mendimet e tyre, të ndërveprojnë dhe të komunikojnë me idetë e njëri-tjetrit, të ndahen në grupe, dhe kështu të gjithë të mësojnë nga njëri-tjetri. Kjo është e rëndësishme sot në kontekstin e një zhvillimi evropian të vendit tonë, përmes komunikimit të brezave të rinj në një shoqëri shumëkulturore nesër.

Më tej, do të argumentohet rëndësia se mësimdhënësit duhet t'i menaxhojnë ligjëratat e tyre në mënyrë që studentët të marrin pjesë aktive, pa menduar se do të gabojnë para pedagogeve të tyre apo studenteve të tjerë. Do të paraqitet problematika e komunikimit mes pedagogut dhe studentit në rolin e lehtësuesit dhe jo të penguesit, në menyrë që t'i motivojë dhe nxit studentët që të marrin pjesë aktive në orë, në debate, diskutime, duke theksuar motivimin e tyre përmes artit të komunikimit e për t'i arritur qëllimet e përbashkëta.

Mësimdhënia interaktive dhe roli i komunikimit në vlerësimin e studentit

Një nga prirjet me rëndësi gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit në procesin e mësimdhënies në Shqipëri është edhe pasurimi i mjeteve dhe formave mësimore, prezantimi i një koncepti të ri, siç ishte përdorimi i mesazheve nga mediat (internet, artikujt e gazetave, videoregjistrimet, referimet nga radioja e televizioni, përdorimi i të dhënave historike gojore, përdorimi i rezultateve të punës projektuese: fotografitë, hartat, grafikët etj. të punuara nga vetë studentet, përdorimi i materialeve të fotokopjuara dhe të dosjeve të studentit etj.), i asimiluar pranueshëm nga studentët dhe mësimdhënësit. Gjate gjithë këtij procesi të ri dhe në zhvillim vërehet se ai vjen me një menyrë të re komunikimi, kulturre të shprehurit, të asimiluarit, përmes një klime etike profesionale të ndërsjelltë, e cila motivon, përfshin dhe forcon akoma më shumë lidhjen student-pedagog.

Ndjekur nga rëndësia e reformave të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës mbi demokratizimit e sistemit të mësimdhënies në Shqipëri, Universitetet sot

i japin nje rëndesi te madhe krijimit të një klime dhe etike profesionale, te cilat ndikojne dukshem në dukurine e motivimit, duke theksuar kujdesin ndaj studentëve të tij.

Mësimdhënia është një proces dhe jo një produkt, ndaj si e tillë, ajo zhvillohet dhe ndryshon me kalimin e kohës. Pedagogë te ndryshem lëvrojne metoda të ndryshme nga njëri-tjetri, jo vetëm nga eksperinca e tyre, jashtë dhe brenda auditorit. Megjithatë, jo të gjithë pedagogët rriten në profesionin e tyre. Rritja dhe përmirësimi vijnë përmes përvojës, teorisë dhe reflektimit. Kërkues dhe studiues të ndryshëm bien dakord se një mësimdhënie cilësore përfshin disa komponentë si:

- krijimi i një ambienti pozitiv dhe dashamirës në auditor;
- motivimi i pjesëmarrjes së studentëve;
- nxitja e konkurrencës dhe e sfidës akademike;
- përgjigjja ndaj nevojave që kanë studentët për të mësuar;
- korrektësia në vlerësimin e aftësive të tyre.

Indikatorët e një mësimdhënie cilësore mund të përfshijnë:

- zgjedhjen efektive të materialeve studimore;
- organizimin e leksioneve në bazë të një informacioni të bollshëm dhe relevant;
- aftësitë për të komunikuar efektivisht;
- njohuritë dhe entuziazmi për subjektin e leksioneve;
- përgjegjshmëria mbi opinionet dhe kërkesat e studentëve.

Por sa i rëndësishëm është komunikimi në këtë proces?

Interaktiviteti

Shumica e njerëzve sot, pavarësisht nëse ato kanë fëmijë që studiojnë ose jo, do të ketë kuptuar se auditorët janë ndryshe, ose se edhe metodat e mësimdhënies kanë ndryshuar shumë vitet e fundit. Në fakt koncepti i mësimdhënies ka ndryshuar, duke prezantuar dhe bashkëpunuar më së miri gradualisht me teknologjinë. E gjitha kjo sot ofron më shumë.

Teknologjia Interaktive duket të jetë mjaft e përhapur në këtë proces dhe për një arsye shumë të mirë. Komunikimi interaktiv premtion shumë për të ardhmen e mësimdhënies. Ndonjëherë ai mund të jetë një betejë në angazhimin e studentëve për të prezantuar dhe marrë njohuritë në auditor.

Duke prezantuar lloje të ndryshme të teknologjisë gjatë mësimdhënies, duke ju dhënë një rol primar gjatë keëtij procesi, tepër inkurajuese për mësimdhënësit se më parë, nuk ka dyshim në efektin pozitiv që do të ketë në cilësinë e mësimdhënies që ata mund të ofrojnë. Vetëm imagjinoni, në qoftë se ju ofrohet një mësim, ku shënimet janë shkruar në një tabelë me shkumës normal ose një tjetër, ku gjatë komunikimit është përdorur teknologjia interaktive, cili do të ishte me i efektshëm? Fuqia e përdorimit të teknologjive të reja tregon se shumë auditorë tashmë janë praktikantë të përhershëm të tyre, duke u bërë metoda e preferuar e mësimdhënies. Do të jetë interesante të shihet se si këto metoda të zhvillohet akoma më tej në të ardhmen.

Përdorimi i këtyre mjeteve do të thotë që mund të përmirësojë rrjedhjen e mësimëve dhe të bëjë përvojën e të mësuar më shumë i efektshëm për të gjithë të përfshirë. Ndryshimet e bëra në informacionin e këtyre formateve, projektuar mbi whiteboard nga kompjuterat, mund të ruhen dhe të përdoren përsëri në mësim të ardhmen. Aftësia për të bërë ndryshime të menjëhershme në dokumentet kursen kohë dhe është shume efikas, i menjëhershëm dhe praktik njëkohësisht. Këto menyra Interactive kanë potencial të përmirësojnë mësimdhënien dhe të nxënit duke përmirësuar të kuptuarit e koncepteve të reja dhe rritjen e motivimin e nxënësve dhe përfshirje. Përdorimi i tyre con në nje nivel interaktive të larte, që do të thotë që procesi i mësimdhënies të jetë më shumë emocionuese dhe angazhimi i studentit të rritet ndjeshëm.

Mësimdhënia interaktive mund të realizohet duke përdorur metoda të ndryshme si përfshirë prezantime interaktive dhe pamore me ngjyra. Shembuj të tillë efikas dhe tërheqëse në të njëjtën kohë ka plot, si metoda që përdoren gjërësisht sot në mësimdhënien shqiptare. Në auditoret tona, nëse kompjuteri i përdorur është e lidhur me folës dhe një DVD ose video, atëherë multimedia mund të përfshihet gjithashtu, me një efekt shumë profesional.

Një mënyrë tjetër e realizimit me efektshmeri dhe interaktivitet më të lartë është edhe kur kompjuteri i përdorur gjatë lesioni është i lidhur në internet. Kështu mund të navigojmë në faqet e internetit me të rëndësishme, të përzgjedhura me parë nga pedagogu, për të forcuar dhe rritur me temën që prezantohet. Mësimi mund të përforcohet me lojra dhe kuize të shpejtë.

Të jesh në gjendje të komunikosh me studentët në mënyra të ndryshme e bën më të lehtë për të siguruar që kjo audiencë është e interesuar. Në këtë mënyrë ata mund të angazhohen, duke përdorur mjete dhe forma të ndryshme të cilat ndihmojnë për të mbajtur vëmendjen e tyre. Kështu është e sigurtë se gjithëpërfshirja e tyre do të jetë tepër pozitive dhe e larte. Komunikimi Interaktiv kombinuar me teknologjine jep një kontribut të rëndësishëm për prezantimin

e informacionit të ri, modelimit e koncepteve të reja dhe të proceseve, duke krijuar simulimet, nxitjen e diskutimit dhe shpjegimin e ideve të reja. Studentet gjithashtu mund të marrë kontrollin e teknologjise se perdorur dhe të përdorin platformën që të paraqesin idetë e tyre me pjesën tjetër të klasës për diskutim. Kjo i inkurajon ata të punojnë së bashku për të kuptuar lëndën dhe lejon mundësi për shqyrtimin dhe reflektimin e çdo gjë mësuar në auditor.

Kështu mësimdhënia e sotme mund të quhet lehtë interaktive, pasi studentët inkurajohen që të angazhohen në një mënyrë sa më aktive në gjithë procesin e mësimdhënies-mësimnxënies. Mësimdhënësit, me anë të përdorimit të teknologjisë së re apo e thene ndryshe, artit të shkencës së komunikimit, prezantojnë një kulture të re, duke krijuar një mjedis ku studentët mund t'i shprehin lirshëm mendimet e tyre, të ndërveprojnë dhe të komunikojnë me idetë e njëri-tjetrit, të ndahen në grupe, dhe kështu të gjithë të mësojnë nga njëri-tjetri. Kjo është e rëndësishme sot në kontekstin e një zhvillimi europian të vendit tonë, përmes komunikimit të brezave të rinj në një shoqëri shumëkulturore nesër.

Menaxhimi i ligjëratave nga vetë pedagogët

Por sa i rëndësishëm është menaxhimi i ligjëratave të dhëna nga vetë pedagogët? Më tej, do të argumentohet rëndësia se mësimdhënësit duhet t'i menaxhojnë ligjëratat e tyre në mënyrë që studentët të marrin pjesë aktive, pa menduar se do të gabojnë para pedagogëve të tyre apo studenteve të tjerë. Do të paraqitet problematika e komunikimit mes pedagogut dhe studentit në rolin e lehtësuesit dhe jo të penguesit, në menyre që t'i motivojë dhe nxit studentët që të marrin pjesë aktive në orë, në debate, diskutime, duke theksuar motivimin e tyre permes artit te komunikimit e për t'i arritur qëllimet e përbashkëta.

Gjëja e parë për të realizuar në nje ore interaktive është se nuk është diçka e re apo misterioze. Nëse një mësues bën pyetje në klasë, apo cakton detyrat dhe i kontrollon, apo të bëjë diskutime, atëherë ky process është interaktiv. Në thelb, mësimi interaktiv është vetëm duke u dhënë studentëve diçka për të bërë, duke u kthyer atë që ata kanë bërë, dhe pastaj ta asimilojnë atë. Deri këtu, ky proces është mëse normal.

Gjithsesi komunikimi nderaktiv nuk është gjithmonë i lehtë. Ka disa shkaqe të mundshme të cilat e pengojnë studentin këtë proces si:

- të mos ketë kuptuar nje koncept të rëndësishëm të shpjeguar më parë dhe kështu vazhdimi është i pakapshëm kollaj

- të ketë humbur një informacion të mëparshëm, kështu që strukturat konceptuale në të cilën është bazuar leksioni mungojnë,
- mungesa e interesit, motivimin, ose dëshira për të bërë përpjekje mendore për të ndjekur prezantimin, të kuptojnë argumentet, dhe të vleresojnë konkluzionet.

Dy aspekte të rëndësishme akademike janë: metodologjia e mësimdhënies dhe marrëdhëniet pedagog-student. Si do ta ngrinte cilësinë e mësimdhënies dhe ofronte një realitet tjetër në marrëdhëniet pedagog-student? Në realizimin e këtij binomi vërehën 4 parime që garantojnë këtë sukses:

Së pari, është karakteri “pluralist” i informacionit. D.m.th. studenti ekspozohet para të gjitha pikëpamjeve, rrymave a teorive që popullojnë tregun e ideve, debateve teorike apo zgjidhjeve praktike, nepermjet cilësise se përgatitjes akademiko-profesionale të profesoratis dhe liria e shprehjes.

Parimi i dytë lidhet me atë se si konceptohet mësimdhënia. Pedagogu nuk duhet paraqitur apo vlerësuar si i “gjithëpushetshëm” në auditor. Ai stimulon debatin, pjesëmarrjen aktive të studentit, nxitjen e të menduarit në mënyrë kritike dhe përpunimin e informacionit. Ajo që ndikon në një mësimdhënie efektive e cilësore është, së pari, komunikimi i hapur dhe i lirë, i paparagjykuar nga vetë pedagogu apo edhe studentët e tjerë. Së dyti, roli prej “moderatori” i profesorit. Ky vërtet ofron hapësirë për debat dhe artikulum pikëpamjesh të ndryshme.

Parimi i tretë, lidhet me mënyrën se si konceptohet komunikimi në të shkruar. Janë percaktuar dhe pranuar disa norma të pranueshme dhe të detyrueshme se si shkruhet, mendohet, kritikohet, strukturohet apo eksplorohet dhe paraqitet një temë. Mendimi kritik dhe proceset e përfshira në të janë elementë thelbësorë të programit mësimor universitar dhe kualifikimit pasuniversitar të studentëve. Në asnjë nivel tjetër si në atë universitar, nuk është më i rëndësishëm aplikimi i të menduarit në mënyrë kritike Futja e lendeve te tilla si “Shkrim akademik” apo edhe lëndë të tjera komunikimi rrisin së tepërmi cilësinë e komunikimit pedagog-student, duke i ndihmuar këta të fundit në formimin e aftësive menaxheriale nesër në karrierën e tyre.

Parimi i katërt lidhte me atë se si konceptohen marrëdhëniet pedagog-student. Ky gjykohet të jetë një raport i hapur, profesional dhe shoqëror njëkohësisht. Në këto marrëdhënie sundon toleranca, fleksibiliteti, qartësia për raportin të drejta - detyrime dhe vlerësimi shumëkomponentësh.

Ndikimi i vlerësimit të performancës së shkollave apo Universiteteve tek performanca e vetë studentit

Faktori më i rëndësishëm dhe unikal që përcakton cilësinë e nxënies së nxënësit/studentit është cilësia e mësuesit/pedagogut të tij, e thënë ndryshe vlerësimi i performancës së mësimitdhënësit. Mësimdhënia dhe arsimit plotësojnë aspektet ekonomike dhe kulturore të një shoqërie të bazuar në dije dhe për këtë arsye duhen parë në kontekstin e tyre social. Mësuesit/Pedagogët duhet të jenë të aftë:

- *Të punojnë me të tjerë*
- *Të punojnë me njohuritë, teknologjinë dhe informacionin*
- *Të punojnë me dhe në shoqëri*

Dhe mbi bazën e atyre vlerësimeve ne ose ata krijojmë bindjet për njerëz, për dukuri natyrore a shoqërore, për objekte, për etosin e shoqërisë, shkollës, për arritjet shkencore, etj. Gjatë shkollimit vlerësimi është i përditshëm dhe përfshinë arritjet në të nxënësit dhe veprime të tjera psikologjike, etike, edukative, etj.

Matja përdoret për qëllime të ndryshme

- **Mësimore:** siguron të dhëna për përparimin e nxënësve duke përfshirë edhe materialet mësimore, motivimin etj.
- **Diagnostikuese:** maten njohuritë, aftësitë, anët e forta e anët e dobta të nx. e të mësimdhënies.
- **Orientuese:** maten interesat për punë për punë të nxënësit; maten cilësi të zhvillimit vetjak të nxënësit.
- **Administrative:** sigurohen të dhëna për personelin, nr. të nxënësve, buxhetin etj.
- **Për politikën arsimore:** sigurohen të dhëna për efektshmërinë e sistemit arsimor dhe ecuria e zhvillimit të tyre.
- **Kërkimore:** sigurohen të dhëna kërkimore për përparimin e mëtejshëm të shkollës.

Këto tipe informacioni kanë të bëjnë me :

- qëllimet e një shkolle/universiteti
- strategjitë dhe planet e tij

- procesin e zbatimit
- rezultatet e zbatimit të tij

Por përse do të ndikonte ky vlerësim i performancës së një mësuesi në performancën e vetë nxënësit/studentit si dhe të vetë shkollës/universitetit më pas? Janë disa rezultate të këtij procesi kaq të rëndësishëm, të cilat qëndrojnë të lidhura for me njera-tjetrën si:

- Gjykon vlerat dhe meritat, është proces krahasimi, gjykon vlerat mbi bazën e informacionit të grumbulluar nga procesi i matjeve dhe vrojtimit
- Vlerat i gjykon përkundrejt një standarti
- Mbështetet në evidencën e brendshme dhe në kritere të jashtme
- Shërben për të sjellë përmirësime
- Shërben për të përcaktuar arritjet
- Siguron informacion për vendimmarrësit
- Siguron informacion për të interesuarit
- Shërben për të ushtruar autoritetin
- është product
- Që një vlerësim të jetë i vërtetë, ai duhet të bazohet në matjen objektive, të saktë, të vlefshme, të besueshme.

Në nivelin shkollor vlerësimi përmbushë pesë nevoja kryesore. Sipas D. Nevo ato kanë të bëjnë me vendimmarrjen, përmirësimin, përgjegjësinë e llogaridhënien, profesionalizmin dhe certifikimin. Një vlerësim i tillë i performancës së mësuesit dhe të vetë Universitetit do të ndihmonte në kuptimin e thelbit të procesit të vlerësimit si një proces sistematik, që mbledh informacione për objektet arsimore dhe gjykon vlerat dhe meritat e tyre.

- Nxënësit/studentët dhe arritjet e tyre nuk duhet të jenë i vetmi objekt vlerësimi në shkollë apo Universitet.
- Rezultatet dhe ndikimi nuk duhet të jetë e vetmja gjë që duhet shqyrtuar kur vlerësojmë një program, një projekt ose një objekt tjetër të shkollës.
- Vlerësimi i shkollës duhet kryer për qëllime formuese dhe përmbledhese duke siguruar informacion për planifikimin, përmirësimin, por edhe për certifikimin dhe përgjegjësinë.
- Nuk duhet gjykuar cilësia e shkollës, mësuesit, nxënësit dhe program vetëm duke u bazuar në një kriter të vetëm.

- Për të drejtuar një vlerësim të dobishëm në shkollë është e nevojshme të përdoret një tërësi mjetesh dhe procedurash kërkimore që përdoren në shkencat e edukimit, duke u përshtatur me nevojat e shkollës.
- Në vlerësimin në bazë shkolle, vlerësimi i brendshëm është kushti parësor për një vlerësim të jashtëm të dobishëm.

Si përfundim, theksohet edhe një herë rëndësia se mësimdhënësit duhet t'i menaxhojnë ligjëratat e tyre në mënyrë që studentët të marrin pjesë aktive, pa menduar se do të gabojnë para pedagogëve të tyre apo studenteve të tjerë. Janë të shumta problematikat e komunikimit mes pedagogut dhe studentit në rolin e lehtësuesit, duke e gjykuar këtë rol si mbështetës, stimulus, motivues, dhe jo të penguesit, në mënyrë që t'i motivojë dhe nxit studentët që të marrin pjesë aktive në orë, në debate, diskutime, duke theksuar motivimin e tyre përmes artit të komunikimit e për t'i arritur qëllimet e përbashkëta, atë të një brezi të arsimuar, të gatshëm për një performancë të lartë në fushat e ndryshme të jetës profesionale.

Bibliografia

“Vlerësimi arsimit” ISP (2002)

IKT (2008) “Standartet e mesuesit, drejtuesit, trajnerit” Raporti kualifikimit QTKA 2008

Kreitner, R. Kinicki, A. Organizational Behavior, Mc-Graw Hill Custom Publishing for Western Michigan University, 2007

Carnegie, D. Si të sillemi me njerezit. Baça, Tiranë, 2005

Scriven, M. Paul, R. Defining critical thinking: A draft statement for the National Council for Excellence in Critical Thinking The University of Tennessee at Chattanooga, 1996

Thompson, N. The impact of conflict resolution education on participating students and their families: A qualitative case study. 2000

Thompson, N. The teaching process: An interaction of experience, theory, and reflection. Journal of Family and Consumer Sciences Education, Vol. 18, No. 1, Spring/Summer, 2000

www.mash.gov.al

www.melcrum.com

<http://www.enqa.eu/>

CILËT JANË FAKTORËT QË PËRBËJNË KËRKESAT PASUNIVERSITARE, DHE CILAT JANË NIVELET E PAJTIMIT ME KËTA FAKTORË?

Nevila XOXA

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Greta ANGJELI

Universiteti Mesdhetar i Tiranës

Vladimir MICI

Universiteti Mesdhetar i Tiranës

ABSTRACT

The aim of this survey is to evaluate the reasons behind the demand for postgraduate programs and the relationships between these reasons among disciplines. This survey was administered to 150 students randomly chosen from master with thesis and doctorate programs at the Mediterranean University of Albania, International University of Struga and Polytechnic University of Tirana. The developed questionnaire was analyzed with SPSS15 (The statistical packet for the social sciences) packaged software. The Chi-square statistical technique was used to determine whether there were meaningful relationships between the groups, and meaningful differences were found between disciplines. The results indicated that one of the important goals of students in graduate education is the self-development in scientific terms.

Keywords: postgraduate education, postgraduate educational demand, master and doctorate programs.

Hyrje

Njerëzit në shekullin e 21 janë të vetëdijshëm se dituria është një fuqi dhe armë e madhe. Njerëzit e ditur luajnë rol domethënës dhe kanë autoritet të

konsiderueshëm në fushat ekonomike, sociale dhe politike në të gjithë botën. Kështu institucionet arsimore, në të cilat prodhohet dhe përmisohet dija, duhet të rrisin rëndësinë e tyre. Aktualisht, me rritjen e kërkesës për fuqi punëtore të kualifikuar, kërkesat individuale për vetë-përmirësim dhe kërkesat në rritje për kushte më të mira në çdo fushë, rrisin kërkesën për arsimim (Sanler et al., 2005). Prandaj, individët që punojnë, të cilët kanë përfunduar arsimin e tyre të lartë ende përipiqen të jenë në kontakt me zhvillimet e njohurive dhe aftësive si dhe synojnë të lëvizin në drejtim të arsimit pasuniversitar.

Baza metodologjike e arsimit në vendin tonë është “Programi Kombëtar i Arsimit”. Programi Kombëtar i Arsimit përfshin të gjitha aktivitetet sistematike dhe të paramenduara, që kanë si qëllim plotësimin e nevojave për të mësuar. Ai përfshin shumëllojshmëri programesh dhe tipesh arsimit, të cilat janë ndërtuar duke u mbështetur në tabanin kombëtar.

Në Programin Kombëtar të Arsimit nuk përfshihen mësimi i rastësishëm që ndodh si pasojë e një ngjarjeje, p.sh. mbledhjet, seminarët etj. Pjesë e Programit Kombëtar të Arsimit është edhe sistemi i treguesve statistikorë, të hartuar në bazë të kërkesave që ka procesi mësimor, organizimi e drejtimi i shkollës si dhe të administratës shtetërore, në radhë të parë të Ministrisë së Arsimit e Shkencës dhe INSTAT-tit. Duke filluar që nga viti 1997, sipas rekomandimeve të UNESCO-s për klasifikimin e Niveleve të shkollave dhe Fushave të studimit të përcaktuara në “ISCED-97”, Klasifikimi Ndërkombëtar Standart i Arsimit-1997, shkolla në vendin tonë ndahet në këto nivele:

- § Niveli 0 - Arsimit parashkollor;
- § Niveli 1 - Cikli i Ulët i Arsimit 9-vjeçar;
- § Niveli 2 - Cikli i Lartë i Arsimit 9-vjeçar;
- § Niveli 3 - Arsimit Mesëm;
- § Niveli 4 - Arsimit mbi të mesmen dhe jo i lartë;
- § Niveli 5 - Arsimit i Lartë universitar dhe jouniversitar;
- § Niveli 6 - Arsimit Pasuniversitar për tituj dhe grada shkencore.

Sipas ligjit Nr.8461, datë 25.2.1999 për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë misioni i arsimit të lartë është:

1. të krijojë, të zhvillojë, të mbrojë e të transmetojë dijet me anën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, të zhvillojë dhe të cojë përpara artet, edukimin fizik dhe sportet;

2. të formojë specialistë të lartë;

3. të përgatisë shkencëtarë të rinj

Arsimi i lartë kryhet në shkollat e larta universitare dhe në shkollat e

larta jouniversitare. Shkollat e larta universitare janë institucione mësimore-shkencore që kanë për detyrë:

1. të realizojnë arsimimin profesional dhe formimin shkencor, nëpërmjet mësim-dhënies e kërkimit shkencor;
2. të kryejnë studime shkencore në fushat që mbulojnë dhe të pergatisin shkencëtarë të rinj

Shkollat e larta jouniversitare janë institucione mësimore dhe detyrë kryesore kanë pergatitjen e specialistëve me kualifikim të lartë. Arsimi pasuniversitar jep një pasqyrë hulumtuese në njohuritë dhe aftësitë e fituara nga individët në arsimin parauniversitar, si dhe mund të merret në konsideratë si një forcë shtytëse në zhvillimin e komunitetit.

Rritjet në këtë lëvizje janë bërë një ndikim shumë i madh në Shqipëri, dhe kërkesa për arsim pasuniversitar është rritur për shumë arsye si dëshira për promovim profesional, dëshira për t'iu bashkuar stafit akademik apo dëshira për të gjetur një punë më të mire.

Arsimi pasuniversitar është një sistem për trajnimin e shkencëtarëve, akademikëve dhe menaxherëve të lartë, të cilët do të kenë një zë në të ardhmen e vendit të tyre. Programet Master, që zhvillohen në kuadër të arsimit pasuniversitar, përbëhen nga arsimi i lartë bazuar në studimet universitare dhe kanë si qëllim arritjen e rezultateve në arsim, trajnim dhe hulumtim.

Në përputhje me studimin e Varis (1984), objektivat e programeve Master dhe Doktoraturë mund të përmbliidhen si më poshtë: qëllimi i programeve Master është për tu përgatitur për programet e doktoraturës, për të siguruar njohuri akademike të nevojshme për mësimdhënie në shkollat e mesme dhe të larta, për të siguruar trajnim adekuat për stafin në fushat e biznesit përkatës dhe për të trajnuar punonjës dhe studiues shumë të kualifikuar.

Në krahasim, qëllimi i programeve të doktoraturës është trajnimi i shkencëtarëve, anëtarëve të fakultetit dhe hulumtuesve të cilët do të planifikojnë, kryejnë, finalizojnë dhe publikojnë studimet themelore të nevojshme për zhvillimin ekonomik dhe teknologjik, si dhe do të sigurojnë kryerjen e këtyre të fundit me qëllim të njohurive dhe brezit të teknologjisë.

Prandaj, arsimi universitar zë një vend kyç në zhvillimin dhe të ardhmen e shumë shoqërive. Arsyet pse njerëzit tani i kushtojnë rëndësi më të madhe arsimit universitar janë si më poshtë: për shkak të rritjes së papritur të popullsisë, përhapjes së konceptit të drejtësisë sociale dhe rritjes së kërkesave të njerëzve. Të gjitha këto kanë sjellë rritje të konsiderueshme të numrit të studentëve që ndjekin programe të studimeve të ndryshme në universitete.

Kjo rritje çoi në specializimin e programeve si dhe në faza të tjera të arsimit, dhe si rezultat nivelet e përgjithshme të specializimeve janë rritur. Për këtë shkak, nevoja për krijimin e universiteteve të reja ka çuar në nevojën për të trajnuar anëtarë të fakultetit. Nevoja për të trajnuar punonjës shumë të kualifikuar dhe specialistë të nevojshëm në fushat shkencore dhe teknike në pothuajse çdo vend, rritja graduale e numrit të studentëve për trajnim të specializuar në këto fusha dhe një pritje për zgjatjen e afatit të nevojshëm për specializime i ka dhënë arsimit pasuniversitar një rëndësi akoma dhe më të madhe.

Pavarësisht profesionit që individët ushtrojnë, ata duan të mësojnë edhe më shumë për të përmbushur rolin e tyre social në mënyrë efektive dhe për të rritur njohuritë e tyre të përgjithshme dhe kapacitetet intelektuale.

Në këtë kontekst, dhe si një kusht i rëndësishëm i të jetuarit në një shoqëri elite, gatishmëria dhe dëshira e një personi për të studiuar e mësuar më shumë rritet me shpejtësi çdo ditë. Risitë në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit kanë sjellë të mësuarit gjatë gjithë jetës. Veçanërisht në vendet në zhvillim, kjo dëshirë mund të arrijë në një nivel që mund të sjellë ndryshime ekonomike. Nga një sondazh të kryer me studentët e diplomuar në vitin '95 në Shkenca Arsimore, në disa vende të zhvilluara të Europës u zbulua se arsytet për të studiuar në një program master përfshinin: ndërtimin e një karriere (35%), zhvillimin e aftësive personale (39%), studimin nën domosdoshmërinë profesionale (5%), arritjen e një statusi më të mire (18%) dhe interesimin (2%). Në një studim të kryer mes studentëve të Shkencave Ekonomike në vitet '89, lehtësia për të gjetur një punë dhe/apo dëshira për një karrierë akademike u identifikuan të përbënin 10% të arsyeve pse studentët e diplomuar studionin për një diplomë master. Në këto vite, qëllimet e studentëve të diplomuar u karakterizuan kryesisht si lehtësi për të gjetur punë dhe dëshirë për një karrierë akademike. Nga ana tjetër, studimi i kryer në vitin 2003 zbuloi se, ndërmjet arsyeve për të marrë një diplomë master, specializimet profesionale ishin në krye të karrierës akademike më shumë se sa lehtësia në gjetjen e një pune. Këto rezultate tregojnë se studentët janë të ndërgjegjshëm dhe kanë dëshirë për arsimim të vazhdueshëm.

Duke filluar në tremujorin e fundit të shekullit të njëzetë, procesi i tranzicionit në një shoqëri të bazuar në dituri filloi në vendet e zhvilluara, dhe një strukturë e re globale ekonomike të quajtur "ekonomia e dijes" mori formë.

Në këtë strukturë të re, fuqia ekonomike e individëve matet me nivelet e dijes dhe arsimit, dhe konkurrenca e vendeve matet me kapitalin njerëzor dhe social. Ky proces ka rritur pritjet e universiteteve, të cilët janë kryesisht

përgjegjës për prodhimin dhe ndarjen e njohurive (Strategjia Kombëtare për arsimin e lartë në Shqipëri - SKALA, 2008).

Pas studimeve universitare, do të ishte një zgjedhje e mirë studimi për një diplomë master me qëllim specializimin në disipinën e mësuar gjatë shkollimit universitar, ndërtimin e një karriere akademike apo aplikimin në një mjedis akademik në kuadër të aktivitetit të biznesit.

Ne të gjithë i dime kërkesat për të punuar në një kompani të mirë apo pasjen e një karriere të shquar në ditët e sotme. Kjo është arsyeja pse ne ndiejmë nevojën për të rritur aftësitë tona për të arritur zhvillim personal si dhe për të vënë veten një hap përpara kandidatëve të tjerë gjatë procesit të përzgjedhjes së punës. Masteri duket se është një alternative e rëndësishme. Normat e shkollimit janë rritur me rreth 50% në vendet e përparuara dhe me 100% në vendet me të ardhura të ulëta dhe mesatare.

Arsimi i Lartë në Shqipëri e ka zanafillen në vitin 1946, me Institutin 2 vjeçar të Tiranës

Në Shqipëri tendenca e rritjes së kuotave të studimeve universitare në universitetet publike është:

Tabela 1 Studentë të regjistruar për çdo universitet publik

	Viti shkollor									
	2000/01	2001/02	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06	2006/07	2007/08	2008/09	2009/10
Studentë gjithsej	40859	42160	43600	53014	63257	74157	86178	90202	93206	116292
- Meshkuj	15790	16036	16420	20168	25129	30832	37312	39283	40596	52162
- Femra	25069	26124	27180	32846	38128	43325	48866	50919	52610	64130
Nga gjithsej:										
1.Universiteti Tiranës	16757	15597	15776	18877	21,313	24189	27745	27318	26197	32884
-Meshkuj	6506	5792	5391	6511	7,270	8420	9800	9368	8351	10411
-Femra	10251	9805	10385	12366	14,043	15769	17945	17950	17846	22473
2.Universiteti Politektik	2668	3116	3644	4243	5,340	5368	6297	7035	8543	9812
-Meshkuj	1959	2359	2695	3128	3,941	3960	4614	4875	6180	7069
-Femra	937	757	949	1115	1,399	1408	1683	2160	2363	2743
3.Universiteti Bujqësor	2150	2702	2820	3694	5,021	6488	6841	7262	8608	9350
-Meshkuj	1213	1471	1599	2183	3,083	4144	4459	4616	5405	5951
-Femra	937	1231	1221	1511	1,938	2344	2382	2646	3203	3399
4.Universiteti Elbasan	4433	5094	5353	6476	7,982	9403	10518	9531	8112	9547
-Meshkuj	827	938	1087	1505	2,084	2873	3448	3074	2636	3172
-Femra	3606	4156	4266	4971	5,898	6530	7070	6457	5476	6375
5.Universiteti Shkoder	6285	6952	6535	7386	8,148	10089	10608	9689	9402	12195
-Meshkuj	2474	2744	2463	2728	3,234	3924	3651	3728	3230	4834
-Femra	3811	4208	4072	4658	4,914	6165	6957	5961	6172	7361
6.Universiteti Gjirokaster	3822	3743	3364	3871	4,261	4997	4553	4179	3354	3723
-Meshkuj	1155	1118	1065	1252	1,606	2182	1965	1794	1504	1796
-Femra	2667	2625	2299	2619	2,655	2815	2588	2385	1850	1927
7.Universiteti Korçë	2002	1833	2322	2764	2,938	3670	3686	3702	3009	4028
-Meshkuj	555	449	773	860	900	1373	1334	1464	1193	1709
-Femra	1447	1384	1549	1904	2,038	2297	2352	2238	1816	2319
8.Universiteti Vlorë	1372	1596	2124	3382	4,940	6874	8520	8139	7691	7659
-Meshkuj	400	402	554	875	1,508	2299	4257	3282	3129	3267
-Femra	972	1194	1570	2507	3,432	4575	4263	4857	4563	4392
9.Akademia e Arteve	521	578	644	710	776	859	1774	961	946	973
-Meshkuj	309	325	341	391	428	478	1008	565	544	583
-Femra	212	253	303	319	348	381	766	396	402	390
10.Akademia e Edukimit Fizik	312	455	448	500	519	528	558	551	575	772
-Meshkuj	307	355	346	391	415	428	457	451	476	645
-Femra	85	100	102	109	104	100	101	100	99	127
11. Shkolla e Lartë e infermierise	457	494	570	706	1,036	0	0	0	0	0
-Meshkuj	85	83	106	152	227	0	0	0	0	0
-Femra	372	411	464	554	809	0	0	0	0	0
12.Universiteti Durrës							999	2329	3358	4506
-Meshkuj							391	1074	1476	1982
-Femra							608	1255	1882	2524

Tabela 2 Studentë të regjistruar në universitetet jopublike

	Viti shkollor									
	2000/01	2001/02	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06	2006/07	2007/08	2008/09	2009/10
Studentë gjithsej në Univ. JoPublike				405	983	1692	4079	9506	13411	20843
- Meshkuj				192	433	751	1928	4992	6473	10743
- Femra				213	550	941	2151	4514	6938	10100

Kjo rritje e cila ndodhi në një periudhë shumë të shkurtër prej vetëm 4 vitesh, tregon se në mbarë botën po ndodh një transformim i madh në arsimin e lartë. Ky intesifikim i arsimit të lartë ndodh për shkak të kërkesës në rritje Brenda grupmoshave 18-23 vjeç, zakonisht në vendet më pak të zhvilluara, të cilat bien në përkufizimin tradicional të studentëve.

Plani Kombëtar i Zhvillimit ka përcaktuar tre sektorë më prioritarë: Turizmin, Industrinë Agro-Ushqimore dhe zhvillimin e Eksporteve në përgjithësi. Këto prioritete do të pasqyrohen edhe në miratimin e kuotave në rritje të numrit të studentëve në IAL. Në vitin 2005-2006 vetëm 13 % e studentëve ndiqnin programe studimi në drejtime si matematika, fizika, informatika dhe shkencat inxhinierike në përgjithësi. Ky raport, i krahasuar me 26%, që është mesatarja e vendeve të BE-së, sugjeron ndërmarrjen e një studimi për të gjykuar nëse duhet vendosur objektiva më të lartë pjesëmarrjeje në formimet e mësipërme, bazuar në nevojat e zhvillimit të vendit dhe përvojat analoge në rajon dhe më gjerë.

Arsimi i lartë është planifikuar me qëllim trajnimin e shkencëtarëve, kërkuesve dhe punonjësve shumë të kualifikuar për të cilët shoqëria ka nevojë. Anëtarë të fakultetit (pedagogët) dhe studentët duhet të punojnë në harmoni për të arritur qëllimet e arsimit të lartë. Në këtë proces, I cili I ngjan marrëdhënies ndërmjet një mjeshtri dhe një nxënësi, anëtarët e fakultetit duhet të zgjedhin nxënësit për cilësinë dhe sasinë e dëshiruar.

Në Shqipëri, arsimi i lartë përcaktohet si arsimi që është i bazuar në studimet universitare dhe përbëhet nga arsimi i lartë universitare, programet master, programet doktoratutë jouniversitare te larta dhe specializime mjekësore, si dhe studime mbi to, trajnime, hulumtime shkencore dhe aktivitete të aplikimeve. Ky arsim përbën një fazë të planifikuar e programuar arsimore që çon në shkallë të ndryshme të ndjeljes së studimeve të larta, prodhon dituri dhe teknologji nëpërmjet kërkimit, drejton zhvillimin e vendit dhe synon drejt trajnimit të shkencëtarëve. Nga një këndvështrim tjetër, arsimi universitar kontribon në aritjen e qëllimeve të vendeve. Këto kontribute mund të përshkruhen si anëtarë të ardhshëm të fakulteteve si dhe gjetje e zgjidhjeve për problemet në zhvillimin teknologjik, ekonomik dhe kulturor të një vendi.

Arsimi universitar është kthyer në një kërkesë në të gjithë botën për pjekuri dhe specializim në fushën e shkencës. Ndikimi I tregut të punës, si në shumë fusha ka filluar të shihet edhe në institucionet arsimore.

Rritja e numrit të të diplomuarve bën që individët të ndjekin nivele më të avancuara arsimore me cilësi të ndryshme. Në këtë këndvështrim, arsimimi universitar mund të shihet si një investim që synon rritjen e të ardhurave në të ardhmen e një individi dhe në statusin social të tij.

Por qëllimi i arsimit universitar nuk është vetëm investim personal. Përtej qëllimeve individuale në arsimin e lartë qëndrojnë qëllimet për trajnimin e punonjësve të kualifikuar, të nevojshëm për zhvillimin e një vendi, si dhe pedagogë të trajnuar fakulteti e shkencëtarë , të cilët, nga ana tjetër do ti trajnojnë këta punonjës.

Zhvillimi I vendeve është I mundur në qoftë se studiuesit mund të prodhojnë zgjidhje të shpejta për problemet, për informacionin, komunikimin, bashkëpunimin në punë, nëse ata janë kreativë, dhe nëse dinë se si të kenë qasje në informacione. Universitetet luajnë një rol të rëndësishëm në fuqinë punëtore të kualifikuar.

Qëllimi i arsimit universitar është që të sigurojë individë me njohuri dhe aftësi përtej atyre të mësuara në nivelin e studimeve. Në vendin tonë, kërkesa për arsimin universitar është duke u rritur çdo ditë.

Sot, kërkesa në rritje për një diplomë master mund të shpjegohet si vijon: *Nevoja për arsimin pasuniversitar ka sjellë si rezultat një rritje të numrit të universiteteve. Kjo, në një farë mase, ka ulur cilësinë e arsimit. Një rritje e numrit të studentëve dhe pamjaftueshmëria e arsimit të nivelit të studimit ka çuar në një rritje në nivelin e specializimit.*

Përveç kësaj, në fusha të ndryshme, diplomat master dhe doktorature filluan të shfaqen ndërmjet kërkesave kryesore për pune. Për më tepër, rritja e numrit të studentëve dhe numrit të universiteteve ka çuar në nevojën për pedagogë të fakulteteve. Arsimi universitar është themeli kryesor i universiteteve.

Në Shqipëri, ashtu si në mbarë botën, studentët pas përfundimit të studimeve të tyre universitare, janë të gatshëm për të studiuar për një diplomë master për arsye të ndryshme. Një diplomë master e cila, për ata që do të ndjekin rrugën akademike është një pjesë e procesit arsimor më tepër se një opsion, ofron mundësi të ndryshme për ata që nuk kanë planë të ndjekin rrugën akademike.

Kursi i studimit të një programi master mund të jetë një mundësi për studentët të cilët nuk janë të kënaqur me degën e tyre universitare, për të studiuar në këtë mënyrë një degë të ndryshme dhe kështu të lëvizin në fushën e tyre të dëshiruar.

Gjithashtu paraqet një mundësi për zyrtarët e shtetit për të rritur nivelin e tyre arsimor. Njerëzit në biznes me njohuri të veçanta të fituara gjatë shkollimit të tyre universitar si dhe me menaxhimin e njohurive të përgjithshme të biznesit, mund të bashkohen në programe të tilla që njihen si MBA (Master në Administrim Biznesi). Për të gjitha këto arsye numri i studentëve që ndjekin studime universitare dhe pasuniversitare do të vazhdojë të rritet në vendin tonë dhe në mbarë botën.

Qëllimi i programeve master është kryerja e hulumtimeve shkencore dhe sigurimi i aftësisë së studentëve për të patur akses, interpretuar dhe vlerësuar informacionin. Kërkimet shkencore përcaktohen si përpjekje që synojnë gjetjen ose sygjerjnë zgjidhje për problemet me anë të vëzhgimit të ngjarjeve në fusha të veçanta ose mbledhjen e informacioneve ekzistuese dhe analizimin e të dhënave në mënyrë sistematike. Funkcionet bazë të arsimit universitar, që bazohen në të njëjtën kohë në kryerjen e hulumtimit dhe trajnimit si dhe në kontributin për krijimtari shkencore, mund të përmbidhen si më poshtë:

1. Te prodhojnë dhe përhapin Shkencë/Art:

Tradicionalisht, prodhimi dhe përhapja e shkencës, ashtu siç ndodh përmes hulumtimeve dhe zhvillimit të studimeve, kryeson listën e shërbimeve të pritura nga një universitet. Nëse këto studime kontribuojnë në Shkencë/Art atherë shkalla e këtij kontributi mund të përcaktphet përmes procesit të Shkencës/Artit, me anë të shqyrtimit dhe filtrimit.

2. Për të zbuluar problemet sociale dhe zhvillimin e zgjidhjeve për këto probleme:

Funksioni i dytë i universiteteve sot është të zhvillojë metoda të duhura të zbulimit, identifikimit dhe zgjidhjes së problemeve që lidhen me idealet dhe vlerat e shoqërisë, si dhe ngjarjet aktuale, teknologjike, zhvillimin ekonomik dhe kulturor, si dhe për të ndihmuar për ti vënë ato në praktikë.

3. Për të kontribuar në trajtimin e nivelit të lartë të fuqisë punëtore:

Nje tjetër funksion i rëndësishëm i institucioneve të arsimit të lartë është e ardhmja e anëtarëve të fakulteteve dhe studiuesve. Këta studiues të pavarur do të kryejnë punën e nevojshme për infrastrukturën e ardhshme të vlerave dhe produkteve. Funksione të tjera përfshijnë trajnimin e atyre që do të marrin pjesë në krijimin dhe përhapjen e shkencës, si dhe duke kontribuar në trajnimin e punëtorëve që do të organizojnë dhe kryejnë shërbime private dhe publike .

Në kushtet e pjekurisë dhe specializimit në fushën e shkencës, arsimit universitar është bërë një kërkesë në mbarë botën. Rritja e numrit të të

diplomuarve ka bërë që individët të ndjekin më shumë nivelet e avancuara arsimore dhe me cilësi të ndryshme. Në këtë kuptim, arsimi universitar mund të shihet si një investim që synon rritjen e të ardhurave në të ardhmen e individit dhe statusin e tij social.

Një numër i konsiderueshëm nxënësish që shkojnë në universitet vendosin për të studiuar për një diplomë master para ose pas fillimit të studimeve të tyre universitare. Disa prej tyre vendosin ta bëjnë këtë duke menduar se arsimi universitar do të kontribuojë në zhvillimin e tyre personal ose do ta bëjë më të lehtë gjetjen e një pune. Të tjerët e marrin këtë vendim për shkak se kanë në plan për tu bërë anëtar në fakultet në të ardhmen.

Problemet

Cilët janë faktorët që përbëjnë kërkesat pas universitare, dhe cilat janë nivelet e pajtimit me këta faktorë?

Nën-problemet

1. Cilët janë faktorët që përfshijnë kërkesat e arsimit pasuniversitar në fusha të Shkencave Sociale?
2. Cilët janë faktorët që përfshijnë kërkesat e arsimit pasuniversitar në fusha të Shkencave Ekonomike?
3. Cilët janë faktorët që përfshijnë kërkesat e arsimit pasuniversitar në fusha të Shkencave Shkencore dhe Teknologjike?
4. Cili është niveli i pajtimit në arsyetimin për ndërmarrjen e studimeve pasuniversitare ndërmjet disiplinave më lart?

Metodat

Ky sondazh është bazuar në modelin e anketimit dhe është përdorur si një mjet për të mbledhur të dhënat nga terreni.

Popullsia

Të dhënat për studim janë marrë në takime ballë për ballë nga një intervistues gjatë një periudhe prej 2 javësh në vitet akademike 2009-2010. Të intervistuarit u përzgjedhën rastësisht ndërmjet studentëve master dhe atyre të doktoraturës në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, Tiranë, Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, Maqedoni dhe Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Tiranë. Sondazhi u administrua për 30 studentë - Shkenca Sociale, 49 studentë - Shkenca Ekonomike dhe 71 studentë - Shkenca të Teknologjive të Informacionit.

Mbledhja e të dhënave

Të dhenat u mbledhën përmes një forme të pyetësorit që përmbante 8 pyetje.

Analiza e të dhënave

U llogaritën shpeshësia (f) dhe përqindja (%) e mbledhur. Për të përcaktuar marrëdhëniet midis disiplinave u përdor programi kompjuterik SPSS15 (Paketë Statistikore për Shkencat Shoqërore) dhe u aplikua analiza Chi-square. Gjithashtu u llogaritën koeficientët alfa Cronbach të variablave të varur. Për të krahasuar vlerat e rëndësishme u dha në formë tryeze përqindja e variablave të të dhënave në analizën Chi-square.

Besueshmëria e shkallës është testuar duke përdorur testin Cronbach. Koeficienti alfa Cronbach i elementëve, duke përfshirë cilësinë perceptuese, ishte 0.636. Koeficienti i shkallës ishte mbi 0.60, duke paqyruar kështu një besueshmëri të mirë sipas disa studiusve (Bagozzi dhe Yi, 1988, Greëal, Krishnan, Baker dhe Borin, 1998, Kim dhe Jin, 2001). Kjo shkallë mund të konsiderohet e besueshme.

Konkluzionet

Universitet e zgjedhura mund të karakterizohen si universitet në të cilat studentët janë gjerësisht përfaqësues të Republikës së Shqipërisë në aspektin e karakteristikave social-ekonomike dhe kulturore. Në anketë, ne shohim se 45% e studentëve për master dhe doktoraturë në vitin akademik 2009-2010 janë nga universitete të tjera, gjë që tregon që nuk ka paragjykime të universitetit ndaj studentëve të saj.

Tabela 3 Rezultati i analizës Chi-square për përgjigjet e "Vetë-zhvillimit shkencor"

Vetë-zhvillimi Shkencor	Disiplina			Totali
	Shkencat Ekonomike	Shkencat Tek. të Infor	Shkencat Sociale	
Janë dakort	97 %	97.2 %	97.7 %	97.4 %
As dakort as kundër	2 %	0.0 %	0.7 %	1 %
Janë kundër	1 %	2.6 %	1.5 %	1.6 %
Totali	100 %	100 %	100 %	100 %

$$X^2 = 2.653 \text{ sd}=4 \text{ p}=.618$$

Për të krahasuar përgjigjet pozitive për vetë - zhvillimin shkencor si arsye për të marrë një diplomë master, sipas programeve master të zgjedhura, u krye analiza Chi-Square. Siç tregohet në tabelën 3, 97,4% e studentëve janë dakord me formulimin “vetë - zhvillimin shkencor”. Përveç kësaj, niveli i pajtimit të studentëve në fushën e shkencave Shoqërore (97,7%) është më i lartë se ai për studentët në shkencat Ekonomike (97%) dhe në shkencat e Teknologjive të Informacionit (97.2%). Nuk ka asnjë ndryshim të rëndësishëm mes mendimit të studentëve në shkencat Ekonomike dhe shkencat dhe Teknologjive të Informacionit [$\chi^2(4)=.618, p>05$]. Ky rezultat tregon se niveli i vetë - zhvillimit shkencorë për studentë në fusha të ndryshme pasuniversitare nuk është i ndryshëm. “Vetë - zhvillimin shkencor” është një nga qëllimet më të rëndësishme në ndjekjen e studimeve për marrjen e një diplome master për studentë në shkencat Sociale, shkencat Ekonomike dhe shkencat dhe Teknologjive të Informacionit.

Tabela 4 Rezultatet e analizës Chi-square, në përputhje me fushat pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me deklaratën, “Unë mendoj se njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë arsimit pasuniversitar do të kontribuojnë në zhvillimin e karrierës time”

	Disiplina			
	Shkencat Ekonomike	Shkencat Tek. të Infor	Shkencat Sociale	Totali
Unë mendoj se njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë arsimit pasuniversitar do të kontribuojnë në zhvillimin e karrierës time				
Janë dakort	98 %	95.8 %	93.9 %	95.7 %
As dakort as kundër	1 %	0.0 %	1.5 %	1.0 %
Janë kundër	1 %	4.2 %	4.5 %	3.3 %
Totali	100 %	100 %	100 %	100 %

$$X^2= 3.577 \text{ sd}=4 \text{ p}.466$$

Në tabelën 4 janë paraqitur rezultatet e analizës Chi-square për studentët në përputhje me fushat e tyre pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e

pajtimin me deklaratën, "Unë mendoj se njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë arsimit pasuniversitar do të kontribuojnë në zhvillimin e karrierës time". Kjo tabelë tregon se sipas rezultateve të analizës, pothuajse të gjithë studentët janë dakord me këtë deklaratë. Përveç kësaj, përqindja e studentëve në fushën e shkencave shoqërore që kanë zgjedhur "Jam dakort" (93.3 %) nuk është më e lartë se përqindja e studentëve që ndjekin studimet në programet master në shkencat Ekonomike dhe shkencat e Teknologjive të Informacionit. Megjithatë, ndryshimi nuk është i një niveli domethënës [$\chi^2(4) = 3.577$, $p > 0.05$]. Ky rezultat tregon se nuk ka dallim domethënës midis mendimeve të studentëve në fusha të ndryshme në lidhje me këtë pyetje, me fjalë të tjera, pothuajse të gjithë studentët në arsimin pasuniversitar mendoj se njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë shkollimit pasuniversitar do të kontribuojnë në zhvillimin e karrierës së tyre.

Tabela 5 Rezultatet e analizës Chi-square, në përputhje me fushat pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimin me deklaratën, "Gjatë kohës që jam pa punë, unë dua të kaloj kohën time në këtë mënyrë"

Gjatë kohës që jam pa punë, unë dua të kaloj kohën time në këtë mënyrë	Disiplina			Totali
	Shkencat Ekonomike	Shkencat Tek. të Infor	Shkencat Sociale	
Janë dakort	26 %	29.2 %	18.2 %	23.4 %
As dakort as kundër	12 %	13.8 %	8.3 %	10.9 %
Janë kundër	62 %	56.9 %	73.5 %	65.8 %
Totali	100 %	100 %	100 %	100 %

$$\chi^2 = 6.620 \text{ sd} = 4 \text{ p} = 0.157$$

Në tabelën 5 janë paraqitur rezultatet e analizës Chi-square për studentët në përputhje me fushat e tyre pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimin me deklaratën "Gjatë kohës që jam pa punë, unë dua të kaloj kohën time në këtë mënyrë". Pasi është analizuar shpërndarja në tabelën 5, shihet se shumica e studentëve nuk pajtohen me këtë deklaratë. Shumica e studentëve të cilët kanë zgjedhur "jam kundër" janë nga fusha e shkencave shoqërore (73.5

%). Megjithatë, nuk ka dallim domethënës midis mendimeve të studentëve në fushat e shkencave Ekonomike dhe shkencave të Teknologjive të Informacionit [$\chi^2(4) = 6.620, p > 0.05$]. Këto rezultate tregojnë se shpenzimi i kohës së tyre në këtë mënyrë kur ata janë të papunë, nuk është një nga arsyet e studentëve që ndjekin arsimin pasuniversitar.

Tabela 6 Rezultatet e analizës Chi-square, në përputhje me fushat pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me deklaratën, "Unë dua të punojnë në universitete, si punonjës akademik"

Unë dua të punojnë në universitete, si punonjës akademik	Disiplina			Totali
	Shkencat Ekonomike	Shkencat Tek. të Infor	Shkencat Sociale	
Janë dakort	76 %	58.3 %	59.1 %	64.5 %
As dakort as kundër	10 %	23.6 %	18.2 %	16.8 %
Janë kundër	14 %	18.1 %	22.7 %	18.8 %
Totali	100 %	100 %	100 %	100 %

$$\chi^2 = 10.308 \quad \text{sd} = 4 \quad p = 0.036$$

Në tabelën 6 janë paraqitur rezultatet e analizës Chi-square për studentët në përputhje me fushat e tyre pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me deklaratën "Unë dua të punojnë në universitete, si punonjës akademik". Pasi është analizuar shpërndarja në tabelën 6, shihet se shumica e studentëve pasuniversitarë (64.5%) janë duke marrë një diplomë master/doktoraturë për të punuar si punonjës akademik në universitet. 59.1 % e studentëve të shkencave sociale, 76 % e studentëve të shkencave ekonomike dhe 58.5 % e studentëve të shkencave të Teknologjive të Informacionit.

Vihet re se niveli i pajtimit me këtë deklaratë është më i ulët për studentët në shkencat e Teknologjive të Informacionit. Dallimet janë të një niveli domethënës [$\chi^2(4) = 10.308, p < 0.05$]. Ky rezultat tregon se niveli i pajtimit ndërmjet studentëve me deklaratën "marrë një diplomë master/doktoraturë për tu bërë një punonjës akademik", është i ndryshëm sipas disiplinave.

Tabela 7 Rezultatet e analizës Chi-square, në përputhje me fushat pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me deklaratën, "Unë besoj se është fakt që arsimi përcakton statusin social në shoqëri"

Unë besoj se është fakt që arsimi përcakton statusin social në shoqëri	Disiplina			Totali
	Shkencat Ekonomike	Shkencat Tek. të Infor	Shkencat Sociale	
Janë dakort	83 %	77.8 %	73.5 %	77.6 %
As dakort as kundër	11 %	9.7 %	14.4 %	12.2 %
Janë kundër	6 %	12.5 %	12.1 %	10.2 %
Totali	100 %	100 %	100 %	100 %

$$X^2=4.248 \text{ sd}=4 \text{ p}.373$$

Në tabelën 7 janë paraqitur rezultatet e analizës Chi-square për studentët në përputhje me fushat e tyre pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me deklaratën "Unë besoj se është fakt që arsimi përcakton statusin social në shoqëri". Pasi është analizuar shpërndarja në tabelën 7, shihet se shumica e studentëve pasuniversitarë pajtohem me këtë deklaratë (77.6%). Kur shpërndarjet janë analizuar sipas fushave, vihet re se 73.5 % e studentëve të shkencave sociale, 83% e studentëve të shkencave ekonomike dhe 77.8 % e studentëve të shkencave të Teknologjive të Informacionit besojnë se arsimi pasuniversitar është një fakt që përcakton statusin në shoqëri. Megjithatë, këet dallime nuk janë të një niveli domethënës [$\chi^2(4)= 4.248, p>05$]. Ky rezultat tregon se studentët besojnë se arsimi pasuniversitar përcakton statusin në shoqëri, dhe mendimet e fushave të studentëve janë të afërta me njëria - tjetrën.

Tabela 8 Rezultatet e analizës Chi-square, në përputhje me fushat pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me deklaratën, "Unë besoj se arsimi pasuniversitar rrit të ardhurat në profesionin time aktual"

Unë besoj se arsimi pasuniversitar rrit të ardhurat në profesionin time aktual	Disiplina			Totali
	Shkencat Ekonomike	Shkencat Tek. të Infor	Shkencat Sociale	
Janë dakort	73 %	70.8 %	57.5 %	65.8 %
As dakort as kundër	7 %	16.6 %	12.1 %	11.5 %
Janë kundër	20 %	12.5 %	30.3 %	22.7 %
Totali	100 %	100 %	100 %	100 %

$$X^2=12.870 \text{ sd}=4 \text{ p}.012$$

Në tabelën 8 janë paraqitur rezultatet e analizës Chi-square për studentët në përputhje me fushat e tyre pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me deklaratën "Unë besoj se arsimi pasuniversitar rrit të ardhurat në profesionin time aktual". Shumica e studentëve që morën pjesë në studim (65,8%) specifikuan që ata besojnë se arsimi pasuniversitar rrit të ardhurat në profesionin e tyre aktuale. Kur nivelet e pjesëmarrjeve të studentëve u analizuan sipas fushave, niveli i pajtimit të studentëve në shkencat sociale ishte 57.5%, në shkencat ekonomike 73% dhe shkencat e teknologjisë së informacionit 70,8%. Dallimi është i një niveli domethënës [$\chi^2(4) = 10.308, p < 0.05$]. Ky rezultat tregon se nivelet e pajtimit midis studentëve të shkencave të disiplinave të ndryshme janë të ndryshme.

Tabela 9 Rezultatet e analizës Chi-square, në përputhje me fushat pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me deklaratën, "Unë mendoj se do ta shtyjë shërbimin tim ushtarak, nëse ai do të ishte i detyruar në Shqipëri"

Unë mendoj se do ta shtyjë shërbimin tim ushtarak, nëse ai do të ishte i detyruar në Shqipëri	Disiplina			
	Shkencat Ekonomike	Shkencat Tek. të Infor	Shkencat Sociale	Totali
Janë dakort	37.2 %	18.4 %	27.6 %	27.7 %
As dakort as kundër	2.8 %	11.5 %	6.2 %	7.3 %
Janë kundër	60 %	70.1 %	66.230.3 %	65.0 %
Totali	100 %	100 %	100 %	100 %

$$X^2=5.360 \text{ sd}=4 \text{ p}.252$$

Në tabelën 9 janë paraqitur rezultatet e analizës Chi-square për studentët në përputhje me fushat e tyre pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me deklaratën "Unë mendoj se do ta shtyjë shërbimin tim ushtarak, nëse ai do të ishte i detyruar në Shqipëri". Pasi shpërndarjet në Tabelën 9 u analizuan, shihet se shumica e studentëve nuk pajtohen me këtë deklaratë (65%). Megjithatë, edhe pajtimi në lidhje me shtyrjen e shërbimit të tyre ushtarak është i lartë (27.7%). Megjithatë, dallimi nuk është i një niveli domethënës [$\chi^2(4) = 5.360, p < 0.05$]. Ky rezultat tregon se studentët në përgjithësi nuk ndjekin studime pasuniversitare për të shtyrë shërbimin e tyre ushtarak, dhe sipas përgjigjeve, nuk ka ndryshime domethënëse midis mendimeve të studentëve.

Tabela 10 Rezultatet e analizës Chi-square, në përputhje me fushat pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me deklaratën, "A është fusha diplomimit tuaj pasuniversitar e njëjtë me atë universitare?"

A është fusha diplomimit tuaj pasuniversitar e njëjtë me atë universitare?	Disiplina			Totali
	Shkencat Ekonomike	Shkencat Tek. të Infor	Shkencat Sociale	
Janë dakort	37.2 %	18.4 %	27.6 %	27.7 %
As dakort as kundër	2.8 %	11.5 %	6.2 %	7.3 %
Janë kundër	60 %	70.1 %	66.230.3 %	65.0 %
Totali	100 %	100 %	100 %	100 %

$$X^2=3.884.360 \text{ sd}=2 \text{ p}.14$$

Në tabelën 10 janë paraqitur rezultatet e analizës Chi-square për studentët në përputhje me fushat e tyre pasuniversitare, për të krahasuar nivelin e pajtimit me pyetjen "A është fusha diplomimit tuaj pasuniversitar e njëjtë me atë universitare?". U vërejt se shumica e studentëve kanë zgjedhur studime pasuniversitare në të njëjtën fushë si fusha e studimeve universitare. Pasi u analizua shpërndarja sipas fushave, 82,6% e studentëve të shkencave sociale, 79% e studentëve të shkencat ekonomike dhe 90,2% e shkencave të teknologjisë së informacionit janë duke ndjekur arsimin pasuniversitar në të njëjtën fushë si arsimimin e tyre universitar. Dallimi nuk është i një niveli domethënës [$\chi^2(4)=3.884$, $p<05$]. Bazuar në këtë të përfundim, duket se shumica e studentëve në shkencat sociale, në shkencat ekonomike apo shkencat e teknologjisë së informacionit zgjedhin studime pasuniversitare në të njëjtën fushë si studimi i tyre universitar.

Përfundimet

Rezultate e arritura bazuar në gjetjet e anketave janë të rradhitura në vazhdim:

Një nga arsyt kryesore se pse studentët e shkencave sociale, shkencave ekonomike ose shkencave teknologjike dhe të informacionit vazhdojnë studimet

Master është “vetë zhvillimi shkencor”. Nuk ka diferencë thelbësore ndërmjet opinioneve të studentëve të shkencave sociale, ekonomike, teknologjike apo te informacionit në lidhje me këtë pyetje.

Nuk ka diferencë thelbësore ndërmjet opinioneve të studentëve të shkencave sociale, ekonomike, teknologjike apo te informacionit në lidhje me qëndrimin “Unë mendoj se njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë arsimit pasuniversitar do të kontribuojnë në zhvillimin e karrierës time”. Gati të gjithë studentët që ndërmarrin studime pasuniversitare mendojnë se njohuritë dhe aftësitë e përftuara gjatë arsimit pasuniversitar do të kontribuojnë për zhvillimin e karrierës së tyre.

“Gjatë kohës që jam pa punë, unë dua të kaloj kohën time në këtë mënyrë” nuk është një nga arsyet se pse studentët ndërmarrin studimet pasuniversitare. Nuk ka diferencë thelbësore ndërmjet opinioneve të studentëve të shkencave sociale, ekonomike, teknologjike apo te informacionit në lidhje me këtë pyetje.

Niveli i të qenit dakord me qëndrimin “Unë dua të punojnë në universitete, si punonjës akademik” ndërmjet studentëve të shkencave ekonomike është më e lartë e krahasuar me studentët e tjerë. Diferenca është thelbësore. Kjo tregon se niveli i të qenit dakord më qëndrimin “Unë dua të punojnë në universitete, si punonjës akademik” është e ndryshme në varësi të fushës së studimit të studentëve.

Shumica e studentëve të arsimit pasuniversitar mendojnë se “arsimi përcakton statusin social në shoqëri”. Nuk ka diferencë thelbësore ndërmjet opinioneve të studentëve të shkencave sociale, ekonomike, teknologjike apo te informacionit në lidhje me këtë pyetje.

Për qëndrimin “Unë besoj se arsimi pasuniversitar rrit të ardhurat në profesionin time aktual” studentët e shkencave sociale dhe ekonomike janë më shumë dakord krahasuar me studentët e shkencave të teknologjisë dhe informacionit. Diferenca është thelbësore.

Në fund të anketës arritëm në përfundimin se studentët në përgjithësi nuk i ndjekin studimet pasuniversitare në mënyrë që të shtyjnë shërbimin ushtarak dhe lidhur me këtë qëndrim nuk ka diferencë thelbësore ndërmjet opinioneve të studentëve

Rezultatet e anketës tregojnë se pjesa më e madhe e studentëve vazhdojnë studimet pasuniversitare në të njëjtën fushë të studimeve paraardhëse.

Bibliografia

Austin, A.E. &McDaniels, M. (2006). Preparing the professoriate of the future: Graduate student socialization for faculty roles. In J. C. Smart (Ed.), *Higher education: Handbook of theory and research*, Vol. XXI (pp.397-456). Netherlands.

Ahlas, a. (2006). Approach to postgraduate education of teachers working the Education Ministry. [Unpublished Master Thesis, Gazi University].

Bagozzi, R.P., &Yi, Y. (1988). On the evaluation of structural equation models. *Journal of the Academy of Marketing Science*, 16, 74-94.

Demirbolat, O.A. (2005). The expectation of Master Degree students about Programmer and Teaching Staff. *Journal of Education Sciences, Gazi University*, 47-64.

Grewal, D., Krishnan, R.Baker, J., &Borin, (1998). The effect of store name, brand name and proce discounts on consumer's evaluations and purchase intentions. *Journal of Retailing*.

Institute of Statistics (INSTAT). Social Indicators / Education / Tables and Methodology. <http://www.instat.gov.al/>.

Ministry of Education and Science. Law for Higher Education in Republic of Albania, No 9741. www.mash.edu.al

Sanlier, N., Demirel, H. Koc, G. Ve Demircioglu, H.G. (2005). The problems of graduate Education and Expectations of Students in Gazi University. 28-30.

Sevinc, B. (2001). Graduate Education Applications, Problems and Suggestions. *Journsl of Education Sciences, Ankara University*.

SKALA (Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë) 2008-2013.

Varis, F. (1984). *Journal of Education Sciences*, 49-54.

REFORMA LIGJORE NË ARSIMIN E LARTË PËRBALLË NEVOJAVE TË SHOQËRISË SHQIPTARE

Rovena SULSTAROVA (ÇADRI)
Ministrisa e Arsimit dhe Shkencës

ABSTRACT

In the years 2003-2011 the legislation on higher education in Albania has undergone radical changes that aim to include the country in the European zone of higher education. This paper will look into the problems that interfered with the accommodation of the Albanian education to the standards of Charter of Bologna that demanded several amendments to the legislation. At the focus of the paper will be the question of the role of law to orient the higher education, both public and private, closer to the exigencies of the labour market and the development of the country.

Keywords: Higher education, levels of higher education, Bologna Process, public/private education

Hyrje

Qëllimi i këtij studimi është përshkrimi dhe analiza e komponentëve kryesorë të Procesit të Bolonjës, në kuadër të zbatimit të tyre në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri. Procesi i Bolonjës është produkt dhe vazhdimësi e serive të konferencave evropiane të ministrave përgjegjës për arsimin e lartë dhe vendimeve politike të marra që kanë për qëllim krijimin e Hapësirës

Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL). Studimet universitare në Evropë janë duke iu nënshtruar një ndryshimi të rëndësishëm, nëpërmjet procesit të Bolonjës, përmes së cilës institucionet evropiane të arsimit të lartë kanë pranuar sfidën për të pasur një rol kryesor në ndërtimin e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Pas nënshkrimit të Deklaratës së Bolonjës në 19 shtator 2003 nga Shqipëria, përpara arsimit të lartë shqiptar qëndron sfida e përfshirjes së plotë në HEAL. Për të arritur këtë objektiv madhor është hapur rrugë një epoke të ndryshimeve të rëndësishme ligjore dhe institucionale në arsimin e lartë që do të nxjerrë brezat e rinj të qytetarëve të mirarsimuar dhe të shkencëtarëve. Studimi është i ndarë në tri pjesë. Pjesa e parë përshkruan atë që quhet tashmë Procesi i Bolonjës, duke u përqendruar në elementet kryesorë. Pjesa e dytë merret me mënyrën se si Shqipëria e ka përshtatur sistemin e arsimit të lartë me parimet e Bolonjës, duke u përqendruar te rregullimet ligjore. Pjesa e tretë përbëhet nga përfundimet e këtij punimi.

Elementet e Procesit të Bolonjës

Tërësia e nismave reformuese dhe bashkërenduese për sistemet e arsimit të lartë, që emërtohen Procesi i Bolonjës, është produkt i globalizimit dhe konkurrencës ndërkombëtare. Ndërkohë që integrimi evropian kishte prekur shumë fusha të jetës, organizimi i sistemeve arsimore dhe i kërkimit shkencor mbetet (dhe vazhdon të jetë) atribut i shteteve kombëtare. Kthimi i Evropës në një zonë të dijes dhe të kërkimit të avancuar shkencor, sikurse ka të tilla në Amerikën e Veriut apo në Lindjen e Largët është synimi themelor i bashkërendimit të sistemeve kombëtare të arsimit të lartë në Procesin e Bolonjës. Mund të themi që lëvizshmëria (mobiliteti) i stafeve akademike, i kërkuesve shkencorë dhe i studentëve është zemra e Procesit të Bolonjës. Gjithashtu këtu nuk përjashtohet që pas Procesit të Bolonjës të ekzistojë edhe dëshira e qeverive për të monitoruar më mirë funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për të standardizuar më mirë produktin e arsimit të lartë të i cili ato investojnë paratë e taksa-paguesve. Në fakt kundërshtimi më i madh i Procesit të Bolonjës ka ardhur nga radhët e akademikëve që frikësohen se autonomia e vendim-marrjes brenda universiteteve po u zvogëlohet në emër të përshtatjes së sistemeve të larta arsimore në Evropë. Megjithatë, duhet thënë se universitetet nuk janë më ishuj të izoluar. Ata janë pjesë e rrjeteve të dijes

dhe shkencës, si edhe pjesë e rrjeteve globale të komunikimit, ekonomisë dhe nevojave të qytetarëve në mbarë botën.

Premisat për procesin e Bolonjës u krijuan me Deklaratën e Sorbonës në Harmonizimin e Arkitekturës të Sistemit të Arsimit të Lartë Evropian, të nënshkruar më Maj 1998 nga ministrat e arsimit të katër shteteve: Francë, Gjermani, Itali dhe Mbretëri e Bashkuar. Deklarata e Sorbonës fokusohet në: konvergencë graduale në drejtim të kuadrit të përbashkët të kualifikimeve dhe cikleve të studimit, lëvizshmëria e studentëve dhe pedagogëve si edhe hartimi i një sistemi të përbashkët të nivelit të diplomave. Deklarata e Bolonjës për një Hapësirë Evropiane të Arsimit të lartë, e inspiruar shumë nga Deklarata e Sorbonës, u nënshkrua nga 29 shtete në Qershor të vitit 1999. Deklarata u bë dokumenti i parë nga vendet nënshkruese që krijoi kuadrin e përgjithshëm për modernizimin dhe reformën e arsimit të lartë në Evropë. Për këtë arsye reforma e nisur filloi të quhej procesi i Bolonjës. Në Deklaratën e Bolonjës, ministrat konfirmuan synimin e tyre mbi: një sistem të diplomave të njohura me lehtësi dhe që të jenë të krahasueshme; zbatimin e një sistemi të bazuar kryesisht në dy cikle; krijimin e një sistemi të krediteve; mbështetja e lëvizshmërisë së studentëve, pedagogëve, kërkesave dhe stafit administrativ; bashkëpunimi evropian në sigurimin e cilësisë si edhe dimensionin evropian në arsimin e lartë (në kuptim të zhvillimit kurrikular dhe bashkëpunimit ndërinstytucional).

Formalizimi i mëtejshëm i bashkëpunimit evropian për arsimin e lartë erdhi me Konferencën e Pragës më 2001. Ministrat pjesëmarrës në këtë konferencë vendosën krijimin e një grupi pune Bologna Follow-up Group (BFUG) përgjegjës për zhvillimin e mëtejshëm të procesit. BFUG përbëhet nga përfaqësues të vendeve nënshkruese dhe Komisionit Evropian dhe drejtohet nga vendi anëtar që ka presidencën e Bashkimit Evropian. Konferenca e Pragës theksoi tre elementë të rëndësishëm të Procesit të Bolonjës: të mësuarin gjatë gjithë jetës; përfshirja e institucioneve të arsimit të lartë dhe studentëve si edhe rritjen e tërheqjes së HEAL. Shqipëria u përfshi në Procesin e Bolonjës që nga Konferenca e Berlinit më 2003, që përfshinte 40 shtete evropiane. Me komunikatën e Berlinit, Procesi i Bolonjës fitoi rëndësi shtesë duke vendosur prioritete të qarta për dy vitet në vazhdim: sigurimi i cilësisë në nivel institucional, kombëtar dhe evropian; zbatimin e dy cikleve të studimit; njohja e diplomave dhe periudhave të studimit; kuadri i kualifikimeve për HEAL; përfshirjen e studimeve të doktoratës si cikël i tretë në këtë Proces; si edhe lidhje të ngushta ndërmjet HEAL dhe Hapësirë Evropiane të Kërkimit Shkencor.

Në konferenca të tjera të mbajtura deri tani janë zgjeruar edhe më fushat e bashkëpunimit evropian të Procesit të Bolonjës, sikurse është zmadhuar

numri i vendeve që kanë vendosur të bëjnë pjesë në të. Ndërkaq, Konferenca e Luvenit, e mbajtur në 28 dhe 29 prill 2009, diskutoi arritjet e Procesit të Bolonjës si edhe parashtrori prioritetet për HEAL për dekadën tjetër. Ministrat që nënshkruan komunikatën e konferencës ranë dakord që: çdo vend të vendosë objektiva të matshëm për zgjerimin e pjesëmarrjes së përgjithshme dhe rritjes së pjesëmarrjes për grupet sociale të nën-përfaqësuar në arsimin e lartë deri në fund të dekadës tjetër; në 2020 së paku 20% e atyre të diplomuar në HEAL dhe të ketë një periudhë studimi apo trajnimi jashtë; të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe mundësia e punësimit të jenë misione të rëndësishme për arsimin e lartë; qendra e të mësuarit të studentëve duhet të jetë një qëllim për reformën e vazhdueshme kurrikulare.

Në Budapest, konferenca e mbajtur më 11 dhe 12 mars 2010, lancoi në mënyrë zyrtare HEAL, ashtu si ishte përcaktuar në Deklaratën e Bolonjës të 1999, duke u bazuar në besimin, bashkëpunimin dhe respektin për larminë. Ministrat u angazhuan në zbatimin e plotë të objektivave dhe axhendës për dekadën tjetër të rena dakord në komunikatën e Luvenit. Ata nënvizuan se qëllimet dhe reformat Bolonjës jo gjithmonë janë zbatuar plotësisht shpjeguar si edhe të dëgjohen pikëpamjet kritike të stafit dhe studentëve për të punuar në përmirësimin dhe komunikimin më të mirë rreth këtij procesi. Në veçanti, ministrat bashkërisht mbështetën pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në strukturat vendimmarrëse dhe qendrave të studentëve. Ministrat e vendeve anëtare rekomanduan liri akademike, autonomi dhe përgjegjësi për institucionet e arsimit të lartë. Ata gjithashtu ripohuan faktin që arsimit i lartë është një përgjegjësi publike, dhe përpos vështirësive ekonomike, janë të angazhuar që institucionet e arsimit të lartë të kenë burimet e nevojshme dhe të garantojnë mundësi të barabarta për një arsim cilësor, duke iu kushtuar një vëmendje të veçantë grupeve të nën-përfaqësuar.

Elementët kryesorë të Procesit Bolonjës të zbatuara në vendet nënshkruese janë:

- i) sistemi i studimeve i bazuar në tre cikle;
- ii) sistemi i mbledhjes dhe transferimit të krediteve;
- iii) suplementi i diplomës;
- iv) korniza kombëtare e kualifikimeve;
- v) agjencitë e pavarura të sigurimit të cilësisë;
- vi) nënshkrimi i Konventës së Lisbonës për njohjen e kualifikimeve të huaja.

Zbatimi i këtyre elementëve përmes mekanizmave ligjor është një proces vullnetar i shtetit dhe suksesi i saj dukshëm mund të varet nga konteksti lokal dhe historik i vendit. Këta elementë janë të shtjelluar më poshtë:

(i) Elementi i parë i rëndësishëm i Procesit të Bolonjës është ndarja e programeve të arsimit të lartë në tre nivele të cilësuar cikli i parë, i dytë dhe i tretë, të cilat përfshijnë tre lloje të diplomimit dhe kualifikimit: Bachelor, Master dhe Doktoratë. Një model i përbashkët është zhvilluar për programet Bachelor dhe Master ndërsa për ciklin e tretë, iu është lënë në dorë universiteteve pa ndonjë përpjekje për rregullime të mëtejshme brenda Procesit të Bolonjës. Në nivelin Bachelor dy lloj modelesh janë miratuar nga vende të ndryshme: programe të hartuar me 180 kredite ECTS (me kohëzgjatje 3 vite akademike) si edhe programet me 240 kredite (4 vite akademike). Zgjedhja e bërë në vende të ndryshme reflekton kryesisht kontekstin gjeopolitik si edhe afërsinë historike ndërmjet vendeve në një hapësirë të caktuar. Në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk duket se dominon ndonjë model (Shqipëria, Bosnja Hercegovina, Maqedonia, Kosova dhe Serbia) si edhe në vende të caktuara të Evropës Lindore si (Bjellorusia dhe Moldavia).

(ii) Sistemi i mbledhjes dhe transferimit të krediteve ka për qëllim rritjen e transparencës të rezultateve dhe procesit të të mësuarit si edhe lehtësimin e njohjes së studimeve. Në praktikë, 60 kredite ECTS janë bashkangjitur ngarkesës për një vit akademik me kohë të plotë dhe rezultateve të të mësuarit. Gjithsesi edhe në ato vende ku sistemi i krediteve përdoret, niveli i implementimit është i ndryshëm, në varësi të institucioneve që përdorin këtë sistem dhe mënyrës sesi kreditit caktohen apo shpërndahen. Nga vendet e rajonit, vetëm 4 prej tyre (Bosnja Hercegovina, Kosova, Moldavia dhe Serbia) kanë arritur nivelin e zbatimit të plotë, që konsiston në aplikimin e krediteve ECTS në më shumë se 75 % të programeve të ofruara nga më shumë se 75% e institucioneve të arsimit të lartë.

(iii) Suplementi i Diplomës është një dokument i cili i bashkëlidhet diplomës të arsimit të lartë të kryer dhe ka për qëllim përmirësimin e transparencës në nivel ndërkombëtar dhe të lehtësojë njohjen e kualifikimeve akademike dhe profesionale. Ajo konsiston në 8 seksione të cilat përshkruajnë në veçanti natyrën, nivelin, kontekstin dhe statusin e studimeve të cilat janë përfunduar me sukses. Suplementi gjithashtu përfshin një përshkrim të sistemit të arsimit të lartë në vend. Suplementi i diplomës duhet të lëshohet në dy gjuhë atë vendase dhe/ose anglisht.

(iv) Korniza Kombëtare e Kualifikimeve është një instrument për klasifikimin e kualifikimeve sipas një grupi kriteresh për nivele të caktuara të njohurive, e cila synon të përmirësojë, transparencën, ekselin, avancimin dhe cilësinë e kualifikimeve në lidhje me tregun e punës dhe shoqërinë civile. Ajo përshkruan kualifikimet e ndryshme dhe njohuritë të cilat mund të fitohen në një vend të caktuar dhe i lidh në mënyrë koherente ato me njëri-tjetrin.

(v) Sistemi Kombëtar i Sigurimit të Cilësisë, i referohet procesit të vlerësimit, monitorimit, garantimit, mbajtjes dhe përmirësimit të cilësisë të institucioneve dhe programeve të studimit në sistemet e arsimit të lartë. Në nivel kombëtar ky nivel i vlerësimit të jashtëm të cilësisë duhet në mënyrë ideale të realizohet nga një organ i pavarur, i cili ka autonomi dhe përgjegjësi për veprimet dhe metodat e kryera. Parimi i sigurimit të cilësisë në mënyrë të pavarur, është më shumë një trend sesa një realitet për shumicën e vendeve të rajonit. Në shumicën e vendeve, sigurimi i cilësisë kryhet nga një organ në varësit të qeverisë apo ministrisë.

(vi) Konventa e Lisbonës është një konventë ndërkombëtare, e cila lejon që kualifikimet e fituara në një vend të njihen nga një vend tjetër mbi bazën e disa standardeve të caktuara. Kjo Konventë është nënshkruar nga më shumë se 50 shtete në Evropë dhe më gjerë, përfshirë Shqipërinë.

Reformimi i legjislacionit shqiptar sipas Procesit të Bolonjës

Në vitet 1994 dhe 1999 u hartuan dy ligje të reja për arsimin e lartë shqiptar. Këto ligje synonin krijimin e një përmbajtjeje më moderne të sistemit tonë të arsimit të lartë, sidomos në hapjen e tij ndaj sistemeve të avancuara evropiane dhe me standardet e Këshillit të Evropës. Me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës nga Shqipëria më 19 shtator 2003, ndryshime të tjera iu shoqëruan kësaj reforme, aktualisht me ligjin nr. 9741 dt. 21.07.2007 'Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë' i ndryshuar (LAL). Periudha e tre viteve të para të zbatimit të këtij ligji mund të konsiderohet si periudha e reformimit të thellë të sistemit të arsimit të lartë, përse i përket liberalizimit, reformës kurrikulare, qeverisjes së Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), zhvillimit të shpejtë të arsimit të lartë privat etj. Për këtë arsye ligji i sipërcituar pësoi ndryshime në shtator të vitit 2010, në përshtatje edhe me disa nga elementët e Procesit të Bolonjës.

Sistemi i arsimit të lartë ka pësuar ndryshime thelbësore. Ai përbëhet nga IAL publike dhe private. Numri i studentëve është 2.5 herë më i lartë se ai i vitit 2004. Studimet universitare janë organizuar në tre cikle sipas standardeve të Bolonjës dhe vlerësohen edhe me Sistemin e Transferimit të Krediteve Evropiane (ECTS). Studimet e ciklit të parë përfundojnë me diplomën internacionale "Bachelor", e cila fitohet për 3 vite akademike dhe përfshin 180 ECTS. Edhe pse në diskutimet publike të zhvilluara herë-herë u shtrua alternativa e kalimit në Bachelor me 4 vjet dhe 240 ECTS, Bachelori vazhdoi me 180 ECTS sepse:

1. Gjumnazi dhe shkollat e mesme në tërësi mbështeten në një kurrikulë të re dhe përfundojnë në një nivel qartësisht më të lartë. Studentët e rinj pranohen tani mbi bazën e rezultateve të Maturës Shtetërore, e cila përmban 4 provime dhe pas 2 vjetësh do të shtohet edhe gjuha angleze si provim i detyruar, duke bërë që maturantët të përfundojnë me një "Diplomë të Maturës" (dhe jo me deftesë pjekurie), e cila parashikohet në Ligjin e Korniza Shqiptare e Kualifikimeve dhe është shumë e afërt me atë të shumicës së vendeve evropiane.

2. IAL-të duhet të përmirësojnë më tej kurrikulat e Bachelorit në mënyrë që t'i afrojnë ato me kërkesat e tregut të punës dhe të zhvillimit ekonomik. Në shumë fusha është plotësisht e mundur që diplomat Bachelor, të orientuar qartazi në profesion, të thithen menjëherë nga tregu i punës. Në kushtet kur ne nuk kemi traditë në shkollat e larta teknike ose institutet profesionale si vendet e tjera evropiane, diploma Bachelor e orientuar qartë në profesion përbën një alternativë realiste shkollimi që u mundëson të rinjve daljen në tregun e punës, madje edhe në atë evropian. Në tip tjetër i Bachelor-it 3-vjeçar është edhe ai që ka një kurrikul shumë më të gjerë dhe fleksibël, e cila u mundëson studentëve që të profilizohen shumë mirë në Masterin profesional të shumë drejtimeve të afërta për pozicione pune më të larta se ai i specialistit të thjeshtë. Është e vërtetë se deri tani IAL-të publike dhe private i kanë dhënë përparësi programeve të masterit shkencor, edhe për arsyen sepse ai të çon në nivelin e tretë të studimit dhe në këtë mënyrë IAL-të mbyllin ciklin e plotë të arsimit të lartë. Për këtë arsye, masterat shkencorë kanë tërhequr numrin më të madh të studentëve si edhe ata më të kualifikuar. Mirëpo shpresohet se shumë shpejt diplomat profesionale do të jenë më të kërkuara në treg dhe fakti se jo të gjithë ata që mbarojnë masterin profesional pranohen në doktoratë, do të bëjë që studentët që duan një përfshirje më të shpejtë dhe më të suksesshme të orientohen më drejt. Këtu ndikon shumë edhe cilësia e kurrikulave që ofruara nga IAL-të, sepse ato realisht i pajisin studentët me dijet e kërkuara si për studime të thelluara shkencore, si edhe me dije praktike për tregun e punës.

3. Kërkesa shumë e lartë për arsimin e lartë në vendin tonë, jo vetëm në nivelin Bachelor por edhe në atë master, kërkon një pozicionim të qartë të politikave të mbështetjes së IAL dhe studentëve. Ndërsa cikli i dytë dhe i tretë i studimeve duhet të mbeten relativisht të liberalizuar, por të mbështetur, gjithnjë e më shumë edhe në investimin e vetë studentëve në formën e tarifës së studimeve, duke respektuar përcaktimin e ligjit, sipas të cilit tarifa e shkollimit nuk mund të jetë më e madhe se kostoja reale të studimeve. Ky është fokusi i reformës financiare që pritet të zbatohet në arsimin publik në vitet në vijim e më pas do të shtrihet edhe të IAL-të private. Ajo u krijon më shumë studentëve

mundësinë për të filluar dhe përfunduar arsimin e lartë, si edhe zgjeron lirinë e tyre të zgjedhjes. IAL-të gjithashtu stimulohen për të tërhequr studentët më të mirë, në degët e preferuara, duke ofruar kurrikula më cilësore dhe staf më të kualifikuar.

Siç dihet diploma master është shumë e kërkuar në Shqipëri në vitet e fundit. Masivizimi i pranimeve në IAL-të ka shtuar konkurrencën dhe nga pikëmapja e shumë studentëve e ka bërë të nevojshëm pajisjen me këtë diplomë për të qenë më të avantazhuar në treg. Kjo ka sjellë që mesatarja e viteve të studimeve të rritet në vitet e fundit. Masteri profesional planifikohet të jetë forma më masive e studimeve të ciklit të dytë, sepse plotëson dhe orienton formimin e studentëve që zotërojnë së paku një diplomë Bachelor në një profesion, në mënyrë që studenti të jetë më konkurrues në tregun e brendshëm dhe atë global të punës. Në mënyrë që kjo diplomë të jetë plotësisht atraktive, IAL duhet të bashkëpunojnë ngushtë me sektorin privat dhe punëdhënësit e tjerë potencialë, për të hartuar kurrikula që çojnë në diploma që i përshtaten sa më mirë kërkesave të tregut të punës. Kjo diplomë mund të përfundojë edhe me një tezë të shkruar, nëse shihet e domosdoshme për formimin profesional të parashikuar.

Programi Master i shkencave (MSc) përfshin studime universitare të ciklit të dytë që synojnë thellimin teorik shkencor dhe formimin metodologjik të kandidatëve që kanë përfunduar së paku ciklin e parë të studimeve dhe dëshirojnë të vijojnë studimet e doktoratës. Si e tillë ajo *planifikohet të jetë e kufizuar*, sepse i përgjigjet grupit të të rinjve që synojnë karrierë akademike shkencore. Nisur nga objektivat e diplomës së MSc, IAL-të vendosin kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve. Studentët e këtij programi studimi duhet të japin edhe provimin e gjuhës angleze me testin internacional TOEFL. *Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë* ofrohen vetëm në fushat e mjekësisë, veterinarisë dhe arkitekturës, zgjasin së paku 5 vjet dhe përmbajnë 300 ECTS. Emërtohen të tilla sepse cikli i parë dhe i dytë i studimeve janë të integruara. Kjo diplomë emërtohet “Master i Shkencave” në fushën e arsimimit të kryer. Studimet e ciklit të tretë janë studime tërësisht shkencore me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese.

Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK) u miratua në Kuvendin e Shqipërisë më 2010. Ajo është hartuar në përputhje me Kornizën Europiane të Kualifikimeve. KSHK ka për qëllim të të bëjë të qartë rëndësinë e kualifikimeve për punësimin dhe të mësuarit, duke siguruar bazën për krahasimin e arritjeve me të gjitha pjesët e sistemit të arsimit dhe formimit kombëtar dhe

ndërkombëtar. KSHK përfshin kualifikimet e dhëna në të gjitha nivelet dhe në të gjithë sektorët e sistemit të arsimit e të formimit, përfshirë arsimin e përgjithshëm parauniversitar, profesional dhe të lartë. Zbatimi i këtij ligji ende nuk ka filluar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 424 datë 28.04.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë" përcakton kryerjen e vlerësimit të jashtëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. Kjo kryhet prej Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Në kundërshtim me parimin e paanshëmrisë së këtij organi për kryerjen e një procesi vlerësim të cilësisë, APAAL është është një institucion me statusin e personit juridik publik, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Për të rritur cilësinë dhe transparencën e procesit të paraakreditimit të IAL-ve private ose të drejtimeve të reja të studimeve në to, LAL parashikon përveç vlerësimit të bërë nga APAAL-i edhe shqyrtimin dhe rekomandimin nga ana e Këshillit të Akreditimit. Në Këshillin e Akreditimit janë të pranishëm në mënyrë të balancuar institucionet e arsimit të lartë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, ekspertë të fushave, një student i propozuar nga Këshilli Kombëtar Studentor, dy anëtarë të huaj të propozuara nga agjencitë ndërkombëtare të akreditimit si edhe një përfaqësues nga sektori privat në vend. Vendimmarrja e KA-së kushtëzohet me prezencën e dy anëtarëve të huaj të pranishëm në mbledhje. Ekspertiza si edhe përvoja anëtarëve të huaj do të rrisë cilësinë dhe korrektësinë e vlerësimit për akreditimin apo vlerësimin në nivel institucional apo programe studimi, përfshi këtu edhe për programe të cilat hapen për herë të parë në IAL-te në vend. Grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin institucional të ngrirura nga APAAL duhet domosdoshmërisht të kenë në përbërje një anëtar të huaj. Kjo përbërje e re e KA-së do të sjellë transparencë dhe paanshmëri në vendimmarrje dhe përmirësime të kurrikulave me kërkesat e tregut e punës.

Diplomat që lëshohen nga Institucionet e Arsimit të Lartë, në fund të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë ose të integruar të ciklit të dytë shoqërohen me Suplementin e Diplomës. Suplementi i Diplomës, në përputhje me modelin e hapësirës europiane të arsimit të lartë përmban tetë seksione dhe lëshohet në dy gjuhë atë shqipe dhe angleze dhe falas për të gjithë të diplomuarit, sipas sistemit të Bolonjës. Megjithë përcaktimet e bëra në këtë udhëzim institucionet e arsimit të lartë nuk lëshojnë një dokument të unifikuar të suplementit të diplomës, kjo për shkak të mungesës së një intepretimi kombëtar që duhet ti bëhet të tre cileve të studimit të cilat duhet të jenë në përmbajtje të këtij modeli të diplomës.

Përfundim

Pas Procesit të Bolonjës ndjehet ekzistenca e forcave globale. Universitetet janë të hapura për studentë nga shtete të tjerë dhe tashmë ata klasifikohen jo vetëm në renditje kombëtare, por edhe ndërkombëtare. Stafet e tyre janë duke u ndërkombëtarizuar gjithashtu. Procesi i Bolonjës është një tentativë e shteteve evropiane për të krijuar një zonë të përbashkët të dijës dhe shkencës, që shkon përtej kufijve aktualë të Bashkimit Evropian, por që plotëson logjikën e integritimeve ekonomike dhe politike që kanë krijuar BE-në dhe po orientojnë zgjerimin e saj në kontinent. Me anë të këtij artikulli synuam të paraqesim elementët kryesorë të Procesit të Bolonjës dhe mënyrën se si reforma e arsimit të lartë në Shqipëri po i përshtatet atij. Artikulli është përqendruar në kuadrin ligjor dhe institucionet që rregullojnë reformën.

Elementët themelorë të Procesit të Bolonjës janë tri ciklet e studimit të lartë, sistemi i krediteve, suplementi i diplomës, korniza kombëtare e kualifikimit, agjensitë e pavarura të cilësisë si edhe njohja e kualifikimeve të reja për të gjitha vendet që janë pjesëmarrëse në sistemin e Bolonjës. Ligji i tanishëm i arsimit të lartë, së bashku me shtesat dhe ndryshimet që i janë bërë në vitet e fundit, i ka adresuar këta elementë. Tashmë mund të themi se IAL-të publike dhe private po përshtaten thuajse plotësisht me studimin në tre cikle. Për këtë është parashikuar edhe konvertimi i diplomave të lëshuara përpara hyrjes së fuqi të ligjit dhe rregullimeve të fundit ligjore. Kurrikulat po organizohen në bazë të krediteve dhe ka filluar lëshimi i suplementit të diplomës. Ndërsa APAAL-i është pjesë e vlerësimit të cilësisë dhe i miratimit të programeve të reja, mbetet për t'u zbatuar Korniza Shqiptare e Kualifikimeve. Gjithashtu, Konventa e Lisbonës është nënshkruar nga Shqipëria.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, qeveria shqiptare dhe IAL-të janë të vetëdijshëm që ngritja e këtij kuadri institucional nuk është fundit, por fillimi (i mbarë) i përshtatjes së Shqipërisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Guri i provës i suksesit të reformës shqiptare në arsimin e lartë është lëvizshmëria jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij. Kjo mbetet një sfidë për t'u realizuar në dhjetëvjeçarin e ardhshëm, ku kapacitetet e shtuara në sasi dhe cilësi në arsimin e lartë do të synojnë të përgatisin një brez të ri të të diplomuarve të aftë për të qenë pjesë e një tregu të përbashkët të profesionistëve dhe e rrjeteve shkencore në mbarë Evropën.

Bibliografia

Bache, I. (2006) "The Europeanization of Higher Education: Markets, Politics or Learning", *Journal of Common Market Studies*, 44 (2): 231-248.

Birtwistle, T. (2009) "Towards 2010 (and then beyond) – the Context of the Bologna Process", *Assessment in Education: Principles, Policy and Practice*, 16 (1): 55-63.

Cippitani, R. & Gatt, S. (2009) "Legal Developments and Problems of the Bologna Process within the European Higher Education Area and European Integration", *Higher Education in Europe*, 34 (3-4): 385-397.

European Union's Tempus Programme (2010) *State of Play of the Bologna Process in the Tempus Countries (2009/2010)*. Bruxelles.

Fejes, A. (2008) "European Citizens under Construction: The Bologna Process Analysed from a Governmentality Perspective", *Educational Philosophy and Theory*, 40 (4): 516-530.

Ligji nr. 9741 datë 21.07.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ligji Nr.10247, datë 4.3.2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve".

Neave, G. (2003) "The Bologna Declaration: Some of the Historic Dilemmas Posed by the Reconstruction of the Community in Europe's Systems of Higher Education", *Educational Policy*, 17 (1): 141-164.

Udhëzimi nr. 7, datë 18.04.2009 "Për suplementin e diplomës".

VKM nr. 424 datë 28.04.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë".

II.

FAMILJA

VLERËSIMI I QËNDRIMEVE NDAJ TERAPISË SË FAMILJES

Brilanda LUMANAJ

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

ABSTRACT

The period of turmoil and social changes that affected Albania in the recent years had major effects on family. Its values were often shaken and the facing with many social problems has not always found protection and support with adequate social services for the family. Family therapy is considered as a practice that strengthens families and relationships between its members in overcoming the various social problems. This paper addresses the concept of family therapy and its value to help the family as an important element in overcoming the consequences of psycho-social problems, focusing on the individuals' attitudes toward family therapy in Shkodra. The paper is quantitative and seeks not only to clarify the importance of family therapy but also to assess the perceptions of individuals toward the practice and acceptance of family therapy. The article also aims to analyze the degree of acceptance of family therapy in relation to educational level, age and gender of respondents. Realization of the paper is based on the use of literature in the relevant field and applying the method of surveying.

Keywords : family therapy, social services, empowerment, psycho-social welfare.

Hyrje

Problematikat e shumta psikologjike, sociale dhe ekonomike prekin në një farë mase të gjitha familjet. Disa nga familjet arrijnë të përballojnë vetë situatat problematike por disa të tjera nuk kanë një strukturë të konsoliduar

për shkak të ndikimit të faktorëve të brendshëm apo të jashtëm duke dobësuar aftësitë e tyre për tu përballur me probleme të ndryshme si konflikte ndërmjet anëtarëve të familjes, probleme emocionale dhe psikologjike, të shëndetit mendor, probleme të edukimit të adoleshentëve dhe përballja me sjellje të delinkuencave rinore, marrëdhënie të tensionuara në çift me ndikim në zbehjen e partnertetit mes partnerëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, etj. Ndryshimet në shoqërinë shqiptare janë reflektuar edhe në strukturat familjare dhe në këtë kontekst terapia e familjes është një formë e trajtimit të këtyre ndryshimeve. Ky shërbim nuk është shumë i zhvilluar në realitetin shqiptar prandaj mbetet sfida e profesionistëve të evidentojnë vlerat e saj.

Rishikim i literaturës Kuptimi mbi terapinë e familjes

Terapia e familjes është një term i gjerë e cila bazohet në një sërë metodash për të punuar me familjet me vështirësi të ndryshme biopsikosociale. Ka shumë teori mbi terapinë e familjes. Të gjithë terapistët e familjes theksojnë rolin e familjes në zgjidhjen e problemit (Carr Alan. (2006). *Family Therapy Concepts, Process and Practice*, Second Edition).

Terapia e familjes është një formë e psikoterapisë që përfshin të gjithë anëtarët e një familje bërthamë ose të zgjeruar (Clark, R. Barkley. (1997). *Psychosocial Assessment of Children & Families*). Terapia e familjes bazohet në teorinë e sistemeve të familjes duke vlerësuar pozitën dhe rolin e anëtarëve të familjes në kuadër të sistemit në tërësi. Problemet trajtohen duke ndryshuar mënyrën se si punon sistemi jo duke u përpjekur për të "rregulluar" një anëtar të vetëm (Carr Alan. (2010) *Ten Research Questions for Family Therapy*". Australian & New Zealand Journal of Family Therapy). Terapistët e familjes e shikojnë familjen si një sistem në të cilin çdo anëtar ka një influencë kuptimplotë tek anëtarët e tjerë. Ato ndihmojnë anëtarët e familjes të modifikojnë e të njohin rolin e konflikteve sociale duke synuar ndryshimin në funksionimin social të familjes si njësi dhe si individ (Michael P. Nichols & Richard C. Schwartz. (1994). *Family Therapy*". Third Edition)

Roli i terapisë së familjes në mirëqënien psiko-sociale dhe fuqizimin e familjes

Mirëfunksionimi i familjes dhe struktura e saj ndikojnë në mirëqënien e anëtarëve brenda familjes. Defektet strukturale të familjes si komunikimi

joefektiv dhe niveli i ulët i kohezionit ndërmjet anëtarëve ndikojnë mirëqënien e anëtarëve brenda familjes (Stewart dhe Gavazzi, 1994). Për të ndihmuar në arritjen e mirëqënies psikologjike të anëtarëve terapia e familjes fokusohet kryesisht në arritjen e Homeostazës e cila ndihmon sistemin e familjes në vendosjen dhe ruatjen e stabilitetit të brendshëm. Terapia e familjes ndihmon anëtarët në kapërcimin e problematikave të ndryshme psiko-sociale dhe emocionale. Terapia e familjes ndihmon gjithashtu në përmirësimin e raporteve ndërpersonale mes anëtarëve duke fuqizuar familjen në përballjen me realitetin ku jeton. Mirëqënia psiko-sociale e familjes ndikon edhe në marrëdhënien ndërmjet bashkëshortëve dhe partneritetin mes tyre. Ponzetti dhe Long (1989) zbuluan se marrëdhënia e fortë bashkëshortore është treguesi më i spikatur i një familjeje të shëndetshme. Kultura ndikon në mënyrën se si anëtarët e familjes i shohin problemet, por familja duhet parë si vendimmarrëse përfundimtare për zgjidhjen e problemeve (Bailey, Donald B., Jr. McWilliam, R.A. Darkes, Lynette Aytch Hebbeler, Kathy Simeonsson, Rune J. Spiker, Donna Wagner, Mary. (1998). *“Family outcomes in early intervention: a framework for program evaluation and efficacy research”*). Mirëqënia psiko-sociale gjithashtu është e lidhur edhe me vetëvlerësimin. Virginia Satir (1973) thekson se anëtarët e familjes duke përmirësuar dhe rritur komunikimin arrijnë që të mbrojnë vetëvlerësimin e tyre në krizë. Kështu nëpërmjet terapisë së familjes synohet të rritet vetëvlerësimi i cili më pas ndikon në fuqizimin e anëtarëve të familjes në përballjen e problematikave të ndryshme dhe në rritjen e nivelit të kënaqësisë brenda sistemit familjar.

Metodologjia

Metoda kryesore e përdorur në këtë studim është ajo sasimore, ku nëpërmjet realizimit të anketimit është synuar të vlerësohen përciptimet dhe qëndrimet e individëve ndaj praktikës të terapisë së familjes. Si instrument matës është përdorur pyetësori. Studimi u shtri në qytetin e Shkodrës dhe konkretisht në 5 rajonet që e përbëjnë atë. Të dhënat e përfutuara nga pyetësori janë analizuar përmes programit SPSS. Pyetësori përmban 38 pyetje të organizuara sipas shkallës së vlerësimit (shkalla Liker) dhe është ndarë në 5 rubrika të cilat synojnë të eksplorojnë: problematikat që hasin më shpesh individët në familjet e tyre, shkallën e diskutimit të problemeve personale me të tjerë, personat me të cilët individët e përfshirë në anketim preferojnë të flasin më tepër, përciptimet rreth rolit dhe nivelit të ndihmës që mund të ofrojë terapia e familjes për problematika të ndryshme, shkallën e pranimin për diskutimin hapur të tematikave të ndryshme me terapistin e familjes, preferencat e të anketuarve në lidhje me

mënyrën e realizimit të terapisë së familjes, qëndrimet dhe përceptimet e të anketuarve mbi zbatimin e terapisë së familjes në realitetin shqiptar.

Të dhëna mbi kampionin

Kampioni përbëhet nga 100 të anketuar banues në qytetin e Shkodrës, përkatësisht 20 persona nga 5 rajonet e qytetit. Mënyra e përzgjedhjes së kampionit është rastësore. Kampioni i studimit përbëhet nga 52 % femra dhe 48 % meshkuj. Grupmosha e të anketuarve është përkatësisht: 37% grupmosha 18-27 vjeç; 13% grupmosha 28-37 vjeç; 19% grupmoshat 38-47 dhe 48-57 vjeç; 10% grupmosha 58-67 dhe 67 vjeç e lart 2 %.


Të anketuarit i përkasin në masën 48 % arsimit të lartë, 31% arsimit të mesëm dhe pjesa tjetër 15% e tyre janë: pa arsim (2 %), arsim tetëvjeçar (3 %), ndjekin shkollën (9%) dhe 1% kanë braktisur shkollën.

Analiza e të dhënave

Problematikat më të shpeshta të anketuarve


Të anketuarit paraqesin disa problematika me të cilat ato ndeshen brenda familjes së tyre. Ato shprehen se kanë përjetuar probleme psikologjike dhe ngarkesë emocionale, pikërisht 31 % e të anketuarve deklarojnë se kanë përjetuar “shpesh” probleme të tilla. Lidhja midis variableve “gjini” dhe “përballja me probleme psikologjike/ngarkesë emocionale” është statistikisht domethënëse (Sig. 0.05). P.sh., 22 femra nga 52 në total janë përballur “shpesh” me problematika të tilla. Ndërsa meshkujt shprehen se janë përballur “rrallë” (27 meshkuj nga 48 në total (Grafiku 1).

Grafiku 1



Të anketuarit deklarojnë se kanë hasur vështirësi në lidhje me shprehjen hapur të mendimeve të anëtarëve të familjes për marrjen e vendimeve. 35% e tyre kanë zgjedhur opsionin “gjithmonë” dhe 45% e të anketuarve deklarojnë se janë përballur “shpesh” me këtë vështirësi (Grafiku 2). Një problematikë tjetër me të cilën janë ndeshur të anketuarit është edhe vështirësia ekonomike. Kështu rezulton se 41% e të anketuarve janë përballur “shpesh” me vështirësi ekonomike.

Grafiku 2



Për të krijuar një panoramë më të qartë në lidhje me shkallën e përballjes me problematika të ndryshme të dhënat paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1


Shkalla e përballjes me problematika të ndryshme	Gjithmone	Shpesh	Rralle	Asnjehere	Total
Shprehjen hapur të mendimeve të anëtarëve të familjes për marrjen e vendimeve	35%	45%	16%	4%	100%
Probleme Shëndetësore	7%	11%	65%	17%	100%
Probleme Strehimi	19%	11%	22%	48%	100%
Konflikte ndërmjet anëtarëve të familjes	5%	13%	43%	39%	100%
Probleme Psikologjike/Ngarkesë emocionale	6%	31%	44%	19%	100%
Dhunë fizike në familje	1%	6%	11%	82%	100%
Dhunë emocionale/psikologjike në familje	5%	9%	31%	55%	100%
Punesimi	17%	28%	26%	29%	100%
Strehimi	19%	11%	22%	48%	100%
Veshtirësi ekonomike	7%	41%	44%	8%	100%

Shkalla e diskutimit të problemeve personale me të tjerë si dhe personat me të cilët preferojnë të flasin më tepër të anketuarit

Të anketuarit deklarojnë në masën 42% se ato i diskutojnë “rrallë” problemet e tyre personale me të tjerë. Por brenda familjes të anketuarit preferojnë më tepër ti diskutojnë problemet me motrën/vëllain ku 45% e tyre kanë zgjedhur opsionin “shpesh” dhe 24% opsionin “gjithmonë”. Ndërsa 44% e të anketuarve pohonë se diskutojnë “shpesh” problemet me nënën. Një vënd të rëndësishëm në diskutimin e problemeve zënë edhe shokët/shoqet. Ndërsa diskutimi me babain paraqet përqindjen më të ulët krahasuar me të gjitha alternativat e paraqitura, ku 51% kanë zgjedhur alternativën “rrallë”. Ndërsa 60 % e të anketuarve pohojnë se “asnjeherë” nuk kanë kërkuar ti drejtohen një specialisti për problematikat e tyre.

Lidhja midis variableve “gjini” dhe “diskutimit të problemeve me babain” është statistikisht domethënëse (Sig. 0.05). 14% e meshkujve deklarojnë se preferojnë “shpesh” ti diskutojnë problemet e tyre personale me babain, ndërsa vetëm 7 % e femrave kanë zgjedhur opsionin “shpesh” (Grafiku 3). Ndërsa nga ana tjetër nuk paraqitet një lidhje statistikore ndërmjet gjinisë dhe diskutimit me nënën për problemet personale. Sic duket meshkujt e anketuar paraqesin më tepër se femrat element të stereotipeve gjinore në familjet e tyre.

Grafiku 3 Diskutim i problemeve personale me babain sipas gjinisë




Shkalla e informacionit të anketuarve për terapinë e familjes

Të anketuarit pohojnë se nuk kanë shumë informacion për terapinë e familjes, kështu 51% e tyre shprehen se kanë “pak” informacion. Ndërsa 32% e të anketuarve deklarojnë se kanë “mjaftueshëm” informacion.


Përceptimet e të anketuarve rreth rolit dhe nivelit të mbështetjes/ndihmës që mund të ofrojë terapia e familjes për problematika të ndryshme

Interesante janë përceptimet e të anketuarve në lidhje me përceptimet ndaj rolit dhe ndihmës së terapisë së familjes. Ndër alternativat e ofruara në pyetësor rezultoi se 40% e të anketuarve mendojnë se terapia e familjes ndihmon “shumë” anëtarët e familjes të flasin në terapi për tema që e kanë të vështirë ti diskutojnë brenda familjes. Gjithashtu 24% e femrave krahasuar me 16% të meshkujve mendojnë se terapia ndihmon “shumë” për këtë problematikë. 42% pohojnë se terapia e familjes ndihmon “shumë” në përmirësimin e marrëdhënies prind-fëmijë. Gjithashtu 36% e të anketuarve mendojnë se terapia e familjes ndihmon “mjaftueshëm” në kapërcimin e problemeve psikologjike/emocionale si dhe 32% mendojnë se terapia ndihmon “mjaftueshëm” në kapërcimin e pasojave psikologjike nga traumat në jetë (Grafiku 4). Alternativat e mësipërme janë ato që kanë përqindje më të lartë për opsionin “shumë” dhe “mjaftueshëm” krahasuar me alternativat e tjera të cilat kanë përqindje më të lartë për opsionin “pak” dhe “aspak” (Grafiku 5).

Grafiku 4




Grafiku 5



Shkalla e pranimit për të diskutuar hapur tematikat dhe problemet e ndryshme me terapistin e familjes


Kjo rubrikë kishte synim të zbulojë mendimet e të anketuarve në lidhje me shkallën e hapjes dhe diskutimit me terapistin e familjes lidhur me problematika dhe tema të ndryshme. Ndër temat për të cilat të anketuarit shprehen se do të flisnin më “shumë” hapur janë metodat e edukimit të fëmijës me një përqindje prej 50% (Grafiku 6). Interesant është fakti se të dy gjinitë pranojnë në një shkallë të lartë se do të flisnin hapur për këtë çështje, kështu ndër 48 meshkuj të anketuar 21 prej tyre deklarojnë se do të flisnin “shumë” hapur dhe 19 meshkuj do të flisnin “mjaftueshëm” hapur si dhe ndër 52 femra të anketuara 29 prej tyre do të flisnin “shumë” hapur dhe 16 femra do të flisnin “mjaftueshëm”.

Grafiku 6 Sa hapur mendoni se do të diskutoni/flisni me terapistin e familjes për temat e mëposhtme?



Siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm rezultojnë se të anketuarit do të flisnin “shumë” hapur (35%) mbi problemet që lidhen me vetëvlerësimin, shkaqet që sjellin problemet ekonomike (34%), marrjen e vendimeve të rëndësishme për jetën e tyre (32 %) dhe problemet që lidhen me dhunën fizike/psikologjike në familje (32%). Për këtë çështje paraqiten dallimore gjinore. Femrat do të flisnin “shumë” (22 femra) dhe “mjaftueshëm” (17 femra) më hapur sesa meshkujt të cilët “pak” dhe “aspak” nuk do të flisnin hapur për një tematikë të tillë (Grafiku 7). Siç duket tema të tilla konsiderohen nga meshkujt çështje që i përkasin vetëm marrëdhënieve të ngushta familjare ndërsa femrat janë më të predispozuar të flasin pasi në të shumtën e rasteve ato janë viktime të formave të ndryshme të dhunës.

(Grafiku 7). *Diskutim me terapistin e familjes sipas gjinisë për problemet e dhunës fizike/psikologjike*




Gjithashtu vlen të theksohet se të anketuarit do të flisnin “mjaftueshëm” (Grafiku 6) hapur edhe për disa tema të tjera si probleme që lidhen me mënyrat e komunikimit mes anëtarëve të familjes (43 %), planifikimin familjar (42%), pasojat që sjellin problemet ekonomike (41%), procesi i vendimarrjes në familje (41%). Në lidhje me diskutimin rreth procesit të vendimmarrjes vlen të theksohet se jo vetëm femrat pranojnë të diskutojnë për këtë çështje por edhe meshkujt. Kështu ndër 48 meshkuj 34 prej tyre shprehen se do të diskutonin hapur në lidhje me këtë fakt. Predispozita për të folur me terapistin e familjes në lidhje me temat me karakter shumë personal, si dhe të lidhura me raportet ndërpersonale mes partnerëve është më e ulët. Rezultatet tregojnë se të anketuarit do të flisnin “pak” ose “aspak” në lidhje me tradhëtinë bashkëshortore (Grafiku 6), ku 36% e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin “aspak”, problemet intime/raporte

seksuale me partnerin ku të anketuarit kanë zgjedhur më së shumti opsionin “pak” (31%) dhe “aspak” (30%). Për këtë tematikë 32 meshkuj dhe 29 femra preferojnë të flasin “pak” dhe “aspak” hapur.


Në lidhje me tradhëtinë bashkëshortore femrat paraqiten më të hapura dhe të ndjeshme ndaj diskutimit për këtë çështje (Grafiku 8) ku 29 femra do të flisnin “shumë” dhe “mjaftueshëm” hapur, ndërsa 35 meshkuj ndër 48 meshkuj në total do të flisnin “pak” ose “aspak” hapur.

Grafiku 8 Diskutim me terapistin e familjes sipas gjinisë për tradhëtinë bashkëshortore



Meshkujt në krahasim me femrat janë më pak të predispozuar të flasin për divorcin (Grafiku 9), 21 meshkuj kanë zgjedhur opsionin “aspak”. Ndërsa femrat shprehen se do të flisnin “shumë” (17 femra) dhe “mjaftueshëm” (19 femra) në lidhje me divorcin.

Grafiku 9 Diskutim me terapistin e familjes sipas gjinisë në lidhje me divorcin



Vihen re ndryshime në lidhje me diskutimin për problemet e dhunës fizike / psikologjike tek të anketuarit sipas nivelit arsimor. Të anketuarit që i përkasin nivelit të lartë arsimor preferojnë të flasin “pak” dhe “aspak” hapur (27 ndër 48 të anketuar me nivel të lartë arsimor), ndërsa ato me nivel pasuniversitar (6 të anketuar në total) dhe 11 të anketuar me arsim të mesëm/profesional preferojnë të flasin shumë hapur për këtë tematikë (tabela 2).

Tabela 2 Diskutim me terapistin e familjes sipas nivelit arsimor për problemet e dhunës fizike / psikologjike


Niveli arsimor	Shume	Mjaftueshem	Pak	Aspak	Total
Pa arsim	1	0	0	1	2
Ndjek shkollen	2	5	0	2	9
Braktisur shkollen	1	0	0	0	1
Arsim tetëvjecar	1	1	1	0	3
Arsim i mesëm / profesional	11	8	4	8	31
Arsim i lartë	10	11	13	14	48
Pasuniversitar	6	0	0	0	6
Total	32	25	18	25	100

Ndërsa për tradhëtinë bashkëshortore të anketuarit si me nivel të lartë arsimor ashtu edhe me arsim të mesëm më së shumti shprehen se nuk do të flisnin hapur me terapistin e familjes. Kështu rezulton se 20 të anketuar me nivel arsimor të mesëm ndër 31 në total dhe 30 me arsim të lartë nga 48 në total kanë zgjedhur opsionin “pak” dhe “aspak”. Gjithashtu për këtë çështje e cila është shumë personale rezulton se edhe të anketuarit sipas grupmoshës nuk do të diskutonin hapur me terapistin e familjes. Nuk paraqiten ndryshime të theksuara ndërmjet grupmoshave.

Preferencat e individëve në lidhje me mënyrën e realizimit të terapisë së familjes

Të anketuarit shprehen se do të preferonin ta realizonin “vetëm” terapinë, 51 % e të anketuarve kanë zgjedhur këtë opsion (Grafiku 10). Gjithashtu 19% e të anketuarve deklarojnë se do të preferonin ta realizonin terapinë së bashku me të gjithë anëtarët e familjes, dhe 16% e tyre me prindërit. Një pjesë shumë e vogël e të anketuarve deklarojnë se do të preferonin ta realizonin vetëm me partnerin. Nuk paraqiten diferenca sipas gjinisë, grupmoshës dhe nivelit arsimor në lidhje me realizimin e terapisë.


Grafiku 10



Qëndrimet dhe përcëptimet ndaj praktikës së terapisë së familjes

Të anketuarit shprehen se terapia e familjes është një praktikë e cila i nevojitet shumë shoqërisë tonë. Një fakt të tillë e mendojnë 61 % e të anketuarve (Grafiku11). Por nga ana tjetër në një përqindje më të vogël 52% e të anketuarve mendojnë se terapia e familjes ndihmon “shumë” në fuqizimin e familjes. Kjo lidhet edhe me faktin se shkalla e njohjes dhe informacionit për terapinë e familjes paraqitet në nivele të ulëta në studim.

Grafiku 11



Lidhja midis variableve “gjini” dhe faktit sa dakort janë të anketuarit për shprehjen se “terapia e familjes është një praktikë që i nevojitet shoqërisë tonë” është statistikisht domethënëse (Sig. 0.05). Kështu 38 femra ndër 52 në total kanë zgjedhur opsionin “shumë”, ndërsa 23 meshkuj nga 48 të anketuar meshkuj në total kanë zgjedhur opsionin “shumë” si dhe 19 meshkuj opsionin “mjaftueshëm”. Gjithashtu të anketuarit mendojnë se Institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare duhet të përshijnë më tepër në shërbimet sociale për familjen edhe terapinë e familjes. Kështu 65% e të anketuarve pohojnë se janë “shumë” dakort me këtë shprehje. Të anketuarit bien shumë dakort (60% kanë zgjedhur opsionin “shumë”) me faktin se kurrikulat arsimore duhet të ofrojnë informacion më të shumtë në lidhje me kuptimin dhe rëndësinë e terapisë së familjes si dhe një përqindje e lartë e të anketuarve mendojnë se mentaliteti shqiptar është një faktor pengues për zbatimin e praktikës së terapisë së familjes (64 % kanë zgjedhur opsionin “shumë”). Nuk paraqiten diferenca sipas grupmoshave, nivelit arsimor dhe gjinisë në lidhje me shprehjet e mësipërme.

Konkluzione

Studimi tregoi se të anketuarit nuk kanë shumë informacion për terapinë e familjes. Nga njëra anë rezulton se të anketuarit pranojnë të diskutojnë rrallë problemet e tyre personale. Por ana tjetër rezulton se problematikat ekzistojnë, dhe në të shumtën e rasteve janë të lidhura me shprehjen hapur të mendimeve të anëtarëve të familjes për marrjen e vendimeve, probleme psikologjike apo ngarkesë emocionale. Meshkujt paraqiten më të predispozuar ti diskutojnë problemet e tyre personale me babain në krahasim me femrat të cilat nuk paraqesin diferencime të dukshme në përzgjedhjen mes babait apo nënës. Të anketuarit kanë një përceptim relativisht të qartë në lidhje me ndihmën që mund të ofrojë terapia e familjes. Të anketuarit mendojnë se terapia e familjes ndihmon në përmirësimin e marrëdhënieve prindër – fëmijë, ndihmon anëtarët e familjes të flasin në terapi për tema që e kanë të vështirë ti diskutojnë brenda familjes, kapërcimin e pasojave psikologjike nga traumat në jetë si dhe për problemet psikologjike dhe emocionale. Rezulton se të anketuarit do të flisnin më hapur me terapistin e familjes për metodat e edukimit të fëmijës, problemet që lidhen me vetëvlerësimin, për dhunën fizike / psikologjike ku paraqiten edhe dallimore gjinore. Ndërsa për çështje shumë personale ndërmjet partnerëve të tilla si divorci, tradhëtia, raportet intime dhe seskuale, të anketuarit, sidomos meshkujt, janë më të rezervuar për të diskutuar. Gjithashtu studimi tregoi që të anketuarit mbajnë qëndrime pozitive ndaj zhvillimit të terapisë së familjes në

realitetin shqiptar, përfshirjen e saj në shërbimet sociale për familjen, rritjen e shkallës së informacionit rreth terapisë së familjes edhe në kurrikulat arsimore. Gjithashtu ato mendojnë se mentaliteti shqiptar është një faktor pengues për zhvillimin e kësaj praktike.

Rekomandime

Është e rëndësishme që njerëzit të informohen më tepër në lidhje me rolin dhe problematikat që trajton terapia e familjes. Sot në familjet shqiptare po paraqiten problematika të ndryshme të cilat ndikojnë direkt edhe në funksionimin e familjes. Terapia e familjes do të kontribuonte për kapërcimin e problematikave të ndryshme me karakter psikologjik dhe emocional.

Mentaliteti shqiptar shpeshherë ndikon në kufizimin e mundësisë për ti diskutuar problemet personale dhe ato familjare me një specialist, duke i konsideruar shpesh problemet e familjes si “çështje të brendshme të familjes”. Shkalla e njohjes të këtij shërbimi mendoj se nuk është shumë e lartë, prandaj që të fillojmë të mendojmë për aplikimin e një metode duhet së pari të rrisim informimin e qytetarëve rreth këtij shërbimi, kjo fare mirë mund të përfshihet edhe në kurrikulat arsimore. Psikologët shkollor dhe punonjësit social gjatë praktikës së tyre profesionale në shkolla mund të promovojnë një gjë të tillë.

Është e domosdoshme që të përfshihet në shërbimet sociale për familjen edhe praktika e terapisë së familjes. Ndërkohë nga ana tjetër këto shërbime mungojnë ose janë të pakta. Prandaj me qëllim ndikimin në përmirësimin e marrëdhënieve familjare si dhe mbështetjen gjatë periudhave të tranzicionit, të cilat mund të jenë kalimtare për familjen, është e nevojshme që të pasurojmë shërbimet sociale edhe me praktikën e terapisë së familjes. Ky kontribut për familjen do të kishte pasoja jo vetëm tek anëtarët e saj por edhe për mbarë komunitetin drejt përmirësimit të mirëqënies psiko-sociale të tij.

Studime të mëtejshme dhe me një kampion më të madh janë të nevojshme për të parë qëndrimet edhe përceptimet e njerëzve rreth terapisë së familjes dhe vlerave të saj.

Bibliografia

- Brian Jory & Carrie L. Yodanis. (2010) *"Power - family relationships, marital relationships"*
- Bailey, Donald B., Jr. McWilliam, R.A. Darkes, Lynette Aytch Hebbeler, Kathy Simeonsson, Rune J. Spiker, Donna Wagner, Mary. (1998). *"Family outcomes in early intervention: a framework for program evaluation and efficacy research"*
- Carr Alan. (2010) *"Ten Research Questions for Family Therapy"*. Australian & Neë Zealand Journal of Family Therapy
- Carlson Cindy I. (1990). *Adolescents and family therapy*
- Carr Alan. (2006). *"Family Therapy Concepts, Process and Practice"*, Second Edition
- Desforges Charles, Abouchaar Alberto. (2003) *"The impact of parental involvement, parental support and family education on pupil achievement and adjustment: a literature review"*
- Herbert James. (1989). *"Assessing the need for family therapy: a primer for rehabilitation counselors"*
- Holtzworth-Munroe, Amy, (1992). *"Considering Issues of Sex, Intimacy, and Gender in Family Therapy"*
- Clark, R. Barkley. (1997). *"Psychosocial Assessment of Children & Families"*
- Michael P. Nichols & Richard C. Schwartz. (1994). *"Family Therapy"*. Third Edition
- Michelle A. Johnson, Susan Stone, Christine Lou, Cathy Vu, Jennifer Ling, Paola Mizrahi, Michael J. Austin. (2006). *"Family Assessment in Child Services: Instrument Comparisons"*
- Michael Rohrbaugh, Varda Shoham, Shelley Kasle & Lucia Natera. (1996). *"Perceptions of culturally sensitive family therapy"*.
- Michelle Renee Ward. (2000). *"Clients' perceptions of the therapeutic process: a common factors approach"*
- McWey, Lenore, Humphreys, Julie, Pazdera, Andrea. (2011) *"Oriented Evaluation of an In-Home Family Therapy Program for Families"*. Journal of Marital & Family Therapy
- Kinsuk K. Maitra, Frances Erway. (2006). *"Perception of Client-Centered Practice in Occupational Therapists and Their Clients"*
- Piroli Sabrina. (2002). *"La terapia come base sicura"*
- Roberts Janine, ED.D. (2005). *"Transparency and Self-Disclosure1 in Family Therapy: Dangers and Possibilities"*
- Thompson, Sanna J.; Bender, Kimberly; Windsor, Liliane C.; Flynn, Patrick M. (2009). *"Keeping families engaged: the effects of home-based family therapy enhanced with experiential activities"*

MARTESAT NDËRMJET PERSONAVE TË TË NJËJTIT SEKS

Ergysa IKONOMI

Universiteti Ismail Qemali

Jonada ZYBERAJ

Universiteti Ismail Qemali

ABSTRACT

Marriages between homosexuals have recently been on the focus of political, religious, legal and moral debate in many countries. Any change or threat to change the basic building stone of society-MARRIAGE- is still considered shocking for some countries, while others as Belgium, Netherlands, Iceland or Spain have accepted a new concept of it. The aim of this paper is the chronological process of legalization of homosexual relations, different forms of legalization and the rights accorded to them. This paper will be based on comparative analysis between legislation where these relations are recognized as marriages, as civil unions as well as legislation which does not recognize any of the above forms.

Keywords: Homosexual, Marriage, Civil Union, Rights, Discrimination

1. Hyrje

Martesa ndërmjet personave të të njëjtit seks është një martesë e njohur në mënyrë shoqërore ose ligjore ndërmjet dy personave të cilët kanë të njëjtin gjini ose dhe pse mund të shfaqin gjini të ndryshme nga pikëmaja shoqërore, biologjikisht kanë të njëjtin seks. Martesat ndërmjet personave me të njëjtin seks kanë qenë së fundmi në qendër të debateve politike, fetare, ligjore, apo morale në shumë vende të botës. Çdo ndryshim, apo kërcënim për ndryshim të kulturës dhe traditave shumë vjeçare është shqetësues për njerëzit. Këto debate

bëhen për një çështje shumë delikate dhe të rëndësishme: për një ndryshim në gurin themelor të ndërtimit të shoqërisë, “MARTESËN” ndryshim i cili konsiderohet ende tronditës.

Ka fakte që tregojnë se martesë ndërmjet dy personave të të njëjtit seks kanë ekzistuar që në antikitet. Rasti i parë i përmendur në histori, i një martese ndërmjet personave të të njëjtit seks është ai i ndodhur në Perandorinë e hershme Romake. Perandori Neron është raportuar të jetë lidhur në një ceremoni martese me një nga robërit e tij. E drejta për të lidhur martesë **ius conubium** i njihej një qytetari romak dhe një qytetareje romake, pra një lidhje si ajo e sipërpërmendur duhet të ishte diçka e jashtëligjshme, e realizuar nëpërmjet veprimeve arbitrare të Perandorit. Në vitin 342 e.s Perandori Kostandin II, nxorri një ligj për të ndaluar martesat e të njëjtit seks në Romë dhe për të ekzekutuar ata që ishin lidhur në martesë të tilla.¹

Për ekzistencën në antikitet të martesave të personave të të njëjtit seks, mund t’i referohemi edhe vizatimeve të gjetura në një varr egjiptian në bregun perëndimor të Nilit, të dy manikyristëve. Është ekstremisht e rrallë që të gjej dy burra të së njëjtës staturë të varrosur së bashku. Burrat janë përshkruar disa herë së bashku, herë duke u mbajtur për duarsh, herë në një përqafim të afërt. Dy herë ata tregohen me hundët që i preken (përqafimi më intim i lejuar në artin egjiptian të kohës, një formë puthje).²

Në fakt, praktikat dhe ritualet martesore të personave të të njëjtit seks, janë më pak të njohura në Egjipt, në krahasim me Mesopotaminë, ku ekzistojnë dokumenta për shumëllojshmëri të praktikave martesore duke përfshirë të dashurit meshkuj të mbretërve dhe poliandrinë.³

Nga Greqia vjen një material i pasur në lidhje me seksualitetin, që nga dialogët e Platonit, si p.sh *Simpoziumi*, pjesët teatrale të Aristofanit si dhe veprat e artit apo vazot greke. Problemi kryesor në Athinë ishte roli aktiv apo pasiv që dikush luante. Roli pasiv ishte i pranueshëm vetëm për inferiorët si gratë, skllevërit dhe meshkujt e rinj të cilët nuk ishin ende qytetarë. Marrëdhënia ideale ndërmjet të njëjtit seks ishte midis një burri të rritur të 20-tat apo 30-tat i quajtur *erastes* dhe një djali të cilit nuk i është rritur mjekra, *eromenos* ose *paidika*. Marrëdhëniet ishin të përkohëshme dhe duhet të përfundonin kur djali arrinte adoleshencën.⁴

1 Wikipedia Encyclopedia Online www.wikipedia.org

2 The Sunday Times, January 1, 2006, <http://www.timesonline.co.uk/tol/news/uk/article784046.ece>

3 <http://www.randomhistory.com/history-of-gay-marriage.html>

4 Brent Pickett HOMOSEXUALITY Stanford Encyclopedia of Philosophy <http://plato.stanford.edu/entries/homosexuality/>

Safo, një poete greke nga ishulli Lesbos, shkroi shumë poezi dashurie në drejtim të vajzave dhe grave. Në emër të famës që kishte në antikitet, ajo dhe vendlindja e saj u bënë emblema e dashurisë ndërmjet grave.

1. Pro dhe kundër

Ndërsa janë të pakta shtetet në Evropë, të cilat njohin dhe lejojnë martesë të personave të të njëjtit seks, shoqëria, komunitetet fetare, organizatat jo fitimprurëse, shoqatat e homoseksualëve apo dhe politikanët në debatet e tyre përplasnin argumenta pro dhe kundër martesave të tilla:

	PRO	KUNDËR
1	T'i mohosh personave të të njëjtit seks të drejtën për t'u martuar, është si t'i pakësosh të drejtat civile bazë, të heqësh një nga të drejtat themelore të njeriut. Kjo është e pandershme dhe e padrejtë në një demokraci.	Qëllimi kryesor i martesës është riprodhimi dhe për këtë duhet një martesë nga një burrë dhe një grua. Meqënëse personat e të njëjtit seks nuk mund të riprodhohen, në martesë, ata nuk kanë të drejtë të martohen.
2	Çiftet e të njëjtit seks nuk kërkojnë vetëm të mirat që vijnë nga martesë, ata kërkojnë njohjen dhe vlerësimin që vetëm një martesë mund ta japë. Institucioni i martesës përcjell dinjitet dhe respekt kundrejt personave që angazhohen për të mbështetur njëri -tjetrin përjetë. Çiftet e të njëjtit seks e meritojnë këtë dinjitet dhe respekt.	Marrëdhëniet ndërmjet personave të të njëjtit seks, duke qenë pak të pranuar nga morali dhe shoqëria, janë marrëdhënie të cilat zgjasin pak dhe do të sillnin për pasojë jo vetëm shtimin e numrit të divorceve por edhe prishjen e traditës së gjatë të institutit të martesës.
3	Çiftet e të njëjtit seks mund të lejohen të adoptojnë dhe të merren me rritjen e fëmijëve, duke ulur kështu numrin e fëmijëve që rriten nëpër institucione shtetërore dhe duke i ofruar atyre familje, dashuri dhe siguri.	Tradita e gjatë i ka rezervuar burrit dhe gruas të drejtën për të lidhur martesë dhe kjo traditë duhet të ruhet. Duke i lënë rrugë të hapur legalizimit të martesave të personave të të njëjtit seks, kjo mund të çojë edhe në këkime të tjera si legalizimi i poligamisë apo incestit.
4	Moslejimi i martesave midis personave të të njëjtit seks sjell pasoja emocionale dhe financiare; në kuptimin që individit nuk mund të angazhohet kundrejt një individit tjetër të të njëjtit seks, edhe pse e do atë. Pasojat financiare dhe të sigurisë vijnë nga probleme të rregullimit të regjimit pasuror, përfitimit për kujdesin shëndetësor, marrjen e vendimeve kur bashkëshorti është përkohësisht i paaftë apo marrja e vendimeve në rast të problemeve shëndetësore.	Nëse realizohet legalizimi i martesave midis personave të të njëjtit seks, shpejt do të vijë edhe barazia në të drejta dhe nuk do të ketë më "diskriminim" për çiftet heteroseksuale përsa i përket birësimeve apo përgjegjësisë prindërore. Kjo do të passjellë që mjaft fëmijë të adoptuar në familjet "gay" do të jetojnë me mungesën e të paktën njërit nga prindërit.

1. Format e legalizimit të marrëdhënieve midis personave me të njëjtin seks

Historia për njohjen e marrëdhënieve midis personave të të njëjtit seks ka qenë e gjatë dhe e mundimshme. Mjafton të kujtojmë këtu se, sidomos në legjislacionet e shteteve të dala nga sistemet komuniste, marrëdhëniet homoseksuale ishin ende të konsideruara si vepra penale.⁵

Për shumë arsye, jo vetëm të karakterit politik, por edhe social e fetar njohja e këtyre marrëdhënieve do të ishte një proces i realizuar në mënyrë graduale. Fillimisht, në shtetet ku këto marrëdhënie konsideroheshin si vepër penale, u shfuqizuan këto dispozita. Në shtete të tjera po kalohej në njohjen juridike të tyre dhe në njohjen e pasojave juridike që sillnin bashkëjetesa të kësaj forme. Ky zhvillim nuk ishte i njëtrajtshëm dhe i njëkohshëm për të gjitha shtetet e Evropës dhe aktualisht në disa shtete si Greqia, Italia, Shqipëria, Turqia, etj diskutimi mbi legalizimin e këtyre lidhjeve mbetet ende një temë e nxehtë dhe shumë delikate. Shtete të tjera u kane dhënë atyre të njëjtin status me atë të martesave. Aktualisht njihen tre forma të marrëdhënieve midis personave të të njëjtit seks të cilat sjellin efekte juridike:⁶

- **Martestat civile**
- **Lidhjet e regjistruara**
- **Bashkëjetesat e paregjistruara**

Dallimi midis martesave civile, lidhjeve të regjistruara dhe bashkëjetesave të paregjistruara nuk është vetëm një dallim i aspektit formal, por i shoqëruar me efekte juridike jo vetëm për partnerët, por edhe raportet e krijuara me të tretët.

- **Martesa** është një institut ligjor, e cila përfaqëson një marrëdhënie midis dy personave, e legalizuar përmes një akti formal regjistrimi dhe që sjell të drejta dhe detyrime për palët. Vetëm shtatë shtete në Evropë kanë legalizuar martesat midis personave të të njëjtit seks, (Hollanda, Belgjika, Norvegjia, Spanja, Suedia, Portugalia dhe Islanda) duke u njohur atyre të drejta pothuajse të barabarta me martesat midis heteroseksualëve. Në këto shtete martesat midis personave të së njëjtit seks realizohen vetëm përpara nëpunësve publik, edhe në ato vende ku martesat midis heteroseksualëve quhen të lidhura edhe në se realizohen përpara institucioneve fetare.

5. Neni 116 i K.P shfuqizuar me ligjin Nr. 8733, datë 24.1.2001, neni 31

6. Kees Waaldijk Levels of legal consequences of marriage, cohabitation, and registered partnership for different-sex and same sex partners no 125 2004. pg 34 <http://www.law.leiden.edu/organisation/publiclaw/publicinternationallaw/staff/waaldijk.html>

· **Lidhjet e regjistruara:** Lidhjet e regjistruara njihen po ashtu si lidhje midis dy personave e krijuar mbi bazën e një akti formal regjistrimi dhe që sjell pasoja ligjore për palët dhe raportet e tyre me të tretët. Lidhjet e regjistruara nuk janë martesë civile edhe pse në disa shtete kuadri i të drejtave që jepet nga martesë është shumë i përafërt me ato që përfitohen nga lidhjet e regjistruara. Por, në shtete të tjera si p.sh: në Gjermani partnerët e një lidhjeje të regjistruar nuk gëzojnë nga të drejta të tilla si: e drejta e pensionit të partnerit pasjetues apo e drejta për një reduktim të mundshëm të taksave mbi trashëgiminë (të drejta këto të cilat u njihen çiftëve të lidhur në martesë). Në Francë, të drejtat që u njihen personave të të njëjtit seks në një lidhje të regjistruar janë më të pakëta. Përveç faktit se partneri nuk gëzon të drejtën e pensionit si bashkëjetues, ai është i përjashtuar edhe nga një tërësi tjetër të drejtash si: e drejta e trashëgimisë, e drejta për të përfituar shtetësinë prej partnerit tjetër dhe madje ata nuk konsiderohen si të afërm në çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin mjekësor.⁷

· **Bashkëjetesat e paregjistruara:** Bashkëjetesat joformale apo jo të regjistruara janë lidhje midis dy personave, të cilat nuk janë legalizuar përmes një akti formal regjistrimi, por që për vetë karakterin e kësaj lidhje ajo krijon efekte juridike edhe pa qënë e formalizuar. Edhe pse formalisht të pa njohur si partnerë, atyre u njihen disa të drejta si: e drejta e dëmshpërblimit për shkaktimin e vdekjes së partnerit tjetër, të drejtën për t'u përfshirë në sigurimet shëndetësore të përbashkëta (Franca dhe Belgjika), por përjashtohen nga të drejta që lidhen me trashëgiminë nga partneri, të drejtat të lidhura me përgjegjësinë prindërore, detyrimin për ushqim, të drejtën për të mos dëshmuar kundër njëri-tjetrit, etj.⁸

4. Martesat midis personave midis të njëjtit seks dhe të drejtat që burojnë prej saj

Martesa shikohet si një ndër mënyrat kryesore që çon në ndërtimin e familjes dhe që sjell të drejta e detyrime të karakterit personal, por edhe të atij pasuror ndërmjet bashkëshortëve. Pikërisht niveli i këtyre të drejtave dhe detyrimeve varion nga një legjislacion në tjetrin. Kështu për shembull në legjislacione të ndryshme çiftëve të të njëjtit seks u jepet e drejta për të adoptuar fëmijë, kurse

7. Enciklopedia on line http://en.wikipedia.org/wiki/Civil_union#cite_ref-22 03.10.2011

8. Major legal consequences of marriage, cohabitation and registered partnership for different-sex and same-sex partners in Belgium by Olivier De Schutter and Kees Waaldijk pg 30

në legjislacione të tjera kjo e drejtë ose nuk u është dhënë ose jepet për raste tepër specifike. Por ka dhe shtete të tjera si rasti i shtetit të Vermontit në SHBA, të cilët i japin lidhjes civile të njëjtat efekte juridike si martesë civile.⁹

Shumica e shteteve të tjera si në Amerikë, ashtu edhe në Evropë legalizojnë martesat midis personave të të njëjtit seks, por nuk i barazojnë ato me martesat heteroseksualeve, duke i përjashtuar nga një kuadër i caktuar të drejtash. Siç shprehet Evan Wolfson, themeluesi i lëvizjes së martesave të të njëjtit seks, në intervistën e tij të 30 shtatorit 2009 në wikinews *“Martesat civile në SHBA janë lidhje civile, kurse lidhjet civile nuk janë martesë”*.

Martesa e personave të të njëjtit seks që prej 2001 e në vazhdim, është një çështje politikisht shumë e ndjeshme. Kjo çështje ka ngjallur debate të zjarra në lidhje me të drejtat e njeriut dhe me zbatimin e barabartë të ligjit për të gjithë, por nga ana tjetër është një çështje po ashtu me ndjeshmëri të madhe sociale, juridike dhe fetare, pasi ngjall diskutime të shumta mbi konceptin juridik të martesës dhe formave të lidhjes së saj.

Me një vështrim pak më kritik mbi shtetet që nuk e kanë legalizuar ende martesat e të njëjtit seks, vihet re se në këto shtete ose ka një ndikim tepër të fortë feja, siç është rasti i Italisë, Greqisë dhe rasti i Turqisë, ose janë vende të cilat nga pikëpamja sociale nuk kanë arritur ende stade të tilla të zhvillimit të mjaftueshme për të përqaftuar lehtësisht një koncept të ri tërësisht të ndryshëm mbi martesën.

Në Evropë numri i shteteve të cilat i kanë legalizuar martesat e të njëjtit seks që prej 2001 rritet vazhdimisht. Por edhe ndërmjet këtyre shteteve ka dallime pasi dikush i njeh ato në formën e bashkimeve civile e dikush tjetër u jep të drejten e lidhjes së martesës, qoftë edhe përpara institucioneve fetare.

· Holanda është i pari shtet i cili në vitin 2001 ka legalizuar martesat midis personave të të njëjtit seks, duke u bërë kështu pararendës për të gjitha shtetet e tjera të Evropës në legalizimin e këtyre martesave. Duhet theksuar fakti se që në fillim Holanda u ka dhënë emrin martesë këtyre lidhjeve duke i njohur njësoj si martesat heteroseksuale¹⁰.

· Belgjika ishte shteti i dytë pas Hollandës, e cila i lejoi martesat e personave të të njëjtit seks në vitin 2003, por jo pa kufizime: Si fillim, mund

9. Goodnough, Abby (2009-04-07). "Vermont Legislature Makes Same-Sex Marriage Legal". The New York Times. Retrieved May 23, 2010. <http://www.nytimes.com/2009/04/08/us/08vermont.html>

10. New York Times Article, published 20 December 2000 <http://www.nytimes.com/2000/12/20/world/same-sex-dutch-couples-gain-marriage-and-adoption-rights.html>

të lidheshin në martesë vetëm ata shtetas të huaj legjislacioni i shtetit prej të cilit ata vinin u njihte të drejtën e bashkimeve civile të këtij tipi, kufizim i cili u hoq në vitin 2004 dhe e drejta e martesës iu akordua çdo çifti homoseksual që jetonte në territorin e Belgjikës për jo më pak se 3 muaj.¹¹ Po ashtu deri në vitin 2006, në Belgjikë nuk lejohej adoptimi i fëmijëve nga partnerë të të njëjtit seks dhe ky kufizim shtrihej madje edhe mbi fëmijët e partnerit tjetër. Vetëm në vitin 2006 kaloi në parlament ligji që u lejonte partnerëve të të njëjtit seks të ushtronin të drejtat prindërore mbi fëmijët e partnerit tjetër.

Islanda, e cila vetëm në vitin 2010 njohu martesat midis partnerëve të të njëjtit seks, është sot shteti i cili akordon kuadrin më të plotë të të drejtave duke u akorduar edhe të drejtën e birësimit pa kufizime dhe të drejtën e inseminimit artificial.¹²

Rruga për të shkuar deri në legalizimin e martesave midis personave të të njëjtit nuk ka qenë kaq e thjeshtë për shtetet e tjera sa për Belgjikën, Hollandën apo Islandën.

Në vendet e tjera të Evropës si në Suedi u desh më përpara të njiheshin bashkimet civile, të cilat më vonë, pas miratimit të kishës do të merrnin formën e martesave. Shtete të tjera të Evropës janë ende në fazën e njohjes së bashkimeve civile si për shembull: Gjermania, Sllovenia, Republika Çeke apo Britania e Madhe. Të legalizuara nën kuadrin e bashkimeve civile, të drejtat që akordohen për çiftet e të njëjtit seks, në këto raste janë më të kufizuara se të drejtat që u jepen atyre përmes martesave.

Hungaria, e cila që prej 1996 njihte format e bashkëjetesës midis çifteve të të njëjtit seks, por nuk kishte detyrimin për t'a regjistruar bashkëjetesën midis tyre. Vetëm në vitin 2009, pas një ndryshimi në Kodin Civil mbi konceptin e bashkëjetuesve si "dy persona të cilët jetojnë së bashku në unitet emocional dhe ekonomik pa qenë të lidhur në martesë"¹³, u lejoi çifteve të të njëjtit seks të regjistrojnë marrëdhënien e tyre, por me disa kufizime si: në të drejtën e marrjes së mbiemrit të partnerit tjetër dhe në të drejtën për adoptim. Ndërkohë që draft Kushtetuta e 25 prillit 2011, e cila pret të hyjë në fuqi me 1 janar 2012, e parashikon martesën si "*një marrëdhënie të lidhur në mënyrë vullnetare midis një burri dhe një gruaje.*"¹⁴

11 Thornberry, Malcolm (2006-04-21). "Belgium OK's Co-Parenting For Gay Couples". 365Gay. Archived from the original on 2006-04-22. Retrieved 08.09.2011

12 Thorvaldur Kristinsson 2008. Additions 2009/2010 by Gayice.is <http://www.gayice.is/articles/gay-life/292-iceland-homosexuality-and-the-law>

13 Kodi Civil Hungarez , Art. 578 G; 685 http://www.wipo.int/wipolex/en/text.jsp?file_id=190520

14 Draft Kushtetuta Hungareze Prill 2011, artikulli M

Gjermania i ka legalizuar marrëdhëniet midis personave të të njëjtit seks në formën e bashkimeve civile, por duke u dhënë atyre një kuadër shumë të gjerë të drejtash duke filluar nga e drejta për të trashëguar nga pasuria e partnerit, e drejta e emrit, të drejta të lidhura me emigracionin, të drejta që lidhen me detyrimin për ushqim si kundrejt partnerit ashtu dhe kundrejt fëmijëve. Në vitin 2004 iu njoh e drejta e adoptimit, por e kufizuar kjo e drejtë vetëm mbi fëmijët e bashkëshortit ose të bashkëshortes.¹⁵

5. Njohja e martesave midis personave të të njëjtit seks nga shtetet e treta

Martesa nuk është vetëm legalizimi i një lidhjeje emocionale, por shoqërohet me një sërë efektsh juridike. Duke qenë se martesat e të njëjtit seks shikohen si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, shumë shtete të cilat nuk i kanë legalizuar këto martesat nuk i njohin ato të lidhura në një shtet tjetër.

Ky përjashtim lidhet me një parim të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare private siç është ai i ruajtjes së rendit publik dhe moralit shoqëror. Mbi bazën e këtij përjashtimi, shumë shtete refuzojnë të njohin martesat e të njëjtit seks të njohura në një shtet tjetër pasi ato bien në kundërshtim me parime të rëndësishme të shoqërisë së atij shteti dhe çenojnë rëndë moralin shoqëror. Mbi bazën e një parimi të tillë dhe parashikimit ligjor që i bëhet institutit të martesës, shteti shqiptar nuk i njeh asnjë lloj efekti juridik martesave midis personave të të njëjtit seks apo formave të bashkëjetesës midis tyre.

Sipas legjislacionit shqiptar, martesat e celebruara jashtë shtetit shqiptar do të njihen për sa kohë ato nuk bien në kundërshtim me parimet themelore dhe kushtet thelbësore të martesës. Neni 7 i Kodit të Familjes përcakton se “*martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç*” duke kuptuar që martesa është një bashkim heteroseksual. U krijua ideja se dhe në Shqipëri do të hidheshin hapa të mëdha në lidhje me njohjen juridike të lidhjeve midis personave të të njëjtit seks, por gjithçka rezultoi në një ligj më të detajuar mbi zbatimin e parimit të mosdiskriminimit edhe pse nisma e gjithë kësaj vendimarrje ishte në kuadër të rekomandimeve të Bashkimit Europian drejtuar vendeve aplikante për garantim e të drejtave të barabarta të homoseksualëve.

Agjensia e të Drejtave të Njeriut, në raportet e saj vjetore, tregon për një

15 German Act on life partnerships art. 1; 5; 6; 9; 12 http://www.euractiv.com/sites/all/euractiv/files/CONSTITUTION_in_English_DRAFT.pdf

nivel të theksuar homofobie në vendet anëtare të Bashkimit Europiane ku lidhjet midis persoanve të të njëjtit seks trajtohen në mënyre diskriminuese.¹⁶

Aktualisht martesat midis personave të të njëjtit seks njihen vetëm nga shtatë shtete anëtare të Bashkimit Europian, ndërkohë që vetëm 10 shtete të tjera i kanë legalizuar ato në formën e bashkimeve civile. Parlamenti Europian, në kuadër të parimit të njohjes reciproke dhe në kërkesë të nevojës për zbatimin e parimit të mosdiskriminimit, ka kërkuar nga vendet e Evropës njohjen e martesave të leglaizuara nga një shtet i Bashkimit Europian në shtetet e tjera të Bashkimit Europian. Në mbledhjen e 7 shtatorit 2010 Parlamenti Europian u shpreh me nota të ashpra në drejtim të shteteve anëtare dhe të përpjekjeve të pakta që ato kanë bërë kundër homofobisë.¹⁷

Më 16 mars 2000 Parlamenti Europian adoptoi rezolutën përmes të cilës u kërkohej shteteve anëtare të Bashkimit Europian të akordonin për çiftet homoseksuale të drejta të barabarta me ato të çifteve heteroseksuale. Rekomandime të tjera 17 janar 2003; 11 shkurt 2003; 3 mars 2004 dhe 20 janar 2006 kërkonin nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian të njohin format e tjera të bashkëjetesës midis çifteve të të njëjtit seks, njohjen e martesave midis tyre dhe garantimin e tyre me të njëjtën kuadër të drejtash si martesat heteroseksuale si dhe njohjen reciproke të martesave brenda shteteve të Bashkimit Europian si një detyrim bazë për respektimin e një prej lirive themelore lirinë e lëvizjes së lirë të personave.

Nga ana tjetër, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në vendimin e 24 korrikut 2003 në çështjen **Karner vs Austria** (40016/98) vendosi “ të gjitha të drejtat dhe liritë që njihen nga shteti për partnerët bashkëjetues heteroseksual do të duhet në të ardhmen të njihen edhe për partnerët homoseksual”¹⁸

Po kjo Gjykatë, në çështjen e korrikut 2010 **Schalk and Kopf**, bën një interpretim të zgjeruar të nenit 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (e drejta për një jetë familjare) duke përfshirë në termin e familjes edhe bashkëjetuesit e të njëjtit seks, të cilët jetojnë në një marrëdhënie de facto të qëndrueshme, por në po të njëjtin vendim Gjykata u shpreh se mungesa e legalizimit të martesave midis personave të të njëjtit seks nga shteti nuk përbën dhunim të nenit 12 (e drejta për martesë) të K.E.D.NJ. dhe se secili prej shteteve

16 Annual Report 2010 of European Union Agency for Fundamental Rights http://fra.europa.eu/fraWebsite/research/publications/annual_report_on_fundamental_rights/ar2010_part2_en.htm

17 Mbledhja e 7 shtatorit 2010 e Parlamentit Europian <http://www.lgbt-ep.eu/press-releases/european-parliament-debates-recognition-of-same-sex-unions/>

18 Çështja Carner vs Austria C (40016/98) GJEDNJ <http://archive.equal-jus.eu/131/>

ka të drejtën të vendosë nëse do t'i legalizojë ose jo këto martesë në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.¹⁹

Edhe pse ka përpjekje të shumta për të arritur në një standard të përbashkët, mungesa e tij dhe mosnjohja e martesave midis personave të të njëjtit seks, të cilat janë legalizuar në shtete të tjera sjell probleme të rëndësishme që lidhen me efektet juridike të martesës, sidomos ato të tipit pasuror në administrimin e një pasurie e cila do të ndodhej në territorin e një shteti ku kjo martesë nuk njihet apo në rastet e çeljes së një trashëgimie kur pasuria e lënë në trashëgim gjendet jashtë territorit.

Por siç shprehet Michael Cashma, anëtar i Parlamentit European dhe president i grupeve të të drejtave të L.G.B.T. (lesbikëve, gay, biseksual dhe transeksualët) në fjalën e tij në mbledhjen e Parlamentit European të 7 shtatorit 2010 " ...kjo ka të bëjë me marrëdhënie, ndoshta me aspektin më personal dhe më privat të jetës së njeirut..." dhe është po aq çështje emocionale dhe shoqërore, po aq sa dhe ligjore.

Një ndryshim i cili do të vërë në dyshim organizimin e sotëm shoqëror dhe familjar dhe për të cilin një pjesë e madhe e shoqërive nuk janë ende të përgatitura.

6. Shqipëria dhe martesat e personave të të njëjtit seks

Në vitin 2009 Kryeministri shqiptar deklaroi :

*"...Ky ligj ka të bëjë me të drejtat e martesave brenda gjinisë dhe probleme të tjera të kësaj natyre. Kjo synon thjesht vendosjen mbi baza ligjore dhe jo diskriminuese, të një të drejte, tashmë tërësisht të ligjëruar në vendet evropiane. Ky ligj është në Parlament dhe duhet të shqyrtohet me seriozitetin më të madh, pasi është një standard që gjykoj se zhduk një lloj diskriminimi..."*²⁰

Deklarata e Kryeministrit shqiptar, u vlerësua si një hap pozitiv drejt mbrojtjes së të drejtave të njeriut, megjithëse u shoqërua nga komente të cilat shprehnin habi për një projektligj të tillë, pasi ishte një lëvizje e papritur nga Shqipëria, një nga vendet më konservatore në Evropë.²¹

Projekt ligji ishte përgatitur nga një grup organizatash jo fitimprurëse dhe

19 Çështja Schalk and Kopf vs Austria C (30141/04) GJ. E. D. NJ. ; <http://www.hrlrc.org.au/court-tribunal/european-court-of-human-rights> retrived 24.06.2011

20 Deklarata e Kryeministrit mbi projektligjin " Për mbrojtjen nga diskriminimi"

21 Mark Lowen Albania "to approve gay marriage" Thursday 30 July 2009 <http://news.bbc.co.uk/2/hi/8177544.stm>

synonte mosdiskriminimin e minoriteteve të caktuara dhe nuk parashikonte ndonjë kërkesë për ligjërimin e martesave të personave të të njëjtit seks, duke e konsideruar si të papërshtatshme për Shqipërinë, martesat e homoseksualëve.²²

Në Shqipëri, janë disa faktorë të cilët i kundërvihen martesave ndërmjet personave të të njëjtit seks:

1. Mentaliteti shqiptar, i cili në përgjithësi trajtimin e çështjeve seksuale e ka konsideruar gjithmonë një tabu. Rrallë mund të ndodhë që në një familje shqiptare të diskutohet për çështje seksuale. Edhe në programet e shkollave, tema të tilla megjithëse përfshihen aty, kalohen apo trajtohen në mënyrë të përciptë nga mësuesët nëpër klasa.

Mentaliteti shqiptar ende nuk e pranon një marrëdhënie me persona të të njëjtit seks, por edhe personat që kanë orientime të tilla nuk kanë bërë shumë për t'u pranuar në shoqëri. Komuniteti i homoseksualëve në Shqipëri është i padukshëm, ata nuk organizohen në "gay pride celebration" apo të frekuentojnë "friendly gay bar". Vetëm disa organizata jo fitimprurëse, të cilat merren me çështje të të drejtave të njeriut, e ngrenë zërin herë pas here për t'u respektuar edhe personat të cilët kanë orientime të ndryshme seksuale. Homoseksualët në Shqipëri ende nuk kanë njohur dhe pranuar veten si të tillë, ata nuk luftojnë për të drejtat e tyre dhe sado që kuadri ligjor shqiptar të jetë favorizues, ata përsëri nuk do t'i tregojnë të tjerëve se cilët janë. Kjo përsa i përket pranimit të çifteve të të njëjtit seks në Shqipëri, ndërsa pranimi i martesave ndërmjet tyre duket shumë larg.

Shoqëria shqiptare e konsideron martesën shoqërisht shumë të rëndësishme, e cila përfshin jo vetëm personat që martohen, por edhe familjet e tyre. Kur diskutohet për martesën, në familjet shqiptare i jepet rëndësi përkatësisë fetare, moralit, origjinës së familjes apo edhe pozicionit shoqëror. Aktualisht, diskutimi mbi seksin e bashkëshortit të ardhshëm është i paimagjinueshëm. Shoqëria shqiptare nuk është e përgatitur për t'u përballur me një martesë të tillë.

2. Besimi fetar në Shqipëri ka qenë i ndaluar në diktaturë, por me ardhjen e demokracisë ndjenja e besimit fetar te shqiptarët është kthyer dhe komunitet fetare janë forcuar.

Qëndrimi i komuniteteve fetare ka qenë i prerë dhe i qartë kundër lejimit me ligj të martesave të personave të të njëjtit seks:²³

22 "Martesat "gay", klerikët: është mëkat" 2009-07-30

<http://www.gazeta-shqip.com/sociale/cdd7496b1240246ee868793718feddc5.html>

23 "Martesat "gay", klerikët: është mëkat" 2009-07-30

<http://www.gazeta-shqip.com/sociale/cdd7496b1240246ee868793718feddc5.html>

v *"Kurani e ndalon në mënyrë kategorike mundësinë e martesave homoseksuale, jo më kot janë krijuar femra dhe mashkulli, për t'u bashkuar mes tyre dhe për të siguruar vazhdimësinë e njerëzimit"* ka pohuar Selim Muça, përfaqësues i komunitetit më të madh fetar në vendin tonë.

v *"Martesa është bashkim i burrit dhe i gruas. Ne nuk kemi asnjë aftësi të dënojmë ose të gjykojmë homoseksualët, megjithatë nuk mund të injorojmë faktin që sipas planit të Zotit martesa është bashkim i dy sekseve të ndryshme. Fatkeqësisht sot ligje të tilla konsiderohen si shenja përparimi, por në të vërtetë nuk është ashtu, përkundrazi është detyrë e çdo shteti ta mbrojë martesën. Ne si të krishterë pranojmë martesën e dy sekseve të ndryshme, nuk është e pranueshme ideja që martesa të bëhet mes dy sekseve të njëjta",* u shpreh Mon Sinjor Gjergj Frendo.

v *"Për Kishën Ortodokse, ashtu si edhe për shumë kisha të tjera, veprimi dhe akti që kryhet mes dy njerëzve të së njëjtës gjini është i dënueshëm. Për këtë arsye, çdo lloj veprimi, aq më tepër kur ato bëhen edhe ligjore, nuk shikohen me sy të mirë dhe nuk mund të aprovohet nga ana jonë si besimtarë dhe si kishë..."*, tha peshkopi Andon Merdani i Kishës Ortodokse.

3. Kuadri ligjor në Shqipëri, duke iu referuar Kodit të Familjes, nuk është favorizues për kalimin e një ligji që lejon martesat midis dy personave të të njëjtit seks. Kodi i Familjes e parashikon martesën si një lidhje të një burri dhe një gruaje:

"Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje..."²⁴

Nëse interpretohet ky nen i Kodit të Familjes, rezulton se e vetmja martesë e njohur dhe e mbrojtur ligjërisht nga shteti është **vetëm** bashkimi i një burri dhe një gruaje, pra në të njëjtën "fjalë" parashikohen menjëherë dy përjashtime:

v Martesa e ligjshme dhe e njohur bashkon vetëm persona të sekseve të ndryshme duke mos lejuar **martesa ndërmjet personave të të njëjtit seks.**

v Martesa e ligjshme dhe e njohur bashkon vetëm dy persona " një burrë dhe një grua" **duke mos lejuar poligaminë.**

7. Ligji "për mbrojtjen nga diskriminimi"

Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" u miratua në Shqipëri në shkurt 2010, si ligj që do të rregullonte respektimin e parimit të barazisë dhe mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi vjen si një progres në mbrojtjen

24 Ligji Nr.9062, datë 8.5.2003 Kodi i Familjes

e të drejtave të njeriut dhe krahasimisht me mbrojtjen nga diskriminimet e ndryshme parashikon një mbrojtje të veçantë për diskriminimin në bazë gjinie. Në kontekstin aktual, duke mbajtur parasysh mentalitetin e shoqërisë dhe presionin që ushtrojnë komunitetet fetare, miratimi i këtij ligji ishte mundësia e vetme që do t'i akordonte të drejta komunitetit homoseksual në Shqipëri.

Me miratimin e këtij ligji, Shqipëria renditet në radhën e shumë shteteve evropiane, të cilat megjithëse ligjërisht kanë sanksionuar mbrojtjen nga diskriminimi gjinor, ende janë në fazën e njohjes së lidhjeve ndërmjet personave të të njëjtit seks dhe nuk i kanë legalizuar martesat ndërmjet tyre.

Martesa është një bashkim që duhet parë jo vetëm nga palët që lidhen në të, por edhe nga shkaqet që i shtyjnë njerëzit për t'u martuar dhe detyrimet që lindin nga martesa. Në rastin e martesave midis homoseksualëve, pavarësisht se bashkohen persona të të njëjtit seks, është e rëndësishme të kuptohet dhe të vlerësohet ndjenja e afeksionit, respektit, besimit, qëllimit për të jetuar së bashku dhe detyrimet për ndihmë të ndërsjelltë.

Ndër kushtet e domosdoshme për lidhjen e martesës, që parashikohen nga legjislacioni familjar shqiptar, e vetmja "mangësi" që ka martesa ndërmjet personave të të njëjtit seks është *seksi i përbashkët* i partnerëve që lidhen në martesë.

Të arrish të angazhohesh për të jetuar përgjithmonë me një njeri është përgjegjësia më e madhe, që merr një vlerë të jashtëzakonshme në momentin kur shoqëria vuan një numër të madh divorcesh. Qëllimi i martesës nuk qëndron thjesht te bashkimi i dy personave me sekse të ndryshme, por te përgjegjësia për të dëshiruar dhe krijuar një lidhje përjetë.

Një nga funksionet kryesore të martesës është edhe riprodhimi. Çiftet ndërmjet personave të të njëjtit seks nuk mund të riprodhohen natyrisht, por kjo nuk duhet të shihet si një shkak për të mos lejuar martesën ndërmjet tyre. Çiftet e personave të të njëjtit seks do të ishin të diskriminuar përballë çifteve heteroseksuale që për shkaqe biologjike apo të zgjedhjes nuk riprodhohen.

Të drejtat e homoseksualeve për t'u lidhur në martesë nuk janë gjë tjetër veçse të drejta themelore të qenieve njerëzore, të cilat duhet të respektohen pasi kanë lidhje të drejtë për drejtë me arritjen e lumturisë, respektimin e dinjitetit dhe nderit të personave dhe janë shprehje e realizimit personal të gjithësecilit në jetë.

Martesa, si një nga institutet më të vjetra shoqërore, ndër shekuj ka njohur, ashtu siç edhe ka kapërcyer një sërë pengesash të lidhura me përkatësinë shoqërore, racore, fetare apo të moshës së partnerëve, të cilat me kohën janë dukur diskriminuese dhe si të tilla janë hequr. Nën të njëjtën dritë duhet parë edhe pengesa që ka lidhje me seksin e njëjtë të partnerëve.

“Kundershtarët e martesave të personave të të njëjtit seks kanë të drejtë për dicka: martesa është një identifikues i shoqërisë. Kur divorcet u legalizuan, kur kontrceptivët u konsideruan si një zgjedhje personale në martesë, kur grave të martuara iu dhanë të drejta pasurore dhe trashëgimore, kur martesat ndër raciale u lejuan, martesa ishte thelbësore në prurjen e ndryshimeve përparimtare në shoqëri. Në çdo kohë martesa “tradicionale” është parë si e sulmuar”²⁵.

Vlerësimi që gëzon martesa dhe koncepti që ka shoqëria shqiptare për martesën nuk mund të ndryshojë lehtësisht dhe as mund të stimulohet artificialisht. Ajo duhet të jetë pasojë e arritjes së emancipimit. Është detyrë e aktorëve shtetërorë dhe jo shtetërorë që të edukojnë shoqërinë për përqaftimin e koncepteve të reja.

Legjislatori shqiptar ka ndërmarrë hapa progresivë në këtë drejtim: me shfuqizimin e veprës penale të “kryerjes së marrëdhënieve homoseksuale” dhe miratimin e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Roli vendimtar mbetet për aktorët joshetërorë si: shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të homoseksualëve dhe komunitetit homoseksual në Shqipëri.

Komuniteti i homoseksualëve në Shqipëri duhet të ndërmarrë një fushatë intensive, ditë pas dite me organizimin e evenimenteve, përdorimin e mediave dhe shfrytëzimin e të gjitha formave të tjera të aksesit me qëllimin final, që megjithëse të ndryshëm të pranohen si të barabartë.

Bibliografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998
2. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë 1995
3. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë 2003
4. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë 1995
5. Kees Waaldijk Levels of legal consequences of marriage, cohabitation, and registered partnership for different-sex and same sex partners; 2004
6. Enciklopedia online www.wikipedia.com

25 Editorial excerpt, Boston Globe, October 2, 2005 <http://www.buddybuddy.com/quotes-2.html>

7. The Sunday Times, January 1, 2006 www.timesonline.co.uk/tol/news/uk/article784046.ece
8. <http://www.randomhistory.com/history-of-gay-marriage.html>
9. Brent Pickett HOMOSEXUALITY Stanford Encyclopedia of Philosophy <http://plato.stanford.edu/entries/homosexuality/>
10. Kees Waaldijk Levels of legal consequences of marriage, cohabitation, and registered partnership for different-sex and same sex partners; 2004
11. Deklarata e Kryemnistrit mbi projektligjin “ Për mbrojtjen nga diskriminimi”
12. Mark Lowen Albania “to approve gay marriage” Thursday 30 July 2009 <http://news.bbc.co.uk/2/hi/8177544.stm>
13. “Martesat “gay”, klerikët: është mëkat” 2009-07-30 <http://www.gazeta-shqip.com/sociale/cdd7496b1240246ee868793718feddc5.html>
14. Editorial excerpt, Boston Globe, October 2, 2005 <http://www.buddybuddy.com/quotes-2.html>
15. Major legal consequences of marriage, cohabitation and registered partnership for different-sex and same-sex partners in Belgium by Olivier De Schutter and Kees Waaldijk
16. Goodnough, Abby (2009-04-07). “Vermont Legislature Makes Same-Sex Marriage Legal”. The New York Times.
17. Thornberry, Malcolm (2006-04-21). “Belgium OK’s Co-Parenting For Gay Couples”. 365Gay. Archived from the original on 2006-04-22.
18. Thorvaldur Kristinsson 2008. Additions 2009/2010 by Gayice.is <http://www.gayice.is/articles/gay-life/292-iceland-homosexuality-and-the-law>
19. Kodi Civil Hungarez
20. Draft Kushtetuta Hungareze Prill 2011
21. German Act on Life Partnerships
22. Site zyrtar i Agjensisë Europiane të të Drejtave të Njeriut
23. Site Zyrtar i Bashkimit Europian, Zyra e Informacionit
24. Site Zyrtar i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

MBI ZBATIMIN E LIGJIT TE RI PER DHUNEN NE FAMILJE: PERVOJE, PROBLEME, SUGJERIME

Uarda ALBUNESA
Hermina ALBUNESA

ABSTRACT

In this work would be handled innovation, effectiveness and problems of the Law "On Measures against Violence in Family Relations" with the conviction that domestic violence as a phenomenon is usually present and known by all of us. For many years this phenomenon has been an accepted reality of Albanian families, due to various factors which cause the number of whistleblowers in violence lies in low levels. It does not bring innovation the laying of the question if there is violence or not, because have been given very good response justified. The paper will be based on statistics for the district of Shkodra, in order to more concrete object of study. The study will tend to give answers to these questions: a) Who commits violence and to whom; b) Does the new law bring innovation; c) Victims are more protected from this new law; d) As translated in statistics reports of victims; e) A law that provides coordination of local and central authorities; f) Is this an effective law against domestic violence?

Keywords: Family, violence, law, statistics, Coordination, Performance, Application

A. Përkufizime dhe çështje teorike.

Përkufizimi i dhunës në familje.

Dhuna në familje nënkupton çdo akt dhune ndërmjet personave që jetojnë në të njëjtën shtëpi apo kanë lidhje familjare. Veprimet që sjellin si pasojë dhunën në familje përfshijnë por nuk limitohen në vrasje, plagosje, torturë, ndërprerje e shtatëzanisë, mohim i ndihmës, nxitje për vetëvrasje, rrëmbim, trafikim, dhunim i banesës, detyrimi për të ushtruar prostitucionin, kërcënim, shpifje, kufizim i lirisë së të shprehurit, lëvizjes apo mbledhjes, përbuzje, dhunim i jetës private, përdhunim, akte të tjera të turpshme, kërcënim për braktisje, mohim i mjeteve të jetesës, marrja ilegale e fëmijës, abuzim fizik dhe psikologjik, seksual apo ekonomik direkt mbi fëmijën si dhe vendosja e tyre në situata të vështira apo në situata të tilla që fëmijët të jenë dëshmitarë të dhunës kundrejt anëtarëve të tjerë të familjes, detyrimi për bashkëjetesë apo përfundim të martesës, shpërdorim i pasurisë apo i të mirave materiale, kufizim i lirisë për të administruar të ardhurat e tyre apo ndalim për të mbajtur mjete monetare (Marrë nga: Një manual për organizatat jofitimprurëse- Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje, OSCE, 2007: 9).

Vitet e fundit nuk kanë munguar në kronikat e lajmeve rrahjet çnjerëzore, plagosjet, vrasjet, abuzimet brënda anëtarëve të familjes.

Në fund të fundit, këto të dhëna a nuk tregojnë se shoqëria jonë sot është më e prirur drejt evidentimit të dhunës në familje dhe më e ndërgjegjësuar ndaj të drejtave të tyre?

Duke u ndodhur në këtë fazë mu duk me interes ta zgjeroja studimin në disa drejtime të tjera:

- a) A ka sjell risi ligji i ri?
- b) Si përkthehen në statistika denoncimet e viktimave?
- c) A ofron ky ligj koordinim të autoriteteve lokale dhe qendrore?
- d) A është efektiv ky ligj kundrejt Dhunës në Familje?

B. Objektivat dhe hipotezat.

Objekti kryesor i punimit tim është interpretimi i ligjit të ri, risitë dhe problematikat që sjell ai.

Ky ligj i ri ofron mbrojtje më të sigurtë për viktimat e dhunës; Kjo siguri passjell rritjen e denoncimeve dhe kërkesave për urdhëra mbrojtjeje; Kjo

mbrojtje realizohet me anë të koordinimit të punës ndërmjet autoriteteve lokale dhe qëndrore.

Hipotezat e ngritura janë:

- Ligji i ri është efektiv.
- Subjektet e mbrojtura nga ky ligj janë vetëm femrat.
- Dhuna në familje është pakësuar ndjeshëm me hyrjen në fuqi të ligjit.
- Gjykatat dhe drejtoritë e policisë kanë të dhëna të sakta të numrit të familjeve të dhunuara.
- Ky ligj ka sensibilizuar ndjeshëm shoqërinë shqiptare për denoncimin e dhunës.
- Ky ligj është nisma më e mirë ligjore deri më sot në vendin tonë në lidhje me masat kundër dhunës në familje.

C. Rreth metodologjisë së përdorur.

Metodologjia e përdorur është gur themeli i një studimi cilësorë.

“Nëse dëshiron të shijosh suksesin tënd, ndërtoje mbi themele të sigurta”.

Në punimin tim kam ndërthurur metodën krahasuese dhe burimet e arkivave/policisë/gjykatës/OJF.

Thinking without comparison is unthinkable (Charles Ragin).

Metoda krahasuese përbën zemrën e metodologjisë shkencore (Sokoli, Lekë, 2009, Metodatat e Kërkimit Shkencor në Shkencat Sociale, IS). Ajo nënkupton konstatimin e ngjashmërive dhe ndryshimeve midis dukurive të jetës shoqërore (Shih po aty).

Metodologjia, është, para së gjithash një disiplinë logjike. Ajo ka të bëjë me logjikën e kërkimit shkencor dhe vlerëson në mënyrë kritike veprime që kryhen gjatë kërkimit shkencor. Në këtë kuptim metodologjia ka të bëjë me filozofinë e kërkimit shkencor, të lidhur me objektin e studimit (Sokoli, L, 2009: 43).

Më poshtë do konstatojmë ndryshimet e denoncimeve dhe kërkesave për urdhëra mbrojtjeje për periudhën (2008-2010) të viktimave të dhunës; pika krahasuese të legjislacionit pararendës me atë aktual. Kjo mënyrë krahasimi dhe këto burime të dhënash do na i qartësojnë situatën në lidhje me hipotezat e ngritura më lart.

Me anë të metodës krahasuese do dalin në pah të metat dhe përparësitë e objektit të studimit. Vetëm pas një metode krahasuese mund të nxjerrim përfundime të sakta dhe të bazuara në argumenta bindës, po ashtu edhe problematika dhe sugjerime në lidhje me objektin e studimit.

Qëllimi i Ligjit:

Parandalimi dhe reduktimi i dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore;

Garantimi i mbrojtjes me masa ligjore të pjestarëve të familjes, të cilët janë viktima të dhunës në familje, duke iu kushtuar vëmendje të vecantë fëmijëve , të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar (shih nenin 1 të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”).

Objekti i Ligjit:

Ø Krijimi i një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;

Ø Orientimi i punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;

Ø Fuqizimi i gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;

Ø Sigurimi/garantimi, për viktimat e dhunës në familje i një shërbimi të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, praën gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit (shih Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006”Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”: neni 2).

Organet Përgjegjëse: (Po aty: neni 5/1 dhe 6).

1. Autoriteti kryesor përgjegjës sipas këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
2. Autoritetet të tjera përgjegjëse të linjës janë: (organe administrative).
 - a) njësitë e qeverisjes vendore;
 - b) Ministria e Brendshme;
 - c) Ministria e Shëndetësisë;
 - d) Ministria e Drejtësisë.
3. Gjykatat (organe gjyqësore).

Parandalimi i dhunës përmes ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”¹.

Hyrja në fuqi e ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (1 Qershor 2007), shënoi një nga hapat më të sigurt për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standartet ndërkombëtare në fushën e legjislacionit kundër dhunës në familje. Miratimi i këtij ligji nga Kuvendi është rezultat i një nisme qytetare dhe u propozua në Kuvend nga 20 mijë zgjedhës, të cilët faktikisht mbështetën projektin e hartuar nga disa organizata jofitimprurëse, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave, fëmijëve dhe grupeve në nevojë. Kuvendi për të parën herë zbatoi procedura të lidhura me nismën ligjvënëse popullore, për të cilat realisht, nuk kishte të parashikuar asnjë dispozitë në rregulloren e tij.

Ja cfarë prashikon dhe synon ligji:

Se pari, ligji parashikon mjete të posacme administrativo-civile, pra nuk është një ligj penal. Midis tyre spikasin shërbimet, strehëzat si dhe mbrojtja përjashtimore përmes urdhërave mbrojtës që jep gjykata.

Së dyti, ligji synon të parandalojë dhe minimizojë dhunën në familje, si dhe të garantojë mbrojtje ligjore për të gjithë anëtarët e familjes që janë viktime të dhunës, duke i kushtuar vemendje të vecantë fëmijëve. Mbrojtja e ofruar nga ligji u përket të gjithë subjekteve të dhunuara, pavarësisht nga gjinia e tyre. Madje ai e shtrin efektin e tij, duke filluar nga subektet e marrëdhënieve bashkëshortore, të gjinisë, birësimit, kujdestarisë, deri tek ato të bashkëjetesës, të ish marrëdhënieve martesore apo të lidhjeve intime, përfshirë edhe lidhjet që nuk ekzistojnë më.

Së treti, në ligj vendose qartazi detyrimet e autoriteteve përgjegjëse shtetërore, që do të hartojnë politikat dhe strategjitë konkrete te parandalimit dhe të reduktimit të dhunës në familje. Në këtë mënyrë krijohet një rrjet institucionesh bashkëvepruese, si në nivelin e pushtetit qëndror ashtu edhe në atë vendor. Autoriteti përgjegjës që mundëson zbatimin e këtij ligji dhe merr përsipër hartimin e politikave dhe strategjive në parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Ndërsa aktorë të tjetër të cilët do të bashkërendojnë punën me të janë: Ministria e Brëndshme me komisaritet e policisë (shiko nenin 7/1 a,b- 8, 10/1f g; 10/4b; 13/1c- 13/3c; 15/2; 23/6-24), Ministria e Shëndetësisë me qëndrat

1 Shih Mjetet Ligjore Që ofron Ligji “Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” dhe Ndikimi i Tij në Luftën Kundër këtij Fenomeni: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare.

shëndetësore (shiko nenin 7/2d dhe 8/3bc), Ministria e Drejtësisë me detyra të posaçme për trajnimin e personave të ngarkuar me detyra, si dhe autoritetet lokale me qëndrat e shërbimeve sociale pranë tyre².

Së katërti, masat mbrojtëse që parashikohen si për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimës së dhunës në familje, ashtu edhe për rehabilitimin e dhunuesit, janë ndoshta pika më e fortë, që sjell zbatimin e këtij ligji. Ky fakt përbën një fushë beteje për punonjësit social, psikologët, sociologët, të cilët duhet të llojnë për të siguruar bashkëpunimin e institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë në këtë fushë, për të krijuar struktura të qëndrueshme dhe të frytshme mbështetëse dhe rehabilituese.

Së pesti, ligji është një kontribut i rëndësishëm për forcimin e pushtetit gjyqësor përmes sanksionimit të masave mbrojtëse kundër dhunës në familje. Parashikohen si masa mbrojtëse të marra nga gjykata: urdhërat e menjëhershëm mbrojtës dhe urdhërat mbrojtës. Këto urdhëra shërbejnë për të parandaluar një krim të mundshëm që mund të ndodhë në të ardhmen.

Duhet pranuar se ky ligj ka shkuar tej masave të parashikuara në kodin e familjes, pasi parashikon një gamë më të gjërë të masave kundër dhunës dhe procedurave të detajuara.

Megjithatë duhet mbajtur parasysh se, urdhërat mbrojtës nuk mund të shihen si zëvendësuese të procedimit penal. Ato nuk mund të ndalojnë procesin penal ndaj dhunuesit kur janë kryer vepra penale, duke përfshirë kanosje, sulme ose forma të tjera dhune.

Së gjashti, ligji i ka kushtuar një sërë dispozitash, procedurave për zbatimin e tij. Çështja e zbatimit është një sfidë për të gjithë aktorët, e sidomos për gjykatat. Mangësitë procedurale kanë përbërë një nga shkaqet kryesore për moszbatimin e tyre deri më sot. Kodi i Familjes ka parashikuar si masë kundër dhunës, vetëm largimin e bashkëshortit dhunues nga banesa bashkëshortore (neni 62), ose heqjen e përgjegjësisë prindërore (neni 228).

Së shtati, situata e dhunës në familje nuk është një situatë normale dhe masat efikase të posaçme për parandalimin e saj, janë të domosdoshme. Ligji ka sanksionuar standarde të reja, si mjete garantuese për zbatimin me efikasitet të dispozitave të ligjit, për të mbështetur më mirë viktimën. E veçanta qëndron tek zgjerimi i rrethit të subjekteve të cilat legjitimohen për të kërkuar marrjen e masave pranë organeve kompetente, tek afatet e posaçme procedurale, sidomos për gjykimin dhe dhënien e urdhërave mbrojtës të gjykatës, apo tek dhënia

2 E rëndësishme: Njësitë e qeverisjes vendore kanë për detyrë instalimin e një linje telefonike 24 orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjeksore dhe OJF duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre.

e menjëhershme e fuqisë ekzekutive ndaj vendimit gjyqësor për lëshimin e urdhërit mbrojtës etj. Zgjerimi i subjekteve të legjitimitit aktiv përbën një garanci për zbatimin e ligjit, pasi është mbështetje për personin e dhunuar, i cili i trembet procedurave gjyqësore dhe shpesh i shmang ose tërhiqet prej tyre.

Lëshimi i urdhërave të mbrojtjes³.

Viti 2008	4 Çështje	1 Pushuar	3 Pranuar	
Viti 2009	73 Çështje	19 Pushuar	50 Pranuar/ 1 Pjesërisht	3 Rrëzuar
Viti 2010	28 Çështje	8 Pushuar	17Pranuar/ 2 Pjesërisht	1 Rrëzuar

Gjatë vitit 2008 janë evidentuar 40 raste të “kërkesë - padive” për Urdhër të menjëhershëm Mbrojtjeje, ku Gjykata në 36 raste ka nxjerrë vendime me masa mbrojtëse për të dhunuarat dhe në 4 raste është vendosur pushimi i çështjes pasi palët janë pajtuar. 36 raste janë evidentuar në rrethin e Shkodrës dhe 4 raste në rrethin e Pukës.

Vlen të theksohet se nga 40 raste të dhunës në familje në 14 raste është bërë kallëzim penal në ngarkim të bashkëshortëve të tyre ku materialet janë referuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Shkodër për veprat penale të “Kanosjes dhe dëmtimeve të tjera me dashje”.

Gjate vitit 2009 konstatohet se janë plotësuar 35 kërkesë-padi më shumë, gjë që tregon një angazhim më serioz në drejtim të evidentimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2010 janë plotësuar 21 kërkesë- padi “Për Lëshim të Urdhërave Mbrojtës”⁴.

Përfundime-Problematika-Rekomandime⁵.

Nga sa u trajtua më lart, është i dukshme efekti i ligjit të ri për Dhunën në Familje. Ai ka përcaktuar qartë subjektet të cilave u drejtohet, mjetet mbrojtëse dhe autoritet kryesore përgjegjëse. Me rëndësi është pika e bashkëpunimit mes organeve të linjës, me qëllim realizimin e objektit të ligjit.

3 Të dhëna të marra nga Kancelaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

4 Informacion mbi punën e bërë nga “Seksioni për Mbrojtjen e të Miturve e Dhunën në Familje” në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër për periudhën 2008-2010.

5 Shih: STRATEGJIA KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE 2007-2010.

Një rol të rëndësishëm ka Gjykata e Shkallës së Parë, si organ gjyqësor në vendimarrje me anë të urdhëravë mbrojtës.

Përpara hyrjes në fuqi të ligjit, Institucone përkatësë, OJF si dhe organizma të ndryshëm ndërkombëtare, kanë propaganduar fuqishëm denoncimin e dhunës në familje, si një shkelje direkte e të drejtave dhe integritetit të njeriut.

Po të shohim me vëmendje, statistikat e latpërmendura për periudhën 2007-2010, tregojnë qartazi se si ka ardhur duke u rritur ndjeshëm sensibilizimi i qytetarëve, gjë të cilën e kanë demonstruar me anë të denoncimeve ne polici si dhe me këkesat për urdhëra mbrojtjeje.

Megjithatë, kuadri ligjor për dhunën në familje paraqitet ende i paplotësuar:

Kodi penal:

Ø Mungon dhuna në familje si rrethane cilësuese (specifike) në vepra të veçanta, si marrëdhëniet seksuale me dhunë, rrahja dhe veprat e tjera të dhunshme, vrasja, plagosjet, fyerja, etj.

Ø Mungojnë dispozita për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi por edhe neglizhenca e anëtarëve të familjes.

Ø Mungojnë disa dispozita që ndalojnë/ndëshkojnë vendosjen e fëmijëve në situata të tilla ku ata mund të bëhen dëshmitarë të dhunës (gjë që ndonëse tërthorazi, i dëmton mjaft ata në zhvillimin e tyre normal dhe në mirëqenien fizike e psikologjike)

Ø Politikat e dënimit nuk kanë ashpërsinë e duhur ndaj dhunës në familje. Gjithashtu, nuk parashikohen disa dënime alternative që janë më të përshtatshme për rastet e dhunës në familje.

Ø Nuk ka parashikime të veçanta për mbrojtjen e familjarëve të moshuar nga dhuna, abuzimi dhe neglizhimi.

Kodi i procedurës penale

Ø Ndjekjen e disa veprave penale, Kodi i Procedurës Penale e lidh vetëm me nismën e viktimës, duke krijuar përshtypjen dhe duke dhënë mesazhin e gabuar se dhuna në familje nuk është aq e rëndësishme sa shteti të investohet vetë (kryesisht) por është një çështje private mes palëve.

Ø Gjithashtu KPP nuk ndjek politikën e mospushimit të çështjes kur ankuesi tërhiqet nga procesi. Duke qenë se në rastet e dhunës në familje ndodh rëndom që viktima të tërheqë kallëzimin nga frika dhe presionet, KPP duhet të parashikojë dispozita që lejojnë prokurorin të vazhdojë ndjekjen penale edhe kur viktima tërhiqet ne rastet e dhunës në familje.

Ø Po kështu, duhen riparë dhe sqaruar më mirë dispozitat që rregullojnë dhe koordinojnë ngritjen e padisë civile brenda procesit penal.

Kodi civil

Ø Nuk bën parashikime të veçanta për rastet e dhunës në familje që t'i sigurojnë viktimës mundësi efektive për shpërblimin e saj për dëmin moral dhe material të pësuar.

Kodi i familjes

Ø Neni 62 i Kodit të Familjes krijon mundësinë e largimit nga banesa të bashkëshortit dhunues, duke nënkuptuar vetëm dhunën mes bashkëshortëve dhe jo edhe dhunën ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes. Deri me tani kjo dispozitë ka qenë e pashoqëruar me dispozita të nevojshme procedurale që të rregullonin mënyrën se si do të merrej kjo masë, kohëzgjatjen e saj, etj, por këto mangësi po adresohen nga ligji i ri për dhunën në marrëdhëniet familjare.

Ø Mungojnë procedura të veçanta dhe më të thjeshtuara për zgjidhjen e martesës për shkaqe të dhunës.

Ø Po ashtu, nuk ka rregullim të veçantë për pasojat që mund të sjellë dhuna në familje për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, lënien e fëmijës njërit prind për rritje dhe edukim, të drejtën e vizitës apo të banimit, etj.

Pushteti gjyqësor⁶

Nga analiza e roleve, përgjegjësi dhe funksionimit të gjyqësorit, problemet e evidentuara më poshtë janë më të rëndësishmet për dhunën në familje:

Ø Ndonëse ekzistojnë mundësitë kushtetuese, në Shqipëri ende nuk është krijuar një gjykatë e specializuar për të miturit.

Ø Gjyqtarët shqiptarë kanë kompetencë të shqyrtojnë të gjitha çështjet penale, civile, administrative, tregtare, familjare si dhe çdo çështje tjetër të përcaktuar më ligj. Megjithatë është me rëndësi ndarja e brendshme në gjykata dhe specializimi i gjyqtarëve të veçantë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Ø Ka një besim të kufizuar të publikut te veprimtaria dhe autoriteti i gjyqësorit. Nuk kane munguar akuzat për korrupsion, zvarritje të gjykimeve, jotransparence, mungesë profesionalizmi të gjyqtarëve etj.

Ø Mungojnë statistikat e qarta, të hollësishme ose të besueshme që vijnë nga gjyqësori lidhur me rastet e dhunës në familje në përgjithësi dhe asaj të ushtruar ndaj/prej fëmijëve, ndaj/prej të moshuarve dhe grave. Mungon

6 Ligji nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH".

edhe një sistem i unifikuar i raportimit të statistikave që duhet të permbajnë të dhënat e mëposhtme:

Ø Numrin e rasteve të dhunës në familje të paraqitur përpara gjykatës dhe numrin e vendimeve të dhëna në gjykata lidhur me to.

Ø Kohën mesatare për trajtimin e rastit deri në vendimin përfundimtar.

Ø Ekzekutimin ose jo të vendimit.

Ø Numrin e gjyqtarëve të trajnuar mbi dhunën në familje, etikën, të drejtat e njeriut, menaxhimin e rastit të dhunës, etj.

Ø Numrin e stafit administrativ të trajnuar.

Ø Duke munguar statistikat, mungojnë njëkohësisht edhe studimet për efektivitetin e dënimeve dhe vendimeve të dhëna nga gjyqësori për të luftuar dhunën në familje, gjë që e bën të pamundur ndërhyrjen e saktë dhe të mirëinformuar për përmirësime të mundshme.

Ø Arsyetimet e vendimeve gjyqësore rezultojnë të jenë të cekëta, pa analiza të qarta të faktit dhe të shkaqeve të dhunës në familje. Si në vendimet penale, ashtu edhe ato civile e familjare ka një skematizëm të theksuar. Argumentet e gjykatës duhet të jenë më të thelluara dhe jo të një rutine të përgjithshme pasi ato kanë mundësi të luajnë edhe rolin shpjegues dhe edukues dhe të brumosin idenë, si për publikun, ashtu edhe për palët e interesuara, e vecanërisht për dhunuesit se dhuna në familje është e patolerueshme dhe e dënueshme nga sistemi i drejtësisë.

Ø Përvoja në çështjet penale ka treguar se jo gjithnjë masa e dënimit ka qenë në përputhje me rëndësinë e veprës dhe rrethanat lehtësuese e rënduese nuk janë zbatuar drejt. **Mosndëshkimi i dhunuesve i bën viktimat në përgjithësi dhe ato të zonave rurale në veçanti më të larguara nga sistemi i drejtësisë.**

Ø Ndërkohë, ndonëse rrahja, plagosja, e të tjera forma të dhunës fizike dhe psikike parimisht përbëjnë vepra penale dhe janë të ndëshkueshme, është vënë re se nëse ato përfshijnë anëtarë të familjes, nga praktika gjyqësore dhe ajo e profesionistëve të ligjit, nuk trajtohen me seriozitetin e duhur.

Ø Ndërsa realiteti paraqet raste të abuzimeve të prindërve ndaj fëmijëve, në praktiken gjyqësore raste të tilla vihen re shumë pak pasi fëmija e ka të vështirë të denoncojë prindin si dhunues. Nga ana tjetër njohuri të specializuara lidhur me metodikën e gjykimit, teknikat e pyetjes së të miturve që janë pjesë e dhunës në familje, në përputhje kjo me veçoritë moshore dhe psikologjike janë ende të kufizuara.

Ø Edhe në rastin e fëmijëve dhunues vihen re keqpërdorime të masave shtrënguese ligjore të cilat mund të shkaktojnë pasoja të rënda psikologjike, morale, fizike për të miturin.

Ø Infrastruktura bazë dhe shërbimet janë përgjithësisht të pamjaftueshme. Gjykimet ende ndodh të bëhen në kushte të papërshtatshme. Ka mungesë të infrastrukturës mbrojtëse ose mos garantimit të masave mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje por edhe të vetë gjyqtarëve, gjatë procesit të hetimit dhe gjykimimit.

Ø Një mangësi kryesore që vihet re është moskoordinimi ndërmjet strukturave. Mungojnë marrëveshjet nderinstitucionale që sigurojnë mbrojtje shumë disiplinore të viktimave të dhunës në familje dhe unifikim të shërbimeve. Të tilla mund të jenë ato me policinë, shërbimet e urgjencës (ambulancat), mjekësinë ligjore, psikiatrinë ligjore, spitalet, pushtetin lokal (për mundësitë e strehimit dhe shërbimet e tjera sociale), avokatinë (për ndihme ligjore, këshillime dhe mbrojtje falas), OJF-të. Rritja e efektivitetit dhe efijences së sistemit të drejtësisë është e lidhur ngushtë me nivelin e bashkëpunimit midis gjyqësorit dhe strukturave të tjera që zbatojnë vendimet dhe ligjet të tilla si prokuroria, policia dhe policia gjyqësore, përmbarimi, etj.

o Përmirësimin e punës së ekspertëve mjeko-ligjore, me qëllim që ata të disponojnë akte ekspertimi edhe me kërkesën e të dëmtuarit akuzues në rastet e veprave penale që nuk ndiqen kryesisht (shumë prej tyre lidhen me dhunën në familje). Aktualisht viktimave të dhunës u nevojitet një autorizim nga policia ose prokuroria për të kryer ekspertimin mjeko-ligjor, gjë që e zgjat procedurën në dëm të viktimës.

o Rimbursimin e shpenzimeve të bëra nga viktimat e dhunës në familje (ne bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës).

Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Inspektorati i KLD-së.

Në situatën kur dhuna në familje është një çështje shqetësuese dhe kur aksesit i viktimave te sistemi i drejtësisë nuk është i standardeve që qasen me nivelin europian, KLD duhet të diskutojë që në vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve të mbledhë të dhëna dhe të shqyrtojë edhe kritere që lidhen me etikën, shkallën e ndjeshmërisë, shpejtësinë dhe mënyrën se si gjyqtari adreson çështjet e dhunës në familje; të orientojë kontrollin të Inspektoratit të KLD-së ndaj këtyre çështjeve dhe vendimeve; të rekomandojë edukimin e gjyqtarëve me këto çështje, etj.

Shkolla e Magjistraturës

Ndonëse në përmbajtjen e programit të trajnimit fillestar dhe të atij vazhdues çështjet e dhunës në familje kanë qenë pjesë, rekomandohet vazhdimësia e sesioneve dhe ruajtja e periodicitetit të tyre, për sa kohë dhuna në familje

mbetet një çështje shumë serioze, ndaj së cilës qëndrimet e sistemit të drejtësisë janë ende të brishta. Organizimi i konferencave, takimeve rajonale, duke patur parasysh edhe specifika të rajoneve të ndryshme të Shqipërisë, gjyqeve imituese, bërja e studimeve, përgatitja e moduleve të trajnimit hartimi i pyetësorëve për njohuritë, ndjeshmërinë, nevojat dhe prirjet e sistemit të drejtësisë duhet të jetë në qendër të vëmendjes së Shkollës. Organizimi i sesioneve multidisiplinore me pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë të sistemit të drejtësisë është i rëndësishëm gjithashtu. Shkolla e Magjistraturës futi për herë të parë në programin e formimit fillestar elemente të dhunës në familje si dhe të barazisë gjinore në vitin shkollor 2003-2004. Këshilli Drejtues i Shkollës në miratimin e programit të formimit fillestar dhe vazhdues duhet t'i mëshojë përfshirjes së temave mbi dhunën në familje me qëllim që të sigurohet vazhdimësia.

Prokuroria

Mungojnë prokurorë të specializuar në shkallë vendi në të gjitha shkallët e prokurorive lidhur me veçoritë e ndjekjes penale të veprave penale të dhunës në familje dhe trajtimin e viktimave. Nuk i kushtohet vëmendja e duhur veprave penale të tilla si rrahja apo plagosja dhe kjo bëhet shkak që dhuna të ashpërsohet aq sa pasohet nga vepra penale të rënda deri me pasojë vdekjen. Masa e dënimit të propozuar për fajtorin përgjithësisht rezulton të jetë e ulët dhe lloji i dënimit jo i përshtatshëm. Kallëzimet në raport me situatën reale janë të kufizuara gjë që reflekton mosbesim tek ky organ.

Shumica e veprave penale që lidhen me dhunën në familje hyjnë në kategorinë e atyre që ndiqen me ankim nga i dëmtuari akuzues. Për këtë arsye, kallëzimet e tyre **nuk regjistrohen në prokurori** dhe i dërgohen për kompetencë gjykatës në mënyrë të drejtpërdrejtë. (fq.17 QNLQ “për një zbatim sa më të mirë të ligjit...”) Ndonëse prokuroria ka për detyrë të vërë në dijeni opinionin publik për veprimtarinë që kryen, asaj nuk i lejohet të japë të dhëna që dëmtojnë procesin e hetimeve, që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, që cenojnë të drejtat e të miturve dhe moralin publik. Trajnimi me këto çështje si edhe ato që kanë të bëjnë me aftësitë përfaqësuese të prokurorit në sallën e gjyqit janë ende të pakta. Konstatohen njohuri të pamjaftueshme lidhur me procedimin në rastet kur viktimat nuk është (ka vdekur) ose nuk dëshiron që të ankohet.

Policia gjyqësore

Policia gjyqësore kryen hetime mbi veprat penale, nën drejtimin dhe mbikqyrjen e prokurorisë.

Ø Organet e policisë nuk janë të qarta lidhur me detyrimin për mbështetjen e mbrojtjes që duhet të ofrojnë ndaj viktimave të dhunës në familje. Trajnimi i policisë me të drejtat e njeriut, etikën, sjelljen profesionale, dhunën në familje është ende një çështje që nuk është përmbushur në standardin dhe masën e duhur.

Ø Dokumentimi i fakteve kriminale nga policia gjyqësore lë për të dëshiruar dhe kjo ka bërë që ndonëse ka pasur një numër të konsiderueshëm kallëzimesh, është vendosur mosfillimi i procedimit (fq33 QNLQ “për një zbatim sa më të mirë të ligjit...”). Njohuritë e policisë gjyqësore lidhur me cilësimin e një vepre si penale nuk janë në standardin e duhur, gjë që shkakton gjithashtu efektin e mësipërm.

Zyra e përmbarimit

Ø Viktimat e dhunës nuk janë të përjashtuara nga pagesat në rastet e ekzekutimit të vendimeve që lidhen me dhunën në familje.

Ø Ka vonesa në veprimtarinë e përmbarimit ose mospërmbushje të urdhrave të ekzekutimit gjë që në rastin e dhunës në familje mund të sjellë pasoja në jetën e viktimës.

Ndihma ligjore dhe avokatia

Legjislacioni që siguron të drejtën e mbrojtjes ligjore është i një niveli të mirë, por zbatimi i tij has në vështirësi. Kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së akteve nënligjore, por edhe e shkaqeve subjektive që në të vërtetë çenojnë efektivitetin e së drejtës së mbrojtjes. Ndihma ligjore falas përgjithësisht i jepet asaj kategorie të personave të cilët kanë mundësi të kufizuara ose janë në pamundësi për të përballuar shpenzimet për zgjidhjen e problemeve ligjore. Me miratimin e ligjit të ri kundër dhunës në familje viktimave të saj u sigurohet ndihmë ligjore falas. Është me rëndësi në këtë pikë zbatimi i kësaj dispozite të re.

Ndërkohë, është e domosdoshme që për efektivitetin e mbrojtjes së ushtruar prej avokatëve (pavarësisht nëse është fjala për mbrojtjen falas ose jo) **të minimizohen ose eliminohen probleme që kanë të bëjnë me etikën profesionale, të tilla si:** heqja dorë nga mbrojtja gjatë procesit, mungesa e profesionalizmit, mosparaqitja në seanca të ndryshme gjyqësore, zvarritjet, etj.

Një koordinim më i mirë midis gjykatave dhe prokurorive (këto caktojnë mbrojtësin falas) nga njëra anë dhe dhomave vendore të avokatisë në rrethe nga ana tjetër kërkohet për të rritur cilësinë e përfaqësimit dhe të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje. Kjo do të kërkojë përgatitjen e listave të

avokatëve falas të cilët janë me përgatitje të lartë profesionale në çështjet e dhunës në familje dhe vendosjen e këtyre emrave në dispozicion të gjykatës dhe të prokurorisë.

Ndihma ligjore për viktimat e dhunës në familje ofrohet edhe prej OJF-ve që veprojnë në këtë fushë. Madje disa prej tyre kanë ofruar një shërbim shumë të kualifikuar. Ndërmjet tyre përmendim kryesisht Qendrën për Nisma Ligjore dhe Qytetare (ish-Qendrën Avokatore për Gratë), Klinikën Ligjore për të Miturit, Qendrën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, etj. Mbështetja e këtyre shërbimeve dhe qendrave prej shtetit është në funksion të rritjes së aksesit në sistemin e drejtësisë.

Ministria e Brendshme. Policia e shtetit. Shkolla e policisë

Në nivel qendror një prej strukturave që lidhet më ngushtë me çështjet e dhunës në familje është Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Ministrisë së Brendshme. Në nivel qarku funksionojnë 12 Drejtoritë e Policive në Qarqe.

Ø Policia ende nuk e luan në mënyrë profesionale rolin e saj në parandalimin e fenomenit të dhunës në familje si edhe në identifikimin, regjistrimin, ndjekjen dhe zgjidhjen e konflikteve të ndryshme që shoqërohen apo pasohen me përdorimin e dhunës në familje. Mungojnë analiza lidhur me përgjegjësitë dhe rolin parandalues që mund të luajë policia në rastet e krimit brenda familjeve dhe të vetëvrasjeve.

Ø Emergjent është krijimi i një sistemi të referimit dhe menaxhimit të rastit të fëmijëve të dhunuar, të grave e të moshuarve në të gjitha nivelet e policisë.

Ø Ende ka standarde jo të kënaqshme në ofrimin e shërbimit policor prej strukturave përkatëse. Nuk janë të qarta mënyrat se si policia do të mbajë nën kontroll individë dhunues dhe familje të rrezikuara nga dhuna.

Ø Megjithatë, si rezultat i ndihmës së huaj në strukturat e policisë po ngrihet sistemi i regjistrimit të kompjuterizuar TIMS, në të cilin do të kenë akses të pakufizuar të gjithë punonjësit e policisë si dhe akses të kufizuar prokurorët dhe gjyqtarët. Sistemi i raportimit TIMS do të përmbajë të dhëna edhe për dhunën në familje. Me këtë rast është me rëndësi trajnimi i oficerëve të policisë për përdorimin e sistemit si dhe hartimi i akteve nënligjore (udhëzimeve) për të dhënat që duhen përfshirë detyrimisht në sistem.

Noteria

Nuk parashikohen shërbime falas për noterizimin e akteve në interes të viktimave të dhunës në familje me pamundësi ekonomike. Trajnimet e notereve lidhur me çështje të ndryshme të etikës profesionale janë shumë të kufizuara.

Mjekësia ligjore

Shërbimi i Mjekësisë Ligjore ka ende nevoja për trajnim të specializuar të ekspertëve mjekoligjore dhe përpilimin e protokolleve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe për mënyrën e ekzaminimit; mënyrën e mbajtjes së rekordeve; Ekspertet duhet të pajisen edhe me paketën e mjeteve të duhura për ekzaminimin e rasteve të dhunës në familje; duhen hartuar udhëzime për mbajtjen e statistikave dhe duhen përfunduar marrëveshjet e bashkëpunimit me shërbimet e tjera që u ofrohen viktimave.

Fakultetet e Drejtësisë. Shkollat Pasuniversitare

Shtimi i numrit të fakulteteve të drejtësisë, kërkon në mënyrë imediate unifikimin e standardit të njohurive në disa lëndë dhe në disa nivele ndërmjet të gjitha fakulteteve publike dhe private me qëllim që studentët të kenë njohuritë e domosdoshme mbi kuptimin e dhunës në familje, format e shfaqjes së saj dhe qëndrimin ligjor ndaj sjelljeve të dhunshme. Jo të gjitha fakultetet kanë klinika ligjore (ose edhe aty ku figurojnë nuk funksionojnë), të tilla që të stimulojnë përgatitjen e ekipeve të studentëve jo vetëm të ditur nga pikëpamja teorike por edhe të aftë në praktikë. Problemi i dhunës në familje dhe mënyra e adresimit të tij prej sistemit të drejtësisë ende nuk përfshihen në programin e ndonjë lënde në shumicën e fakulteteve të drejtësisë. Pedagogët dhe studentët duhet të inkurajohen në kryerjen e punimeve shkencore mbi dhunën në familje (universitare dhe pas universitare) dhe masat për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave.

Së fundmi, një nga plotësimet që mund ti bëhet ligjit është vendosja e sanksioneve për personat që bëjnë një denoncim të rremë për motive dhe qëllime të ndryshme që ata/ato mund të kenë.

Bibliografia

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Miratuar me Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, Tiranë, Kuvendi i Shqipërisë.

Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë, 2003, Tiranë, Botim i qendrës së publikimeve zyrtare, Kristalina- KH.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ardita Alsula, 2008, Tiranë, Alb Juris.

Ligji Nr. 9669, dt. 18.12.2006 *“Për Masa ndaj Dhunës në Familje në Marrëdhëniet Familjare”*.

Ligji Nr.9877, dt. 18.02.2008 *“Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*.

MPÇSHB, 2007-2010, *“Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje”*, Tiranë, Botim i MPÇSHB.

OSCE, 2007, *“Si të Kërkojmë Mbrojtje nga Dhuna në Familje”*, Tiranë, Botimet OSCE.

Qendra për nisma ligjore qytetare, 2007-2008, *Mjetet Ligjore që Ofron Ligji “Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” dhe Ndikimi i tij në Luftën Kundër këtij Fenomeni*, Tiranë, Botim i QNLQ.

Qendra e Aleancës Gjinore Për Zhvillim, Nëntor 2008, *“Broshurë për Viktimat e Dhunës në Familje dhe Komunitet”*, Tiranë, Mediaprint.

Statistika nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Drejtorisë së Policisë: Periudha 2008-2010.

FËMIJËT ME NËNA TË DËNUARA

Juliana AJDINI
Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

This article aims to contribute to the growing interest and consideration for the effects of mother's punishment of children by addressing issues of new practice of social work with this social group. The purpose of this paper is to explore through the experiences of children with mothers themselves prosecuted, the rights and needs, aiming to address social policy on European integration in the framework of our country. This study will use the stories of participants to explore the process of coping with a new situation in their lives. This new situation will assess the needs and rights should enjoy and the role that social workers should have in their welfare as human beings. The article presents a study that the author has conducted with 10 children with imprisoned mothers. Introducing a general overview of political-makers in European countries in such cases will also be the focus of this article. The method has been that of qualitative research, based on semi-structured interviews. The conclusions of this study are important for raising awareness of social institutions to pay attention to social problems brought incarceration, especially of women - mothers as a vulnerable target group that needs specialized treatment by a multidisciplinary team. One of the most important recommendations of this paper is that of increasing awareness of policy makers to better address the needs and rights of children with mothers in prison.

Keywords: children, children with a mother convicted, social work, social policy, social integration.

I. Hyrje

“Gratë dhe burrat janë të ndryshëm. Trajtimi i barabartë i burrave dhe grave nuk do të thotë se do të na japë rezultate të barabarta”

Burrat dhe gratë janë subjekte të burgimit, por shumë pak janë konsideruar nevojat dhe problemet e ndryshme me të cilat përballen ata gjatë këtij procesi.

Kjo ndoshta vjen dhe nga fakti se gratë përbëjnë një minoritet të vogël në popullsinë e burgjeve; vetëm 4% në të gjithë botën. Shumë gra në burgje nëpër botë janë nëna. Gratë ka mundësi të jenë kujdestarët e vetme të fëmijëve dhe ky fakt e bën eksperiencën e burgimit më domethënëse për to se sa për burrat. Efektet e burgimit të nënës janë më të domethënëse tek fëmijët sesa burgimi i babait. Për fat të keq, kjo gjë nuk është e njohur nga sistemi i drejtësisë kriminale.

Në të gjithë botën, burgjet dhe mënyrat se si ato funksionojnë janë ndërtuar për t'iu përgjigjur nevojave të pjesës më të madhe të burgjeve, burrave. Nevojat fizike, mendore dhe emocionale të grave të dënuara ndryshojnë nga ato të burrave. Burgjet mund të mos jenë të aftë të ofrojnë mjedise materniteti dhe kujdes para-natal, ose akses ndaj produkteve higjienike të përshtatshme. Gratë mund të kenë nevoja të ndryshme lidhur me problemin e varësisë ndaj substancave, shëndeti mendor, manaxhimit të zemërimit, historitë e abuzimit fizik, psikologjike ose atë seksual.

Të dënuarat femra kanë një shkallë të lartë raportimi të përballjes me problem të shëndetit mendor dhe kanë më shumë mundësi të jenë pjesë e historie të abuzimit fizik, psikologjik apo seksual sesa popullsia e përgjithshme dhe kanë një risk të lartë për tu përfshirë në sjellje vetë-dëmtuese dhe vetë-vrasëse. Shumë gra në burgje janë nëna dhe në shumë raste prej tyre ata mund të jenë të vetmet kujdestare të fëmijëve. Ky është një fakt interesant për të gjetur rrugë/mënyra për të që këto nëna të mbajnë lidhjet familjare. Të drejtat e fëmijëve më nëna të dënuara janë gjithashtu të rëndësishme për tu konsideruar.

Kërkimet kanë treguar se burgimi i grave nuk është forma më efektive e reduktimit të krimit. Eksperiencia e burgimit mund të ketë efekte dëmtuese si tek nëna ashtu edhe tek fëmija duke rritur mundësitë që të përballen me çështje të shëndeti mendor ose probleme të varësisë nga droga dhe alkooli.

Qëllimi i këtij artikulli është eksplorimi nëpërmjet eksperiencave të vetë fëmijëve me nëna të dënuara, të të drejtave dhe nevojave e tyre duke synuar adresimin e politikave më sociale në kuadrin e integritimit evropian të vendit tonë. Prezantimi i një panorame të përgjithshme politikë-bërëje në ShBA dhe vendeve të Evropës do të jetë gjithashtu fokus i këtij artikulli

Objektivat e këtij studimi do të jenë:

- Eksplorimi i disa të drejtave që duhet të gëzojnë fëmijët me nëna të dënuara në Shqipëri.
- Prezantimi i modeleve bashkëkohore evropiane dhe botërore për fëmijët me nëna të dënuara.

Pyetjet kërkimore të këtij studimi do të jenë:

- Si i perceptojnë të drejtat e tyre, fëmijët nëna të dënuara?
- Çfarë ndryshimesh në konceptin e të drejtave kanë ndodhur në jetën e fëmijëve pas dënimit të nënës së tyre?
- Në çfarë mënyre siguruesit e shërbimeve sociale, punonjësit socialë dhe administratorët duhet t'i adresojnë problemet e respektimit të të drejtave të tyre?

II. Metodologjia

Ky studim ka në thelb metodën shkencore cilësore e cila nuk bazohet në kampionim të popullatës. Do ishte ideale që kërkuesja të arrinte që të studioje të gjithë fëmijët me nëna të dënuara. Por kjo në një situatë reale është pothuajse e pamundur. Rezultatet e këtij studimi nuk mund të përgjithësohen në një popullsi të gjerë, por qëllimi i këtij studimi është të kuptuarit në mënyrë të detajuar, të unicitetit të fenomenit që studiohet për ata persona që ishin pjesë e këtij studimi.

A) Pjesëmarrësit

- **Kriteret për përzgjedhjen e rasteve**

Në këtë studim me fëmijë me nëna të dënuara do të kuptohen ata individë nën moshën 18 vjeç që gjatë periudhës Korrik – Gusht 2010 kanë pasur nënën e tyre të dënuar në IEVP 325 në Tiranë, Shqipëri. Në studim u përfshinë 10 fëmijë, nga të cilët 3 ishin femra. Pjesëmarrësit u intervistuan në periudhën Korrik – Gusht 2010. Për pjesëmarrjen e tyre u vendosën disa kriteret:

- o Të kishin të dënuar sa paku nënën e tyre;
- o Nëna e tyre të vuante dënimin në IEVP 325 në Tiranë, Shqipëri;
- o Mosha të varionte nga 10 -18 vjeç;
- o Të ishin të shoqëruar nga kujdestari i tyre ligjor;
- o Të jepnin konsentin e tyre për pjesëmarrjen në studim së bashku me miratimin e kujdestarit ligjor;

Kriteret synonin të përzgjidhnin një kampion sa më përfaqësues, duke qenë e ndërjegjeshme se rezultatet nuk do të mund të përgjithësoheshin.

B) Hartimi i kërkimit

Ky studim perceptohet si një proces zbulimi dhe jo një testim i thjeshtë i hipotezave. Në këtë kërkim cilësor theksi do i vihet kuptimit të eksperiencave, zakoneve, pritshmërive dhe perspektivës së pjesëmarrësve në lidhje me respektimin e të drejtave të tyre dhe përcaktimi i nevojave më imediate të tyre.

Ky punim bën pjesë në një sërë mini-studimesh që autorja ka realizuar në përmbushje të studimit të doktoraturës. Gjithashtu, eksperiencia personale me grupet e deprivuar nga liria dhe dëshira e madhe për të sjellë diçka ndryshe, diçka të re në fushën e studimeve, për të kontribuar në zhvillimin e profesionit të punës sociale e nxiti kërkuesen për studimin e një grupi për të cilin nuk kishte shumë të dhëna, siç ishin fëmijët me nëna të dënuara. Ky grup shumë i ndryshëm, jo i qëndrueshëm, në kohë dhe hapësirë, u konsiderua si grupi i studimit. Studimi u konceptua që në fillimet e tij si cilësor. Ai do të përfshinte jo vetëm të dhënat që do të merreshin nga pjesëmarrësit, por edhe nga rishikimi i literaturës.

Do të përfshiheshin fëmijë me nëna të dënuara, jo sepse në Shqipëri nuk ka të dënuar meshkuj, por grupi përfaqësonte një diversitet të madh analizues. Kërkuesja shpreh bindjen se në të ardhmen dhe ky grup fëmijësh do të jenë fokus i studimeve të saj.

C) Instrumentet

Në këtë studim hartimi i instrumenteve është bërë duke u mbështetur në punën e Holstein dhe Gubrium (1995). Janë përdorur "intervistat gjysëm të strukturara" të cilat përqendrohen në teknika aktive dhe jo me pyetje tërësisht të strukturuar. Intervista aktive është "lirshmërisht i drejtuar". Ajo konsiston në të dyja elementët, objektive dhe subjektive. Elementët objektive kanë të bëjnë me atë se *çfarë* do të diskutohet në mënyrë të vullnetshme mes të intervistuarit dhe intervistes. Është subjektive sepse ndikon se si intervistesit do e interpretojnë "atë që duan intervistesit dhe kanë mundësi të zhvillojnë mendimin e tyre mbi këtë perceptim, që mund të jetë edhe i gabuar". Gjatë realizimit të intervistave është mbajtur një format pyetjesh të ndërtuara nga kërkuesja në përputhje me qëllimin dhe objektivat e këtij kërkimi.

Ky studim është bazuar edhe në studimin e literaturës në lidhje me objektin kryesor të saj. Në përzgjedhjen e literaturës, kanë dominuar katër kritere, të cilat janë marrë në konsideratë.

Ø Autenticiteti, është origjina e burimit të vërtetë;

Ø Kredibiliteti, përfshin shmangien e çdo gabimi ose manipulimi të mundshëm;

- Ø Përfaqësues, është burimi tipik në llojin e tij;
- Ø Kuptimi, është burimi i qartë dhe gjithëpërfshirës;

D) Procedura

Pas prezantimit, të intervistuarve ju është bërë e qartë qëllimi i intervistës dhe çështjet e konfidencialitetit. Më pas u është kërkuar konsenti/miratimi me shkrim i tyre për të qenë pjesë e këtij studimi. Pasi ata kanë dhënë konsentin e tyre, ka filluar intervista.

Pyetjet janë bërë në përputhje me linjën logjike që intervista merrte ndërmjet intervistuesit dhe të intervistuarit. Qëllimi i intervistës ishte të lejonte të intervistuarin të paraqiste historinë e tij me ndërhyrje minimale nga intervistuesi. Janë drejtuar të gjitha pyetjet e përfshira në format, jo gjithmonë sipas renditjes së tyre, dhe shumë pyetje të tjera për të cilat intervistuesja ishte e interesuar të merrte opinionin, mendimin dhe perceptimet e të intervistuarve.

Pjesëmarrësit janë intervistuar vetëm një herë për pothuajse 90 minuta. Atyre u është kërkuar të tregojnë historinë e tyre të bazuar në çështjet kryesore të intervistës. Intervistat janë zbardhur në të ashtuquajturat narrativa. Analizimi narrativ është hallka e parë e analizimit të intervistave. Ajo përdoret për të interpretuar të dhënat. Narrativat janë përshkruar nga Gubrium dhe Holstein (1997) si "llogari që ofrojnë disa skema, në mënyrë implicite ose eksplicite, për organizimin dhe kuptimin e marrëdhënieve mes objekteve dhe ngjarjeve të përshkruara". Narrativat na ndihmojnë në procesin e kodimit. Në këtë studim është përdorur procesi i kodimit të hapur, në të cilin konceptet përzgjidhen dhe përshkruhen në bazë të dimensioneve dhe karakteristikave të tyre. Në këtë studim është përdorur kodimi i fjalive dhe paragrafëve. Kategoritë fillestare janë zhvilluar më tej në lidhje me rrethanat shkakësore, pasojat, kontekstin, veprimin dhe ndërveprimin dhe faktorëve ndërhyrës. Së fundmi, është përdorur kodimi selektiv në mënyrë që të konsolidohen dhe të integrohen rubrikat kryesore të studimit. Kategoritë e identifikuar kishin të bënin me këto elementë të socializimit:

- Ø Stigmën dhe turpin;
- Ø Izolimin social;
- Ø Nevojat ekonomike.

Në këtë studim ju është kushtuar vëmendje e rëndësishme këtyre *principeve etike*:

§ *Konsenti i informuar* sipas Terre Blanche dhe Durrheim (1999) dhe Strydom (2002) është procesi i kërkimit të lejes në mënyrë eksplicite subjektiv për të qenë pjesëmarrës në studim, bazuar në kuptueshmërinë e plotë të tij mbi procedurat e intervistimit dhe qëllimit të tij. Për shembull, të gjithë pjesëmarrësve në këtë studim iu është bërë e ditur qëllimi i intervistës dhe fakti i mbajtjes shënim i intervistës. Ata janë lejuar që t'i lexojnë shënimet në çdo moment të intervistimit.

§ *Konfidencialiteti* përfshin një marrëveshje nga kërkuesi për të mbrojtur anonimat e pjesëmarrësve në studim (Strydom, 2002). Shumë pak njerëz do të donin të ndanin me të tjerët detaje të jetës së tyre private, opinionet dhe emocionet e tyre. Për këtë arsye konfidencialiteti është një kërkesë e domosdoshme për kërkime të besueshme (Oka dhe Shaë, 2000).

§ *Raportimi i rezultateve*: Rezultatet e studimit duhen publikuar duke treguar shumë kujdes mbi të drejtat e pjesëmarrësve. Në asnjë moment nuk duhen keqinterpretuar apo shtrembëruar informacioni i dhënë nga pjesëmarrësit në studim (Strydom, 2002). Në këtë studim, rezultatet mbështeten plotësisht në të dhënat e marra nga pjesëmarrësit.

III.Rezultatet

Të drejtat dhe interesi më i lartë i fëmijëve të grave të dënuara shumë radhë janë konsideruar nga proceset e drejtësisë penale, edhe pse edhe dënimi i babait ka impakt të lartë në jetën e tyre. Janë tri mundësi:

- Fëmija të shkojë në burg me nënën dhe të vuajë pasojat e dënimit së bashku me të
- Fëmija të ndahet nga nëna dhe të vuajë pasojat e saj.
- Kur ka më shumë se një fëmijë, ata mund të trajtohen në mënyrë të ndryshme, p.sh njëri mund të shkojë në burg me nënën e tij ndërsa tjetri të ndahet. Në të dyja rastet, fëmijët vuajnë pasoja specifike.

A. Fëmijët dhe nënat e tyre.

1. Stigma dhe turpi.

Ajo çfarë përjetojnë fëmijët me nëna të dënuara, ka qenë pjesë e shumë studimeve në botë. Në Shqipëri, fatkeqësisht, akoma nuk është bërë një studim

i mirëfilltë në lidhje me një çështje të tillë. Kërkesja i pyeti fëmijët e intervistuar në lidhje me këtë çështje. Këndvështrimet dhe problemet me të cilat ishin përballur fëmijët ishin të shumta. Ata dëshmojnë për paragjykime, përbuzje, mbyllje në vetvete, etj.

Fëmijët e intervistuar dëshmojnë se që nga momenti i arrestimit të nënës së tyre, në komunitetet ku ata jetojnë gjykojnë dhe nuk mirëpritën. Shumë shpesh ata janë etiketuar, jo vetëm nga bashkëmoshatarë të tyre, si “kriminelë”, “burgaxhinj” dhe “të padëshiruar”. Alma thekson:

“Nuk dua ta kujtoj fare situatën e të nesërmes...nëna ime kishte bërë një krim të tmerrshëm, por ne nuk kishim faj. Kur dola në rrugë, më gjuajtën me gurë dhe më shanë me fjalë nga më të ndryshmet”.

2. Izolimi social

Shumë shpesh, ajo çfarë raportohet nga studimet është dhe fakti që fëmijët e të dënuarve jo vetëm që mbyllën në vet-vete, por si rezultat i stigmës ata izolojnë nga bota e jashtme. Një fakt i tillë, raportohet edhe nga të intervistuarit taë. Kështu, Mira shprehet:

“Kur nëna u dënua, nuk doja të dilja. Mbjaj mend se kam qëndruar 50 ditë e mbyllur brenda, vetëm me motren. Shpesh herë nuk doja të flisja edhe me ato.”

3. Nevojat ekonomike.

Fakti që nëna dënohet nuk do të thotë domosdoshmërisht që fëmijët të humbasin të drejtën për përkujdesje. Në shoqërinë tonë, ku marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes vazhdojnë të jenë i vetmi burim përkujdesjeje dhe figura atërore perceptohet si kryesoja për sigurimin e të ardhurave, mungesa e nënës sjell për pasojë moskujdes sociale për fëmijët. Institucionet shtetërore mbi përkujdesjen e fëmijëve të prindërve të dënuar duhen forcuar. Mandi, 11 vjeç tregon:

“Në shtëpinë time vetëm babi punonte. Kur nëna u dënua ne nuk kishim me çfarë të jetonim. Babi u detyrua ta çonte motrën e vogël në jetimore.”

B. Politika, Ndryshimet dhe Praktika të Mira

Ndërsa numri i popullatës rritet nëpër burgje, gjithnjë e më tepër po rritet dhe interesi për fëmijët dhe familjet e tyre.

a) Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Disa shtete të SHBA – ve kanë marrë masa për të rritur cilësinë e mjediseve në të cilën fëmijët takohen me nënat e dënuara. Megjithëse, këto mjedise lënë shumë për të dëshiruar, mbetet një fillim i mirë. Në burgun e San Antonio, Texas, ekziston një program për prindërimin e drejtë, 'MATCH' (mothers and their children) që filloi për herë të parë në vitin 1984. 70 nëna të programit jetojnë së bashku duke marrë pjesë në trajnime mbi prindërimin dhe shprehitë jetësore. Shteti i Illinoisit dha ai Neë York-ut, kanë demonstruar gjithashtu një praktikë të mirë në këtë fushë duke implementuar procedura që inkurajojnë prindërimin dhe mbështetjen e fëmijëve të tyre.

b) Mbretëria e Bashkuar

Sistemi i burgjeve në MB ka qenë gjithmonë më progresistë se sa SHBA në promovimin e një ideali rehabilitimi, dhe tani me "burgjet e hapura", fëmijët kanë pritshmëri dhe nivel aksesi më të mirë ndaj nënave të dënuara. Ministria e Brendshme ka mbështetur një numër të konsiderueshëm iniciativash prindërimi për të rritur kontaktet familjare me të dënuarit.

Ka disa skema të efektshme arsimore dhe mbështetje në Mbretërinë e Bashkuar, disa nga të cilat drejtpërdrejt kanë si objektiv nënat e dënuara. Një shembull i vlerësuar me çmime në këtë drejtim është "Libri me Tregime nga Nëna", përmes të cilit nënat lexojnë historitë e librit duke i regjistruar në një CD dhe i'ua dërgojnë fëmijëve të tyre. Një iniciativë e tillë lejon dhe nënat që nuk dinë të lexojnë, që pasi punonjësi social t'ua lexojë librin, ata ta ritregojnë historinë dhe ta regjistrojnë. Programe të tilla nxisin marrëdhëniet mes nënave dhe fëmijëve të tyre.

c) Evropa

Edhe pse pjesa më e madhe e informacionit në lidhje me praktikën e mirë mbi kujdesin përkundrejt fëmijëve me nëna të dënuara vjen nga MB dhe ShBA, dhe në vende të Evropës mund të gjejmë praktika pozitive. P.sh në **Francë** funksionon Federata e Marrëdhënieve Fëmijë-Prindër (FMF-P) që është një organizatë ombrellë për 17 shoqata në të gjithë Francën. Ajo, me anë të profesionistëve të saj mundëson ruajtjen e marrëdhënieve të fëmijëve me prindërit e tyre, edhe pas dënimit të këtyre të fundit. Profesionistët e saj luajnë kryesisht rolin e ndërmjetësit duke shoqëruar fëmijët gjatë vizitave tek prindërit, dhe në mbështetjen e fëmijëve për të ndarë ndjenjat e tyre me ta.

Një organizatë e tillë funksion edhe në **Belgjikë**. Synimi kryesor i saj është nxitja e kurseve të prindërimit. Në këtë kuadër, FMF-P organizon diskutime në grup, aktivitete sportive të përbashkëta nëna - fëmijë dhe vullnetarët e saj shoqërojnë fëmijët gjatë vizitave tek nënat e tyre.

Në **Luksemburg**, Shërbimi Treffpunkt ofron ndihmë të ngjashme me FMF-P. Profesionistët e saj punojnë për të ndihmuar fëmijët e ndarë nga prindërit e dënuar, të të dy gjinive, të punojnë me ndjenjat e tyre dhe i shoqërojnë fëmijët në vizitat periodike. Nëse këta profesionistë nuk do i ofronin këto shërbime, me shumë mundësi, fëmijët do ta kishin të pamundur të takoheshin dhe të ruanin marrëdhëniet me prindërit e tyre.

Shoqatat **italiane** Bambinisenzasbarre ofron mbështetje për nënat dhe baballarët e dënuar, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të tyre mbi aspekte të ndryshme të marrëdhënieve prind-fëmijë. Synimi është përforcimi i shprehive prindërore. Gjithashtu, profesionistët e kësaj organizate mbështetje psiko-sociale për fëmijët e këtyre prindërve. Qartësisht, një përjasje e tillë është e kushtueshme dhe kërkon ndërhyrjen e profesionistëve të shumtë, si punonjës socialë, psikologë, gjyqtarë dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme sociale.

IV. Diskutimi

Duke qenë një studim i pari në llojin e tij, kërkuesja synon jo vetëm të përmbushë qëllimet dhe objektivat e këtij studimi, por dhe të sjellë një konceptualizim të ri të profesionit të punës sociale dhe me fëmijët e të dënuarve. Nevojat e tyre janë të shumta, mosplotësimi i tyre ndikon drejtpërdrejtë në mënyrën e të sjellurit, menduarit dhe të vlerësuarit të jetës dhe vetes në veçanti. Të gjithë këto komponentë ekonomikë, psikologjikë dhe socialë duhen konsideruar sepse kur flasim për fëmijët si e ardhmja e shoqërisë nuk përmendim thjesht vetëm një klishe.

Fëmijët me nëna të dënuara sjellin këndvështrimin e tyre mbi të drejtat që edhe ata duhet të gëzojnë, pavarësisht statusit të nënës së tyre. Rezultatet e këtij studimi do të shërbejnë për të ri-konceptualizuar praktikën shqiptare të punës sociale me fëmijë me nëna të dënuara.

· Roli i profesionistëve të punës sociale në punën me fëmijët me të nëna të dënuara

Profesioni i punës sociale, si një profesion që nxit përgatitjen e individëve

për përmbushjen e kapaciteteve të tyre intelektuale brenda kontekstit social ku ata jetojnë, ka marrë përsipër edhe ndihmesën e fëmijëve me nëna të dënuara. Për hir të së vërtetës duhet thënë se të punuarit me një target të tillë nuk është aspak e lehtë. Çështjet dhe problemet etike që mund të hasen janë të mëdha.

Shumë nga këta fëmijë shmangin diskutimet që kanë lidhje me problemet potenciale të tyre duke shfaqur shenja pesimizmi dhe prezantuar veten si genie të dobëta e pa synime në jetë, ata shmangin marrjen përsipër të përgjegjësiave duke synuar në çdo rast sabotimin e mundësisë së ndërtimit të një procesi ndihme. Ata ndjehen të pashpresë. Por kjo është vetëm panorama e parë e përballjes së punonjësit social me ta. Dhe siç edhe e dimë një reagim i tillë është mëse i kuptueshëm edhe me klientë të cilët shfaqin problematika të natyrave të tjera. Punonjësit social i duhet të gjejë teknika dhe të përdorë metoda të ndryshme për të nxitur klientin të bashkëpunojë. Punonjësi social duhet të rishikojë pozicionin e tij dhe të kuptojë se rezistenca e shfaqur prej tyre është ndoshta një mjet mbrojtës që përdorin ata fëmijë për të shmangur paragjykimet, lëndimin e mëtejshëm apo për t'i qëndruar besnik kulturës në të cilën janë rritur. Ndërtimi i një marrëdhënie të mirë arrihet kur vetë punonjësi social jep shembullin konkret të përdorimit të drejtë, në kohën e duhur dhe në vendin e caktuar të mendimeve, ndjenjave, fjalive, gjesteve, sjelljes në përputhje gjithnjë me etikën e tij profesionale. Mbajtja parasysh e këtyre rekomandimeve do ta ndihmonte punonjësin social të ndërtonte një marrëdhënie të drejtë ndihme.

Ne si profesionist duhet të bëjmë vlerësime individuale. Për të realizuar një proces të tillë punonjësi social duhet të jetë i vëmendshëm që të mbledhë një informacion sa më të gjerë për problemin dhe situatën të cilën po përjeton individi. Ky proces përfshin marrjen e një informacioni sa më të gjerë jo vetëm nga klienti, por edhe nga të afërmit e tij. Kjo do ta ndihmonte punonjësin social që të kuptonte më mirë problemet që këto klientë kanë, faktorët që i shoqërojnë këto probleme që në lindjen e tyre si dhe të kuptojnë burimet e problemit apo ato burime që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Punonjësi social duhet të japë kontributin e tij edhe në hartimin dhe përpilimin e politikave të reja mbi fëmijët me nëna të dënuara. Të gjitha këto funksione dhe role punonjësi social nuk mund t'i realizojë i vetëm, pa ndihmën dhe mbështetjen e duhur ligjore dhe institucionale.

Fëmijët me të paktën njërin prind të paraburgosur gëzojnë dhe duhet të gëzojnë të njëjta të drejta sikurse edhe fëmijët e tjerë, të cilët i kanë prindërit e lirë. Problemet dhe shqetësimet që ata ndanë me kërkuesen ishin të shumta. Kjo thekson edhe njëherë domosdoshmërinë e ngritjes së strukturave sociale mbështetëse edhe për kategori të shoqërisë tonë. është detyrë e profesionistëve

të punës sociale që të realizojnë studime të plota mbi këtë grup dhe më pas mbi bazën e gjetjeve të ngrënë kapacitetet dhe strukturat mbështetëse. Intervistat e realizuara me ta treguan vunerabilitetin e këtij grupi. Ata janë pjesë e shoqërisë tonë, dhe ne e kemi për detyrë të ndërgjegjësohemi se ata janë mes nesh dhe më pas të mendojmë se si mund t'i ndihmojmë. Fëmijët nuk kanë asnjë faj! Ata thjesht janë fëmijë! Nuk kanë zgjedhur të jenë fëmijët e dikujt apo të dikujt tjetër!

Kërkuesja uron dhe shpreson që intervistat e realizuara me ta, të paraqitura në studim të ndërgjegjësojnë grupin e profesionistëve për të vënë në qendër të vëmendjes së tyre edhe fëmijët nëna të dënuara. Si profesionistë dhe praktikienë të punës sociale duhet të zhvillojmë aftësi drejtuese dhe të jemi vizionare mbi ndryshimet shoqërore duke promovuar dhe advokuar për të drejtat e këtij grupi shoqëror.

Bibliografia

- Braithwaite, John (1991) *Crime, Shame and Reintegration*: Sage Publication
- Bryman, A. (2001) *Social Research Methods*, Oxford: Oxford University Press
- Devine, F. "Qualitative Methods" in Marsh, D and Stoker, G (ed) (1995) *Theory and Methods in Political Science*, Houndmills: Palgrave
- Dragoti, Edmond. et. al. (1996) *Puna Sociale*. Tiranë: TOENA.
- Dragoti, Edmond (1999). *Adoleshenti. Vështrim socialpsikologjik i fillimeve të Adoleshencës*. Tiranë: ALBDESIGN.
- Fantuzzo, J. & Lindquist, C. (1989). The effects of observing conjugal violence on children: A review & analysis of research methodology. *Journal of Family Violence*, 4(1), 77-94.
- Fritsch, T.A., and J.D. Burkhead. "Behavioral Reactions of Children to Parental Absence Due to Imprisonment." *Family Relations* 30, 1981.
- Gubrium, Jaber F. & Holstein, James A. (1997). *The New Language of Qualitative Method*. New York: Oxford: Oxford University Press

Gabel, Katherine and Denise Johnston (1995). *Children of Incarcerated Parents*. New York: Lexington Books.

Susan M. Hunter (1980) "Forward," in Gabel and Johnston.

Katz, Pamela Covington (1998) "Supporting Families and Children of Mothers in Jail: An Integrated child Welfare and Criminal Justice Strategy." *Child Welfare League of America*.

Lowenstein, Ariela. "Temporary Single Parenthood—The Case of Prisoners' Families." *Family Relations* 1986

Mumola, Christopher. *Incarcerated Parents and Their Children*. Washington DC: U.S. Department of Justice, 2000.

Schaeffer, C., & Briesmeister, J. (Eds.). (1989). *Handbook of parent training: Parents as co-therapists for children's behavior problems*. New York: John Wiley.

Travis, Jeremy and Michelle Waul. *Prisoners Once Removed*. Washington DC: The Urban Institute Press, 2000

ROLI PRAKTIKAVE EDUKATIVE FAMILJARE NË NDËRTIMIN SOCIAL TË IDENTITETIT GJINOR TEK FËMIJA

Marta TOPÇIU

Universiteti Aleksandër Xhuvani

Joana MYFTIU

Universiteti Aleksandër Xhuvani

ABSTRACT

The purpose of this study is to analyze the influence of the parental educational practices in building the gender identity of the child, emphasizing the fact that the parental models, whether masculine or feminine, considerably help with the affirmation of this identity, the analysis of which will be dictated by the cognitive, social and affective dimensions. In short the paper will, firstly, put the theoretical models into practice, and secondly will be an analysis of the parental contribution based on the fundamental principles of education, which lead the process for gender equality and the socialization among children within the family.

Keywords: Children, gender identity, socialization, parental model

Hyrje

Në këtë mijëvjeçar, arritja e barazisë gjinore renditet si një objektiv shumë i rëndësishëm i shoqërisë njerëzore. Duke filluar nga fundi i shekullit të 20, lëvizja feministe ka ndikuar mjaft studimin e aspekteve gjinore dhe teorive rreth saj, shumë e dukshme kjo brenda fushës së sociologjisë, por jo vetëm.

Teoria bashkëkohore sociologjike mbështet konceptin që një fëmijë i sapo lindur, ka një seks biologjik, por jo gjini sociale. Ndërsa fëmija rritet “shoqëria sjell një tërësi modelesh të sjelljeve të përshtatshme për njërin apo tjetrin seks”, të cilët socializojnë fëmijën brenda përkatësisë së një gjinie specifike në këndvështrimin kulturor.

Traditat gjinore luajnë një rol të madh në atribuimin e karakteristikave mashkullore dhe femërore seksit bazë biologjik. Kodet socio-kulturore dhe traditat, rregullat me anën e të cilave funksionon shoqëria, të cilat dhe vetë janë një krijim i shoqërisë, këto veçori specifike që sigurojnë bazat për krijimin e ndryshimit gjinor, ia akordojnë sekseve. Ndërsa seksi është biologjik dhe ka të bëjë me shumë veçori fizike, gjinia është shumë më e komplikuar. Ajo është një lidhje komplekse midis këtyre veçorive dhe kuptimit të brendshëm të njeriut si mashkull, si femër, të dyja ose asnjëra. Njëherazi lidhet me prezantimet dhe sjelljet e jashtme. Gjinia mund të supozohet si marrje dhe brendësim i normave sociale.

Pra, individët socializohen nga pritshmëritë e shoqërisë së tyre për atributet gjinore të pranueshme, të cilat ekzistojnë brenda institucioneve të tilla si familja, shteti dhe media. Një nocion i tillë i “gjinisë”, më pas natyralizohet brenda kuptimit të një personi për veten ose identitetin e tij.

Koncepti që njerëzit janë më tepër gjinorë se sa seksualë, koïncidon gjithashtu me teoritë e Judith Butler për performancën gjinore. Butler argumenton se gjinia nuk është një shprehje e asaj çka është dikush, por më tepër një shprehje e asaj çka dikush bën.

Studiuesit e këtyre problematikave konkludojnë që gjinia është ndërtuar në mënyrë sociale dhe çdo individ është unik në karakteristikat e veta gjinore, pavarësisht çfarë seksi biologjik ka. Çdo fëmijë socializohet për tu sjellë në mënyrë të përcaktuar dhe ka atributet gjinore “personale”. Nëse individët në shoqëri nuk konformohen me këtë presion, ata janë të destinuar të trajtohen si jo normalë; si pasojë atyre u duhet të koïperojnë brenda disa rregullave “korrekte” të përcaktuara nga shoqëria.

Gjinia është e pranishme kudo rreth nesh. Pritshmëritë gjinore dhe mesazhet e lidhura me të na bombardojnë vazhdimisht. Edukimi në fëmijëri, familja, kultura, të barabartërit, komuniteti, media etj., janë disa nga faktorët që na ndihmojnë të formojmë kuptimin tonë mbi këtë aspekt bazë të identitetit tonë.

Në shoqërinë shqiptare, ku kjo problematikë mbart edhe specifika (pa harruar dhe faktin që dukuritë që lidhen me çështjet gjinore janë tepër të ndërlikuara), mendoj se çelësi i suksesit qëndron në njohjen, ndërgjegjësimin

dhe trajtimin realist të problemit, në identifikimin e shkaqeve si dhe rrugëve të ndërhyrjes, në një perspektivë më tepër sociologjike e psikologjike. Kjo pasi, fenomeni në fjalë nënkupton marrëdhënie ndërpersonale e ndërveprimi, komunikim brenda familjes ku ne shpesh në mënyrë të pavetëdijshme japim modelet tona, që mbarten aq lehtë nga fëmijët. Lypset një ndryshim mentaliteti së pari brenda familjes, larg stereotipeve. Ato janë ndryshime që duhet të vijnë nga institucionet e edukimit në makromjedis ku në plan të parë janë familja dhe shkolla. Në kohë, këto institucione kanë ndihmuar në një farë mënyre edhe përjetësimin e roleve gjinore stereotipe tek burrat dhe gratë. Prandaj, është detyrë e këtyre të fundit të vazhdojnë ndryshimet, që edhe kanë filluar, por që gjithësesi janë larg perfeksionit; të nxisin ndryshimet duke u ofruar të dyja gjinive të njëjtin status, ndër të tjera edhe me qëllim rritjen dhe lartësimin e imazhit femëror.

Është detyrë e të gjithëve t'i dalin në mbrojtje gruas për t'u ndarë nga ato role që me të padrejtë janë aq femërore sa duken sikur kanë lindur bashkë me të. Një pjesë e rëndësishme e këtij "revolucionit" shumë të ngadaltë, që duhet detyrimisht të ndodhë është përgjegjësia e vetë familjes. Kjo e fundit duhet të ngrihet fuqishëm për të ndihmuar zhvillimin e sjelljeve, shprehive dhe aftësive të ndryshme nga ato të deritanishmet.

Krahas,shkollës e medias, familja ka për detyrë t'a prezantojë gruan, vajzën si pjesë të rëndësishme të shoqërisë në të cilën jetojmë dhe jo në role stero tipe gjinore, duke hequr dorë nga ajo që, vajzat të paraqiten me aftësi edukuese e role përkujdesëse, ndërsa djemtë në krye të individëve me prirje konkurruese dhe role liderësh. Kështu, në mënyrë të gabuar, është vetë familja që në një farë mënyre përgatit atë çka shoqëria pret prej saj: njerëz, që në dy grupime të mëdha sipas gjinisë, veprojnë në të gjithmonë në mënyrë stereotipe.

Përditshmëria e jetës familjare, por dhe jashtë saj, na ofron situata ku respektohet dhe i ofrohen lavde gjinisë mashkullore, duke mënjanuar padrejtësisht gjininë tjetër, nisur gjoja nga misioni "ndryshe" i saj. Një shoqëri e barabartë nga pikpamja gjinore është një shoqëri e bazuar tek respekti. Ajo është një shoqëri, në të cilën gra e burra kanë vlera të barabarta dhe shihen si individë, jo si anëtarë të njërit apo tjetrit seks. Në një shoqëri të tillë, si burrat dhe gratë arsimohen, punojnë, kujdesen për fëmijët dhe sigurojnë jetesën. Në një shoqëri të barabartë nga pikpamja gjinore një burrë dhe një grua janë thjesht dy individë me shanse të drejta dhe përgjegjësi të barabarta. Pikërisht ky duhet të jetë ishte imazhi që u duhet ofruar fëmijëve tanë nga edukimi, dhe praktikat edukative familjare, sepse familja është vendi i parë ku fëmija mëson pothuajse gjithçka mbi veten dhe njerëzit që e rrethojnë.

Është e domosdoshme pra, që familja të ndihmojë emancipimin shpirtëror dhe zhvillimin social fëmijëve; që ajo të ndihmojë në krijimin e një imazhi gjinor të barabartë për vajza dhe djem. Ajo duhet të bëjë gjithçka duke filluar nga identiteti individual.

Identiteti dhe socializimi gjinor

Studimi i identitetit është një pikë kritike brenda mendimit sociologjik modern. Por, si e krijojnë njerëzit identitetin gjinor? Kërkimet sugjerojnë që identitetet gjinorë, racial, etnik, seksual dhe klasor janë fluidë, multidimensionalë, ndërtime sociale të personalizuara që reflektojnë kontekstin aktual dhe mjedisin socio-historik.

Identiteti është marrëdhënia psikologjike e individit me sistemet e kategorive sociale (Sherif, 1982). Identiteti individual është një koncept global që përfshin ndjenjën që ka individi për vetveten, për personalitetin e tij, për vetë ekzistencën e tij. Identiteti është një koncept kompleks që u interson shumë disiplinave - sociologji, antropologji, psikologji, psikanalizë etj. Për Pierre Tap identiteti “ është ç’ka na bën të ngjashëm me veten dhe të ndryshëm nga të tjerët, është ç’ka na bën të ndejmë se ekzistojmë si persona dhe si personazhe social, me role dhe funksione të caktuara, është ç’ka na bën t’a përkufizojmë veten dhe ta njohim atë , është ç’ka na bën të ndihemi të njohur dhe të pranuar si të tillë nga të tjerët, dhe nga kultura të cilës i përkasim (Tap, 1986).

Familja dhe mjedisi përreth kanë ndikimin e tyre mbi këtë identitet. Ai forcohet dhe ripunohet gjatë gjithë jetës. Çdo eksperiencë afektive apo sociale e trondit ndërkohë që edhe e pasuron atë. Ndërtimi i identitetit është personal dhe i veçantë. Ai realizohet nën lëvizje konstante dhe permanente midis vetes dhe mjedisit. Por identiteti është njëherazi edhe **identitet gjinor**.

Aktualisht, gjithnjë e më shumë studiues konsiderojnë faktin që studimi i identitetit gjinor lypset të analizohet në gjirin e modeleve shumëfaktoriale dhe ndërvepruese që integrojnë dimensionet konjitive, sociale dhe afektive.

Individi dallon në lindje nga seksi i tij që pak a shumë ndikon veprimet dhe sjelljet e tij gjatë gjithë jetës. Nocioni i identitetit gjinor përfshin ndjenjën e përkatësisë ndaj një seksi dhe përvetësimin e karakteristikave të përcaktuara nga ana kulturore që i bashkangjiten atij. Kështu, fakti nëse fëmija është vajzë apo djalë, gjë që ka të bëjë me ndryshimet biologjike midis dy gjinive, mësohet ditën kur fëmija vjen në jetë. Identiteti gjinor, pjesa sociale e tij, do të takohet do të zhvillohet dhe do të ndërtohet pikërisht në raport me të parin dhe do të shkojnë sëbashku gjatë gjithë jetës, sepse mbi të do të influencojnë ndjeshëm familja dhe mjedisi rreth individit, djalë apo vajzë qoftë.

Mënyra se si sillemi dhe mendojmë, është produkt final i socializimit.

Nëpërmjet socializimit ne nxëmë çfarë është e përshtatëshme dhe e papërshtatëshme për të dy gjinitë. Nëse problematika e lidhur me gjininë është shumë e rëndësishme në këndvështrimin e studimeve sociale, akoma më shumë merr vlerë ajo, nëse flitet për socializimin gjinor.

Socializimi është procesi nëpërmjet të cilit fëmija bëhet një individ duke respektuar ligjet e mjedisit të tij, normat dhe zakonet. Ndërsa socializimi gjinor është një nga format më specifike të socializimit; ai ka të bëjë me atë, se si fëmijët e sekseve të ndryshme socializohen brenda roleve të tyre gjinore dhe mësojnë çdo të thotë të jesh mashkull ose femër.

Socializimi gjinor fillon që në momentin kur ne lindim, nga pyetja e thjeshtë: “është djalë apo vajzë”? Ne mësojmë rolet tona gjinore nëpërmjet mjeteve të socializimit, që janë “mësuesit” e shoqërisë: familja, grupet e të barabartëve, media. Por në lidhje me socializimin gjinor, çdo njëri nga mjetet, ndër to edhe familja, mund të përforcojë **stereotipet gjinore**.

Stereotipet gjinore

Në përgjithësi, njerëzit i kategorizojmë me termat gjinorë. Në këtë ndarje të madhe, ne tentojmë ti quajmë të gjithë meshkujt të ngjajshëm, dhe po kështu dhe femrat. Por, të dy kategoritë, “meshkuj” dhe “femra”, ne i quajmë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra, ndërkohë që në jetën reale, karakteristikat e grave dhe burrave mund të përkojnë vetëm pjesërisht.

Stereotipet janë shfaqje të njohjes kolektive të zakoneve, miteve, ideve, besimeve të shoqërisë. Brenda kësaj njohjeje çdo individ zhvillon një stereotip ose besim rreth një grupi të caktuar. Stereotipi është një pjesë e njohjes sociale të individit. Si pasojë e prezencës ose jo të kësaj njohjeje, stereotipi ka një efekt mbi sjelljen e tyre sociale. Edhe vetë sjellja stereotipike, nisur nga fakti se si ajo është nxënë, transmetuar apo ndryshuar, është pjesë e procesit të socializimit.

Një stereotip është përcaktuar si një formë ose model i pandryshueshëm, një nocion ose koncept konvencional ose i fiksuar në mënyrë specifike, për një person, grup, ide, që kanë një numur njerëzish dhe që nuk pranon gjykim kritik dhe individual. Stereotipia lidhet me atë se si ne e perceptojmë njëri-tjetrin, veçanërisht individët jashtë grupit tonë. Stereotipet gjinore janë të lidhura me proceset konjitive, sepse kemi pritshmëri të ndryshme për sjelljet femërore dhe mashkullore.

Rolet tradicionale gjinore, na ndihmojnë ne të mbështesim stereotipe gjinore të tilla si ato, që, meshkujt supozohen të jenë aventurierë, ngulmues, agresivë, të pavarur, të orientuar ndaj detyrave, ndërsa femrat më të ndjeshme, më xhentile, të varura, emocionale dhe të orientuara drejt njerëzve.

Nga natyra, burrat dhe gratë kanë disa diferenca biologjike, por është

eksperienca e jetës që i përforcon ose kundërshton këto diferenca. E vërteta shtrihet në socializimin e diferencuar, i cili pretendon që meshkujt dhe femrat mësojnë sjellje të përshtatëshme, të ndryshme, për gjininë e tyre.

Socializimi brenda familjes është një proces relacional midis fëmijëve dhe prindërve dhe një nga objektivat e tij është të ndërtojnë identitetin e fëmijës (në këtë rast gjinor), përmes këtij socializimi.

Praktikat edukative familjare dhe ndikimi në krijimin e identitetit gjinor.

Mjedisi luan një rol mbizotërues në ndërtimin e identitetit gjinor të fëmijës dhe në këtë këndvështrim, roli i familjes në ndërtimin social të identitetit gjinor është vendimtar. Para se fëmija të ndërjegjësohet për identitetin e tij gjinor ai ekziston në mendjen e prindërve të tij. Këta të fundit kanë dëshiruar, kanë përfytyruar, ëndërruar për një fëmijë. Para lindjes, ata janë përgatitur, e kanë imagjinuar fëmijën, kanë menduar madje edhe një emër për të. Ai ka tashmë një vend imagjinr dhe real brenda lidhjes familjare.

Kështu sipas psikologes Suzanne B. Robert Ouvray, fëmija “ është sjellë nga përfytyrimi i nënës, i babait, i njerëzve rreth tyre para se ai të ekzistojë vërtet”. Gjatë shtatzanisë babai po ashtu e ka imagjinuar fëmijën e tij të ardhshëm. Sipas analizës së M. Lerner, “fëmija është një vazhdimësi e vetë atij, përçues i imazheve që vijnë nga historia e tij, një përgjigje ndaj dëshirës së tij për pavdekësi, një revansh i mundshëm ndaj edukimit të tij, një afirmimim i burrërisë së tij. Prandaj, fëmija që sapo lind, edhe pse nuk është i vetëdijshëm për këtë, ka tashmë një identitet të dhënë nga prindërit e tij që është regjistruar në historinë prindërore dhe familjare. Sipas G. Le Manner-Idrissi, “ seksi është një nga karakteristikat e para, në mos e para, që prindërit dhe ambienti social njohin nga fëmija që sapo ka ardhur në jetë dhe në shumë raste ata do ta njohin para lindjes nëpërmjet ekografisë. Sapo prindërit paraprkisht e njohin seksin e fëmijës, e pranojnë ose jo atë, pranim që në njërin apo tjetrin rast ka pasoja mbi edukimin që do të marrë fëmija. Që nga lindja, dhe madje para saj, prindërit bëjnë projekte të diferencuara dhe sjelljet e tyre nuk janë identike për njërin apo tjetrin gjini. Identiteti i individit ndërtohet pra, që në origjinë, si identitet gjinor, duke u konceptuar edhe nga prindërit si një identitet apo më mirë si një mundësi që e regjistron individin në grupin social sipas përkatësisë së tij. Pra ky është qëndrimi, reagimi jashtë tij, ndikimi i të tjerëve në përkufizimin social të identitetit të tij gjinor. Nga ana tjetër në ndërtimin e këtij individualiteti, edhe vetë individi ka pjesën e tij. Edhe ai vetë nuk është pasiv por i ndjeshëm dhe aktiv në formimin social të individualitetit të tij gjinor.

Theksuam që, ndërtimi i identitetit gjinor të fëmijës është gjërësisht i

influencuar nga ambienti social që e rrethon. Fëmija, duke qënë që në lindje një qenie sociale e përfshirë në një kontekst kulturor të dhënë, edhe sjelljet dhe qëndrimet i përcakton në bazë të këtij konteksti. Kështu, nëse fillimisht identiteti i tij gjinor ofrohet nga karakteristikat anatomike, tashmë, ndeshja me mjedisin social e njeh atë edhe më mirë me rolin e tij gjinor. S' mund të mohojmë rëndësinë që luan socializimi i djemve dhe vajzave në moshë të hershme. Stereotipitë që kanë të bëjnë me rolin e vajzave dhe të djemve, përcaktohen nga mënyra se si socializimi vjen në fëmijërinë e tyre. Socializimi fillon në lindje dhe lidhet me procesin e të mësuarit të roleve sipas gjinisë. Trajtimi i diferencuar që herët, i vajzave dhe djemve, bën që ata të mësojnë ndryshimin midis tyre. Pritshmëritë e prindërve dhe të shoqërisë, përzgjedhja e lodrave për vajza dhe djem ose detyrat e ndryshme që u besohen fëmijëve të të dyja gjinive, duket se përcaktojnë një proces socializimi që buron nga diferencimi i lidhur me seksin. Ekzistojnë shumë shembuj në rajone të ndryshme të botës që konfirmojnë se socializimi sipas gjinisë, është ngushtësisht i lidhur me vlerat etnike, kulturore apo fetare të shoqërisë në fjalë. Socializimi i lidhur me seksin vazhdon gjatë gjithë jetës. Ai është proces nëpërmjet të cilit individët mësojnë të sillen në funksion të bindjeve, vlerave, qëndrimeve dhe shëmbujve që u serviri atyre shoqëria. Socializimi sipas gjinisë fillon që nga momenti kur një nënë e re gjendet shtatzënë dhe kur ambienti rreth saj fillon të shprehë një gjykim mbi vlerat e djemve në krahasim me vajzat. Këto stereotipi përjetësohen nga antarët e familjes, mësuesit dhe njerzit e tjerë që ndërkohë shprehin pritshmëritë e tyre të ndryshme sipas asaj nëse bëhet fjalë për djalë apo për vajzë.

Përfytyroni skenën e mëposhtme: një nënë e re është duke sjellë në jetë fëmijën e saj të parë. Kur e pyesim nëse preferon që fëmija i saj të jetë një vajzë apo një djalë ajo përgjigjet se kjo s'ka rëndësi. Por përbri saj një person më i moshuar i familjes thotë : "të shpresojmë që të jetë një djalë". Dhe pikërisht këtu, tek gjërat e vogla që kanë rëndësinë e tyre, socializimi sipas sekseve fillon para lindjes. Fëmijët ballafaqohen me normat që përcaktojnë "mashkulloren" dhe "femëroren" që nga fëmijëria e tyre e hershme. U mësojnë djemve të mos qajnë, të mos kenë frikë, të mos falin lehtë por përkundrazi të tregohen të sigurt dhe të fortë. Vajzat përkundrazi, nuk duhet të jenë kërkuese, ato duhet të falin, të jenë të shkueshme dhe " me edukatë". Këto role dhe pritje ekzistojnë, në shkallë të gjerë.

Prindërit janë ndikuesit primarë mbi zhvillimin e rolit gjinor në vitet e hershme të jetës së secilit. Sa i përket diferencës gjinore, në fakt familja, ndryshe nga grupet e tjera, ka si karakteristikë një mënyrë specifike jetese dhe i ndërton diferencat gjinore nëpërmjet një procesi që natyrisht është biologjik, por edhe

relacional e social. Familja është edhe një relacion gjinor. Por duhet theksuar fakti që, në veçanti, në familje karakterizimi gjinor, reflekton individualitetet e prindërve.

Në familje fëmijët ndodhen para një edukimi të diferencuar. Praktikrat tregojnë se sapo merret vesh seksi i bebes që do të vijë në jetë dhoma e saj dhe veshjet marrin ngjyra të paracaktuara, madje i blihen edhe lodra që i korrespondojnë natyrës së saj. Prindërit projektojnë madje edhe aktivitetet që do të mund të realizojnë me fëmijën sipas seksit të tij dhe, shpesh, një nga dy sekset është edhe më i dëshirueshëm sesa tjetri. Më pas ata inkurajojnë pjesëmarrjen e fëmijës së tyre në aktivitete të tipizuara si kukullat për vajzat dhe makinat për djemtë. Nga kërkimet mbi këtë temë, (Lindzei, Mize;2001), prindërit tentojnë të modifikojnë sjelljet e tyre gjatë përzgjedhjes së lojrave në varësi nga seksi i fëmijës. Sipas këtyre autorëve:”një baba që luan me djalin e tij në oborr, por që nuk merr pjesë në një punë shtëpie, mund ta mësojë djalin e tij të shoqërojë rolin e mashkullit me një aktivitet të tillë dhe jo me një punë shtëpie”. Në këtë mënyrë prindërit mund të transmetojnë skemën e tyre mendore mbi gjininë e fëmijës nëpërmjet transmetimit të disa konteksteve si më të përshtatëshme për vajza apo djem. Pra, roli i prindërve në diferencimin gjinor është i madh, meqë vetë prindërit favorizojnë të nxënit e skemave konjitive mbi identitetin gjinor nëpërmjet sjelljeve të tyre. Figurat prindërore (Lindsey, Mize, 2000; Banerije, Lintern 2000; Ruble & Martin, 1998) mendojnë që vajzat dhe djemtë kanë ndryshime cilësore dhe këto besime mbi identitetin gjinor si dhe pritshmëritë e tyre ndikojnë perceptimin e të rriturit dhe sjelljet përballë fëmijëve.

Ky trajtim ka pasoja gjatë gjithë jetës. Meqë ai fillon shpejt, dhe po kaq shpejt ai përftohet nga fëmija ai natyralizohet: diferencat kuptohen si të lindura, biologjike ndërkohë që mekanizma të shumtë psikologjikë të të mësuarit mund t’ i shpegojnë ato më së miri.

Teoria klasike mbi identitetin gjinor e trajton ndërtimin e tij nëpërmjet tri modeleve: teoria psikanalitike, ajo e të mësuarit social dhe teoria konjitive e zhvillimit. Teoria psikanalitike analizon ndërgjegjësimin mbi diferencimin anatomik të sekseve, konfliktin e Edipit dhe vendin kryesor të identifikimit me prindin e të njëjtit seks. Teoria e të mësuarit social e vë theksin mbi influencën e madhe të imitimit të modeleve të prindërve sipas sekseve. Teoria konjitive e zhvillimit (Kohlberg 1966) na njeh me aspektin ndërtimor dhe zhvillimor nëpërmjet vetëndërtimit të kategorive mashkull-femër. Ai e përcakton identitetin gjinor si “një vetëkategorizim konjitiv”, si “djalë” ose “vajzë” (Kohlberg 1966, fq.88). Sipas tij , fëmijët nuk e marrin pasivisht informacionin nga jashtë, por e

interpretojnë aktivisht dhe e aplikojnë në mënyrë selektive.

Por, ndërkohë, individi ndodhet edhe nën presionet e ndryshme që i vijnë nga ambienti rreth e rrotull tij. Një prej tyre është presioni normativ.

Presioni normativ.

Presioni normativ ushtrohet kur njeriu largohet nga norma që pritet prej tij, ose kur në të kundërt ai i përshtatet asaj. Në njërin rast dhe konkretisht në atë të mospërshtatjes do të ketë ndëshkim dhe në të dytin shpërblim. Në fëmijëri ky proces i parë quhet përforsim i diferencuar: p.sh. inkurajohet djali i vogël të vrapojë, të hidhet dhe të harxhojë energji madje duke i veshur edhe rrobat e përshtatëshme për këto lloj aktivitete. Atij do t'ia rrëmbejnë nga dora kukullën e motrës nëse e merr dhe do t'a lavdërojnë kur të jetë kurajoz dhe i fortë. Përkundrazi do të inkurajojnë vajzën e vogël të luajë qetësisht me kukullat e saj, duke e veshur bukur dhe duke e këshilluar të rrijë pastër, do i kërkojnë asaj të ndihmojë nënën për të përgatitur drekën dhe do t'a lavdërojnë për bukurinë e saj. Shpërblimi për përshtatjen ndaj stereotipive do të jetë miratimi social që vjen nga dëshira e prindërve për t'i parë fëmijët ashtu sikurse edhe i magjinojnë.

Modelimi i diferencuar.

Nëpërmjet një kombinimi të kushtëzimit social dhe preferencës personale, në moshën 3 vjeç shumica e fëmijëve preferojnë aktivitete dhe realizojnë sjellje tipike të lidhura me seksin e tyre. Pra që në këtë moshë fëmija kupton që i takon njërit nga dy sekset, dhe që këto dy sekse janë të lidhura me gjëra të veçanta. Në moshën 7 vjeç fëmijët kuptojnë se përkatësia ndaj një seksi është e qëndrueshme dhe konstante. Kur ky identifikim ka mbaruar, fëmija fillon të përdorë mjedisin rreth tij për të mësuar më shumë mbi atë ç'ka është dhe ç'ka duhet të bëjë. Më saktë, fëmija sheh modelet e të njëjtit seks me veten, dhe adopton sjelljet e tyre, shijet dhe qëndrimet. Pikërisht ky është modelimi i diferencuar. P.sh. nëse nëna lan enët dhe babai lexon gazetën ambicjet e vajzave dhe djemve që në moshë të vogël do të riprodhojnë pikërisht këto modele.

Duke u larguar nga dimensionet biologjike të fjalës seks, përkatësia gjinore të jep mundësinë e një dimensionit më të plotë, më real. Ky dimension real nënkupton që seksi mashkull dhe ai femër duhet të përcaktohen jo më si njëri kundër tjetrit, por njëri me tjetrin, duke mundësuar mbështetjen e femrës. Duhet kuptuar se mbështetja e gruas në shoqëri nuk përbën një politikë seksiste por një domosdoshmëri. Nëse duam ta shohim gruan si një forcë të konsiderueshme në zhvillimin shoqëror, nëse nuk duam t'a paraqitim atë si "seks i dobët" siç përdoret rëndom, kjo së pari është detyrë e familjes. Gjithçka e ka fillesën e saj tek familja.

Më sipër theksuam, se ajo ç'ka presim nga një vajzë ndryshon nga ajo ç'ka presim nga një djalë, pavarësisht nëse jemi apo jo të ndërgjegjshëm për këtë. Mungesa e ndërgjegjësimit është një pengesë e madhe për barazinë gjinore. Pikërisht kjo është arsyeja pse duhet të fillojmë me veten tone dhe jo me fëmijët. Ne duhet të kuptojmë sjelljet e pavetëdijshe dhe mënyrën si i trajtojmë të tjerët. Sapo të kemi kuptuar mirë këtë do të mund të bëjmë një ndryshim.

Prindërit japin modelet e para të roleve gjinore për fëmijët e tyre. Në familje relacionet me nënën dhe babain marrin një rëndësi themelore në përcaktimin e përkatësisë gjinore, pasi kjo për fëmijën është eksperiencia e parë e lidhjes me meshkujt dhe femrat.

Modelet nga të cilat janë frymëzuar nëna dhe babai duhen njohur e verifikuar pasi "krizat e autoritetit prindëror i kanë dhënë më shumë hapësirë babait në formimin e relacionit edukativ me fëmijën.

Socializimi gjinor brenda relacioneve familjare tregon gjithashtu dimensionin kohor të transmetimit të stileve dhe pritshmërive midis prindërve dhe fëmijëve. Prindërit e sotëm kanë pritshmëri të ndryshme nga prindërit e tyre; po kështu dhe fëmijët e tyre nga këta të fundit.

Prindërit e një fëmije janë pra, agjentët e parë të socializimit me të cilët ai do të kontaktojë dhe meqë, identiteti gjinor dhe ndërtimi i tij social e ka zanafillën e tij tek familja, lypset që ajo të ketë në vëmendje të saj:

- të vlerësojë në mënyrë të barabartë djemtë dhe vajzat
- t'i mësojë shumë rreth jetës në familje, dhe t'i kultivojë dashurinë dhe respektin reciprok
- t'i qartësojë për detyrat e përbashkëta në familje, marrëdhëniet brenda saj, t'u bëhen të qarta konceptet kompromis, marrëveshje mirëkuptim
- t'i formojë aftësitë për punë të barabarta; si djemtë dhe vajzat të marrin pjesë aktive në problemet e familjes
- Të kultivohet vetëpërmbytje, kurajo si cilësi shumë të rëndësishme për të kuptuar barazinë gjinore dhe për të formuar identitetin e duhur gjinor
- Të ndihmojë vajzat të ndërtojnë në mënyrë pozitive figurën e të qenit vajzë dhe djemtë të ndërtojnë në mënyrë pozitive figurën e të qenit djalë
- T'u mësojë fëmijëve që orari, rregull korrektësia duhet të jenë cilësi të të dyja gjinive në të njëjtën masë
- Të mos përdorë terminologji të ndryshme ndaj të dyve
- T'u tregojë vajzave se duhet të luftojnë për të realizuar çdo aspiratë të të ardhmes
- Të mësohen vajzat të dëshirojnë edhe profesione që kërkojnë guxim
- T'u mësojnë se për karrierë mund të flasin edhe vajzat edhe djemtë

Por nuk duhet harruar një faktor shumë i rëndësishëm: fëmija është i aftë të vetërealizohet për t'i koresponduar gjinisë së tij, gjithnjë edhe nën ndikimin e familjes. Por jo vetëm; ka edhe ndikime të shumta shpesh të pakontrollueshme, që luajnë rolin e tyre në socializimin e fëmijës. Ndikime të tilla u ofrohen fëmijëve nëpërmjet televizionit, apo literaturës për fëmijë, nga qëndrimet e shokëve, shoqeve apo mësuesve në shkollë, pra nëpërmjet shumë rrugësh që inkurajojnë riprodhimin e diferencave gjinore dhe ndihmojnë në formimin social të identitetit gjinor në mënyrën më pozitive.

Dhe më në fund, nëse gjithçka do të shkonte mirë lidhur me identitetin gjinor dhe rolet jo stereotipe të tij, familja do të ishte vërtet e lumtur dhe shoqëria shumë më shpresëdhënëse.

Disa përfundime

Ndërtimi social i identitetit gjinor tek fëmijët është një proces jo i lehtë; aq më pak arrihet duke dhënë receta. Në të ndikojnë shumë institucione e ndërthuren shumë faktorë, socialë-kulturorë e psikologjikë. Familja, si ajo tradicionale dhe ajo moderne, si një nga institucionet bazë të edukimit, ka specifikat e saj në këtë drejtim. Nga brezi në brez fëmijët vëzhgojnë e brendësojnë jo vetëm modelet e prindërve të tyre, por formësojnë identitetin e tyre gjinor edhe nga stereotipet gjinore që janë aq të pranishme brenda institucionit familje.

Ndryshimi i roleve gjinore duket i vështirë jo sepse gratë apo burrat nuk kanë aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat e tjetrit, por sepse secili mbart fort një simbol të “botës” së tij.

Një konsideratë me interes është fakti që një marrëdhënie ndërgjinore midis baballarëve dhe vajzave, nënave dhe djemve duket mjaft domethënëse në përcaktimin tradicional apo jo të qëndrimeve gjinore. Sidomos gjatë adoleshencës, identifikimi me modelet gjinore bëhet me anë të mekanizmave të ndryshëm relationalë, që në përgjithësi theksojnë më shumë marrëdhënien me gjininë e kundërt.

Prindërit, por edhe të rriturit e tjerë, kanë detyrën specifike të ndihmojnë zhvillimin e një identiteti dhe roli gjinor korrekt tek të vegjëlit; ata kanë detyrë ti japin fëmijëve (djalë edhe vajzë), ato përvoja dhe eksperiencia jetësore specifike që ndikojnë në këtë drejtim.

Duke e parë edukimin e fëmijëve, edhe në aspektin e edukimit gjinor, sidomos në familje, është e nevojshme të ndryshojë dimensionin e prindërimit. Krahas vlerësimit real të problematikës në fjalë, lypset të ndjehet më shumë në mjedisin dhe në familjen shqiptare diskutimi i natyrshëm rreth saj, sjellja e modeleve pozitive duke nxitur një grua më aktive, ambicioze dhe të pavarur dhe një burrë më emocional dhe të përfshirë në punët brenda familjes.

Diskutimi mbi problemet gjinore, që kanë një shtrirje të gjërë e të larmishme, të mos i lihet rastësisë, të mos bëhet me fushata dhe vetëm i kufizuar në simpoziume a konferenca. Që fëmijët tanë të tejkalojnë edukimin tradicional dhe të bëjnë pjesë të natyrshme të personalitetit të tyre modelet dhe rolet gjinore larg stereotipeve, nuk është i mjaftueshëm vetëm roli i familjes; kjo e fundit, shkolla dhe tërë mjedisi që na rrethon duhet të jenë bashkë dhe të ndërgjegjësohen për rëndësinë që ka socializimi në ndërtimin e identitetit gjinor.

Bibliografia

1. Bhasim Kamla Understanding gender, Publication of the Women's centre, 2003
2. M. Dharmo, E. Gjermeni, M. Sinani, A. Sulstarova, J. Sinani, M. Dauti. "Review of Elementary School Texts from the Gender Perspective"
3. Giddens, Anthony. 2002: Sociologjia, fq. 163-207.
4. Burr V. 2000: Psicologia delle differenze di genere, Mulino, Bologna.
5. "Analiza Gjinore e teksteve të shkollës fillore". Studim i Qendrës "Aleanca gjinore për zhvillim. Tiranë, 2005.
6. Frable E.S. Deborah. 1997(48), Annu. Rev. Psychol., fq. 139-143.

FORMA DHE STRUKTURA E FAMILJES NË SHOQËRINË BASHKËKOHORE - NJË VIZION DHE SFIDE GLOBALE

Sonila OMARI

Universiteti i Tiranës

Eniana QARRI

Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

The authors of this paper will analyze, in a legal perspective, the current trends that characterize the form and the structure of the contemporary family. To achieve this goal, the authors will be based primarily on the provisions of the current Albanian legislation, noting the reform that the family Albanian law has incurred due to the adoption of the new family code, but also referring through the comparative method to the legislation of the European Union member states. The main part of the paper will be given to the analysis of some of the new styles of living found today in the society, which differ from the traditional structure of the family or from the source that served for the family formation. At the end, the authors conclude that the Albanian family law should follow the contemporary trends and flows and should provide solutions to the new phenomena that appear in the contemporary society.

Keywords: Family; marriage; cohabitation, gay marriage; assisted reproduction; transsexual rights

I. Koncepti juridik i familjes dhe dallimi me kuptimin sociologjik. Konsiderata të përgjithshme

Familja konsiderohet një nga fenomenet më të lashta të njerëzimit. Mirëpo, nëse i referohemi periudhave historike, vërejmë se tjetër ka qenë koncepti i

familjes në origjinë të këtij instituti, e tjetër është kuptimi që i jepet sot atij. Gjithashtu, nëse i referohemi kulturave e civilizimeve të ndryshme, arrijmë në të njëjtin përfundim; familja nuk ka përfaqësuar kurrë një nocion statik, por ka ndryshuar e vazhdon të ndryshojë, duke marrë trajta të ndryshme.

Fillimisht lidhja familjare bazohet në lidhjen e gjakut. Faktori biologjik ka qenë ai pra që përcaktonte strukturën e familjes. Me kalimin e kohës, lidhja familjare u bazua edhe në pëlqimin e dy subjekteve që shprehnin vullnetin për të jetuar së bashku, për të formuar një bashkësi jetese e interesash. Kështu, martesë e lidhur në kushtet dhe formën e parashikuar në ligj, konsiderohet edhe sot si burimi kryesor i formimit të një familje. Më tej, birësimi i cili bazohet në vullnetin e individit për marrjen përsipër të përgjegjësisë prindërore për rritjen dhe edukimin e një fëmijë, u konsiderua nga shumë legjislacione si një nga format për të formuar një familje, edhe pse në këtë rast mungon lidhja gjinore ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Gjithë këto ndryshime që kanë ndodhur në drejtim të formës dhe strukturës së familjes, mund të konsiderohen edhe shkaku i mungesës së një përkufizimi mbi konceptin "familje". Përkufizimi i këtij nocioni bëhet edhe më e vështirë, nëse do të shtojmë faktin se familja studiohet nga disiplina të ndryshme shkencore; familja jo vetëm që trajtohet nga shumë disiplina shkencore, ku spikat e drejta, sociologjia e demografia, por ajo trajtohet edhe nga këndvështrime të ndryshme sikurse janë ai ekonomik apo historik.

Në kuptim sociologjik, familja përfaqëson një bashkësi personash, e cila karakterizohet nga elementi i jetesës së përbashkët dhe interesave të përbashkëta ndërmjet tyre. Si fenomen social, familja paraqitet si një formë e marrëdhënieve sociale ndërmjet individëve, të lidhur ndërmjet tyre me lidhje gjaku apo pëlqimit reciprok për të formuar një familje. Bazuar në këto marrëdhënie, anëtarë të familjes janë prindërit, të martuar ose jo, fëmijët e tyre; persona të tjerë në lidhje gjinore me prindërit dhe për rrjedhojë edhe me fëmijët. Në drejtim të strukturës së anëtarëve të familjes, nuk ka një të tillë të përcaktuar, ajo ndryshon në varësi të rrethanave konkrete. Duke qenë se si rregull familja lind nga martesë e dy individëve, familja fillimisht formohet nga dy bashkëshortë. Forma tipike e familjes është megjithatë ajo që formohet nga prindërit dhe fëmijët e mitur që jetojnë me ta. Megjithatë, në këndvështrim sociologjik konsiderohen familje edhe dy persona që nuk kanë lidhur martesë, por bashkëjetojnë ndërmjet tyre; apo fëmija që jeton vetëm me njërin nga prindërit e tij; apo fëmija që jeton me njërin nga prindërit biologjik dhe me një person tjetër që nuk është prindi i tij. Pikërisht bazuar në këtë strukturë të familjes, sociologët bëjnë dallimin ndërmjet: bërthamës familjare -e quajtur

edhe familja e thjeshtë-, e cila përbëhet nga prindërit dhe fëmijët e tyre të pamartuar dhe familjes së madhe, e cila përbëhet edhe nga persona të tjerë përveç atyre që bëjnë pjesë në familjen e madhe.

Krejt ndryshe nga koncepti sociologjik, në kuptim juridik familja përfaqëson grupin e personave ndërmjet të cilave dispozitat ligjore parashikojnë të drejta dhe detyrime.

Kushtetuta e Shqipërisë i referohet nocionit të familjes, pa dhënë njëkohësisht një përkufizim ligjor për familjen. Gjithashtu, akte të tjera ndërkombëtare zgjedhin një mënyrë të përafërt për të përkufizuar nocionin e anëtarit të familjes. Kështu, Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, përkufizon familjen si “bërthama natyrore dhe themelore e shoqërisë e cila gëzon mbrojtjen e shtetit”, pa iu referuar as strukturës së familjes dhe as formës që duhet të përmbushë kjo e fundit për t’u njohur nga rendi juridik. Nga ana e saj, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, parashikon në nenin 8 se “Cdokush ka të drejtë që t’i respektohet jeta ...familjare... “. Në fakt, teknika e përzgjedhur është e drejtë, pasi *omni definitio in iure periculosa est*. Këto parime themelore, të lexuara në mënyrë të kombinuar me kodin e familjes apo ligje të tjera të posaçme, na çojnë në konkluzionin se familja është si rregull një grup personash të lidhur me martesë ose lidhje gjinore, ndërmjet të cilëve ligji parashikon të drejta dhe detyrime.

Thënë këto, është e kuptueshme se jo çdo marrëdhënie sociale ndërmjet personave që bashkëjetojnë dhe kanë interesa të njëjtë, do të konsiderohen marrëdhënie familjare, por vetëm ato marrëdhënie sociale të cilat ligjvënësi i ka rregulluar me ligj e për rrjedhojë i ka kthyer në marrëdhënie juridike.

Bazuar në dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi, konsiderohen persona të së njëjtës familje, e për rrjedhojë ndërmjet tyre ekzistojnë të drejta e detyrime: personat që kanë lidhur martesë; persona që kanë lidhje gjinore ndërmjet tyre, e krijuar si rezultat i lidhjes së gjakut apo birësimit, apo disa subjekte të cilëve ligji i zbaton me analogji disa pasoja të marrëdhënies familjare.

Parë në aspektin krahasimor me nocionin sociologjik të familjes, konstatojmë se, këto dy nocione nuk mbivendosen në të gjitha rastet:

- Nga njëra anë koncepti juridik është më i ngushtë se ai sociologjik. Në këtë kuptim, dy persona që bashkëjetojnë pa lidhur martesë, të sekseve të ndryshme apo të sekseve të njëjtë, edhe pse në kuptimin sociologjik përbëjnë një familje, në kuptimin juridik –të paktën aktual-, nuk konsiderohen *ipso iure* persona të së njëjtës familje, pasi dispozitat ligjore si rregull, nuk parashikojnë të drejta e detyrime ndërmjet tyre.

- Nga ana tjetër, koncepti juridik paraqitet në disa raste edhe më i gjerë se

ai sociologjik. Kështu për shembull, si fenomen social dy ish-bashkëshortë që kanë zgjidhur martesë, nuk përbëjnë më të njëjtën familje, pasi pas zgjidhjes së martesës nuk ekziston një bashkësi jetese dhe interesash, element esencial që dallon familjen në kuptimin sociologjik. Në të kundërt, në kuptim juridik ndërmjet tyre në disa raste vazhdojnë edhe pas zgjidhje së martesës të drejta e detyrime, pra një marrëdhënie familjare. Po kështu, nëse fëmija nuk jeton me të dy prindërit, por i besohet vetëm njërit prej tyre, fëmija e prindi që nuk jetojnë së bashku edhe pse nuk i përkasin së njëjtës familje në kuptimi sociologjik të fjalës, mbeten të lidhur në një marrëdhënie juridike, pasi dispozitat ligjore parashikojnë të drejta e detyrime ndërmjet fëmijës dhe prindit tjetër.

Në analizë të fundit duhet theksuar megjithatë se, edhe në kuptim juridik nuk ka një koncept të njëjtë e të zbatueshëm në të gjitha rastet për strukturën e familjes. Ekziston një koncept i përgjithshëm juridik për familjen, i cili parashikohet nga kodi i familjes dhe koncepte të tjera të posaçme në fusha të veçanta të së drejtës, që rregullohen me ligje të tjera të veçanta. Për më tepër edhe në kuadrin e të njëjtit akt normativ siç është kodi i familjes, nuk kemi një kuptim të vetëm të familjes, por ai varion në varësi të çdo instituti. Kështu, nëse në kuadrin e institutit të martesës do të përfshijmë në nocionin e familjes vetëm bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të mitur, në institutin e “trashëgimisë”, ky nocion zgjerohet edhe më tej duke përfshirë lidhjen gjinore deri në shkallën e gjashtë.

Parë në këtë këndvështrim, është e kuptueshme se koncepti “anëtar i familjes”, do të përcaktohet rast pas rasti, duke iu referuar përmbushjes së formës dhe të kushteve të tjera të parashikuara nga dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet familjare.

II. Forma e familjes. Vështrim historik dhe tendenca bashkëkohore

Forma për kryerjen e një veprimi juridik familjar përfaqëson tërësinë e kërkesave që parashikojnë dispozitat ligjore në drejtim të verifikimit të kushteve materiale dhe mënyrën e deklarimit të vullnetit të personave që do të jenë anëtarë të familjes. Si element përbërës për vlefshmërinë e marrëdhënies familjare, forma paraqet rëndësi në rastet kur familja formohet si rezultat i pëlqimit të palëve. Kështu, si në rastin e martesës ashtu edhe të birësimit, kodi i familjes parashikon një procedurë për kryerjen e këtyre veprimeve. Në këto rrethana, vetëm martesa apo birësimi i kryer sipas formës së parashikuar në

ligji do të jetë i vlefshëm dhe do të sjellë pasoja juridike ndërmjet anëtarëve të familjes.

Në sistemin tonë të së drejtës burimi themelor i familjes është martesë. Kjo përfaqëson bashkimin juridik ndërmjet një burri e një gruaje, lidhja e cila njihet në literaturën juridike me termin “familje legjitime” për shkak se ajo lidhet sipas formës së përcaktuar në ligji. Kjo procedurë rregullohet nga kodi i familjes dhe ligji “Për Shërbimin e Gjendjes Civile”. Veçanërisht në rastin e martesës, duhet theksuar se ligjvënësi largohet nga parimet e përgjithshme të së drejtës private, duke përfshirë në procedurë ndërhyrjen e shtetit. Në këto rrethana, prezenca e nëpunësit të gjendjes civile; verifikimi i kushteve thelbësore për lidhjen e martesës; lidhja e saj në mënyrë publike; regjistrimi në regjistrin e martesave, bëjnë që natyra juridike e veprimit juridik të martesës të gjendet diku ndërmjet sferës së të drejtës private dhe asaj të së drejtës publike.

Përtej kësaj forme të parashikuar në ligj, asgjë nuk pengon që një burrë e një grua të bashkëjetojnë pa lidhur martesë, duke realizuar kështu një bashkëjetesë jashtëmartesore, të cilën, për shkak të ngjashmërisë së madhe me familjen që rrjedh nga martesë, literatura juridike e quan bashkëjetesë *more uxorio*.¹ Zgjedhja e bashkëjetesës si një nga format për të formuar familje konsiderohet nga shumë autorë si shprehje e lirisë individuale të personit. Kodi aktual i familjes, përkufizon në nenin 163 bashkëjetesën si një “bashkim fakti midis burrit e gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që ka karakter stabiliteti e vazhdueshmërie”. Nga analiza e këtij përkufizimi ligjor rezultojnë se veçoritë e bashkëjetesës janë:

- Bashkëjetesa e një burri e një gruaje; Njëpërmjet këtij cilësimi është përjashtuar nga ky rregullim bashkëjetesa ndërmjet dy personave të të njëjtit seks. Megjithatë, edhe në këto kushte, asgjë nuk i pengon dy persona të së njëjtës gjini, jo vetëm të bashkëjetojnë, por edhe të rregullojnë me marrëveshje pasojat që lindin nga bashkëjetesa. Një zgjidhje e kundërt me të nuk mund të pranohet, pasi bashkëjetesa e personave të të njëjtit seks nuk përbën një veprim në kundërshtim me ligjin, ndaj shkaku i një marrëveshje të tillë është kurdoherë i ligjshëm.
- Personat që bashkëjetojnë sillen si bashkëshortë apo “jetojnë në çift”, sipas terminologjisë së ligjit ; Nuk do të quhet bashkëjetesë ajo e personave nga e njëjta familje e.g. jetesa e përbashkët e motrës me vëllanë apo e dy personave që vetëm ndajnë të njëjtën banesë si pasojë e një kontrate qiraje.

1 Termi latin *more uxorio* ka kupimin “si edhe”, ndaj përdoret në të gjitha rastet për të identifikuar atë bashkëjetesë që është si edhe martesë.

- Bashkëjetesa ka një karakter të qëndrueshëm e të vazhdueshëm, e cila nënkupton jo vetëm jetesë të përbashkët por edhe interesa të përbashkëta; ndihmë morale e materiale ndërmjet personave që bashkëjetojnë dhe eventualisht fëmijëve që rezultojnë nga kjo bashkëjetesë, duke përfshirë raste sporadike bashkëjetese, siç është për shembull bashkëjetesa për kohë të përcaktuar në raste të pushimeve të përbashkëta.

Nëse plotësohen kushtet e mësipërme, midis një burri dhe një gruaje lind *de facto* një familje, e për këtë arsye ajo ka marrë emrin familje faktike.²

Kodi i familjes, edhe pse ka bërë një hap përpara duke përkufizuar nocionin e bashkëjetesës, nuk ka parashikuar *asnjë pasojë juridike* në drejtim të personave që bashkëjetojnë *more uxorio*, duke parë të arsyeshme me sa duket, të rregullojë e të mbrojë vetëm familjen që rrjedh nga martesë. Nga leximi i nenit 163 de 164 të kodit të familjes, rezultojnë se ligjvënësi ka lejuar vetëm mundësinë që këta persona të parashikojnë me marrëveshje pasojat që lindin në drejtim të fëmijëve apo pasurisë së fituar gjatë bashkëjetesës. Në këto rrethana, është e kuptueshme se këta persona janë të privuar nga një sërë të drejtash, ku ndër më kryesore janë: e drejta për kontribut material në favor të bashkëjetesës; detyrimi për ushqim në favor të partnerit që nuk është i aftë të fitojë të ardhura të mjaftueshme; përcaktimi i pronësisë së sendeve të fituara gjatë bashkëjetesës; lehtësira fiskale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, e të tjera. Vështirësitë më të mëdha juridike paraqiten në rastet e mbarimit të bashkëjetesës, si pasojë e ndarjes apo vdekjes së njërit prej partnerëve, ku këtyre individëve nuk u njihet e drejta reciproke e trashëgimisë, pavarësisht afeksionit që mund të kenë ndaj njëri tjetrit; pjestimi i sendeve të fituara bashkërisht; fitimi i pensionit pas vdekjes së njërit prej tyre; apo të drejta të tjera që rrjedhin nga ligje të posaçme.

Një nga çështjet më të mprehta që shtrohet për zgjidhje gjatë bashkëjetesës është ajo e përcaktimit të pronësisë që fitohet nga secili bashkëjetues. Lind pyetja cili do të jetë regjimi juridik i këtyre sendeve? Duke iu referuar eksperiencave të vendeve të tjera, gjejmë rregullime kontraktore në drejtim të aspekteve pasurore ndërmjet personave që bashkëjetojnë.³ Këto kontrata kanë rezultuar të dobishme pasi i paraprijnë konflikteve që lindin më pas, zakonisht në periudhën e përfundimit të bashkëjetesës. Në mungesë të një marrëveshje të tillë, pasojat pasurore ndërmjet personave që bashkëjetojnë do të rregullohen

2 Në literaturën juridike ndeshim edhe termin “familje ilegjitime” -në sensin që nuk është e lidhur sipas ligjit, jo në sensin që sanksionohet nga ligji-, i cili duket se po eliminohet gjithnjë e më tepër nga përdorimi për shkak të induktimit të një gjykimi negativ për këtë marrëdhënie. Aktualisht termi më i përdorur është ai i familjes *de facto* (*menage de fait*).

3 “*Contrats de menage*” apo “*Cohabitation contracts*” rregullojnë pasojat pasurore që lindin gjatë bashkëjetesës *more uxorio*.

sipas dispozitave të përgjithshme të së drejtës civile. Kështu, nëse gjatë periudhës së bashkëjetesës janë fituar sende mbi pronësinë e të cilave kanë pretendime të dy bashkëjetuesit, gjykata do të zbatojë rregullat e bashkëpronësisë në pjesë; sendi do të konsiderohet i përbashkët nëse bashkëjetuesit do të provojnë që për fitimin e këtij sendi kanë kontribuar efektivisht të dy bashkëjetuesit.

Si konkluzion, mund të themi që rritjes së ndjeshme të numrit të familjeve faktike në Shqipëri, nuk i korrespondon ende një rregullim juridik i posacëm.⁴ *De lege ferenda* dispozitat e kodit të familjes duhen amenduar, duke i njohur *disa* të drejta, në mënyrë të veçantë në drejtim të marrëdhënieve pasurore ndërmjet anëtarëve të kësaj familje faktike. Sikurse me të drejtë është konstatuar në literaturën juridike, në njohjen e pasojave të bashkëjetesës nuk duhet anashkaluar fakti se " ...në bazë të saj qëndron një marrëdhënie afektive që lidh këto subjekte, e cila në disa raste më e fortë se ajo që rrjedh nga martesë".⁵ Me të vërtetë, ndërkohë që shteti mbron martesën, pa bërë asnjë dallim nëse bashkëshortët jetojnë bashkë apo të vecuar, a do të ishte e drejtë të mos mbrohej në një masë të caktuar një lidhje *more uxorio* e qëndrueshme?

III. Struktura klasike e familjes dhe tendenca globale në drejtim të përcaktimit të anëtarëve të familjes

1. *Të drejtat e individëve homoseksualë sipas legjislacionit shqiptar aktual dhe tendenca bashkëkohore mbi "martesën homoseksuale"*

Legjislacionit shqiptar, edhe pse nuk i ndalon bashkimet homoseksuale -vepra penale është shfuqizuar tashmë prej disa vitesh nga kodi penal-, nuk njih të drejtën e personave të të njëjtit seks për të formuar familje. Në zbatim të dispozitave të kodit të familjes, martesë e këtyre individëve jo vetëm që pengohet, por në rastet kur konstatohet lidhja e saj në kundërshtim me këto dispozita, ajo konsiderohet martesë e paqenë, sanksion ky që shkon përtej pavlefshmërisë absolute të martesës.⁶

4 Arsyet që cojnë në një bashkëjetesë *more uxorio*, në praktikë janë nga më të ndryshmet: mundësia e zgjidhjes së lirë -zgjidhja *ad nutum*-, duke eliminuar procedurat e zgjidhjes së martesës; pamundësia e celebrimit të martesës, pasi nuk është realizuar ende zgjidhja apo pavlefshmëria e një martese të mëparshme; për të anashkaluar kufizimet juridike që rrjedhin nga martesë e të tjera.

5 G. Bonilini, *Manuale di Diritto di Famiglia*, UTET., fq 36.

6 Shih për detaje S. Omari., *E Drejta Familjare*, Tiranë 2007, fq 46 e në vijim.

Ekzistenca e sekseve të ndryshme ndërmjet bashkëshortëve të ardhshëm, konsiderohet nga një pjesë e doktrinës të së drejtës familjare si kushti natyror më i rëndësishëm për lidhjen e martesës. Në këtë kuptim, pjesa më e madhe e literaturës mbështet opinionin sipas të cilit ky kusht duhet përmbushur edhe në rastet kur dispozitat ligjore nuk e parashikojnë shprehimisht këtë kusht për lidhjen e martesës.⁷

Aktualisht kodi ynë i familjes nuk njeh *as formën e bashkëjetesës* ndërmjet personave me seks të njëjtë, pasi neni 163 e 164 të këtij kodi, parashikon *expressis verbis* se personat që bashkëjetojnë duhet të jenë të sekseve të ndryshme. Megjithatë, edhe në kushtet e këtij rregullimi ligjor, asgjë nuk i pengon dy persona të së njëjtës gjini, jo vetëm të bashkëjetojnë, por edhe të rregullojnë me marrëveshje pasojat që lindin nga bashkëjetesa. Një përfundim i kundërt me të do të ishte i bazuar, pasi bashkëjetesa e personave të të njëjtit seks nuk përbën një veprim në kundërshtim me ligjin derisa ky i fundit nuk e ndalon atë. Në këto rrethana, trajtimi juridik i personave homoseksuale që bashkëjetojnë, do të jetë i njëjtë me atë të dy individëve me seks të kundërta që bashkëjetojnë *more uxorio*, pa lidhur martesë. Por, nëse për këta të fundit, bashkëjetesa është një zgjedhje personale, në rastin e personave të të njëjtit seks, bashkëjetesa përfaqëson të vetmin instrument për të realizuar një bashkësi e për të formuar një familje.

Thënë kjo është e kuptueshme se këta subjekte janë të privuar nga një sërë të drejtash, ku ndër më kryesore mund të përmendim: e drejta për kontribut material në favor të bashkëjetesës; detyrimi për ushqim në favor të partnerit që nuk është i aftë të fitojë të ardhura të mjaftueshme; përcaktimi i pronësisë së sendeve të fituara gjatë bashkëjetesës; lehtësira fiskale, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, e të tjera si këto.

Për më tepër, vështirësi më të mëdha juridike paraqiten në rastet e mbarimit të bashkëjetesës, si pasojë e ndarjes apo vdekjes së njërit prej partnerëve, ku këtyre individëve nuk u njihet *e drejta reciproke e trashëgimisë*, pavarësisht afeksionit që mund të kenë ndaj njëri-tjetrit, i cili shpeshherë përlligj një trajtim juridik më të favorshëm se kategori të tjera të trashëgimtarëve ligjorë të këtyre subjekteve; *pjestimi i sendeve të fituara bashkërisht gjatë bashkëjetesës* dhe përgjegjësia ndaj detyrimeve të përbashkëta; *fitimi i pensionit pas vdekjes* së njërit prej partnerëve; apo të drejta të tjera që rrjedhin nga ligje të posaçme në favor të bashkëshortëve.

Njohja e së drejtës për të lidhur martesë nga ana e çifteve me orientim të njëjtë seksual, e njohur si “martesa homoseksuale”, përfaqëson sot në botë një

7 I.Filipescu., *Tractat de Dreptul Familiei.*, 1997fq 17. G.Bonilini., *op.cit.*, fq 40.

nga lëvizjet kryesore në drejtim të ndalimit të diskriminimit në trajtimin juridik të individëve. Kjo aspiratë politiko-juridike, synon të eliminojë dallimet që evidentohen në legjislacionet e vendeve të ndryshme, të cilët bëjnë një trajtim juridik të ndryshëm të individëve duke përdorur si kriter orientimin seksual. Në këtë kontekst, duhet të kujtojmë Rekomandimin e Këshillit të Europës 1474/ 2000 apo, Rezolutën e Parlamentit European A3-0028/1994 drejtuar vendeve anëtare, në drejtim të modifikimit të legjislacioneve kombëtare dhe të pasqyrimin në legjislacionet e tyre të brendshme të drejtave të individëve homoseksualë bazuar në këto akte.⁸

Pa u ndalur në argumentat pro⁹ dhe kundër¹⁰ që janë shfaqur në polemikat doktrinale, pasi këto tejkalojnë objektin e këtij punimi, në gjykimin tonë, edhe pse “martesa homoseksuale” paraqet vështirësi të mëdha konceptuale e tradicionale, pranimi dhe njohja e një instituti juridik të ngjashëm me martesën, do të ishte një zgjidhje e mirëpritur. Bazuar në ndryshimet që kanë pësuar legjislacione të tjera, të cilat e lejojnë një martesë të tillë, apo i njohin pasoja juridike bashkëjetesës ndërmjet personave të të njëjtit seks, konstatojmë se parimi i lidhjes së martesës ndërmjet një burri e një gruaje, nuk përfaqëson më sot një parim të rendit publik global.

Formalizimi zyrtar i një marrëdhënie homoseksuale, përtej problematikës fetare e politike, paraqet një rëndësi të veçantë në drejtim të pasojave juridike të një njohje të tillë. Kështu, një njohje publike e familjes ndërmjet personave të të njëjtit seks, do t'i njëjto mundësinë këtyre individëve të përfitojnë disa prej pasojave të parashikuara nga kodi i familjes në drejtim të bashkëshortëve. Edhe pse kundërshtimi i një martese të tillë bazohet kryesisht në argumentin e mundësisë së birësimit të një fëmije apo riprodhimit të asistuar, pas njohjes së një lidhjeje të tillë -cështje e cila në të vërtetë mbetet mjaft e diskutueshme-, gjejmë vendin të kujtojmë se asnjëra nga alternativat e mësipërme nuk është pasojë e drejtëpërdrejtë e “martesës homoseksuale”. Parë në terma praktikë,

8 Rekomandimi i Këshillit të Europës 1474/ 2000, “Mbi gjëndjen e homoseksualëve në vendet anëtare të Këshillit të Europës”. Shih, OFFICE database of the Council of Europe – September 2000; Rezoluta e Parlamentit European A3-0028/1994, “Mbi Barazinë e të drejtave të homoseksualëve në Bashkimin European”.

9 John Bosëell., **Kristianizmi, toleranza, homoseksualiteti. Kisha dhe homoseksualët në fillimet e shekullit të XIV**; D. Danna., *Martesa Homoseksuale*, 1997.

10 Shih për një opinion kundër martesës së homoseksualëve, Giovanni Paulo II., *Le unioni omosessuali non sono una realtà coniugale*, “La Famiglia”, n. 194, 1999, fq. 78-81, ku paraqitet një refleksion modern mbi refuzimin e kishës katolike për të konsideruar “familje” bashkëjetesën ndërmjet personave të të njëjtit seks; R. Buttiglione., **Commento della Risoluzione**, *La Famiglia*, n. 164, 1994, fq. 78-80, i cili përfaqëson një nga komentet kritikë në drejtim të Rezolutës së Parlamentit European të sipërcituar.

nga leximi i dispozitave ligjore që rregullojnë birësimin dhe shëndetin riprodhues¹¹, rezulton se asnjë nga këto procedura ligjore nuk kushtëzohet me lidhjen e martesës. Në këto rrethana, një individ i vetëm mund të birësojë një fëmijë apo të konceptojë një fëmijë nëpërmjet metodave alternative të riprodhimit, pavarësisht nëse është heteroseksual apo homoseksual, pasi asnjë dispozitë ligjore nuk e pengon këtë. Në këto kushte, shqetësimi i autorëve që kundërshtojnë “martesën homoseksuale” bazuar në mundësinë e këtyre individëve për të patur fëmijë vërtetohet edhe në kushtet e legjislacionit aktual, edhe pse ai nuk lejon martesën homoseksuale.

2. Familja me një prind dhe rregullimi i saj nga legjislacioni shqiptar

Përtej marrëdhënies ndërmjet vetë prindërve, marrëdhënia prind-fëmijë nuk bazohet në martesën e prindërve, por krijohet si rezultat i zënies dhe lindjes së një fëmijë si rezultat i marrëdhënies intime ndërmjet dy subjekteve të gjinive të ndryshme. Për të rregulluar edhe jurikisht këtë formë të familjes që bazohet në lidhjen e gjakut, legjislacioni shqiptar parashikon të drejta dhe detyrime në ngarkim të secilit prind, pavarësisht nëse këta të fundit janë të martuar, bashkëjetojnë, apo fëmija ka lindur si rezultat i një marrëdhënie intime sporadike. Thënë këto është e kuptueshme se për efekte të ligjit fëmija krijon marrëdhënie familjare që nga çasti i lindjes me secilin prej prindërve të tij. Duhet kuptuar se kjo marrëdhënie krijohet edhe në rastet kur prindi/prindërit e fëmijës janë të panjohur. Sipas dispozitave të kodit të familjes, në ato hipoteza kur amësia apo atësia njihet pas një intervali kohor pas lindjes së fëmijës, pasojat e marrëdhënies familjare do të fillojnë në mënyrë prapavepruese, që nga data e lindjes.

Në këto kushte, rezulton natyrshëm konkluzioni se modeli klasik i familjes është ai i fëmijës me të dy prindërit e tij. Edhe në rastet kur prindi është i panjohur –sikurse ndodh në rastet e atit kur fëmija ka lindur jashtë martese-fëmija ka potencialisht mundësinë të krijojë marrëdhënie familjare me prindin e panjohur. Kodi i familjes parashikon në këtë drejtim mundësitë për vërtetimin vullnetar apo gjyqësor të amësisë/atësisë së panjohur.

Përtej këtij modeli klasik të familjes biologjike, një nga zhvillimet e fundit, që ka vënë zbatuesit dhe hartuesit e *ligjit* përpara një sërë dilemesh e reflektimesh, janë pikërisht arritjet e dekatave të fundit në shkencat biomjeksore dhe progresin teknologjik. Mirëpo, ndryshe nga shkencat biomjeksore, të cilat

11 Ligji Nr 8876, datë 4.4.2002, “Për shëndetin riprodhues”.

evoluojnë vazhdimisht, shkenca e së drejtës, ashtu si edhe morali mbi të cilën ajo mbështet, janë përgjithsisht terene konservatore, ku ndryshimet pasqyrohen vetëm në kushtet e një sigurie të lartë dhe kur këto ndryshime janë pranuar më parë në ndërgjegjen kolektive .

Bazuar në përkufizimin e dhënë nga neni 30 i ligjit “Për Shëndetin Riprodhues”¹², riprodhimi mjekësor i asistuar ka për qëllim t’i përgjigjet kërkesës së një individ apo çifti për të konceptuar e lindur fëmijë, në rastet kur këta nuk mund ta realizojnë këtë në rrugë natyrore.¹³ Riprodhimi mjekësor i asistuar përfshin sipas këtij ligji, një sërë teknikash të cilat bëjnë të mundur riprodhimin jashtë procesit natyror. Kështu për shembull, ndër më të ndeshurat në praktikë janë: inseminimi artificial; fekondimi artificial *in vitro* (IVF); transferimi i embrioneve (GIFT) apo kombinime të ndryshme ndërmjet këtyre teknikave.

Përballë këtyre fenomeneve të reja biomjeksore, dy janë problemet që shtrihen për zgjidhje përpara zbatuesve të ligjit:

Së pari, polemika të shumta juridike ndeshen lidhur me legjitimitetin e kësaj metodologjie alternative për konceptimin e një fëmije. Ligji “Për Shëndetin Riprodhues” nëpërmjet një rregullimi të gjërë dhe jo shterues, përcakton në nenin 31 disa nga teknikat më kryesore të riprodhimit të asistuar, duke parashikuar shprehimisht mundësinë e zbatimit të të gjithë teknikave të tjera që lejojnë riprodhimin jashtë procesit natyror.

Ky parashikim ligjor, në gjykimin tonë, ka respektuar parimin kushtetues të lirisë dhe pavarësisë në zgjedhjet personale dhe ato familjare, ndaj ka lejuar pa kufizim të gjitha llojet e fekondimit të asistuar që ekzistojnë apo që mund të gjejnë zbatim në të ardhmen. Në këtë kontekst, duhet theksuar se një pjesë e konsiderueshme e literaturës juridike ka kundërshtuar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e pakufizuar të teknikave të riprodhimit të asistuar. Në vijim të këtij opinioni, nën influencën e argumentave biologjikë, gjenetikë, etikë, socialë, fetarë e psikologjikë e juridikë, konsiderohet se një zbatim i pakushtëzuar i tyre do të çonte pashmangshmërisht në cënimin e parimeve të rendit publik. Me gjithë dyshimet mbi bazën solide të këtyre argumentave, të cilat shpeshherë nuk i përkasin sferës të së drejtës, duhet pranuar se zbatimi i teknikave të riprodhimit të asistuar, mund të kufizohet në disa raste të përcaktuara.

Në mungesë të një koncepti të qartë juridik mbi lloje të tjera metodash

12 Ligji nr 8876, datë 4.4.2002 “Për Shëndetin Riprodhues” .

13 Shih për detaje., Et’hem.Ruka., Leksione të Endokrinologjisë dhe Fiziologjisë së Riprodhimit, Tiranë 1886.

që mund të shfaqen në të ardhmen, gjykojmë se duhet të mbështetemi në përkufizimin e dhënë nga Gjykata e Drejtësisë së Komunitetit Europian¹⁴, sipas së cilës: “*Si pasojë e një pasigurie shkencore mbi pasojat negative të një aktiviteti apo teknologjie, këto të fundit nuk mund as të ndalohen e as të kufizohen nën nivelin për të cilin rreziqet janë pranuar apo parashikuar, por duhet të rregullohen nga ana ligjore*”.

Në rrethanat kur pranohet unanimisht se jo çdo gjë e mundur nga ana shkencore duhet të gjejë zbatim në praktikë, roli i shkencës të së drejtës është të përcaktojë kritere të qartë, të cilët do të bëjnë të mundur zbatimin racional në praktikë të çdo metode të riprodhimit të asistuar. Pikërisht për këtë qëllim, janë miratuar edhe disa akte ndërkombëtare, ku ndër më të rëndësishmet do të përmendnim: Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Dinjitetit Njerëzor, përballë Zbatimeve të Biologjisë e Mjeksisë; Protokollin shtesë në Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor, përballë zbatimeve të biologjisë e mjeksisë, e cila i referohet ndalimit të klonimit të qënies njerëzore, Paris 12 ianar 1998; Konventa Për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjeksisia, Oviedo, 4 prill 1997.

Së dyti, në një pjesë të rasteve të lindjes së fëmijës sipas teknikave të riprodhimit të asistuar dhe konkretisht në rastet e konceptimit të fëmijës si rezultat i *dhurimit* të pasurisë gjenetike të një subjekti të panjohur, shtrohet problemi i strukturës së familjes, e cila në një hipotezë të tillë do të përbehet vetëm nga njëri nga prindërit biologjik, ndërkohë që prindi tjetër është jo vetëm i paidentifikuar, por për më tepër i paidentifikueshëm, pasi në raste të tilla legjislativi e ndalon njohjen e identitetit të dhuruesit.

Kështu, në të gjitha ato hipoteza kur një grua apelon e vetme tek metoda e riprodhimit të asistuar, duke përdorur vezën e saj dhe pasurinë gjenetike të një dhuruesi dhe njëkohësisht asnjë subjekt tjetër –bashkëshort apo partner-nuk merr përsipër vullnetarisht atësinë e fëmijës, ky i fundit ka të përcaktuar lidhjen familjare me nënën e tij, por nuk mund të kërkojë gjyqësisht në asnjë rast përcaktimin e atësisë biologjike. Gjithashtu nga ana e tij, edhe ati biologjik edhe pse ekziston siguri maksimale për të provuar lidhjen biologjike ndërmjet tij dhe fëmijës, nuk do të mundet në asnjë rast të kërkojë vullnetarisht apo gjyqësisht njohjen e fëmijës dhe vendosjen e një marrëdhënie familjare ndërmjet tyre. Nga ana tjetër, *mutatis mutandis*, e njëjtë do të jetë zgjidhja edhe në drejtim të një burri që i drejtohet dhurimit të vezës nga ana e një dhuruese të panjohur dhe mbajtjes së fetusit prej saj, për konceptimin e një fëmije, në të gjitha ato raste kur këtij vullneti nuk i bashkëngjitet edhe ai i bashkëshortes apo partneres së tij në drejtim të birësisht të fëmijës së konceptuar sipas kësaj procedure.

14 Shih C-157/96 dhe C-180/96

Në këto rrethana të reja, e drejta në përgjithësi dhe ajo familjare në veçanti, nuk mund të injorojë ndryshimet që reflektohen në shoqëritë bashkëkohore, ndaj *de lege ferenda* lind nevoja e amendimit të dispozitave të kodit të familjes. Në mungesë të dispozitave ligjore të posaçme, praktika gjyqësore do të jetë ajo që duhet t'i përballojë këto ndryshime. Në këtë kontekst, do të veçonim një nga opinionet e shfaqura në praktikën e vendeve të tjera, të cilat tashmë janë ballafaquar me një sërë konfliktesh në fushën e përcaktimit të *status filiationi* për fëmijën që lind nga riprodhimi i asistuar, sipas të cilit: “Gjetja e një zgjidhje të saktë dhe unike, e cila të zbatohet në të gjitha rastet e fekondimit artificial, është e vështirë. Në këto rrethana, kësaj problematike do t'i jepet zgjidhje rast pas rasti, duke u nisur nga parimet themelore të së drejtës dhe ato të etikës”.¹⁵

IV. Refleksione mbi tendencat bashkëkohore të konceptit të familjes dhe roli i të drejtës familjare mbi këto zhvillime. Objektiva dhe perspektiva

Sikurse rezulton nga zhvillimi historik i familjes, rruga që kjo ka ndjekur, që nga kuptimi patriarkal që dominonte qytetërimin feudal, e deri në pranimin e barazisë juridike të anëtarëve të saj, ka kaluar nëpërmjet tensionesh sociale dhe konfliktesh në ndërgjegjen kolektive. Parë në këtë këndvështrim, duhet pranuar se organizimi i jetës familjare dhe personat që e përbëjnë atë, nuk kanë qenë e as mund të jenë të përcaktuara njëherë e përgjithnjë. Familja ka lindur, ndryshuar dhe zhvillohet në vazhdimësi, krahas zhvillimeve që pëson vetë shoqëria. Në këto rrethana, nëpërmjet normave të saja e drejta familjare duhet të kontribuojë në mbrojtjen e hierarkisë së vlerave të qytetërimit, të formuara këto si pasojë e një eksperience shumë vjecare të njerëzimit. Në këtë kuptim e drejta familjare shfaqet nëpërmjet normave të saja, si një garanci për një qëndrim apo ndërgjegje juridike korrekte, e cila respekton parimet morale por njëkohësisht edhe lirinë e çdo individit.

Nga ana tjetër, dinamika e jetës na ballafaqon me qasje të ndryshme, mënyra të reja të menduari e të jetuari, të cilat na bëjnë të reflektojmë si në drejtim të njohjes dhe respektimit të lirive të individit ashtu edhe ruajtjes së konceptit të familjes tradicionale. Konstatojmë sot se në shoqëri janë shfaqur stile të reja jetese, të cilat ndryshojnë nga struktura tradicionale e familjes apo sipas rastit nga burimi që shërben për formimin e familjes. Janë disa prej tyre:

15 Deklarim i bërë nga Komiteti Kombëtar të Bioetikës, 17 Qershor 1994, Itali. *Apud*, ëëë. diritto.it.

- Bashkëjetesa apo familja faktike ndërmjet një burri e një gruaje, pa lidhur martesë;
- Familja faktike ndërmjet personave të të njëjtit seks apo edhe lidhja e martesës ndërmjet tyre;
- Familja me 1 prind, që rrjedh nga lindja e një fëmije nëpërmjet metodave të riprodhimit të asistuar, kur dhuruesi i pasurisë gjenetike mbetet përjetësisht i paidentifikuar;

Në këto rrethana të reja, e drejta familjare duhet të ndjekë prirjet e prurjet bashkëkohore, e t'u japë zgjidhje fenomeneve të reja. Me fjalë të tjera, ajo duhet të rishikojë normat e mëparëshme, duke i modifikuar ato, apo nëpërmjet zbatimit të parimeve të përgjithshme të saj duhet t'i garantojë mbrojtje edhe këtyre formave të reja të familjes.

Kështu për shembull, kur ndotja globale konsiderohet nga shkaktarët e rritjes së infertilitetit në individë të ndryshëm, apo numri i meshkujve është ndjeshmërisht më i ulët se ai i femrave, duhet pranuar se konceptimi i fëmijës si rezultat i teknikave të riprodhimit të asistuar, ku përdoret pasuria gjenetike i një dhuruesi të panjohur, çon pashmangësisht në pranimin e familjes me një prind; Apo në emër të parimit të lirisë së individit, bashkëjetesa e dy personave, pavarësisht nga seksi i tyre, duhet të legjitimohen nga e drejta familjare.

Në këtë kontekst nuk duhet harruar ndikimi i së drejtës ndërkombëtare mbi legjislacionin tonë të brendshëm. Është koha kur Shqipëria në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian, të vazhdojë reformimin e sistemit të brendshëm edhe për sa i përket të drejtës familjare duke pasqyruar dukuritë dhe fenomenet me të cilat shoqëria europiane prej vitesh përballet dhe t'u japë zgjidhje atyre, duke marrë në konsideratë respektimin e të drejtave të individit në raport me mbrojtjen e rendit publik.

Nëse i referohemi konventave ndërkombëtare, liria e individit shfaqet sot si vlera më e cmuar. Në këto rrethana, vlerat e qytetërimit perëndimor do të depërtojnë nëpërmjet këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare në vlerat kombëtare, duke influencuar edhe mentalitetin dhe ndërgjegjen kolektive mbi tendencat e reja të familjes, dhe pranimit të tyre në emër të mbrojtjes së lirisë së individit dhe respektimit të pakicave. E drejta pozitive duhet t'i paraprijë ndërgjegjes kolektive duke ndihmuar emancipimin e saj, jo vetëm nëpërmjet mungesës së ndëshkimit, por edhe njohjen e të drejtave, duke eliminuar kështu çdo formë të diskriminimit njerëzor.

Në përfundim, duhet theksuar se duke parashikuar apo mbrojtur modele alternative të familjes, e drejta familjare nuk merr përsipër për të ndikuar mbi zgjedhjet personale të individëve, të cilët mbeten të lirë të bëjnë zgjedhjen që

e konsiderojnë të arsyeshme; morale; apo sipas rastit, në përputhje me lirinë e tyre. Në këtë kuptim, e drejta familjare i përgjigjet vetëm kërkesave të atyre personave të cilët nuk dëshirojnë t'i nënshtrohen modelit tradicional të familjes, por që në të njëjtën kohë, nuk mund t'u mohohen të drejtat e detyrimet që lindin nga këto mënyra jetese.

Në analizë të fundit, nuk duhet harruar se roli i së drejtës nuk bazohet në imponimin e një sjellje, qëndrimi apo familje ideale, të njëjtë për të gjithë qytetarët, por vetëm në garantimin e të drejtave të gjithësecilit, duke i harmonizuar këto me interesat e shoqërisë.

Bibliografia

- Begeja. K., *E Drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*, Tiranë 1984.
- Bonilini. G., *Manuale di Diritto di Famiglia.*, UTET, 2002.
- Filipescu. I., *Tractat de Dreptul Familiei.*, ALL., 1996.
- Omari. S., *E Drejta Familjare*, Tiranë 2007.
- Boswell. J., *Kristianizmi, toleranza, homoseksualiteti. Kisha dhe homoseksualët në fillesat e shekullit të XIV.*, 1999.
- Danna. D., *Martesa Homoseksuale*, 1997.
- Giovani Paulo II., *Le unioni omosessuali non sono una realtà coniugale*, "La Famiglia", n. 194, 1999.
- Buttiglione. R., *Commento della Risoluzione*, *La Famiglia*, n. 164, 1994.
- Ruka. E., *Leksione të Endokrinologjisë dhe Fiziologjisë së Riprodhimit*, Tiranë 1886. www.diritto.it

III.

KOMUNIKIMI

DIMENSIONET SOCIAL-KULTURORE NË EVIDENTIMIN E VLERAVE DHE NDËRTIMIN E IMAZHEVE PËR TURIZMIN

Dhimitraq Furxhi
Teatri Petro Marko

ABSTRACT

Panoramic study targets experiences that link, man, culture and tourism. Its purpose is to collect and present theoretical and statistical data, on the basis of which can be implemented methodology and analysis in the case of a qualitative study according to the argument. Also, the paper aims at highlighting from the theoretical standpoint, but also by closely monitoring experiences, the relation between tourism, culture and society depending on the mass society concept evolution, social spaces that are considered strong points in front of those weak, which in terms of competition serve as incentive for the positioning of tourist structures and services according to social economic and political growth of the area. The problem that will lead the paper, concerns the identification of reciprocity that exists between events and tourism resources with those derived from estimates of culture and products of human activity, in the social and economic point of view.

Key words: mass society, social image, tourism, development.

Hyrje

Punimi panoramik¹ «Dimensionet social-kulturore në evidentimin e vlerave dhe ndërtimin e imazheve për turizëm», ka në qendër lidhjen e turizmit me njeriun, kulturën.

1 Punimi kompilues dëshmon se është shqyrtuar në mënyrë kritike një pjesë e konsiderueshme e literaturës që lidhet me çështjen e zgjedhur, duke dhënë kontribute të vlefshme teorike e panoramike për specialistët e fushës, edhe kur këta nuk kanë ndërmarrë ndonjëherë studime të thelluara në fushën përkatëse.

Turizmi vlerësohet si një nga industritë më të sukseshme jo vetëm për sot, por më tepër për të ardhmen. Me të lidhen nevoja, dëshira dhe interesa të njerëzve të ndryshëm në çdo vend të botës. *Turizmi specifikohet si një tërësi e marrëdhënieve dhe fenomeneve që lindin midis turistëve gjatë udhëtimit dhe qëndrimit të tyre në një vend të caktuar turistik dhe banorëve vendas.* Kjo nënkupton që turizmi është jo thjesht një fenomen i natyrshëm, por para së gjithash një fenomen social. Lidhur me këtë vlerësim që i bëhet turizmit është shtuar nevoja e domosdoshmërisë së njohjes së turizmit në tërësi, ose të problemeve të tij në veçanti.

Në këtë kuadër nuk kanë mbetur prapa edhe përcaktimet që vijnë nga shkencat shoqërore mbi turizmin, të cilat zenë një vend të rëndësishëm në sfondin e të gjitha shkencave të tjera që merren me turizmin. Zhvillimi i turizmit bëhet në hapësira dhe vende të caktuara turistike dhe shoqërohet me mjaft interesa, probleme apo raporte sjellore të ndryshme që lindin midis turistëve dhe banorëve të vendit pritës. Pikërisht ky punim, përqëndrohet në analizën e dimensioneve social-kulturore të turizmit, ndikimin që ato ushtrojnë mbi kërkesën turistike dhe vendimmarrjen për organizimin e udhëtimeve. Problemi që udhëheq punimin, ka të bëjë me evidentimin e reciprocitetit që ekziston midis eventeve dhe burimeve për turizmin, me ato të rrjedhura nga vlerësimet e kulturës dhe produkteve të veprimtarisë njerëzore, të para në planin social dhe ekonomik. Kjo është realizuar përmes shqyrtimit të literaturës mbi çështje të industrisë së turizmit në këndvështrimin e shkencave sociale, për të renditur situatat që mundësojnë kuptimin dhe shpjegimin e reagimeve dhe rezultateve të deritanishme në trekëndëshin që ka nisur të bëhet pjesë e diskutimeve për turizmin në shoqërinë shqiptare: komunitet-kulturë-turizëm. Diskutime, ide, kritika vlerësohen sidomos në drejtim të koncepteve të turizmit dhe kulturës masive.

Diskutimi i rezultateve

Në turizëm janë njerëzit që spostohen dhe jo mjetet dhe mallrat. Ky fakt jep një përgjithësim të kontakteve njerëzore me gjithë kompleksitetin e personit që merret në analizë, i parë ky nga këndvështrimi i raporteve me të tjerët, pra në sensin social. Duke menduar kështu, është marrë në analizë turizmi si fenomen social dhe si fenomen i masës, me gjithë konsekuencat që rrjedhin në këto situata, qofshin pozitive apo edhe negative².

Girolamo Rossi (1994), mendon se turizmi i masës shpesh nuk është gjë tjetër veçse transferimi nga një situatë sociale e jetës së përditshme në qytet,

2 Koçollari, N. *Psiko-sociologjia e turizmit*, Triptik, Vlore, 2005, fq.131.

drejt të njëjtës situatë në një qytet tjetër, ku kërkohet gjithçka, ose ndryshe ajo që është lënë në vendin ku banon. Në praktikë, është një transferim pa ndryshime thelbësore dhe vetë mjedisi, me det apo mal, gjendet i pushtuar nga turmat e njerëzve, duke humbur kështu karakteristikat themelore për një akomodim fitimprurës e të shëndetshëm. I vetmi element që mbetet i vlefshëm konstatohet të jetë koha e lirë, mungesa e kohës zyrtare të punës, ndërkohë që kjo përbën shumë pak në raport me vlerat e turizmit.³

Gjithashtu, “efekti qytet”⁴ shpjegon sjelljen e turistëve, të cilët nga njëra anë duan të harrojnë dhe shmangin të gjitha aspektet negative të jetës së përditshme, trazirat urbane, duke bërë turizëm, nga ana tjetër kërkojnë një mjedis të ndryshëm, të qetë, shlodhës, pra të gjitha përfitimet e mundshme nga një eksperiencë pushimi, duke vizatuar kështu, një tablo kontradiktore, e cila konstatohet edhe nga sondazhet sociologjike, pasi turistët kërkojnë në mënyrë sistematike, por gati të pavetëdijshe, pa asnjë shpjegim apo argument, të gjejnë të gjitha grimcat e vorbullës urbane të jetës së përditshme në zonat që zgjedhin për të pushuar. Nëse ata nuk i kontaktojnë komoditetin, apo elementët e jetës argëtuese të jetës së përditshme, krijohet një problem i konsiderueshëm e si rrjedhim pushimet bëhen të mërzitshme. Problemit i rritet ndjeshmëria, nëse vërrejmë se jo të gjitha zonat e destinuara për turizëm masiv frekuentohen në periudha të gjata kohore vjetore, për shkak se edhe strukturat që promovojnë e ofrojnë shërbime turistike vjetore mungojnë. Të ashtuquajturit “qytete të vdekur”, nëse vizitohen jashtë sezoneve përkatëse turistike që promovojnë, “vrasin” të gjitha përjetimet dhe ndjeshmëritë për burimet dhe vlerat turistike të zonës.

Studimet tregojnë se çështje të tilla që prekin direkt turizmin e masës, ende nuk kanë “receta” të rehabilitimit apo përmirësimit të eventeve. Thjesht, listohen disa hipoteza⁵, të cilat lidhen më tej me mjediset specifike të zonave turistike. Ndër to mund të përmendim: *shkallëzimin e periudhave të pushimit* (eksperiencë që së paku nga raportimet e mediave të vendeve fqinje, që në sezonet turistike publikojnë matje të shpejta për format dhe destinacionet e lëvizjes së turistëve, zunë sezonin e shkuar të 2011-ës, një vend të rëndësishëm, për shkak të ndryshimit të vizionit të pushimit dhe shkurtimit të periudhës dy javore të pushimit në periudha 5-7 ditë); *përmirësimi i jetës në qytete, humanizimi i mëtejshëm i qyteteve dhe bërja e tyre*” më të përshtatshëm për jetën”, në pikëpamjen mjedisore dhe transformimit të qyteteve, shpërndarjes

3 Rossi, G., , *Storia e psico-sociologia del turismo*, San Marco, Bergamo, Italia, 1994, fq.123.

4 Rossi, G., , *Storia e psico-sociologia del turismo*, San Marco, Bergamo, Italia, 1994, fq.122,123.; Koçollari, N. *Psiko-sociologjia e turizmit*, Triptik, Vlore, 2005, fq.128.

5 Rossi, G., , *Storia e psico-sociologia del turismo*, San Marco, Bergamo, Italia, 1994, fq.124-126.

së efektshme të rrjeteve urbane, shërbimet sociale, edukative, sportive, të komunikimit dhe trafikut, që krijojnë një imazh më të personalizuar të zonës në raport me të ardhurit; *sfrocoja që të njihen më mirë vlerat kulturore të qytetit*, edhe nga vetë qytetarët e tij, pasi kudo është një eksperiencë e ngjashme, që edhe pse jetohet prej shumë vitesh në një qytet, ai rezulton i panjohur në vlerat që ofron; *"animimi" i qyteteve*, përmes organizimit të festave dhe ceremonive tradicionale popullore, nxitja dhe promovimi i grupeve folklorike përmes përfshirjes në të qytetarëve; diferencimi i ofertave turistike përmes formave të studiuara të marketingut, orientimit serioz të klientelës dhe destinacioneve të lëvizjes, duke patur objektiv arritjen e fluksit turistik gjatë gjithë vitit. Kësaj do t'i shërbente p.sh., studimi i preferencave dhe nevojave për turizëm tek të rinjtë dhe moshat e tretë, organizimi i konferencave, kongreseve, panairove, etj, në zonat që promovojnë turizmin.

Turizmi masiv në zonat ku zhvillohet shpesh çel diskutime të shumta. Kështu, nëse në një metër vend (siç ndodh në plazhet e Vlorës, me keq në ato të Durrësit), përqëndrohen 10 vetë, kur rreth e qark ka mjedise të ndotura për shkak të mungesës së kanalizimeve, nëse në restorante duhet të presësh 2 orë për një pjatë patate, nëse parkimi është një torturë e vërtetë, nëse qarkullimi të bën të përshkosh 200 m rrugë në 1.5 orë, nëse veshët të gjëmojnë nga zhurma e muzikës, apo artikujve që promovohen me megafonë, nëse kur shkon në hotel, papritur mungon uji, nëse rrugët janë të ngushta dhe duhet të presësh rradhën për të kaluar, nëse je me fat, sepse mund të ndodhet një punëtor i vetëm duke hapur kanal në mes tv rrugës për ujin, kabllot elektrike apo të telefonisë dhe ti e gjen shenjën e rrugës së pariparuar edhe kur kthehesh nga pushimet, lind pyetja, *a është i vlefshëm turizmi? Ai konsumohet apo jetohet?* Vështirësisht ta konfirmosh përgjigjen vetëm nga pozita teorike, pasi turizmi është një element që prek ndjeshëm sistemin tonë social-ekonomik. Turizmi është pjesë e ekonomisë, shoqërizimit, kulturës. Qytetet e artit, zonat me specifika të klimës, apo natyrës, shprehin burime që vetëm kërkesa turistike mund t'i valorizojë. Përsa i takon shkëmbimeve kulturore, turizmi bën pjesë tek lidhja e pakthyeshme me raportet ndërkombëtare. Turizmi nuk është thjesht një lëndë e parë, potencialisht e pazëvendësueshme, por një mundësi për një promovim global.

Sipas Salzano (1969)⁶, zhvillimi i turizmit masiv gjen përfaqësimin e vet në fazën kur shpërndarja dhe zgjerimi i konsumit bëhet një realitet dominant i ekonomisë. Ndërkohë, Knebel (1960)⁷, në veprën *"Turma e vetmuar"* në mënyrë shumë kritike evidenton rëndësinë e faktorëve psikologjikë e socialë, që lidhen

6 E. Salzano, *Urbanistica e società opulente*, Bari, 1969.

7 H.J.Knebel, *Soziologische strukturwandlungen im modernen tourismus*, Stuttgart, 1960.

me krijimin e shtresave të reja sociale. Sipas tij turizmi prezanton një “privilegj social”, një “status simbol”, një eksperiencë që pasqyron një model pozitiv për veten pas kthimit në shtëpi. Gjithashtu, ai kritikon edhe eksperiencat dhe shpjegimet e disa autorëve italianë⁸ (bëhet fjalë për C.Stroppa në “*Svilupo del territorio e ruolo del turismo*”), duke ritheksuar dëmet dhe faturat ekologjike (ekonomia turistike për të promovuar shpërndarjen e sistemeve metropolitane në realizimin e strukturave turistike, shkakton dëme të pariparueshme në mjedis). Një element tjetër kritik vihet re në fenomenin e quajtur “*frenetika e konsumit*”, kur konsumi i tipit publik dhe privat hyjnë në shoqërinë e konsumit masiv, ku kurba e konsumit bëhet obsesive në vetvete. Ky fat stimulon “manipulimin e konsumatorit” duke krijuar nevoja të rreme të kënaqësisë, që në vazhdim, sjellin rritjen e hapësirave të prodhimit. Më thjesht, krijohen diferenca në lidhje me konsumin e burimeve private e publike dhe përfitimet prej tyre. Kështu, hapësirat publike, shfrytëzohen nga të gjithë falas, rrugët, parqet, shkollat, spitalet, etj., ndërsa strukturat private në përdorim kanë një kosto që duhet të përballohet nga turistët. Kjo situatë ku turisti paguan për shërbimet që përfiton nga privati, por nuk paguan për ato publike, sjell një disekuilibër social. Nganjëherë kjo bën që kërkesat e turistëve të jenë të pakuptimta në lidhje me objektet që duan të përdorin, që rezultojnë të padobishëm apo të padukshëm (“qiqra në hell”).

Po të krahasojmë me kujdes teoritë dhe kritikën edhe në periudha të mëvonshme, kritikën e forta lëvizin sipas analizës që i bëhet shoqërisë së konsumit dhe arsytet janë tipikisht ekonomike. Kuptohet që nuk mund të realizohet një studim mbi turizmin nëse përjashtohen termet ekonomike, por , nëse nuk kemi referenca sociologjike, psikologjike e antropologjike, studimet na lënë në udhëkryq. Kjo është situatë dilematike që ka prekur edhe klientelën shqiptare në zgjedhjen e destinacioneve turistike (dialogë si ky në vijim, janë shumë të zakonshëm kur flitet për pushimet: ... të shkoj të pushoj në jug të Shqipërisë? Atje më duket se vetëm harxhoj e nuk kënaqem...Do shoh në ndonjë agjensi...Në fakt pyeta, por ishte shumë shtrenjt. Do të përfundoj atje, e di. C' të bëj?).Kjo ndodh sepse, turizmi u përgjigjet radikalisht të gjitha ekzigjencave të njeriut në një shoqëri moderne, që shkojnë shumë më larg sfondit ekonomik. Kërkimet mbi motivet e lëvizjes në turizëm, orientojnë që produkti turistik të ofrohet në formën më të kërkuar. Motivacioni në turizëm përcaktohet si një prej proceseve që bëjnë pjesë në përcaktimin e sjelljes.⁹ Në praktikën e turizmit masiv vërrehen edhe dukuri negative që çënojnë, jetën,

8 C.Stroppa “*Svilupo del territorio e ruolo del turismo*”,Bologna, 1976.

9 Pollastri, C., “*Turismo: elementi ed orientamenti di storia, sociologia e psicologia*”,Padua, Cremona, Italia, 1986.

mjedisin, por nuk mendohet se kjo vjen thjesht nga praktika të gabuara në turizëm, por nga paaftësia e “njeriut modern” për t’u përgjigjur në mënyrë inteligjente, krijuese, origjinale dhe me një kulturë të re, nevojës për të bërë turizëm, fakte që mbeten në thelb çështje të planit psikologjik, sociologjik, por edhe ekonomik. Normat e edukimit në funksion të turizmit e kulturës, që krijojnë produkte sociale dhe nxitin psikologjinë e sjelljes brenda fenomenit, janë një proces jo lehtësisht i arritshëm e realizueshëm, pasi nevojitet shtrirje në kohë dhe në mjete, duke përfshirë shkollën dhe kurrikulat e deri tek media dhe opinioni public, që ndikojnë mentalitetet e reja për turizmin, kohën e lirë dhe përfitimet e individit.

Karakteri i shprehjes së turizmit.

Nuk është e lehtë të dallosh qartë sjelljet, motivacionet, pritshmeritë, origjinale nga ato të ndikuara nga mjedisi social, cilat janë shtysat dhe cilët janë faktorët pengues të zhvillimit.

Për t’u orientuar drejt në këtë pikë, nevojitet imagjinata, e cila na lejon të kapërcejmë drejtimit tradicionale teorike e metodologjike dhe të realizohet hapja me ambientin e jashtëm.

Ndryshimi i bazës ekonomike, krijimi i klasave të reja, i raporteve të reja me botën e jashtme, konfrontimet mes brezave prodhojnë tensione të brendshme, por nuk fshijnë marrëdhënien bazë me komunitetin lokal, që vazhdon të zhvillojë rolin e vet simbolik të identifikimit.¹⁰ George Simmel, një nga më të shquarit në sociologji, në lidhje me raportin territor-shoqëri, bën fjalë për një ekuilibër të vështirë midis dominimit psikologjik dhe atij territorial, d.m.th., roli i forte pengues në ndryshimet ekonomike, sociale e kulturore. Në këto kushte në ndihmë na vjen një koncept i njohur: tradita, jo në sensin e identitetit, jo si nostalgji për të shkuarën, por si një teknikë e kujtesës për të jetuar të njëjtin territor dhe për ta ndryshuar atë, si një forcë e vazhdueshme dhe dinamike.

Sipas Koçollari, N. (2005), turizmi sot përbën një nga treguesit më të sigurtë të mirëqenies. Këtë e dëshmojnë përmasat e gjera që ka marrë ky fenomen kohët e fundit, si dhe orientimet e motiveve të individëve drejt lëvizjes së lirë, në arritje të shërbimeve që ofron turizmi. Si fenomen, ka qenë gjithnjë në qendër të vëmendjes sociale dhe shoqërisë. Shumë shprehje të sjelljes njerëzore në dukje, nuk manifestohen më si pritjet e thjeshta të natyrës individuale e subjektive, por përbëjnë një proces të socializimit, që lëviz dhe drejton gjithë sistemin.

10 Za, L., Comunita memoria sviluppo, Pensa Multimedia, Lece, Itali, 2001.

Turisti që hyn në një lokalitet dhe merr kontakt me banorët e tij, jo vetëm kontakton me një realitet të ri, me njohje të reja, por detyrohet të kuptojë problematikën altruiste dhe të modifikojë kuptimin e tij për jetën, si dhe veprimet që kryhen realisht. Pavarësisht nga raportet e ngushta që ekzistojnë midis individit dhe realitetit social, fenomeni turistik në të gjitha aspektet e veta, lidhet me tipin e shoqërisë. Një nga kriteret thelbësore që preçizon konceptin për turizëm, kundrejt konceptit të përgjithshëm për lëvizje, lidhet me mobilitetin, i perceptueshëm ky, në tre plane: mobiliteti territorial (horizontal, që ka lindur nga sociologjia e emigracionit), social (vertikal që tregon lëvizjen e individëve në hierarkinë e shtresave sociale gjatë procesit të industrializimit. Kjo ka të bëjë me të ardhurat, fuqinë ekonomike e politike, si dhe atë kulturore. I rëndësishëm është këtu prestigji social, përmes të cilit individit rrit efikasitetin e veprimtarisë dhe aktivitetit të tij për periudha relativisht të gjata.)¹¹ dhe ai psikologjik¹² (varet nga temperamentit, karakteri dhe inteligjenca, kultura, shoqëria dhe prezantohet si faktor i rëndësishëm i mobilitetit territorial¹³).

Turizmi dhe kultura e masës.

Karakteristikat e kultures se mases.

Ka nisur të flitet për *turizëm të masës*, që shpreh një *kulturë të masës*, pas Revolucionit Industrial. Kjo kulturë e ka origjinën në progresin teknologjik dhe përhapjen e fuqizimin e mjeteve të komunikimit, mas-media. Ka nisur në vitet 1930 dhe pas Luftës së Dytë Botërore u përhap edhe në vendet europiane perëndimore, si produkt tipik i shoqërisë industriale¹⁴. Kultura e masës ka të bëjë me këto aspekte: është tentativë e parë në historinë e njerëzimit për të krijuar një *kulturë universale*; përbën një pikë që favorizon procesin e *homogjenizimit të konsumit* dhe kontribuon në shuarjen e kufijve klasorë: sot punëtorët, mësuesit, fshatarët, tregtarët, bashkohen në shumë tipe sjelljesh, në praktikat sportive, në turizëm, në argëtim dhe në mjetet e komunikimit. Mjetet e komunikimit kanë

11 H.J.Knebel, *Soziologische strukturaländerungen im modernen tourismus*, Stuttgart, 1960, fq. 107, cituar nga Savelli A., *Sociologjia del turismo*, Franco Angeli, Milano, 1996, fq. 139, 140, 143

12 Cituar nga W.Hunziker & K.Krapf, *Grundris der Allgemeinen Fremdenverkehrslehre*, Zyrih, 1942.

13 Koçollari, N. *Psiko-sociologjia e turizmit*, Triptik, Vlore, 2005, fq. 115.

14 Rossi, G., *Storia e psico-sociologia del turismo*, San Marco, Bergamo, Italia, 1994, fq. 137, 138.

mundësuar përhapjen e konceptit të kulturës së masës në të gjithë botën. Në këte tip kulture bëhet e rëndësishme pjesëmarrja sociale, e lidhur me konsumin e masës, me përfshirjen kulturore dhe këto kontribuojnë fortësisht në pasjen e turizmit masiv. Në lidhje me këtë formë të të bërit të turizmit, ka edhe kritika, për “kulturën e elitës” e cila nën konceptimin e kulturës massive, pothuaj humbet dhe ideohet nga mbështetësit e vet, si një degjenerim i turizmit dhe edukimit, pasi lëvizjet apo në përgjithësi fenomenet e destinuara të jenë masive kanë brenda mentalitetet e ndryshme, etnitë e ndryshme, kulturat e ndryshme, vulgaritetet, etj. Gjithsesi, kultura e masës sjell me vete shpërbërjen e *mitit të konsumit* vetëm në shtresa të caktuara dhe nga ana tjetër bëhet një pikë e fortë diskutimi mbi turizmin, si një mjet i lirisë së lëvizjes, sidomos drejt zonave rurale¹⁵.

Motivacionet kulturore te turizmit.

Turisti¹⁶ në përgjithësi mendohet së është një person i përgatitur, që me bërjen e turizmit, përfiton të kuptojë më mirë mënyrën dhe jetën, e si rrjedhim të zgjerojë thellësisht kufijtë e njohjes së tij. Në këtë këndvështrim turisti dhe kontakti i njerëzve me identitete kulturore të ndryshme, sjell një pasurim të trashëgimisë kulturore të turistit dhe duke qenë se eksperiencat turistike në ditët e sotme mund të tejkohen e përhapen shumë lehtë, sjell pasuri në gjithë komunitetin. Shpesh ndodh që kulturat e hapura ndaj vendeve të tjera, bëhen një mjet për të nxitur e realizuar procese të rëndësishme zhvillimi e progresi në shumë aspekte, ku përfshihen edhe ato artistike, letrare muzikore, filozofike, por edhe teknologjia dhe ekonomia e vendeve përkatëse. Pra, penetrimi, hyrja në kultura e qytetërimi të ndryshme në vendet që vizitohen, shënon një

15 Po aty, fq.137-138.

16 Rossi, G., , *Storia e psico-sociologia del turismo*, San Marco, Bergamo, Italia, 1994, fq.124-126 Para Revolucionit industrial motivacionet kryesore që percaktonin turizmin janë thellësisht të karakterit kulturor. Ato janë ekzigenca që i përgjigjen nevojave të njerëzve për të njohur e ditur, për të zgjeruar kufijtë e njohjes së tyre, për të bërë eksperiencë të reja. Kështu, turisti udhëton për të vizituar vende e popuj të panjohur, për të kuptuar mënyrën e tyre të jetesës, zakonet dhe qytetërimet e tyre, për të admiruar bukuritë e natyrës dhe krijimet artistike që kanë karakterizuar gjithë periudhën në fjale. Nga format me të vjetra të turizmit të praktikuar nga greket e sidomos nga romanet, motivacionet e para për të udhëtuar, i takojnë atyre të tipit kulturor. Në kohën e romaneve shtohet një motivacion tjetër i lidhur me ikjen nga rutina e përditshme në kërkim të pushimit, por kjo në miniaturë. Këto tipe të motivacioneve mbeten gjithnjë të rëndësishme dhe kanë vazhduar edhe pas epokës së Revolucionit Industrial, por tashmë kemi një fenomen turistik me tipare moderne dhe një klientelë turistike të përgatitur.

përgatitje kulturore dhe gjithashtu turistike të cilitdo që tërhiqet dhe afektohet nga udhëtimi. Që të kemi gjithë specialitetet e specialistët, nevojitet një nivel i lartë kualifikimi, ku përfshihen: njohuritë mbi legjislacionin, një apo disa gjuhë të huaja, njohje e mirë e veprave të artit, monumenteve, objekteve arkeologjike, bukurivetë natyrës, burimeve të çfarëdo lloji të një zone, në të cilën duhet ushtruar profesioni i operatorit në turizëm, njohje e mirë e terreneve gjeografikisht e nga pikpamja historike e kulturore, traditat, zakonet, komunikimi, kapacitete teknike për të realizuar profesionet e sipërpërmendura, sidomos ato që kërkojnë një nivel specifik njohurish, informacioni dhe përgatitjeje, njohje e mirë e gjuhëve teknike e zyrtare për të organizuar mbledhjet e konferencat, etj.

Faktorët psikologjikë që motivojnë njerëzit të marrin pjesë në një udhëtim janë:

- 1- Eksperienca kulturore
- 2- Koha e lirë
- 3- Vlerat personale
- 4- Kontakte sociale
- 5- Prirjet sociale

Faktorët sociologjikë që motivojnë njerëzit të marrin pjesë në një udhëtim janë:

1. Tradita
2. Kultura
3. Klasa sociale
4. Referenca e grupit
5. E kaluara sociologjike

Arsye të tjera si rritja e hapësirës së kohës së lirë, niveli i të ardhurave, programi i transportit, bëjnë të mundur ekzistencën e motiveve për kërkimin e kontaktit të njerëzve me natyrën, zbavitjen, udhëtimin, etj. Ngjarjet e ndryshme që mund të ndodhin si psh, festivalet, festa të ndryshme, olimpiada, si dhe kurioziteti i njerëzve për të njohur ato vende të cilat kanë qenë të mbyllura ndaj shteteve të tjera, përbëjnë edhe disa arsye të ekzistencës së tyre .

Raporti i turizmit dhe kulturës masive.

Turizmi masiv, si mbartës i kulturës masive, paraqet një fakt që ndërhyt në çdo nivel të kulturës tradicionale, duke krijuar kështu edhe thyerje të

papritura. Nga njëra anë turizmi mund të jetë një faktor ndryshimesh, rritjeje, me shkëmbime pozitive nga të gjithë aktorët, por nga ana tjetër, është baza e marrëdhënieve negative e të ngarkuara nga konflikte (kolonizimi turistik, efekti qytet, etj.)¹⁷. Tendencat negative lidhen me dyndjet e mëdha të klientelës turistike në zona të caktuara, duke i kthyer këto të fundit në zona të marginalizuara, sidomos në zonat metropolitane.

Turizmi kulturor shihet si një formulë alternative për turizmin.

Nuk mund të bëhet kultura vetëm duke folur për kulturën, sepse kultura si dëshmi, njohje, pjesëmarrje, dije, imagjinate, trashëgimi qytetare e civile, gjuhe, forme, bukuri, mister, dashuri – është një dimension i shkëlqyer i shpirtit për të krijuar pa ndërprerje¹⁸.

Turizmi kulturor është një perspektivë reale, e gjallë dhe e gatshme për të entuziazmuar këdo. Të bësh turizëm kulturor do të thotë të krijosh kushtet për një drejtim konkret me realitetin që lëviz, me jetën, mendimet, dëshirat e një komuniteti të gjallë në historinë e tij të të gjitha kohërave. Në fund të fundit, kjo do të thotë: Bëj turizëm atje ku prodhohet kulturë¹⁹.

Në kuadrin e turizmit masiv, një psikologji masive e përgjithësimit sjell humbje të vlerësimit real të kulturës së një vendi. Është tipike e *sjelljes së turistëve*, që duke vizituar vetëm një lokalitet turistik të panjohur më parë e identifikojnë atë me gjithë vendin, p.sh. nëse dikush ka vizituar Venecian, thotë që e njej Italinë, etj. Por, kjo është në fakt një sjellje jo e përshtatshme, nga pikpamja e vlerësimeve sociologjike dhe shënon humbje në vlerësimin e kulturës së një vendi. Kjo sjellje deformat perceptimin e individit për imazhin e zonës që viziton, por edhe imazhin e të tjerëve që kontaktojnë opinionet e tij për zonën e vizituar, pasi përgjithësimet vendosen mbi baza të gabuara. Momenti i të bërit të turizmit duhet të jetë i orientuar drejt një *personalizimi masiv*, ku mund të kuptohen edhe momentet kulturore, edhe motivacionet bazë të të bërit turizëm, duhet të jetë një moment personal dhe i pjesëmarrjes aktive në të njëjtën kohë²⁰.

Impakti i turizmit mbi kulturën është vështirë të vlerësohet. Kërkesa turistike mund të sjellë të mira, osë të këqija, mbrojtjen ose prishjen e formave të artit lokal, ose zakoneve. Ana pozitive qëndron në faktin se artistët vendas, muzikantët ose individë të tjerë që merren me art, janë të aftë të lidhin

17 Këto janë rezultate të punës kërkimore të antropologeve amerikane në fushën e turizmit, por janë pranuar edhe nga studiues e antropologje në vende të tjera.

18 Koçollari, N. *Psiko-sociologjia e turizmit*, Triptik, Vlore, 2005, fq.127.

19 Rossi, G., *Storia e psico-sociologia del turismo*, San Marco, Bergamo, Italia, 1994, fq.141.

20 Savelli A., *Sociologjia del turismo*, Franco Angeli, Milano, 1996, fq. 270

mjeshtërinë e tyre me pushimet, duke ndihmuar kështu mbajtjen gjallë të artit dhe kulturës së një vendi. Kjo tendencë e artistëve të punësuar, mund të orientojë interes të përsëritur të rezidentëve ndaj trashëgimisë kulturore të tyre.

Ana negative qëndron në faktin se, duke shitur ose duke kryer me pagesë, sipas një rregulli atë çfarë më parë përbënte një traditë ceremoniale të përjetshme, mund të shkatërrohen vlera, pjesë të kulturës dhe respektit të banorëve lokale për format e artit dhe traditat. Disa sociologë mendojnë se turizmi nuk është gjë tjetër, veçse një përplasje e kulturave dhe e vlerave - fillimi i një konfrontimi direkt midis njerëzve me forma sociale dhe vlera mjaft të ndryshme.

Interpretimi kulturor i zonës, është një mënyrë për të zbutur impaktet negative të turizmit mbi kulturën e rajonit pritës. Një prej objektivave kryesore të interpretimit kulturor, është të ndihmojë vizitorët të jenë të ndërgjegjshëm në vlerësimin dhe kuptimin e kulturës së njerëzve të zonës që ata vizitojnë. Përpara se të arrihet kjo, duhet që banorët të dinë gjithçka rreth vlerave kulturore që zotëron vendi ku ata jetojnë. Pra, qëllimi kryesor i interpretimit kulturor të vendit, është të lidhë njerëzit me qytetet, historinë e tyre dhe informacione të tjera rreth zonës, për t'i transmetuar këto pastaj tek vizitorët dhe turistët.

Informimi sa më i mirë i vizitorit rreth një vendi dhe popullsisë së tij, do të ndikojë në respektin ndaj popullsisë vendase. Interpretimi kulturor gjithashtu, krijon më shumë eksperiencë për vizitorët dhe ndihmon ata të dallojnë një destinacion nga një tjetër. Ndërsa për banorët, interpretimi kulturor e zgjeron më shumë arsyetimin për mbrojtjen e integritetit kulturor të zonës. Për këtë luan një rol të rëndësishëm reklama turistike, e cila mund të realizohet nga mediat, shoqatat, operatorët turistikë, etj.

Mikpritja dhe kultura janë zemra e industrisë së turizmit. Sidoqoftë aktiviteti shlodhës, edukues, historik, i lidhur me biznesin, ose thjesht pushim, mikpritja dhe kultura lokale, ose do ta hartojnë, ose do ta shkatërrojnë programimin e komunitetit.

Vizitorët duhet të ndihen të mirëpritur në të gjitha aktivitetet. Shumë komunitete ofrojnë programe të veçanta për punonjësit e çdo biznesi që kanë kontakte të shpeshta me vizitorët. Komunitete të tjera, zbatojnë programe të veçanta të informimit publik, për të bindur banorët e zonës mbi rëndësinë e turizmit në komunitet.

Komuniteti ka nevojë të dijë se cili prej aktiviteteve të tij kënaq më shumë vizitorët. Kjo është shumë e rëndësishme në nxitjen e programit të

përshtatshëm për vizitorët. Një nga metodat më efektive në mbledhjen e këtij informacioni është *intervistimi i vizitorëve*. Intervista nuk ka nevojë të jetë një proces zyrtar. Një pyetje e sjellshme rreth preferencave për t'u zbavitur, aktiviteteve të shlodhjes, tregon se kujdesemi për interesat e vizitorëve dhe siguron një informacion të mjaftueshëm për një planifikim të ardhshëm. Kur turistët hyjnë në vendin pritës sjellin tipe të ndryshme zakonesh që ndikojnë në vlerat dhe mënyrën e sjelljes së popullsisë vendase. Për këtë arsye, turizmi është një ngjarje "sociale", e cila sjell një ndryshim strukturor në të gjithë sektorët e shoqërisë.

Disa herë përdoren evenimente të veçanta për të tërhequr vizitorët gjatë sezonit turistik. Këto mund të jenë fesetivale lidhur me kulturën e zonës, ose evenimente të tjera që kanë lidhje të veçantë me zonën. Këto evenimente bëjnë të mundur nxitjen e interesit për vizitorë të ndryshëm.

Gjatë sezonit turistik popullsia vendase jo vetëm duhet të pranojë efektet e mbipopullimit që nuk ekziston për pjesën tjetër të vitit, por ata shpesh duhet të modifikojnë mënyrën e tyre të jetës, pasi jetojnë dhe janë në kontakt me të afërt me një tip të ndryshëm të popullsisë. Megjithatë, kjo "bashkëjetesë», jo gjithmonë është e lehtë dhe shpesh udhëheq tensione sociale në shumë zona turistike, ose atje ku popullsia për arsye sociale, kulturore, psikologjike nuk është e gatshme të përballojë këtë invazion turistik. Pra, ekziston një konflikt midis mentalitetit arkaik rural dhe shoqërisë së industrializuar. Ky konflikt është mjaft i pranishëm edhe në vendin tonë. Disa banorë shfaqin karshi turistëve refuzim në forma dhe mënyra të ndryshme. Ata ruajnë një sens indiference, gjë që sjell si pasojë që turistët të mbeten gjithnjë njerëz të zakonshëm, të mërzitshëm, që sjellin një disekuilibër në jetën e përditshme të banorëve. Janë këto qëndrime të veçanta që bashkëjetojnë me fenomenin turistik dhe që sjellin aspekte negative dhe injorim të tij. Po kështu, këto qëndrime mund të vijnë edhe nga gjendja jo e mirë ekonomike e zonës. Mjaft turistë, duke iu referuar shpenzimeve të larta, krijojnë një qëndrim superioriteti dhe distance me banorët vendas, mirëpo kjo bën që banorët e disa zonave turistike të reagojnë në mbrojtje të dinjitetit personal të fyer. Pra, tek banorët mund të lindë një formë e poshtërimit psikologjik me efekte të ndjeshme negative për vetë personalitetin e tyre, nostalgjitë, për të shkuarën. Disa banorë jetojnë në një lloj ankthi të veçantë për degradimin e zakoneve të vendit dhe më tepër kjo ndjehet tek të moshuarit të cilët shprehen se "në kohën tonë nuk ishte kështu". Shumë zona me fillimin e turizmit të masës, kanë humbur karakterin e vet, origjinalitetin kulturor, tradita, zakone, folklorin etj. Në fakt ka diçka të vërtetë nga pikpamja e bazave historike, kulturore të traditës, zakoneve, të cilat

i janë nënshtruar traditave të tjera, kushtëzuar kjo, nga konsumi i traditave dhe zakoneve të turistëve, nga shkalla e konceptimit të ndryshimeve.

Pavarësisht nga disa impakte negative të trashëguara në kulturën e një vendi, ajo në pjesën më të madhe, dallohet për ndikimin pozitiv. Turistët e huaj i tërheq mjaft kultura dhe historia e vendit tonë, veshjet tradicionale, vallet folklorike, organizimi i festivaleve folklorike, kuzhina, punimet artizanale të traditës, etj. Mund të përmendim punimet artizanale që përbëjnë konsum jo vetëm për tregun e brendshëm, por edhe për tregun turistik. Në zona turistike si Berat, Shkodër, Lezhë, Korçë, Gjirokastrë, Krujë etj, është zhvilluar prodhimi artizanal si formë e një tregëtie të vogël, por me rëndësi të madhe për familjen dhe zonën. Pjesa më e madhe e suvenireve ka funksione praktike dhe dekorative, sidomos prodhimet e tekstileve (pëlhura, çanta, këpucë, përpunimi i arit e argjendit, bakrit, drurit, gjithashtu dhe i materialeve plastike). Disa prej këtyre përpunimeve të arit, të argjendit, etj., janë ruajtur që nga antikiteti, më pas nga periudha e sundimit turk dhe kjo tërheq mjaft vëmendjen e turistëve. Dyqanet me prodhime artizanale, japin pamjen tipike të një stacioni turistik dhe ndikojnë në realizimin e strukturës së konsumit turistik.

Efektet atraktive të këtyre elementeve shfaqen në mënyrën e prezantimit dhe në përmbajtjen e tyre. Këto kanë për qëllim njohjen me jetën e një populli dhe specifikat e tij si dhe përmirësimin e konsumit të përgjithshëm turistik. P.sh., tek vallet tona popullore, vlera folklorike përqëndrohet në kompozicionin e tyre. Ato mund të duken edhe primitive, por si të rralla kërkohen në programet turistike. Kompozicionet janë të lidhura me strukturat dhe figurat artistike, si dhe me muzikën që përcillet. Në të shprehet e kaluara ekonomike, shoqërore dhe politike e popullit, e përcjellë me ngjyrën e peisazheve të vendit. E gjithë kjo, paraqet një mundësi për tërheqjen, sidomos nga aspekti i ruajtjes së fondit të tyre.

Nëpërmjet lëvizjes turistike në destinacinet turistike, mundësohet shkëmbimi kulturor midis vendit pritës dhe turistëve.

Turizmi kulturor ndikon në gërshetimin e kulturave, zakoneve, traditave midis popullsisë vendase dhe turistëve. Ajo ndikon edhe në krijimin e një atmosfere tolerante mes njerëzve me prejardhje e etni të ndryshme sociale. Funksioni kulturor i turizmit, përmban edhe elemente edukative që shprehen në turizmin rinor dhe në atë të fëmijëve, të cilët zgjerojnë njohuritë rreth kulturave të popujve të ndryshëm.

Me krijimin e raporteve të ndryshme sociale, ka rëndësi formimi i mentalitetit dhe i kulturës turistike tek popullsia. Pra, turizmi bën të mundur

afrimin e njerëzve, krijimin e lidhjeve të miqësisë dhe zhdukjen e mosbesimit reciprok.

Ushtrimi i ndikimeve pozitive të turizmit pasqyrohet edhe në zhvillimin e ndjenjave patriotike ndaj vendeve fqinje, apo më gjerë. Njohja e viseve të ndryshme të botës, vlerësimet antropologjike e sociologjike, zgjojnë ndjenjën për bashkëjetesë njerëzore të përbotshme, pa marre parasysh ndryshimet e sistemeve politike.

Tablo e impakteve pozitive dhe negative kulturore e sociale të turizmit

Impaktet pozitive:

1. Mundësia e punësimit
2. Rritje e të ardhurave
3. Rritje e standartit të jetesës
4. Përmirësimi i strukturave ekonomike
5. Përmirësimi i shoqërive bujqësore dhe urbane
6. Ndikimi në tregtinë lokale
7. Ndikimi në artizanat
8. Ndikimi në gastronomi
9. Njohje më e mirë e historisë, kulturës
10. Mirëmbajtja e veprave të artit
11. Mikpritje për të huajt

Impaktet negative:

1. Karakteri stinor i turizmit
2. Spekulum në territore
3. Inflacion, rrjedhje e turizmit (kur oferta nuk i përgjigjet kërkesës turistike).
4. Modele të tepruara konsumi
5. Interes i ulët i investimeve turistike
6. Importimi i drejtuesve të turizmit
7. Inflacioni
8. Mbipopullimi
9. Droga
10. Kriminaliteti
11. Alkoolizmi
12. Erozioni i gjuhës

Në çdo rast shteti është ai që jep sigurinë e turizmit. Kjo do të thotë se ai zhvillon politika të tilla kombëtare që i japin sigurinë turizmit dhe turistëve, që identifikojnë dhe mbrojnë komunitetet e destinuara për turizëm dhe aktivizon median për ta promovuar këtë rol siguries. Elemente të politikave të sigurisë së turizmit janë pasja e paketave ligjore që tregojnë procedura e kompetenca në këtë drejtim, policia e turistëve, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e mjedisit, etj. Me kalimin e kohës njerëzit ndryshojnë, qëndrimet e grupeve ndryshojnë dhe popullsia ndryshon. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në interesimin e njerëzve për të udhëtuar, pra mund të themi që interesi për udhëtimin, gjithashtu ndryshon. Ngjarje të ndryshme priren të fokusojnë vëmendjen publike mbi vende apo rajone të veçanta të botës, duke rritur interesin dhe dëshirën për t'i vizituar ato. Mund të themi që edhe cikli i jetës dhe struktura e familjes ndikon në udhëtimet. Kështu, prezenca e fëmijëve të vegjël në familje, modifikon vendimmarrjen për të udhëtuar.

Të ardhurat ndikojnë në realizimin e udhëtimeve. Të ardhurat dhe edukimi janë të lidhura. Edukimi sjell rritjen e interesit të njerëzve dhe stimulimet e tyre për udhëtimin.

Turizmi shpesh lehtëson një ndryshim në sjelljen e ashpër që ekziston në disa vende kundrejt disa të tjerave. Ndërveprimi midis vendasve dhe miqve mund të thyejë stereotipet e bazuara në një dimension të vetëm. Kur një vizitor arrin të njohë personalisht njerëzit, është në dijeni të problemeve dhe shpreson të gjejë mënyrat e sjelljes që do ta kënaqë më shumë. Ky vizitor, bëhet më shumë i ndjeshëm ndaj çështjeve humane në përgjithësi. Disa probleme janë shpesh të rrënjosuara në problemet ekonomike si papunësia. Turizmi mund të ndihmojë në ekonominë e vendit, si dhe të eliminojë vështirësi të tilla sociale.

E DREJTA PER TU INFORMUAR DHE INTERESI PUBLIK

Loreta TOZAJ (ALUSHI)

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Eriola CAKRANI (HOXHA)

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

ABSTRACT

There are a lot of academic discussions about the question regarding globalization as a real artifact (myth) or just a real phenomenon. Even though the term in question is wide spread, many authors claim that features dedicated to globalization are mentioned even earlier in different history periods. The economic dimension of the globalization has without a doubt an extreme importance and is a cause and a driving force for the other globalization processes in other areas of interest. Some authors mention that country (state) boundaries, in real sense are far from being built and the process of globalization probably will not even happen, keeping in mind that during the whole human history internationalism has never been adapted to real globalism. (EU is still trying to prove its case). Other authors say that we are going through a planetary phase of civilization; the form and the exact character of the global society is getting contested and this will be determined from the choices that we are going to make in the upcoming critical decades.

Keywords: European Union, Albania, democracy, institution, community, transition

Hyrje

Në një vështrim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, do të të vëmë re që e drejta e informimit,

për vetë rëndësinë e saj renditet në kategorinë e lirive dhe të drejtave vejtake, menjëherë pas të drejtës së jetës dhe lirisë së shtypit dhe mjeteve elektronike. Në një demokraci politike efektive e cila respekton të drejtat e njeriut, e drejta për t'u informuar nuk mbart rëndësi vetëm në vetvete, por gjithashtu luan një rol qëndror në mbrojtjen e të drejtave të tjera. Nuk ka vend të lirë, nuk ka demokraci pa pasur një garantim të gjërë të së drejtës për t'u informuar. Në shumë demokraci në zhvillim si në Shqipëri, njohja formale e të drejtës së informimit nuk është transmetuar gjithmonë dhe domosdoshmërisht në jetën e përditshme për qytetarët, kjo për shkak të mungesës së zbatueshmërisë. Që nga viti 1999 Shqipëria ka dhe po përpiqet efektivisht të vëre në zbatim ligjin e lirisë së informacionit. Zbatimi i ligjit konsiston mbi të gjitha në kryerjen e detyrës për të transformuar procedurën e veprimtimit dhe të funksionimit në administratë nga ajo e vendeve me një pushtet të centralizuar në atë me pushtet të decentralizuar, pra në aplikimin e programeve demokratike për garantimin e të drejtës për informim. Vetë ligji është vetëm hapi i parë dhe zbatimi i tij duke mbajtur parasysh detyrën e transformimit të kulturës së administratës në një kulturë më demokratike dhe të qëndrueshme përmban një ndryshim të madh, veçanërisht në vendet me ekonomi të rrënuar ku buxhetet e shtetit për zbatimin e një programi bashkohor janë të kufizuara.

Liria e informimit

Liria e informimit karakterizohet nga dualiteti i saj pasi shikohet si një përfitim nga të dyja palët si nga ata të cilët e "transmetojnë informacionin" ashtu edhe nga ata që e "marrin atë" .

Shkëmbimi i informacionit në një shoqëri është oksigjeni i demokracisë. Nëse njerëzit nuk e dinë se çfarë është duke ndodhur në shoqërinë e tyre, nëse veprimet e atyre që i qeverisin janë të fshehura atëherë ata nuk mund të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në mënyrë të kuptueshme në mbarëvajtjen e kësaj shoqërie. Për këtë arsye është e nevojshme që standartet ndërkombëtare të parashikuara në një sërë aktesh ndërkombëtare që nga Deklarata e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Deklarata e Këshillit të Evropës Mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Informimit, Deklarata e Përbashkët për Mekanizmat Ndërkombëtarë të Nxjitjes së Lirisë së Shprehjes etj, të mund të përcaktojnë rrugën e legjislacionit kombëtar, parimet dhe rregullat të cilat i japin kuptim të drejtës së informimit dhe parashikojnë kushtet për zbatimin e plotë të kësaj lirie.

Pikërisht në zbatim të këtyre standarteve ndërkombëtare, e drejta e informimit si një e drejtë vetjake e patjetërsueshme i takon çdo individ. Kjo është ndoshta gjëja e parë që çdo njeri i vjen ndërmend kur dëgjon fjalët “liri e informimit”. Qeveritë, institucionet e tjera shtetërore, publike dhe kompanitë e mëdha tregtare kanë informacione për çdo njeri në vend. Ky informacion renditet si informacioni më i thjeshtë, si p.sh datëlindja, vendbanimi, statusi civil etj. Sasia dhe kompleksiteti i informacionit që është ruajtur, është rritur me zhvillim dhe përdorimin e teknologjisë. Në veçanti, kompjuterizimi i sistemit të qeverive dhe të kompanive bën më të lehtë shkëmbimin e informacionit midis enteve të ndryshme. Nuk ka asgjë të keqe në lidhje me informacionet vetjake të mbajtura nga qeveria. Nëse ata nuk do kishin informacione, ata nuk do të mund të kryenin shërbimet që populli pret prej tyre. Po kështu nuk do të mund të realizonin të drejtat e popullit. Për shembull, populli mund të jetë shumë i zhgënjyer kur shkon për të ushtruar të drejtën aktive të votës në zgjedhje dhe nuk mundet vetëm sepse autoriteti elektoral nuk disponon dokumentacioni përkatës për ta.

E njëjta gjë do të ndodhte kur një qytetar do të shqetësohej nëse një prej bankave të nivelit të dytë ku ai ka depozituar të hollat e veta nuk do të kishte gjendjen e llogarisë, kur ai ka provuar të tërheqë të holla jashtë saj.

Për një institucion, mbajtja e informacioneve individuale është pjesë normale e mënyrës së të vepruarit të shoqërisë. Pikërisht për këtë individët duhet të kenë mundësinë të njihen dhe të korrigojnë informacionin e pasaktë në lidhje me ta. Edhe nëse ata nuk e kanë mundësinë për të parë informacionin, ata e ruajnë të drejtën themelore për t’u njohur me këto informacione. Në Dokumentat Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut ashtu si edhe në shumicën e ligjeve të brendshme, individit ka të drejtën e mbrojtjes së jetës private. E drejta e informimit është një nga mënyrat ku fillon sigurimi dhe respektimi i jetës private të çdo individit.

Liria e informimit është përgjegjshmëri dhe informacioni i mbajtur nga qeveria, është informacion public dhe qeveria është vetëm një përdorues i këtij informacioni mbi një bazë të përkohshme. Informacioni rreth qeverisë është themelor nëse publiku është për të bërë një zgjedhje, siç janë zgjedhjet elektorale, por gjithashtu edhe në shumë situata të tjera ku ata mund të ushtrorjnë të drejtat e tyre si qytetarë.

1.1 E drejta e informimit që mund të përftojë individët

Qeveritë dhe institucionet shtetërore e publike ruajnë dhe mbajnë në sistemin e tyre të të dhënave informacione që tashmë nuk mund të klasifikohen si të dhëna personale, që kanë lidhje direkte me një individ të vetëm, por përfshijnë interesat e të gjithë individëve si anëtarë të shoqërisë. Informacionet që mbajnë institucionet qeverisëse, që prekin individët mund të ndahen në këto kategori: Politikat; Mirëqënia sociale; Shëndeti; Arsimi; Mjedisi; Planifikimi i investimeve; Sigurimi dhe Drejtësia

Në të gjitha këto fusha të përmendura më sipër qytetari ka lidhje të drejtpërdrejtë dhe të veçantë për çështje të cilat i takojnë. Në qoftë se qytetari nuk do të ketë informacionin e përshtatshëm se çfarë është duke bërë pushteti ekzekutiv në këto fusha, atëherë nuk do të jetë i aftë të ushtrojë plotësisht këto të drejta.

Publiku ka të drejtën për të ditur se çfarë bëhet në parlament, në mënyrë që të dijë se si do të votë në zgjedhjet e ardhshme. Ka disa detyra që kryejnë parlamentarët, për të cilat është mjaft e rëndësishme që qytetarët të jenë të mirinformuar. Puna kryesore e parlamentarëve është të miratojnë ligjet, por ata gjithashtu luajnë një rol kryesor në rishikimin e politikave qeveritare, edhe nëpërmjet debateve ose shumë shpesh përmes komisioneve të specialistëve që ekzaminon çështjet e politikave më kryesore.

Publiku ka po ashtu të drejtën për të ditur se çfarë bëhet me drejtësinë duke bërë të sigurt që sistemi gjyqësor të jetë duke operuar me korrektësi. Sigurisht një nga arsyet kryesore që është edhe më e rëndësishmja, është që ky informim jep një garanci të madhe për dikë që akuzohet për një vepër penale dhe e siguron që ai të ketë mundësi të gjykohet me korrektësi.

E drejta për të ditur çfarë bëhet me institucionet e tjera publike, të cilat marrin vazhdimisht vendime të cilat ndikojnë në jetën e gjithësecilit. "Qeveria" nuk i referohet vetëm kryeministrit dhe ministrave. Nga dita në ditë, koncepti i qeverisjes nënkupton një numër më të madh institucioneve dhe komitetesh vendimmarrëse brenda institucioneve të cilat marrin vendime dhe kryejnë veprime, që zbatojnë politikën ose ligjet. Kur ka një interes të madh publik në atë se çfarë ndodh në parlament apo në gjykatë, këto institucione marrin vendime të rëndësishme

E drejta e medias për informim zyrtar për të vetmin fakt që shumë njerëz nuk e ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e informimit në mënyrë direkte dhe individuale. Shumica e njerëzve nuk shkojnë në parlament apo në gjykatë

për të marrë informacion. Po ashtu ata pak qytetarë që shkojnë përpiqen të marrin dokumenta apo informacione të mbajtura nga qeveria. Por pjesa më e madhe e publikut në shumicën e rasteve përdor masmedian, shtypin e shkruar, radion, televizionin dhe çdo ditë e më shumë internetin. Publiku pret një shumëllojshmëri gjërash të ndryshme nga media. Shumicën e kohës ata e shikojnë median për zbavitje. Por gjithashtu ata presin që media t'u ofrojë atyre informacion për gjërat më të rëndësishme që kanë ndodhur në shoqëri. Nëse është miratuar ndonjë ligj i ri apo ka ndonjë çështje të rëndësishme në gjykatë, nëse është marrë ndonjë vendim i rëndësishëm mbi politikën ekonomike etj.

Është e rëndësishme që media të jetë në gjendje të përdorë ligjin "Për të drejtën e informimit" për të informuar vetveten, në mënyrë që të mbajë të mirëinformuar edhe publikun.

E drejta për vërtetësinë rreth dhunimit të të drejtave të njeriut. Veçanërisht në shoqëritë që janë në tranzicion nga sistemet politike autoritare ose janë të dala nga konfliktet, ekziston një nevojë e madhe për informimin rreth dhunimit të të drejtave të njeriut në të kaluarën. Qeveritë mund të jenë të stepura për të dhënë këtë informacion ose për të hetuar dhunimin e të drejtave të njeriut në të kaluarën, duke argumentuar që "pajtimi" është një prioritet më i madh se sa drejtësia ose zbulimi i informacionit. Ende nuk ka asnjë dyshim që ligji ndërkombëtar i jep çdonjerit që ka qënë viktimë e krimit të drejtën të gjykojë përmes sistemit ligjor, Zyrtarët publikë duhet të japin llogari për çdo dhunim të të drejtave të njeriut që ata kanë bërë. Por, kjo gjithashtu nënkupton edhe që populli ka të drejtë të informohet rreth ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë qeverive të mëparshme apo gjatë konflikteve edhe pse informacioni mund të jetë i papërshtatshëm politikisht.

1.2 Të mirat e lirisë së informimit

Kur disa institucione të rëndësishme argumentojnë se është më mirë për të mbajtur të rezervuar nga publiku një kategori informacionesh, zakonisht thonë që kjo është "për të mirën tuaj". Në realitet argumenta të tillë mund të shfaqen të gabuar. Ideja që qeveritë mbajnë informacion, sepse kjo i shërben të mirës së publikut është një pikëpamje antidemokratike e marrëdhënieve midis saj dhe popullit. Argumenti kryesor në favor të lirisë së informimit është që ai nuk i përket qeverisë por popullit si i tërë dhe shfrytëzimi i kesaj të drejte nga publiku do të conte në *më pak korrupsion*. Individët dhe institucionet bëhen të korruptuar kur nuk ka vëzhgim të asaj çfarë bëjnë. Sa më shumë që ata të

veprojnë nën vëzhgimin e rreptë të publikut aq më pak të korruptuar janë dhe aq më shumë eficientë.

Mungesa e urisë mund të duket si diçka e çuditshme të vendoset në këtë listë. Fituesi i çmimit Nobel, ekonomisti Amartya Sen ka argumentuar se “mungesa e ushqimit nuk ndodh në ato vende me shtyp të lirë, por nga mosveprimi i qeverive. Qeveritë nuk guxojnë të jenë joaktive në një çështje kaq të rëndësishme kur ata janë subjekt i vëzhgimit konstant të mediave

Një shoqëri më e shëndetshme. Edhe kjo mund të duket si diçka e çuditshme që të përfitojë nga liria e informimit. Duke e konsideruar si krizën më të madhe të shëndetit public të kohëve tona, HIV_AIDS, që është përhapur kudo. Në vitet e para, infeksioni I HIV ishte i aftë të shpërndahej me shpejtësi, pasi mungonte informacioni public rreth virusit dhe mënyrës se si të evitohet ai. Vendet që kishin programe efektive informimi për publikun kanë qënë të afta të kthejnë drejtimin e infektimit me hiv

Një ambient më i pastër sepse shumica e vendimeve që i shkaktojnë dëme ambientit merren me dyer të mbyllura. Shumica e këtyre vendimeve, mund edhe të evitoheshin, në qoftëse vendimet që merren kishin për t’u shoqëruar me një studim mbi impaktin në ambient, i cili duhet të bëhet i vlefshëm për publikun

Respektimi i të drejtave të njeriut. Disa nga dhunimet më të rënda të të drejtave të njeriut, të tilla si tortura janë gjithmonë diçka që zënë vend vetëm pas mbylljes së derës. Një qeveri e hapur duke përfshirë për shembull publikimin e hetimeve sipas dëshmimeve të dhunimit të të drejtave të njeriut është më shumë e prirur për të patur rezultate në respektimin e këtyre të drejtave.

Respektimi i jetës private. Pa lirinë e informimit nuk ka asgjë që të garanton që qeveritë dhe institucionet e tjera të saj nuk do të grumbullojnë sasi të mëdha informacioni rreth individëve. Nëqoftëse individët kanë gjithmonë të drejtë të shikojnë se çfarë informacioni është mbajtur rreth tyre, e drejta për privatësi ka më shumë mundësi të respektohet. Në këtë kuptim njerëzit kanë të drejtën të sigurohen që informacioni i mbajtur për ta është i saktë. Nëse ai nuk është i tillë, mund të merren vendime të gabuara dhe të dëmshme.

Një shoqëri më e sigurtë. Argumenti në favor të sekretit zyrtar është pikërisht nevoja për mbrojtjen e “sigurisë kombëtare”. Ekzaminimi public i vendimeve të lidhura me mbrojtjen është i nevojshëm për një shoqëri më të sigurt. Fshehtësia drejton korrupsionin dhe bën joeficientë shërbimet secrete.

Demokraci më efektive. Liria e informimit është vendimtare për një demokraci efektive. Liderat politikë kanë më shumë mundësi të veprojnë në mbështetje me dëshirat e elektoratit, nëse ata e dinë që veprimet e tyre mund të merren në konsultime të hollësishme me publikun.

Liria e informimit si pjesëmarrje. Në demokraci, vendimet e rëndësishme qeveritare merren nga institucionet e zgjedhura. Nëse qeveria ka një sjellje të hapur, me publikimin e dokumenteve dhe me takime të hapura të publikut, këto në interesin e çështjes së përgjithshme mund t'i quajmë vendimmarrje. Atëhere kur ka një vendim planifikimi local, praktika më e mirë për zyrtarët është të presin komente dhe pjesëmarrjen e publikut nga persona të cilët kanë njohuri të veçanta në çështjen në fjalë.

Parime të lirisë së informimit

Për të vendosur një standart me të cilin cilido të mund të masë nëse ligjet vendase e lejojnë në mënyrë të mirëfilltë mundësinë ndaj informacionit zyrtar janë përcaktuar qartë dhe saktë rrugët në të cilat qeveritë mund të arrijnë hapje maksimale në përputhje me standartet më të mira ndërkombëtare. Parime si hapje maksimale; detyrimi për të botuar; nxitja e qeverisjes së hapur; shtrirja e kufizuar e përjashtimeve; procese për lehtësimin e aksesit; kostot; takime të hapura; ekspozimi ka përparësi; mbrojtja për individët që japin informacion, përcaktojnë standarte për regjime kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat i japin kuptim të drejtës së lirisë së informacionit.

Hapje maksimale. Ky parim vendos një supozim që i gjithë informacioni i mbajtur nga organet publike duhet t'i nënshtrohet hapjes dhe se ky supozim mund të tejkalohet vetëm në rrethana shumë të kufizuara. Institucionet publike kanë detyrimin të ekspozojnë informacion dhe çdo anëtar i publikut ka të drejtën korresponduese për informacion. Cilido që është i pranishëm në territorin e vendit duhet të përfitojë nga kjo e drejtë dhe ushtrimi i kësaj të drejte, nuk duhet të kërkojë nga individët që të tregojnë një interes të veçantë për informacionin. Atje ku një autoritet publik kërkon të mohojë aksesin ndaj informacionit, duhet të mbartë përgjegjësinë ligjore për të justifikuar refuzimin në çdo hap të procedurave.

“Informacioni” përfshin të gjitha të dhënat që mbahen nga një institucion publik, pavarësisht nga forma në të cilën arkivohet informacioni (dokument, kasetë, regjistrim elektronik etj), burimin e tij (nëse ka qënë prodhuar nga institucioni public apo nga ndonjë institucion tjetër) si dhe datën e prodhimit. Legjislacioni duhet të zbatohet mbi materialet që kanë qënë të justifikuara, duke ia nënshtruar ato të njëjtit test si dhe materialet e tjera.

Për qëllime të ekspozimit të informacionit, përkufizimi i “institucionit publik” duhet të përqëndrohet tek lloji i shërbimit që ofrohet sesa tek orientimet

formale. Për këtë qëllim duhet të përfshijë të gjitha degët dhe nivelet e qeverisjes duke përfshirë qeverinë lokale, institucionet e zgjedhura, institucionet që funksionojnë sipas një mandati statutor, institucionet juridike, institucionet private që kryejnë funksione publike. Organizatat ndër-qeveritare gjithashtu duhet t'i nënshtrohen rregullave të lirisë së informacionit mbi bazën e këtyre parimeve.

Për të ruajtur integritetin dhe disponibilitetin e arkivave ligji duhet të parashikojë që pengimi i aksesit ndaj materialeve ose shkatërrimi i qëllimshëm i tyre është një shkelje që përbën krim. Ligji duhet të përcaktojë standartet minimale lidhur me mirëmbajtjen dhe ruajtjen e materialeve arkivore nga institucionet publike

Detyrimi për të botuar. Liria e informacionit nënkupton jo vetëm që institucionet publike t'u pergjigjen kërkesave për informacion, por edhe që ato të botojnë dhe përhapin gjerësisht dokumentat me interes të rëndësishëm public duke iu nënshtuar vetëm kufijve të arsyeshëm mbi bazën e burimeve dhe kapacitetit. Institucionet publike duhet që minimumi të kenë detyrimin të botojnë kategoritë e mëposhtme të informacionit si:

informacion operativ mbi mënyrën si funksionon institucioni përfshi kostot, objektivat, llogaritë e miratuara, standartet, arritjet etj veçanërisht atje ku institucioni ofron shërbime të drejtpërdrejta për publikun; informacion mbi çfarëdo kërkesash, ankesash apo veprimesh të tjera të drejtpërdrejta që mund të ndërmarrin anëtarët e publikut në lidhje me institucionin public; udhëzime mbi proceset përmes të cilave anëtarët e publikut mund të ofrojnë idera e sugjerime për propozime mbi politikën madhore apo legjislativën; llojet e informacionit që mban institucioni si dhe formën në të cilën mbahet ky informacion; përmbajtjen e çfarëdo vendimi apo politike që ndikon mbi publikun përkrah arsyeve për vendimin dhe dokumentacionin me rëndësi për ndërtimin e vendimit

Nxitja e qeverisjes së hapur. Informimi i publikut për të drejtat e veta dhe nxitja e një kulture hapjeje brenda qeverisjes janë të domosdoshme nëse duam të arrihen synimet e legjislativës të lirisë së informacionit. Përvoja në vende të ndryshme tregon se një shërbim civil kokëfortë mund të minojë edhe legjislativën më të përparuar. Për rrjedhojë veprimtaritë promovuese janë një përbërës thelbësor i rregullave të lirisë së informacionit. Kjo është një fushë në të cilën veprimtaritë kalojnë nga një vend tek tjetri, në varësi të faktorëve të tillë si mënyra e organizimit të shërbimit civil, kufizimet kyçe ndaj ekspozimit të lirë të informacionit, nivelet e dijës si dhe shkalla e ndërjegjishmërisë të publikut të gjërë.

Shtrirja e kufizuar e përjashtimeve. Të gjitha kërkesat individuale për informacion nga institucionet publike duhet të plotësohen, në rast se institucioni public nuk mund të tregojë se informacioni futet brenda shtrirjes së rregullave të kufizuara mbi përjashtimet. Refuzimi për të ekspozuar informacion nuk quhet i justifikuar deri sa autoriteti publik të tregojë që informacioni përputhet me një test tri-piesësh:

- informacioni duhet të lidhet me një qëllim legjitim të rradhitur në ligj
- ekspozimi duhet të kërcënojë shkaktimin e dëmit thelbësor ndaj atij qëllimi,
- dëmi ndaj qëllimit duhet të jetë më i madh sesa interesi public për pasjen e informacionit.

Asnjë informacion public nuk duhet përjashtuar tërësisht nga shtrirja e ligjit edhe nëse shumica e funksioneve të tyre përfshihet në zonën e përjashtimeve. Kjo është e zbatueshme për të gjitha degët e qeverisë si dhe për të gjitha funksionet e qeverisë. Mosekspozimi i informacionit duhet justifikuar mbi bazën e çdo rasti. Në ligj duhet të përfshihet një listë e plotë e qëllimeve legjitime që mund të justifikojnë mos ekspozimin. Kjo listë duhet të përfshijë vetëm interesat që përbëjnë baza legjitime për refuzimin e ekspozimit të dokumentave dhe duhet kufizuar për çështje të tilla si zbatimi i ligjit, intimiteti, siguria kombëtare, konfidencialiteti tregtar, siguria publike a individuale si dhe efektshmëria dhe intregiteti i proceseve qeveritare të vendim-marrjes.

Nuk mjafton që informacioni thjesht të përfshihet brenda shtrirjes së një qëllimi legjitim të rradhitur në ligj. Informacioni publik duhet të tregojë që ekspozimi i informacionit do t'i shkaktonte dëm thelbësor atij qëllimi legjitim. Në disa raste, ekspozimi mund edhe t'i vlejë qëllimit edhe ta dëmtojë atë. Edhe nëse mund të tregohet që ekspozimi i informacionit do t'i shkaktonte dëm thelbësor një qëllimi legjitim, informacioni përsëri duhet ekspozuar nëse përfitimet e ekspozimit e tejkalojnë dëmin.

Procese për lehtësimin e aksesit. Procesi për të vendosur mbi kërkesat për informacion duhet specifikuar në tri nivele të ndryshme, brenda institucionit public, apelimi në një institucion të pavarur administrativ si dhe apelimet në gjykata. Atje ku është e nevojshme duhen marrë masa për sigurimin e aksesit të plotë ndaj informacionit për grupe të caktuara. Të gjitha institucioneve publike u duhet kërkuar të ngrenë sisteme të hapura, të arritshme, të brendshme me qëllim që të sigurohet e drejta e publikut për të marrë informacion. Në përgjithësi, institucionet duhet të caktojnë një individ i cili është përgjegjës për përpunimin e kërkesave të tilla dhe për sigurimin e respektimit të ligjit. Institucionet publike gjithashtu u duhet kërkuar të ndihmojnë aplikantët,

kërkesat e të cilëve lidhen me informacion të botuar dhe janë të paqarta, janë tejet të gjëra apo kanë nevojë për riformulim. Nga ana tjetër institucionet publike duhet të jenë në gjendje të refuzojnë kërkesa joserioze apo të bezdisshme dhe nuk duhet t'u ofrojnë individëve informacion që përfshihet në një botim, por në këto raste institucioni duhet ta drejtojë aplikantin tek burimi i botuar. Ligji duhet të parashikojë kufijë kohorë rigorozë për përpunimin e kërkesave dhe të kërkojë që çdo refuzim të jetë i shoqëruar nga arsye thelbësore të shkruara.

Kudo ku është praktikë duhet parashikuar një apelim i brendshëm tek një autoritet më i lartë brenda një autoriteti public i cili mund të rishikojë vendimin fillestar. Në të gjitha rastet, ligji duhet të parashikojë të drejtën e një individi për të apeluar në një institucion të pavarur administrativ refuzimin e një institucioni public për të ekspozuar informacion. Ky mund të jetë si një institucion ekzistues ose një i ngritur posaçërisht për këtë qëllim. Në cilindo rast, institucioni duhet të përmbushë standarte të caktuara dhe të ketë pushtete të caktuara. Pavarësia e tij duhet të jetë e garantuar si formalisht ashtu edhe përmes procesit me anë të të cilit emërohet kryetari dhe/ ose bordi. Institucionit demonstrativ i duhet dhënë pushtet i plotë për të hetuar çfarëdo apelimi, përfshi aftësinë për të detyruar dëshmitarët dhe ka rëndësi t'i kërkojë institucionit public t'i furnizojë çfarëdo informacioni apo dokumentacioni për shqyrtim. Me përfundimin e një hetimi, institucioni administrativ duhet të ketë pushtetin të kundërshtojë apelimin, t'i kërkojë institucionit publik të ekspozojë informacionin, të përshtasë çfarëdo detyrimesh të vendosura nga institucioni publik, të vendosë gjoba mbi institucionet publike për sjellje penguese atje ku është e justifikueshme dhe/ose të imponojë kostot që lidhen me apelimin mbi institucionet publike. Institucioni administrativ duhet të ketë pushtetin të çojë në gjykatë rastet kur zbulohen fakte pengesash kriminale për aksesin ndaj materialeve arkivore apo shkatërrimin e vullnetshëm të tyre. Si aplikanti ashtu edhe institucioni publik duhet të jenë në gjendje të apelojnë në gjykatë ndaj vendimeve të institucionit administrativ. Apelime të tilla duhet të përfshijnë pushtetin e plotë për të rishikuar çështjen me objektivitet dhe të mos kufizohen në çështjen nëse aktiviteti administrativ ka vepruar arsyeshëm apo jo.

Kostoja e marrjes së aksesit ndaj informacionit që mbahet prej institucioneve publike nuk duhet të jetë aq e lartë sa të pengojë aplikantët e mundshëm me kusht që i gjithë arsyetimi për ligjet e lirisë së informacionit është promovimi i aksesit të hapur ndaj informacionit. Në çdo rast përvoja në një numër vendesh sugjeron që kostot e aksesit nuk janë një mjet i efektshëm për balancimin e kostove të rregullave të lirisë së informacionit.

Takime të hapura. Liria e informacionit përfshin të drejtën e publikut për

të ditur se çfarë është duke bërë në emër të tij qeveria dhe të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes. Për rrjedhojë legjislacioni për lirinë e informacionit duhet të vendosë supozimin se të gjitha takimet e institucioneve qeverisëse janë të hapura për publikun. “Qeverisja në këtë kontekst i referohet në rradhë të parë ushtrimit të pushteteve vendimmarrëse me qëllim që të mos përfshihen institucionet që thjesht ofrojnë këshilla. Komitetet politike, takimet e anëtarëve të të njëjtës parti politike nuk konsiderohen të jenë institucione qeverisëse. Nga ana tjetër, takimet e institucioneve të zgjedhura dhe komitetet e tyre, bordet planifikuese dhe të zonave, bordet e autoriteteve publike dhe arsimore si dhe agjensitë publike të zhvillimit industrial duhet të përfshihen. Termi “takim” i referohet një takimi formal, përkatësisht mbledhja e një institucioni publik me qëllim zhvillimin e punëve publike. Faktorët që tregojnë se një takim është formal janë kërkesa për një numër të domosdoshëm anëtarësh dhe zbatueshmëria e rregullave procedurale. Njoftimet për takimet janë të nevojshme në mënyrë që publiku të ketë mundësi për të marrë pjesë dhe ligji duhet të kërkojë që njoftimet e përshtatshme për takimet të jepen duke lënë një kohë të mjaftueshme për të planifikuar pjesëmarrjen. Takimet duhet të jenë të mbyllura por vetëm në përputhje me procedura të përcaktuara dhe atje ku ekzistojnë arsye të mjaftueshme për mbylljen. Çfarëdo vendimi për ta bërë një takim të mbyllur, në vetvete duhet të jetë i hapur për publikun. Në rrethana të përshtatshme, arsyet për mbyllje mund të përfshijnë shëndetin dhe sigurinë publike, zbatimin e ligjit apo hetime, çështje të punonjësve apo të personelit, çështje tregtare dhe sigurinë kombëtare.

Dhënia e informacionit ka përparësi. Ligji mbi lirinë e informacionit duhet të kërkojë që legjislacione të tjera të interpretohen, deri në atë masë sa është e mundur në mënyrë konsistente me dispozitat e tij. Atje ku kjo nuk është e mundur, legjislacioni tjetër që trajton informacion të mbajtur publik duhet t’i nënshtrohet parimeve që nënvizojnë legjislacionin e lirisë së informacionit. Përjashtimet që parashikohen në ligjin për informacionin duhet të jenë të plota dhe nuk duhet lejuar që ato të zgjerohen nga ligje të tjera. Në veçanti, ligjet për sekretin nuk duhet ta quajnë të paligjshme kur zyrtarët nxjerrin informacion të cilin u kërkohet ta japin sipas ligjit për lirinë e informacionit. Gjithashtu, zyrtarët duhen mbrojtur nga sanksionet kur ata me arsye dhe mirëbesim, kanë dhënë informacion në përgjigje të një kërkesë. Përndryshe, kultura e sekretit e cila rrethon shumë institucione qeverisëse do të mbetet meqënëse zyrtarët mund të jenë tejet të kujdesshëm ndaj kërkesave për informacion me qëllim shmangien e ndonjë rreziku personal.

Mbrojtja e individëve që japin informacion mbi kundravajtjet. Individët

duhet të mbrohen nga ndonjë sanksion të karakterit ligjor, administrativ apo që lidhet me vendin e punës për shkak të informacionit mbi kundravajtjet. Termi “kundravajtje” përfshin kryerjen e një vepre penale, mospërmbushjen e një detyrimi ligjor, keqzbatimin e drejtësisë, korrupsionin apo pandershmërinë apo keqadministrimin serioz në lidhje me një institucion publik, kërcënim serioz ndaj shëndetit, sigurisë apo mjedisit pavarësisht nëse lidhet apo jo me një kundravajtje individuale. Mbrojtja duhet të ofrohet atje ku e kërkon interesi publik i cili do të përfshinte situatat ku perfitimet e ekspozimit tejkalojnë dëmin ose atje ku një mjet alternativ për nxjerrjen e informacionit është i nevojshëm për të mbrojtur një interes të rëndësishëm.

Bibliografia

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
 Deklarata e Këshillit të Evropës mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Informimit (1982)
 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
 Rekomandimi 2002(2) I Këshillit të Europës për Aksesin në Dokumenta Zyrtare
 Deklarata e Përbashkët për Mekanizmat Ndërkombëtare të Nxitjes së Lirisë së Shprehjes (2004)
 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
 Ligj nr 8503 datë 30.06.1999 “ Për të Drejtën e Informimit Për Dokumentat Zyrtare”
 Ligji nr.8475, date 12.5.1999 “Kodi i Procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”.
 Ligji nr 8517 datë 22.07.1999 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”
 Ligji numër 8454 datë 04.02.1999” Për Avokatin e Popullit”
 Dobjani Ermir “E drejta Administrative 1, Shtepia botuese “Luarasi”, Tirane 2001.
 Anastasi Aurela “e drejta Kushtetuese”, Shtepia botuese “Pegi” Tirane, 2004.
 Novicki Marek Antoni “Rreth Konventës Evropiane, Tiranë 2003
 Vendimi i Gjykatës Kushtetues nr .16, datë 11.11.2004
 Dobjani Ermir “E drejta për t’u informuar: Nevoja për përdorimin e ligjit në kuadrin e transparencës dhe qeverisjes efikase”. Tiranë, 2005/12/12.

ASPEKTET PSIKOSOCIALE TË KOMUNIKIMIT

Roland LAMI

Universiteti Europian i Tiranës

ABSTRACT

Based on theoretical perspective of some distinguishable authors in the field of sociology of communication, it will be intended to defend the hypothesis that non-communication between individuals or social groups during socializing processes produces problems related to psychosocial nature. Here, it is not the case that the actors of communication, such as "provider" and "recipient", face organic difficulties to capture or make their message accessible, but the fact that they do not understand the codes through which they transmit messages and the refore misunderstand the roles as a result of miscomprehending these messages. Exactly, this discrepancy between roles and codes of communication along the socialization process produces a state of "stagnation" of social conventions and confusion of roles. Analyzing the phenomenon in this perspective tends to contribute to the understanding of the Albanian context, as frequent demographic changes during last two decades, inside and outside the territory, have led to difficulties for some social groups or individuals to be integrated into new social realities. On one hand, this social movement has created a reality with subcultures that is manifested in socializing processes but, on the other hand, these groups face the dilemma to be socialized, and, at the same time, the need to be differentiated, discriminated and excluded. The perspective in question claims to contribute to the understanding of possible reasons that produce the difficulties and implications of psychological

Keywords: Typology, Identity, Code, Psychopathology, Autism.

Hyrje

Sipas Max Weber, në këndvështrimin sociologjik të botës dhe të njeriut në veçanti, një vend qëndror zë analiza e grupeve shoqërore. Nga këndvështrimi i autorit, ekzistojnë lidhje të dyfishta dhe të ndërsjellta midis individit dhe grupit shoqëror si dhe raporte të caktuara midis indentitetit grupor dhe formave të mendësive dhe të ndergjegjes shoqërore. Subjektiviteti kolektiv i jep identitetin çdo grupi shoqëror, dhe njëkohësisht, natyra e një grupi shoqëror i jep specifikat e veta të veçanta mendësive të individëve të ndryshëm .

Në gjykimin e tij, i njëjti grup shoqëror, por i shfaqur në kohë të ndryshme, në vende të ndryshme të hapësirës shoqërore, përmes historisë dhe jetëve të veçanta e formon identitetin e vet shoqërore në mënyra të ndryshme duke i'u përmbajtur kritereve të ndryshëm. Ai dallon në mënyrë të përsosur atë që është e rendit të qëllimeve dhe motivacioneve nga njëra anë dhe nga ana tjetër atë cfarë shkaktojnë në rrafshin shoqëror veprimet e ndërmarra nga individë. Jo në

Në këtë rast del në pah struktura e ç'rregulluar e lidhjeve funksionale midis aktorëve brenda familjes dhe jashtë saj duke prodhuar tensione të niveleve të ndryshme. Fakti i dobësimit dhe i thyrjeve të panumërta të lidhjeve familjare dhe shoqërore deri diku bëhet shkak që shoqëria të humbas ekulibrin e vet të brendshëm. Pikërishtë, prishja e këtij ekulibri krijon një tension që shfaqet në tre nivele; me veten, me tjetrin dhe grupin.

Nga kjo pikëpamje vlen të studiohen tipologjitë e grupeve shoqërore dhe shkalla e ndërveprimit në një kontekst shqiptarë me qëllim kuptimin e situatës dhe zbulimin e barrierave që mund të pengojnë zhvillimin normal të ndërveprimit ndërmjet tyre.

Një analizë e këtij dimensionit, merr një rëndësi të veçante në kontekstin shqiptar, për vetë faktin se në dy dekadat e fundit jemi përballur me një eksod rural të gjërë dhe masiv si dhe një përqëndrim demografik të konsiderueshëm në disa prej qyteteve kryesore të vendit. Sigurisht, ky mobilitet social ka mundësuar krijimin e një realitet multikultural që manifestohet gjatë proceseve socializuese. Pikërisht, këto aspekte manifestohen më mirë se kudo tjetër në kryeqytetin e Shqipërisë, i cili është "prekur" ndjeshëm nga lëvizjet migruese gjatë dy dekadave të fundit.

Tirana gjate kësaj periudhe është "pushtuar" nga popullsia rurale dhe periferike urbane. Për këtë qytet, viti 2005 personifikon më mirë se çdo vit tjetër këtë dinamizëm demografik. Bazuar në të dhëna zyrtare¹ rezulton se në këtë vit janë ngulur 46,024 banorë të ardhur nga vise malore e fushore jashtë këtij

1 Shih. Popullsia e Shqipërisë, INSTAT, Tirane, 2006

rrethi, kanë lëvizur brenda rrethit nga një vend në një tjetër 4,470 si dhe kanë dalë me banim jashtë rrethit 7,226 banorë. Kjo lëvizje “marramendëse” ardhje – largimesh ka ndodhur vetëm në një vit (2005) po në 20 vjet c’ sasi numerike lëvizjesh ka pasur?² Vlen të theksohet se një pasqyrë e detajuar e të dhënave për të gjithë periudhën postkomuniste është e paplotë për arsytet që tashmë janë të njohura. Pikërisht, për këtë fakt përzgjedhëm vitin 2005, si një nga vitet më të plota për sa i përket regjistrimit të lëvizjeve migruese. Por nuk mund të themi se ky vit është “piku” i lëvizjeve demografike, pasi është i njohur fakti se lëvizje të tilla me intesitet akoma më të madh kanë ndodhur midis viteve 1993 – 2000. Megjithatë, në këtë analizë nuk do të ndalemi në identifikimin e faktorëve që kanë projektuar luhatjen e kurbës së zhvendosjeve demografike nga një vit në tjetrin, por do të analizojmë aspektet psikosociale që prodhojnë të tilla realitete nga prespektiva e sociologjisë së komunikimit.

Duke u kthyer tek analiza, mund të nënvizojmë faktin se banorët e ardhur në kryeqytet janë me origjinë: 39% nga rajonet e veriut dhe 38% nga rajonet e Jugut.³ Pjesa më e madhe e tyre janë vendosur në zonat periferike të Tiranës dhe më konkretisht në njësitë 4 (zona rreth Alliasit), 6 (zona rreth Kombinatit), 11 (zona rreth Laprakës). Këto njësi, vleresohen nga pikëpamja zhvillimore si më të varfrat e rrethit të Tiranës. Një vleresim i tillë lidhet me një sërë faktorësh si: niveli i ulët i konsumit mesatar për banor, koeficienti i lartë i varfërisë së përgjithshme, niveli i lartë i papunësisë si dhe niveli i ulët i shkollimit.⁴ Kjo ka bërë të mundur që fqinjët nga pikëpamja territoriale të jenë aq të ngjashëm sa janë në tërësinë e zhvillimeve demo-ekonomike e sociale.⁵ Sigurisht, e gjithë kjo panoramë, mundëson përafrim identitetesh ndërmjet banorëve të sapoardhur por, njëkohësisht, krijon diferencë me autoktonët si pasojë e këtij indentiteti.

Shumë grupe shoqërore që dikur kanë qenë të detyruar të jetojnë në heshtje dhe në “cepat” e shoqërisë, në rrethanat e reja u lind nevoja të ripozicionohen në strukturën shoqërore. I gjithë ky proces për disa nuk është i lehtë, pasi i’u lind nevoja të përshtaten me realitete të reja social kulturore dhe njëkohësisht të ruajnë norma dhe traditat e përfituara nga e kaluar. Kjo dileme i vendos ata, siç i përshkruan me shumë realizëm akademiku Fuga (2000:212) në një pikë të ndërmjetme, midis fshatit dhe qytetit, midis jetës rurale dhe asaj urbane, midis të shkuarës dhe të sotmes, midis mbijetesës dhe mjerimit, midis personifikimit të vetvetes dhe kalimit në identitetin e një grupi tjetër. Për pasojë, kriteret morale

2 Shih. Popullsia e Shqipërisë, Prefektura e Tiranës, INSTAT, Tirane, 2005

3 M.Karaguni, B.Dumani, (2005) Tirana, relief demo – ekonomik e social, Torane: Iiar.

4 M. Karaguni, B. Dumani, (2009) Zhvillimet ne Tirane, refleksion mbi disa sfida, Revista Demografike, fq.89

5 Po aty

që frymëzojnë normat morale të shoqërisë, modelet e sjelljes të individëve dhe grupeve të ndryshme të shoqërisë, përjetojnë një proces të shpejtë ç'ekulibrimi dhe shpërbërjeje. Por, njëkohësisht, nuk mungojnë rastet e konsolidimit të vlerave ekzistuese për shkak të pasigurisë që shkakton braktisja e tyre.

Meunier & Peraya (2009:274) këtë dualitet e shikojnë në logjikën normale të funksionimit të çdo individi apo grupi shoqëror, të cilët e ndërtojnë kohezionin e veçantë ndërmjet tyre me anë të përjashtimit të grupeve të tjera të konsideruara "të huaja". Ata shfaqin dëshirën për t'u socializuar, për të qenë pjesëmarrës në të njëjtat veprime, për t'i përkatur të njëjtit grup dhe në të njëjtën kohë, u lind nevoja për t'u diferencuar, diskriminuar dhe përjashtuar. Përjashtimi në këtë rast shfaqet në nivele të ndryshme që variojnë nga dhuna fizike (përjashtimi fizik i tjetrit) deri tek nuancat e holla – të sjelljes, gjuhës etj, ndërsa kohezionin si mënyrë e të bërit njëshë e unit të tij me atë të grupit. Për aspektin e fundit autorët në fjalë shpehen: "Njeriu si individ kërkon që të bëjë njëshë unë e tij me vetveten – ky është narcizizmi, unë e tij me tjetrin në çift – ky është narcizizmi i çiftit, unë e tij me të tjerët në grup – ky është narcizizmi i grupit." (po aty) Në këtë dinamik, stofi shoqëror fragmentarizohet në komunitete të kundërta.

Edgar Morin (1977) mbron tezën se çdo sistem është një *unitas multiplex* në të njëjtën kohë, një raport mes njëjësit dhe shumësit, tërësisë dhe llojeve, sipas kulturave dhe momenteve historike. Ky raport, nëse do të huazonim shprehjen e filozofit postmodern Jascues Derrida në shumë raste shërben për krijimin e identitetit të gjithkujt. Me specifikisht, autori shprehet "Identiteti i secilit ndërtohet nga diçka e ndryshme prej tij, sikurse është identiteti i tjetrit."

Natyrisht, komunikimi i përshkruan efektet e tyre në këto lëvizje dhe njëkohësisht ndihmon ose pengon ndërveprimin ndërmjet tyre në pranimin ose refuzimin e identiteteve që ata përfaqësojnë. Martin & Nakayama (2010:108) argumenojnë se këto identitete shfaqen në momentin kur mesazhet e komunikimit, shkëmbehen midis personave, dhe ata me vullnet të lirë zgjedhin të negociojnë, bashkëkrijojnë, përforcojnë ose të sfidohen përmes komunikimit. Komunikimi për ta merr një vlerë thelbësore në prezantimin e identiteteve dhe njëkohësisht në krijimin e identiteteve të reja. I të njëjtit mendim është Stefano Zecchimi, i cili thotë: "Komunikimi është gjithnjë zanafilla e identitetit të një shoqërie, është shprehje e një dallimi. Të kuptuarit e këtij komunikimi bën të mundur njohjen e veçorive të shoqërisë që e përdor atë." (2006:9) Jo pa qëllim Wright Mills (1969) theksonte "midis ndergjegjes dhe ekzistencës qëndron komunikimi që ndikon në mënyrën me të cilën njerëzit ndërjegjësohen në lidhje me ekzistencën e tyre."

Përpjekja për t'u përshtatur me veçoritë e secilit gjatë përcjelljes së

mesazheve dhe në të njëjtën kohë, interesi për t'u diferencuar për shkak të ruajtjes së identitetit, bëhen procese normale të komunikimit. Ky proces herë pas here nxjerr në pah mungesën e dëshirës për ta vendosur veten në pozicionin e të tjerëve, me qëllim kuptimin e pikëpamjeve të tyre në fazën finale të formulimit të mesazhit, pasi ekziston bindja se nuk është e nevojshme. Mirëpo, për Jean Piaget në rastet kur mungon ky vullnet, fillojnë të shfaqen probleme me kuptimin e mesazhit dhe nuk mungojnë prirjet përjashtuese dhe marginalizuese ndaj të tjerëve. Ky paralajmërim i Piaget mbështetet edhe nga arsyetimet e bëra nga David Morley dhe më vonë Stuart Hall. Sipas autorëve të sapopërmendur problemi lidhet me vetë kuptimin e mesazhit, i cili nuk varet vetëm nga përmbajtja në vetvete e mesazhit por më shumë nga shkalla e interpretimit të tij dhe kjo e fundit kushtëzohet nga traditat që qëndron pas tij. Mos njohja e kësaj tradite në shumë raste krijon keqkuptime në fazën e dëshifrimit të mesazhit.

Qeniet njerëzore veprojnë ndaj sendeve mbi bazën e kuptimeve që këto sende kanë për to. " Sendet mund të jenë objekte fizike, si guri , tryeza, (një universitet, ndërmarrje, qeveri) ideale, veprimtari të tjetërkujt (urdhra, bindje), etj. (Blumer,1969) Në këtë prespektivë semantike, shprehet bindja se shumica e fjalëve – simbol nuk kanë lidhje ngjashmërie me objektin që ata përfaqësojnë. Erik From (1998:11) shkruan:" Ç'lidhje ekziston midis fjalës "tryezë" dhe objektit "tryezë"? A ka ndonjë marrëdhënie mes njëra - tjetrës? Sigurisht që jo, përgjigjet autori. Shkaku i vetëm që kjo fjalë simbolizon këtë objekt, është për faktin se është pranuar në komunitet si pasojë e një harku kohor socializimi, që ky objekt i veçantë të quhet me këtë emër të veçantë. Ky konvencion na ngulitet, që kur jemi fëmijë, përmes pervojës së përsëritur të dëgjimit të kësaj fjale për të treguar këtë objekt. Simbole të tilla shpesh etiketohen si simbole konvencionale. Prandaj, të komunikosh nuk do të thotë vetëm të prodhosh informacion dhe ta shpërndash atë, por nënkupton gjithashtu të jesh i vemëndshëm ndaj kushteve në të cilat mesazhmarrësi e merr, e pranon e kundërshton, e rimodelon në funksion të horizontit të vet kulturor, politik, filozofik dhe i përgjigjet nga ana e tij. Në këtë rast, urat e komunikimit konsolidohen brenda anëtarëve që ndajnë të njëjtat kode komunikimi dhe përjashtohen të tjerët e ndryshëm nga ata. Anëtarët e grupi "saldojnë" unitetin e tyre duke krijuar një entitet në të cilin çdo anëtar njihet dhe me të cilin identifikohet, në të njëjtën kohë dobëson ndjeshëm lidhjet me anëtarët e tjerë të ndryshëm nga ata.

Kështu thelbësore për të kuptuar një veprim njerëzor nuk është ta shpjegosh me faktor sociologjik të jashtëm (gjendja shoqërore ose të tjerë) ose me faktor psikologjik të brendshëm (prirje, nxitje, qëndrim etj), por ta lidhësh

me kuptimet e vecanta që kanë për aktorin aspektet e ndryshme të mjedisit të tij me të cilat ai ndërvepron. Pastaj, kuptimet vijnë nga ndërveprimi i qënieve njerëzore ndërmjet tyre. (Blumer, 1969). Për Herbert Mead një shenjë ka një kuptim kur ai që e përdor vihet në vendin e atij që i jepet shenja. Në këtë kuptim, të përdorësh simbole do të thotë të brendësosh procesin e ndërveprimit social dhe të mundësosh kështu zotërimin e shpalosjes së këtij procesi.

Ndërveprimitarizmi simbolik i përfaqësuar nga Cooley, Mead dhe Blumer, me konceptin e tyre të kuptimit, u kundërvihen dy teorive të përhapura: “realizmit”, sipas të cilit kuptimet janë të qenësishme e të pandara nga objektet (një karrige është një karrige në vetvete, pa qenë nevoja për asnjë proces formimi të kuptimit) dhe “psikologjizmit”, sipas të cilit kuptimet janë shtojca psikike ndaj objekteve (këto shotjca mund të jenë, për shembull, ndijime, ndjenja, etj). “Për ndërveprimitarizmin simbolik, kuptimet nuk janë as produkte të sendeve, as produkte të personave, por produkte social. Kuptimi i një sendit për një person lind nga mënyra me të cilat personat e tjerë veprojnë ndaj personin në lidhje me atë send” (Valade & Fillieule, 2008:421)

Kuptimet, nuk janë dhënë automatikisht e njëherë e mirë. Përdorimi i tyre kërkon cdo herë nga personi që vepron një proces interpretimi. Ky proces është komunikimi me vetveten gjatë të cilit kuptimet bëhen, zhbëhen, shndërrohen në funksion të situatave në të cilat gjendet personi. “Një yll nuk është e njëjta gjë për astronomin që e vëzhgon, për poetin të cilin e frymëzon, për lundërtarin për të cilin shërben si udhërrëfyes etj. (Valade & Fillieule, 421)

Dukuritë që lidhen me fushën kulturore (normat, vlerat, zakonet dhe tradita, etj) dhe ato që lidhen me lëmin strukturor (pozitat sociale, rolet, autoriteti etj) janë si të thuash produkte të prejardhura nga ndërveprimi. Sipas Blumer-it është ndërveprimi simbolik ai që lind kulturën dhe strukturën dhe jo kultura e struktura ato që lindin ndërveprimin simbolik. Pra, është ky i fundit ai që qëndron më lart mbi gjithcka tjetër dhe pikërisht komunikimi i shënjon ato.

Jo pa arsy, Paolo Alto (1951) e konsideronte komunikimin “matrica e të gjitha veprimtarive njerëzore” dhe ku gjuha si një nga elementët përbërës të tij, merr një rëndësi parësore. Fal tij, njerëzit arrijnë t’u transmetojnë kuptime të caktuara personave të përfshirë në komunikim, ndërsa këta të fundit kanë mundësi ta interpretojnë atë dhe ta orientojnë përgjigjen e tyre, bazuar mbi këto interpretime. Në të njëjtën linjë George Ritzer shprehet: “Kuptimet dhe simbolet i japin karakteristika të dallueshme veprimit shoqëror (i cili përmban një aktor të vetëm) dhe ndërveprimit shoqërorë (i cili përmban dy ose më shumë aktorë të përfshirë në veprime reciproke social)”. (2009:371)

Ekzistenca e kësaj bote ndërsujektive supozon një marrëdhënie

komunikimi në trajtën e simboleve të përbashkëta (për shembull, shenjave të gjuhës). Këto simbole përbëjnë një rrjet interpretimesh që secili e trashëgon nga shoqëria dhe nga grupi social të cilit i përket. Kur, për shembull, “shohim një person që përshëndet një tjetër, vetëm fakti i cilësimit si “përshëndetje” të këtij veprimi nënkupton se tanimë e kemi interpretuar. Fjalët dhe shprehjet e gjuhës janë një rezervuar kontekstesh interpretimi për tipa të ndryshëm veprimesh, dëshmitarë të të cilave jemi gjatë rrjedhës së jetës sonë të përditshme.” (Mead, 2001:235)

Në këtë mënyrë realiteti social ndërtohet prej interpretimesh të kryera nga aktorët socialë që janë të angazhuar. Jo vetë caq, por që ndajnë kuptimet të njëjta interpretative për simbolikën e shprehur gjatë procesit të ndërveprimit.

Te ne, shumë nënkultura që dikur zhvilloheshin në krahina dhe zona relativisht të ndara dhe të veçuara, tani, si pasojë e migrimit të brendshëm janë vendosur në të njëjtat hapësira urbane. Por duhet saktësuar se hapësira e përbashkët fizike nuk nënkupton njësimin e zakoneve, traditave, besimeve, mënyrave të sjelljesh që ata mbartin nga e shkuara e tyre. Ardhja nga zona të mbyllura shoqërore me norma morale apo kode të fiksuara, u minimizon aftësinë për të përceptuar një botë tjetër, të ndryshme nga ajo që kanë parë. Sapo dalim për arsye nga më të ndryshëm jashtë këtij realiteti dhe ballafaqohen me situata të panjohura, ata mbyllën brenda vetes dhe humbasin lidhjet me realitetin e jashtëm duke jetuar me të shkuarën. Sigurisht, nuk përjashtohet mundësia që të kofirmohen kuptime dhe linja të reja kuptimi. Kjo sjellje, lidhet me problematikat që shfaqen nga komunikimi gjatë proceseve socializuese. Është komunikimi që kushtëzon aftësinë e përshtatjes në proceset ndërvepruese dhe më specifikisht, keqkuptimi ose mungesa e kodeve të duhura.

Pamundësia e kuptimit të kodeve të panjohura më parë ose keqkuptimi i tyre lidhet thjeshtë me një vështirësi të tipit organikë ku “dhënësi” ashtu edhe “marrësi” e kanë të pamundur të dëshifrojnë kuptimin e mesazhit të tyre ose të njohin kode të reja. Por, tek fakti se ata nuk i kuptojnë kodet me anë të cilave transmetohen mesazhet ose nuk zotërojnë kodet e përshtatshme për të dhënë mesazhet e tyre. Mendimi nuk arrin të formulohet qartë pasi i mungojnë fjalët autentike shprehëse. Në këtë rast, Fuga në mënyrë të figurshme shpehet se ndodhemi në një situatë kur “mendimi vuan”. Ai përpiqet të gjejë atë që i duhet, mëmërit, por mbetet i paplotë me të meta dhe zbrazëti gjuhësore, sepse gjetja e fjalës që i korrespondon nuk është diçka e lehtë. Mesazhi nuk arrin të shprehet i plotë, pasi “burimi”, sikurse “marrësit” e tij, nuk zotërojnë atë sistem të kodifikuar shenjash që do të lejonte përmbajtjen semantike të tij të shprehej lirshëm dhe në mënyrë të shpenguar.”(2010:158) E gjitha kjo, influencohet nga

ajo që me të drejtë nënvizohet nga Piere Boudrie (2008:82), trashëgimi kulturore. Është ky komponent që i ka pajisur ato me një seri skemash të brendësuar, të cilat ndikojnë në shkallën e perceptimit, kuptimit, dhe vlerësimit të botës shoqërore të përcjell nëpërmjet komunikimit. Në shumicën e rasteve ato janë viktimat të këtyre skemave.

Në këto kushte, individit apo grupe të caktuar rrezikojnë të kthehen në njësi të mbyllura brenda vetes, pa komunikim real e të vërtetë me të tjerët. Pra, të shndërrohet në njësi të izoluar që janë në kontakt vetëm me veten, brenda botës së tyre. (Fuga, 2010:276) Në nivel individual vetja vihet në qendër, e kuptuar sipas egos së vetë personit, dhe prej këtej bëhen përpjekje për ta paraqitur atë tek njerëzit e tjerë apo për të ndërtuar një tablo përshkrimore mbi botën që na rrethon duke u nisur nga vetja apo duke vënë veten në qendër të saj. Nuk bën përpjekje që veten ta njoh nëpërmjet tjetrit siç na sugjerojnë përfaqësuesit e ndërveprimit simbolik. (Cooley. Mead, Blumer). Në këtë mënyrë, njeriu, duke dashur të njohë veten pa asnjë ndërmjetës tjetër, krijon një përfytyrim shumë të idealizuar për personalitetin e tij pasi vendos veten në qendër të botës. Nuk përjashtohen rastet që një psikozë e tillë të manifestohet edhe në nivel grupi.

Per Jurgen Ruesch, nga mënyra sesi perceptohet “tjetri” variojnë format e sjelljeve devijante. Autori mbron mendimin se “rrjeti i komunikimit përcakton universin tonë psikiatrik.” (1998:16) Shpesh here shtohen simptomat e ç'rregullimeve psikopatologjike shkaktohen nga deformimet dhe mangësitë në funksionimin e sistemit të komunikimit, gjatë trasmetimit të mesazheve në tre nivele: atë të komunikimit të individit me veten, me të tjerë si dhe midis grupeve të gjëra shoqërore. Është pikërisht, infrastruktura e lidhjeve që krijohet përgjatë trasmetimit të mesazheve që ndryshe emërtohet “matrica shoqërore e komunikimit” e cila shërben për të gjetur edhe rrënjët më të thella të dukurive dhe të ç'rregullimeve psikopatologjike që nxisin, mbajnë gjallë një pjesë jo të vogël të sjelljeve devijante.

Njerëzit e prekur nga simptoma të tilla shprehin autori gjatë komunikimit nuk dialogojnë me tjetrin por sikur flasin vetëm me veten e tyre dhe humbasin kështu atë që psikoterapistët e quajnë aftësi vetëkorrigjuese. Si të thuash ata mbyllën brenda vetes dhe humbasin lidhjet me realitetin e jashtëm. Pikërisht të ndodhur në këtë situatë fillojnë të lindin personalitete paranojake të cilët dëshirojnë në thelb të shkojnë vetëm fjala e tyre. Ata nuk marrin parasysh asnjë mendim tjetër alternativë në diskutimin shoqëror, kërkojnë me çdo kusht t'u imponohen të tjerëve dhe të urdhërojnë në mënyrë autoritare në familje, shkollë etj. Sapo hasin një kundërshtim të vogël një individ i tillë ka prirje për t'u nxehur, grindur, konfliktuar.

Duke e lidhur me kontekstin shqiptare, mund të shprehemi se individë apo grupe sociale të vendosura në qendrat e mëdha urbane jo rrallë herë mbyllën brenda simboleve konvencionale. Ardhja nga rrethe të mbyllura shoqërore me norma morale apo kode të fiksuara, u minimizon aftësinë për të përceptuar një botë tjetër, të ndryshme nga ajo që kanë parë. Sapo dalim për arsye nga më të ndryshëm jashtë këtij realiteti dhe ballafaqohen me situata të panjohura, ata mbyllën brenda vetes dhe humbasin lidhjet me realitetin e jashtëm duke jetuar me te shkuarën.

Ata, pavarësisht dëshirës për t'u socializuar, për të qenë pjesëmarrës në të njëjtat veprime, për t'i përkitur të njëjtit grup u lind nevoja për t'u diferencuar, diskriminuar dhe përjashtuar për shkak të komunikimit. Në këto rrethana konflikti shoqëror jo vetëm që nuk zbehet, por përkundrazi, marrin forma të reja që vazhdojnë edhe në kohën kur ndarjet e dikurshme shoqërore kanë humbur terrenin e mëparshëm. Konfliktet e reja shoqërore zhvillohen tashmë në një shoqëri bashkëveprimi, dallimesh dhe komunikimi. Dhe një nga komponentë e rëndësishëm që e prodhon atë është komunikimi.

Sic duket vlerat apo kriteret me të cilat njeriu përpigjet ta njoh veten, ta shoh veten si në pasqyrë, përpara se të jenë norma botëkuptimi, janë fjalë të një gjuhe të caktuar dhe kanë kuptim vetëm në kuadrin e përmbajtjes së tyre gjuhësore. Këto fjalë, përmbajtjen e tyre kuptimore si dhe mënyrat e përdorimit të tyre nuk i përcakton asnjë individ i marrë në vecanti dhe në vetminë e tij intime. Ato janë produkte shoqërore të krijuara gjatë një procesi të gjatë socializimi që kërkon kohë të ndryshojë.

Bibliografia

- Baterson, G. & Ruech, J. 1998. Communication et Societe. Seul.
 Blumer, G. Herbert. 1969. Symbolic Interactionism, London: Routledge
 Bourdieu, Piere. 2008. ON TELEVISION (Perkth. Budina, Belina.) Polis.
 Nr.8, Tirane: UET PRESS
 Dervishi, Zyhdi. 2008. Lente te nderveprimit simbolik.Tirane:EMAL
 Fuga, Artan. 2010. Mnolog, Tirane:DUDAJ
 Fuga, Artan. 2007. Rrota e Mundimit, Tirane:DUDAJ
 Fuga, Artan. 2000. Shoqeria periferike. Tirane:ORA

Martin, J. N., and T. K. Nakayama. *Intercultural Communication in Contexts*. 5th ed. Boston: McGraw-Hill, 2010.

Meunier, J. & Peraya, D. 2009. *Hyrje ne Teorine e Komunikimit*. Tirane: UET PRESS

Mead, H. George, 2001. *Mendja, Vetja dhe Shoqeria*, Tirane: TOEMA

Hall, Stuart. 1996. *Critical Dialogues in Cultural Studies*, London: Routledge.

James, W. Carey. 1992. *Communication as Culture. Essay on Media and Society*. London: Routledge.

George Herbert Mead, *Mendja Qenia dhe Shoqeria*, Tirane: Prishtine, 2001

Karaguni, M & Dumani, B. 2009. *Zhvillimet ne Tirane: "Refleksion mbi disa sfida"*. Revista Demografike. ILAR

Karaguni, M & Dumani, B. 2005. *Tirana, Relievi Demo - ekonomik e Social*, Tirane,

Magner, Erick. 2010. *Sociologjia e Komunikimit dhe e Mediave*. Tirane: UET PRESS

Popullsia e Shqiperise, INSTAT, Tirane. 2006

Popullsia e Shqiperise, INSTAT, Tirane. 2005

Ritzer, G. & Goodman, D. 2009. *Teoria e Sociologjike*, Tirane: UFO PRESS

Valade, B. & Fillieule, R. 2008. *Hyrje ne Shkencat Shoqerore*. Prishtine:

DUKAGJINI

Zecchini, P. S. 2006. *Dizionario dei sinonimi della lingua Italiana*, stereotipa. University Oxford